

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**60**



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPERISE



**ENVER HOXHA**



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**VELLIMI**

**60**

**DHJETOR 1976 – SHKURT 1977**

SHTËPIA BOTUESE «NËNTORI»  
TIRANË, 1988

## **PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 60-TË**

Vëllimi i 60-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban shkrime të periudhës dhjetor 1976-shkurt 1977. Një pjesë prej tyre botahen për herë të parë.

Pas përfundimit të Kongresit të 7-të të Partisë udhëheqësi i saj shtonte problemin se si duhej punuar për zberthimin e vendimeve historike e të direktivave të tij. Kjo kërkonte një punë të menduar e të organizuar mirë në mbarë vendin. Siç theksohet në vëllim, një detyrë e tillë do të realizohej jo vetëm me përgatitjen e disa referateve, por edhe me një veprimtari të shumanshme të Partisë, nëpërmjet angazhimit të sa më shumë njerëzve kompetentë. Këta do të zberthenin politikisht dhe ideologjikisht problemet, duke i parë në gjerësinë dhe thellësinë e tyre, jo vetëm për kohën, por edhe për perspektivën. Autori kritikon disa dobësi në metodën e punës të aparateve të Partisë në këtë drejtim dhe jep porosi që ato t'i shmangen shtrimit të çështjeve në forma të përgjithshme, pa detyra konkrete, dhe ta ndihmojnë më shumë bazën. Gjithashtu u tërheq vëmendjen që të jenë më të zhđërvjellta, të sugjerojnë ç'probleme dalin në këtë kuadër dhe rrugëzgjidhje më të mira për to.

Studimi i çështjeve teorike, politike e teknike, të

shtruara në Kongresin e 7-të të Partisë, duhej lidhur me jetën, me detyrat konkrete. Për zbatimin me përgjegjësi të kërkeseve të kohës shoku Enver Hoxha orientonte: Jo të mbetemi në statistika e përqindje, por t'i bëhet një analizë marksiste-leniniste gjendjes së punëve në prizmin e kërkeseve të Kongresit dhe, duke pasqyruar thellë realitetin, të përcaktojmë masa konkrete. Me këtë rast, organeve të Partisë u sugjerohet të merrin më mirë me disa probleme, siç janë puna me masat, zhvillimi drejt i luftës së klasave, forcimi i disiplinës proletare, i unitetit Parti-popull, përballimi i rrithimit imperialisto-rezisionist etj.

Duke theksuar qëllimin e Partisë për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së popullit, shoku Enver Hoxha porosit forumet udhëheqëse t'u hapin horizonte masave për realizimin e detyrave ekonomike. Në disa diskutime e biseda ai ndalet në çështjet e planifikimit dhe të organizimit shkencor të punës. Për këtë jep mendime racionale lidhur me përqendrimin në disa probleme kryesore të planit të viti 1977, që t'u dilej përparrë vështirësive. Kjo bënte të nevojshme të njiheshin mirë situata, sukseset e dobësitë, të zbuloheshin shkaqet e të metave dhe të merreshin masa të shpejta e të frytshme për plotësimin e boshllëqeve. Në stadin e atëherëshëm përparrë punonjësve e kuadrove vihej detyrë: të gjenden e të zbatohen forma më elastike për shtimin e prodhimit, për qarkullimin dhe për shpërndarjen e mallrave. Në realizimin e këtij objektivi një rol i rëndësishëm u takonte ekonomistëve e specialistëve, qoftë të prodhimit, qoftë të dikastereve, të cilët, siç nënvi-

zohet në vëllim, të vihen më mirë në vendin që u takon dhe, duke i mbështetur studimet e tyre në politikën ekonomike të Partisë, të dalin me propozime e zgjidhje konkrete të problemeve.

Në disa materiale trajtohen çështje të rëndësishme të sektorit të bujqësisë. Autori nënvizon se janë të gjitha mundësítë për realizimin e planeve jo vetëm në drithërat e bukës, por edhe në bimët industriale, në pemëtari, në perime. Duke theksuar se të ardhurat e kooperativistëve shtohen nëpërmjet rrjitjes së prodhimit, ai vë në dukje se në kooperativat bujqësore kërkojnë një punë më e thellë shkencore, drejtim dhe kontroll më i mirë. Forcimi i kontrollit bëhej i domosdoshëm edhe sepse në praktikë vëreheshin kuptime jo të drejta dhe shkelje të ligjeve e të rregullave të vendosura lidhur me përdorimin e ndihmës që shteti u jep kooperativave në investime e mjete. Kërkesa e Partisë, siç është në vëllim, që kësaj ndihme ato t'i përgjigjen me shtimin e prodhimit dhe të të ardhurave. Ndërmjet të tjera, në këtë kuadër shtrohet edhe nevoja e një pune të kujdeshme për t'u bërë të qartë kooperativave rëndësinë dhe rrugët e krijimit e të shtimit të fondit të paprekshëm, si dhe domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë të tij. Shoku Enver Hoxha porosit, gjithashtu, se edhe ngritja e vlerës së ditës së punës në kooperativat e tipit të lartë duhet të vijë nga rritia e prodhimit. Dobësitë në normim, në kontroll, në cilësinë e punimeve, si dhe prirja për të ndarë më shumë të holla për ditë-punë e për të mbajtur më pak në fondin e akumulimit, dëmtojnë jo vetëm kooperativën dhe

shtetin, por edhe ndërgjegjen e kooperativistëve. Gji-thashtu thekson nevojën e përmirësimit të punës për përdorimin sa më drejt dhe me efikasitet të levave ekonomike, si tatimi, çmimi, tarifat, me qëllim që të nxitin realizimin e detyrave të planit, shtimin e prodhimit.

Krahas kujdesit për bujqësinë, në këtë libër spikat edhe interesimi i autorit për mbarëvajtjen e blegtorisë. Ai ndalet në çështjet e të ushqyerit të bagëtive, të përmirësimit racor, si dhe të tufëzimit të tyre, i cili kërkonte jo vetëm organizim e disiplinë të fortë, por edhe një punë më të madhe svaruese e bindëse me njerëzit.

Për realizimin me sukses të detyrave të mëdha të Kongresit të 7-të ishte e domosdoshme të sigurohej roli udhëheqës i organizatave-bazë të Partisë në të gjitha drejtimet. Gjallërimi i tyre dhe përsosja e punës për edukimin e komunistëve e të masave nga ana ideopolitike dhe tekniko-profesionale viheshin në rend të ditës. Në këtë kuadër shtrohen edhe detyra për edukimin ushtarak të njerëzve, për një disiplinë të ndërgjegjshme. Duke analizuar disa probleme në fushën e mbrojtjes, kujdes i kushtohet përgatitjes së të gjithë popullit të armatosur. Udhëheqësi i Partisë jep udhëzime të hollësishme për një bashkëpunim të planëzuar midis organizatave të Partisë të terrenit e të ushtrisë.

Në këtë vëllim tërhiqet vëmendja edhe për forcimin e vigjilencës revolucionare, për ndjekjen sistematike e me kujdes të zhvillimit të situatave në botë dhe nxirren konkluzione me rëndësi teorike dhe praktike. Një varg materialesh i përshkon ideja e rëndësishme se PPSH qëndron në pozita të palëkundshme në mbrojtje

të marksizëm-leninizmit. Duke zhvilluar tezën e luftës në të dy krahët, si kundër imperialistëve amerikanë, ashtu edhe socialimperialistëve sovjetikë dhe pasuesve të tyre, shoku Enver Hoxha shpreh kundërshtimin e vendosur të PPSH ndaj politikës oportuniste të udhëheqjes kineze që predikonte aleancën me imperialistët amerikanë dhe me çfarëdo klikë reakcionare për të luttuar socialimperializmin sovjetik. Në vëllim lexuesit gjejnë refleksione që i njojin me ecurinë e marrëdhënieve midis PPSH dhe PKK. Një analizë demaskuese i bën autori, midis të tjerash, «dekalogut» ballist të Mao Ce Dunit, në të cilin kanë gjetur shprehje strategjia dhe botëkuptimi i tij jomarksist, eklektik, që e quan Kinën në rrugë pa krye.

Vëllimi i 60-të i Veprave të shokut Enver Hoxha është një tjetër ndihmë për komunistët, kuadrot e mbartë masat e popullit, që i janë përveshur punës për të zbatuar vendimet historike të Kongresit të 9-të të Partisë. Materialet e tij do t'u shërbejnë jo vetëm për të pasuruar bagazhin ideopolitik, por edhe për t'i pasur udhërrëfyese për arritje të reja në të ardhmen.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



## **BAZA KA MUNDËSI T'I ZBËRTHEJË VETË DIREKTIVAT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**4 dhjetor 1976**

Sivjet kemi mbetur prapa me mbjelljen e grurit edhe për shkak të metodës burokratike të punës. Komitetet ekzekutive mbështeten më shumë në disa afate minimale e maksimale të vendosura njëherë dhe nuk bëjnë përpjekje të marrin mendimin e vlefshëm të agromëve në përshtatje me kushtet e veçanta të çdo viti. Edhe agronomët, nga ana e tyre, duhet të mbajnë më shumë përgjegjësi për punën. Ata, pasi ta shoshitin problemin nga të gjitha anët, duke pasur parasysh mundësitë e kushtet konkrete dhe duke i ballafaquar me eksperiencën që kanë, duhet të vrasin mendjen dhe të përcaktojnë për çdo vit afatet më të përshtatshme për mbjelljen e grurit dhe të mos mbështeten vetëm në ato që rekomandohen nga literatura, sepse, në kushtet e veçanta të zonës e të motit, mund të ndryshojnë edhe afatet. Vetëm pasi t'i përcaktojnë ato në mënyrë të

tillë, të marrin aprovim e të fillojnë nga puna. Konformizmi edhe për afatet e mbjelljes ka kultivuar te disa shokë fryshtë e justifikimit, si, fjala vjen, «nuk produham dot, pasi koha që na u rekomandua për mbjelljet ishte me shi», «mbollëm me vonesë dhe prandaj nuk e realizuam dot planin» etj. Këto lloj justifikimesh nuk duhen pranuar në asnje mënyrë. Nuk duhen pranuar as justifikime të tillë, si: «nuk mbollëm herët, se mos na rritej gruri shumë», kur, po këta që thonë kështu, e dinë mirë se edhe për këtë rast ka metoda për ta ngadalësuar rritjen e parakohshme të bimës. Defekti është se komiteti i Partisë nuk vë si duhet në lëvizje komitetin ekzekutiv, ky, nga ana e vet, seksionin dhe seksioni specialistët e bujqësisë.

Jo, shokë! Të japësh urdhra nga zyra, duke u nisur nga kushtet klimatike të vjetme, nuk është e pranueshme. Në qoftë se do që ta kryesh punën tamam, shko e shiko konkretisht kushtet atje në vend, ku do të mblitet. Të bëhet kujdes që të dëgjohen edhe shokët e bazës.

Lidhur me çështjen tjetër se çfarë problemesh do të marrin në analizë Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror, ne duhet të mendojmë më mirë. Byroja Politike duhet të marrë në shqyrtim probleme të rëndësishme, që t'u hapin horizont politik e ideologjik forumeve të Partisë dhe bazës, si dhe t'i japin shtytje përpëra zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Problemet duhen parë me kujdes, sepse na ka ndodhur që, megjithëse e kemi parashikuar, ndonjë prej tyre nuk e kemi analizuar, për arsyen se nuk e kemi parë

të nevojshme. Ne nuk duhet të analizojmë përsëri ato probleme që i kemi diskutuar një herë e për të cilat kemi marrë edhe vendime para një, dy ose tre vjetësh. Këto vendime e ruajnë dhe duhet ta ruajnë forcën e tyre, por kërkohet mobilizim për t'i vënë në jetë. Problemet, për të cilat kemi marrë më parë vendime, ne mund t'i shqyrtojmë përsëri për të parë se si janë zbatuar ato, për të bërë plotësimet e nevojshme dhe për t'i pasuruar më tej, pra, për t'i dhënë punës një shtytje të re përpara.

Edhe unë i ndjek rregullisht problemet që shqyrt ton Qeveria. Ato janë shumë dhe kanë një karakter më konkret, se kanë të bëjnë me atë se si u zbatua kjo apo ajo detyrë e Komitetit Qendror apo e vetë Qevcrisë. Ne këtu në Komitetin Qendror nuk merremi me çështje të tilla operative, siç bën Qeveria, sepse do të futeshim në kompetencat e të tjerve. Këtë praktikë e kemi kritikuar dhe po e kritikojmë edhe për bazën. Por edhe kjo duhet kuptuar drejt, sepse, kur shohim, për shembull, që në objekte shumë të rëndësishme, si në Fierzë, punët nuk na shkojnë mirë e kanë mbetur prapa, ne do të ndalemi te kjo, do të thërrcsim përgjegjësit e do t'u kërkojmë llogari, për të nxjerrë se kush e ka fajin dhe për ç'arsye jemi prapa. Në këto raste nuk duhet të pranojmë justifikime. Çështjet t'i shohim në të dyja anët, për të zbuluar cilat janë fajet e gabimet e organizatave të Partisë dhe cilat janë të organeve shtetërore.

Në trajtimin e problemeve forumet e Partisë duhet të ngrihen mbi nivelin e organeve të tjera e t'u

hapin atyre horizonte, sepse janë këto që kontrollojnë zbatimin e vendimeve të Kongresit dhe të vetë Komitetit Qendror të Partisë.

Menjëherë pas mbledhjeve, takimeve apo fjalimeve të shokëve të Partisë, duhet të caktohen detyra konkrete, të merren vendime dhe të mobilizohet masa për zbatimin e tyre deri në fund, ndryshe të parat mbeten diçka formale. Marrja e një vendimi ka rëndësi të madhe, ai nuk duhet të ketë as agitacion, as propagandë, por detyra të realizueshme, me afate të përcaktuara e me njerëzit ose organet që do të ndjekin zbatimin e këtyre detyrave.

Kam folur vazhdimisht për probleme që kanë prekupuar Partinë. Edhe në të ardhmen do të flas, ashtu siç do të flasin edhe shokët e tjerë. Në këtë drejtim mendoj se ka rëndësi që disa nga idetë e fjalimeve e të diskutimeve të mia e të shokëve të pasqyrohen edhe në vendime e detyra. Kështu që më pas mund të verifikohet se sa u vu në jetë ky ose ai vendim, kjo apo ajo detyrë dhe për një çështje të veçantë, për të cilën ka vendime, nuk ka nevojë të shihet gjithë fjalimi.

Kur diskutohet një problem, ai zërthehet së pari politikisht dhe ideologjisht, se nuk mjafton të thuhet vetëm që s'kemi bërë këtë ose s'kemi bërë atë. Krahas kësaj, siç thashë më lart, të nxirret patjetër edhe vendimi ose detyra përkatëse se ç'duhet të bëjmë. Në këtë drejtim nuk punohet kudo mirë. Kjo dobësi rrjedh edhe nga metoda e punës e aparateve të komiteteve të Partisë, të cilat, kur paraqitin një studim ose raport, janë mësuar t'i shtrojnë çështjet në forma të përgjith-

shme dhe pa detyra konkrete. Ndodh që lexon me dhjetëra faqe të një raporti, por zor se gjen aty ndonjë detyrë. Prandaj, shpesh, pas diskutimit të një problemi, është bërë zakon të thuhet: «Kemi raportin» apo «kemi studimin».

Shumë shokë nuk kanë një ide të saktë për forcën, për nivelin e për pjekurinë politiko-ideologjike të Partisë sonë, për intelektin dhe vullnetin e anëtarëve të saj. Duke u nisur nga kjo, ata mendojnë se Partia, baza e saj, duhet ushqyer vazhdimi si me biberon. Për realitetin tonë të sotëm një pikëpamje e tillë nuk është e drejtë, sepse Partia, nëpërmjet materialeve të vazhdueshme, e ka njojur bazën me të gjitha problemet. Njerëzit tanë, po t'u shtrosh një problem apo t'u japësh një direktivë, janë në gjendje t'i zbërthejnë ato dhe të ecin sipas tyre, për t'i vënë në jetë. Në këtë drejtim baza edhe duhet ndihmuar, po këtu ka rëndësi të kemi parasysh dy gjëra:

**E para**, të mos e ngarkojmë shumë bazën duke e ushqyer gjithnjë nga lart, por t'i lëmë asaj mundësi t'i zbërthejë e t'i përpunojë vetë më tej direktivat e dhëna.

**E dyta**, që është mjaft e rrezikshme: Partia në bazë nuk duhet të ushqehet me citate të thata ose me sloganë enigmatike, siç ngjet në Kinë, ku flitet me shprehje të tillë abstrakte si «tri të mirat», «katër të këqijat», «pesë mesataret» etj. Shumë nga këto sloganë as që kuptohen fare nga masat, por atyre vetëm sa u thuhet se këto janë maocedunide. Një gjë e tillë duhet pasur mirë parasysh, se udhëheqja vërtet do të dërgojë

direktiva e vendime në bazë, por unë, si sekretar, si kuadër, apo edhe si komunist, do t'ua shpjegoj ato mësime, do t'ua zbërthej politikisht e ideologjisht dhe, pastaj, së bashku, do t'i konkretizojmë me detyra, për t'i vënë në jetë.

Vlerësimi objektiv i aftësive të shokëve të bazës duhet pasur parasysh nga komitetet e Partisë të rretheve, sepse, aty-këtu, ka sekretarë të këtyre komiteve apo kuadro drejtues që mendojnë se janë «kërthiza» e rrethit, rreth së cilës vërtiten gjithë të tjera. Sigurisht, nuk mendojnë kështu tërë kuadrot, por në këtë drejtim duhet të kihet kujdes. Ta kemi të qartë se gjithë këtë punë të madhe e bëjnë Partia, masat e gjera të popullit, që tashmë janë të ngritura e të përgatitura nga çdo pikëpamje e, njëkohësisht, edhe të sakrificës. Prandaj na bie për detyrë t'i mësojmë njerëzit të dinë të punojnë me vendimet e direktivat, t'i zbërthejnë sa më mirë ato. Po ia arritëm kësaj, aq më shumë rezultate do të kemi, aq më shumë guxim do të kenë punonjësit për t'i kritikuar të metat dhe aq më pak burokratizëm do të vihet re. Kështu, te njerëzit tanë ngrihet edhe kuraja, rritet guximi, hiqen frika e ndrydhja. Kur me komunistët dhe kolektivin e një uzine shtrohet, fjala vjen, direktiva që të prodhojmë me forcën tonë pjesë ndërrimi, pajisje e makineri, punëtorët dhe inxhinierët mblidhen kokë më kokë, diskutojnë e vendosin t'i futen punës për të prodhuar këtë apo atë dhe ia arrijnë objektivit. Për të tillë punonjës mund të thuhet se janë njerëz me dinjitet e që kanë personalitetin e tyre.

Marksizëm-lininizmi është një thesar i madh. Çdo ditë ne përvetësojmë nga një «grimë» prej tij, por çshtë pikërisht kjo «grimë» që na hap horizonte të mëdha për punë, na thotë «ndal», kur nuk e kemi mirë, na inkurajon të ecim përpara, kur jemi në rrugë të drejtë.

Le të shohim ç'po bëhet në Partinë Komuniste të Kinës. Pse ndodhin atje këto që po dëgjojmë? Ndodhin për arsyen se Partia Komuniste e Kinës nuk ka pasur dhe nuk ka një bosht marksist-leninist, qoftë për problemet e brendshme, qoftë për ato të jashtmet. Mungesa e boshtit ideologjik marksist-leninist ka sjellë atje njërën çoroditje pas tjetrës dhe ka bërë si metodë të përhershme punën fraksioniste në radhët e kësaj partie. Ta kemi të qartë se fraksione mund të dalin (dhe dalin) edhe në një parti që ka një bosht të fuqishëm marksist-leninist. Por midis saj dhe Partisë Komuniste të Kinës, që nuk e ka këtë bosht, ekzistojnë ndryshime të mëdha.

Së pari, në një parti me bosht të fuqishëm marksist-leninist këto fraksione nuk janë të vazhdueshme, nuk e kanë jetën të gjatë.

Së dyti, këto fraksione në një parti të tillë nuk gjijnë mbështetje dhe shkatërrohen.

Së treti, kontradiktat joantagoniste kjo parti i zgjidh me mjetet e edukimit dhe të organizimit, kurse ata persona ose grupe personash që dalin kundër vijës dhë përpigen t'i shndërrojnë kontradiktat joantagoniste në kontradikta antagoniste, në diktaturën e proletariatit dënohen pa hezitim në bazë të ligjeve të saj.

Mungesa e një boshti ideologjik në Partinë Ko-

muniste të Kinës ka qenë karakteristike dhe e dëmshme jo vetëm në të kaluarën e kësaj partie, por është e tillë edhe në të tashmen e do të jetë e rrezikshme e shkataerrimtare edhe në të ardhmen. Kjo përfaktin se radhët e partisë shtohen vazhdimisht me elementë të rinj. Këta, kur vijnë në parti, nuk gjejnë aty një ambient të shëndoshë ideologjik e një qëndrim unik marksist-leninist përfshi problemet e jashtme dhe të brendshme. Përkundrazi, gjejnë lulëzimin e njëqind luleve, gjejnë edhe përkrahësit e vjetër të këtyre njëqind luleve. Logjika ta thotë që në këto kushte të mos ketë pikëpamje unike në parti përfshi gjitha problemet; komunistët do të janë të grupuar sipas influencave e interesave dhe të ndarë sipas pikëpamjeve të njëqind luleve. Dhe nuk duhet harruar se, kur themi një lule, në Kinë ajo përfshin 20-30 milionë veta. Pra, grupimi në fraksione i komunistëve, që militojnë në një parti që nuk ka bosht ideologjik marksist-leninist, është diçka objektive, e pashmangshme. Kështu, ekzistenca e fraksioneve nuk është rezultat i mungesës së rastit të vigjilencës, por një rrjedhim logjik përfshi balancimin e forcave në këtë lloj partie.

Në këto kushte lindin mendjemadhësia dhe prepotanca e njërit grup apo fraksioni ndaj një grupei ose fraksioni tjetër. Këto grupe mbështeten në maocedunidenë. Por edhe në bazën e luftës kundër njëri-tjetrit këto grupe përsëri kanë maocedunidenë. Kështu fillojnë konfliktet midis tyre, të cilat nuk kanë fund, ashtu siç nuk kanë fund fraksionet. Kjo është logjika e mungesës së një boshti ideologjik shkencor në parti.

Maoja ka drejtuar në Partinë Komuniste të Kinës jo në bazë të marksizëm-leninizmit, por në bazë të kundërpeshës fraksioniste, ai ka luajtur atje rolin e vet si centrist.

Ja, për shembull, të marrim gjithë këta që u likuiduan në Kinë. Ta zëmë se Lin Biaoja ose ata të katër, që u spastruan pas vdekjes së Maos, kanë qenë në pozita majtiste. Ata duhet ta kishin kuptuar se Kina nuk mund të ecë pa një bosht të fortë ideologjik marksist-leninist. Këtij grapi të majtë, për të luftuar të djath-tët, mundet që iu desh të mbështetej në fillim te mao-cedunideja, tek «timonieri i madh». Maoja e ka pasë kuptuar lindjen e këtij grapi dhe e përkrahu, jo për ta lënë që të dilte në krye të situatës, por për t'u thënë atyre të grupit të djathët: «Ja, unë kam në krahun tim edhe këta, prandaj kini kujdes, mos më bëni shumë naze». Kjo qe dhe arsyaja që Maoja nuk i la të majtët ta vazhdonin deri në fund Revolucionin Kulturor.

Nga ana e vet pjesëtarët e këtij grapi i hynë punës për të çuar deri në fund shkatërrimin e borgjezisë në parti, për të likuiduar të djathët, dhe në këtë drejtim morën edhe masa. Maoja ndiqte situatat dhe, kur pa se po kalohej masa që kishte caktuar ai, e ndaloi thellimin e Revolucionit Kulturor. Më vonë, për të rregulluar bilancin që u prish, bashkë me Çu En Lain, prunë përsëri në udhëheqje Ten Hsiao Pinin dhe, të dy bashkë, filluan të përkrahnin elementët e grupit të djathët. U rehabilituan shumë kuadro që qenë dënuar gjatë Revolucionit Kulturor, në qendër dhe në bazë. Kështu që kohët e fundit Maoja punoi për forcimin e grupit të

djathtë, i cili, pas vdekjes së tij, siç e dimë, mori fuqinë dhe u hodh në masa të egra kundër grupit tjetër.

Elementët e grupit që mori fuqinë në Kinë tanë i njohim mirë. Ata janë njerëz të ligj. Hua Kuo Feni është një forcë e ndërmjetme, tranzitore, kompromisi. Megjithatë, ai po bën përpjekje për të fituar simpatinë e fraksionistëve të djathtë. Për të térhequr në anën e vet pasuesit e Çu En Lait, ai ngriti gruan e këtij si zëvendëspresidente të Asamblesë Kombëtare Popullore. Kjo masë është njëkohësisht një afrim edhe me Tenin. Teni është pjesëtar i fraksionit të vjetër të Liu Shao Çisë. Ai me siguri që nuk do të pranojë çfarëdo lloj vendi që do t'i ofrohet në parti apo në shtet. Hua Kuo Feni e di shumë mirë që Ten Hsiao Pini ka pasues të shumtë në parti dhe në ushtri, prandaj është duke e afruar atë në Pekin e do ta ngrejë edhe në pozitë, pas ndonjë autokritike të përciptë që mund të bëjë ky i fundit. Ai mendon se për këtë duhet të kalojë edhe ca kohë. Por, siç duket, Teni është njeri i tillë që nuk bën autokritikë. Pra, është logjike që një parti që s'ka bosht ideologjik marksist-leninist të arrijë gjithë këtë çoroditje.

Ne marksistë-leninistët shqiptarë mendojmë se, për të fituar marksizëm-leninizmi në Kinë, është e domosdoshme që revolucionarët e vërtetë kinezë të hedhin poshtë maocedunidenë, flamurin e «timonierit të madh», dhe të marrin në duart e tyre e të ngrenë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Kjo jo vetëm sepse është absolutisht e domosdoshme për një parti marksiste-

-leniniste, por edhe për faktin se maocedunizmi tashmë e ka treguar veten si një teori centriste, që mund ta mbajë e ta përdorë në çdo kohë edhe njëra, edhe tjetra palë.

Në Kinë njerëzit mësohen në parti me legjenda dhe jo me marksizëm-léninizmin. Tregimi për plakun Jui Gun që «lëvizi malet» bën aluzion për vetë Mao Ce Dunin. Ky merrej me vjersha, të cilat konsideroheshin si filozofia e tij, ndërsa populli kinez as që i kuptonte dhe bota tallej me to. Një parti që e mban veten për parti komuniste dhe një udhëheqës që hiqet si marksist-léninist, përsë merren me përralla, me legjenda e vjersha dhe nuk kujdesen të përpilojnë, fjala vjen, historinë e Partisë Komuniste të Kinës?! Atje u bë një revolucion, një luftë çlirimtare, u luftua kundër japo-nezëve e u mund Çan Kai Shia. Atëherë, të gjitha këto ngjarje të mëdha duhen shkruar. Mirëpo, të bësh një histori, bota apo kushdo që do ta lexojë, do të gjykojë mbi të, sepse aty do të dalë qartë se ç'ishin këto fraksione, ç'ishte Lin Biaoja, Liu Shao Çia, «katërshtja» etj., etj. Me sa duket, kinezët nuk e bëjnë këtë histori, se janë të vetëdijshëm që kjo histori e këto ngjarje, konkretisht, nuk janë zhvilluar në bazë të marksizëm-léninizmit, kështu që do t'i dilte boja edhe historisë që do të shkruhej. Prandaj preferuan më mirë të mos shkruhej fare dhe në vend të saj të tregoheshin legjenda e përralla, me të cilat historia nuk ka asgjë të përbashkët.

Shumë gjëra ne i kemi thënë për revisionistët sovjeticë. Por ka shumë të tjera që nuk i kemi thënë për

Partinë Komuniste të Kinës dhe që nuk do t'i themi akoma edhe për një kohë. Për ne shqiptarët nuk ka asgjë të paqartë. Është e vërtetë se Partia jonë nuk ka folur publikisht kundër udhëheqjes kineze, por vijën e saj ajo e ka thënë gjithnjë qartë, gjë që i ka ngritur politikisht dhe ideologjikisht kuadrot dhe komunistët tanë, të cilët, në bazë të kësaj vije të drejtë, të kësaj ngritjeje, janë në gjendje të kuptojnë qëndrimet parimore të Partisë sonë dhe i miratojnë ato. Një nuhatje e tillë politike ndodh vetëm në Partinë tonë, me komunistët dhe me popullin tonë, për arsyen se ata ushqehen çdo ditë nga Partia me materialet e saj. Se te ne nuk ka probleme të rëndësishme politike e ideologjike, për të cilat të mos vihen në dijeni komunistët dhe masat, ose që të mos u kërkohet edhe atyre mëndimi që kanë përkëtë apo atë çështje.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

# **PROBLEMET STUDIOHEN E ZGJIDHEN ME MASA TË KOORDINUARA**

**Shënimë**

**6 dhjetor 1976**

Bisedova me shokët sekretarë për zhvillimin e punës së Partisë e për koordinimin dhe lidhjen e kësaj pune me jetën dhe me gjithë sektorët e saj.

Kam përshtypjen se kjo nuk bëhet si duhet, me gjithëse punën drejtuese, si në qendër edhe në komitetet e Partisë në rrethe, e kemi ndërtuar në mënyrë të tillë që kjo të realizohet. Si në Komitetin Qendror edhe në rrethe, instruktorët, në parim, janë të ndarë me zona, por mblidhen tok, shkëmbejnë eksperiencë, formojnë komisione të përbashkëta dhe shkojnë për kontroll dhe ndihmë. Por shumë herë, në praktikë, nuk ruhet ky unitet në veprim, por zbatohet sipas ndarjes së punës së sekretarëve të komiteteve të Partisë. Instruktorët thonë se interesohen për çdo gjë, por, më të shumtë e herës, intresohen për sektorin e tyre.

Më konkretisht u thashë shokëve sekretarë se në Vlorë kanë ndodhur disa avari në naftë. Komiteti i Partisë i këtij rrjeti nuk ishte në dijeni për të gjitha këto

dhe mori në shqyrtim dy a tre prej tyre. Por në ç'më-nyrë i mori në shqyrtim? Dërgoi sekretarin që merret me ekonominë dhe ai erdhi raportoi në udhëheqje të Partisë të rrethit si njeri i pushtetit.

Por këto avari ndodhën se organizatat-bazë të Partisë në këto puse nuk po punojnë mirë, se ka dobësi në punën organizative e ideologjike, nuk kuptohen problemet politikisht e njerëzit nuk ngrihen si duhet teknikisht etj. Me fjalë të tjera, është një grumbull problemosh që duhen studiuar së bashku dhe për të gjitha duhen marrë masa të koordinuara.

Shokët më thanë se kjo punë nuk po bëhet si duhet dhe ka të meta serioze në këtë drejtim. Atëherë, u thashë, pse nuk merrni masa të përmirësoni ndihmën dhe kontrollin? Atyre u vura në dukje edhe çështjen e kontrollit punëtor që konstatoj se ka rënë. U bë bujë, u shtrua ky problem, u gjend i drejtë, po pastaj u la. Vazdohet me punën burokratike të aparateve; as detyrat e vendimet për këtë problem s'janë vënë në zbatim, sic është instruktimi nga shokët që njohin ligjet për të specializuar mijëra njerëz të popullit për kontroll. I porosita shokët që t'i ndjckin këto probleme.

*Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# KOMUNISTËT NË SEKTORIN E NAFTËS NUK JANE VETËM ZBATUES, POR EDHE VËZIIGUES E KËRKUES

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

10 dhjetor 1976

*Në fillim shoku Enver Hoxha u interesua për gjendjen e punëve në Qytetin Stalin. Ndër të tjera ai pyeti se si paraqitet grafiku i nxjerrjes së naftës nga puset, a ka pasur avari, sa diskutojnë kuadrot e specialistët për problemet që u dalin, sa lidhen ata me naftëtarët etj. Pasi u informua nga shoku Prokop Murra, që kishte qenë ato ditë në Qytetin Stalin, shoku Enver Hoxha tha:*

Këto gjëra ne i kemi kritikuar edhe herë të tjera që të mos rendet pas metrave. Ne kemi rekomanduar që problemi kryesor të jetë studimi i imët e komplet i terrenit dhe dhënia e pikës me përafërsi. Kurse këta shokët drejtues të sektorit të naftës, me sa duket, po përsëritin disa nga gabimet e mëparshme.

Për shpimet ata kanë bërë një debat të gjatë, kur zbuluan sabotimin e grupit armiqësor në sektorin e

naftës. Atje doli se ata, në vend që t'i jepnin me përgjegjësi pikat e shpimit, duke u mbështetur në të dhënat shkencore, konkrete, sipas shtresave etj., e drejttonin sondën në të kundërtën. Kështu kanë vepruar ata, ose, në vend që të arrinin metrazhin e caktuar, e ndërpritnin shpimin dhe nuk vinin deri aty ku duhej. Gjatë gjithë procesit të shpimit ata nuk studionin strukturën e përbërjes së tokës dhe shenjat që jepte ajo. Për të gjitha këto çështje edhe këtu në Byronë Politike janë bërë diskutime të gjata, derisa u vërtetua sabotimi. Tani këta njerëz kanë vënë mend apo jo? Këto studime, projektme e shpime bëhen në baza shkencore, apo nuk bëhen? Kjo prapambetje është objektive apo subjektive? Vjen nga mungesa e organizimit, nga mungesa e aparaturave apo nga mungesa e kuadrit? A vure re, shoku Prokop, nëse ka shqetësimi nga ana e komunistëve për tërë këto? Ata janë jo vetëm zbatues, por njëkohësisht edhe vëzhgues, kërkues dhe diskutues për këto probleme. Njerëzit e Partisë, jo vetëm inxhinieri, gjeologu apo tekniku i sondës, por edhe të gjithë punëtorët e tjerë, anëtarë dhe jo anëtarë partie, i gjithë kolektivi i pusit, hyjnë në diskutime apo nuk hyjnë? Këta shokë rrinë në zyrë. apo shkojnë nëpër rajone, nëpër puse, nëpër organizata partie? Natyrisht, ata nuk mund të qepen dhe të rrinë përditë atje, por, kur ngjasin këto gjëra dhe punët nuk shkojnë mirë, çfarë bëjnë?

Ju thatë se disa kuadrove drejtues nuk u bindeshin ndërmarrjet që kishin në varësi. Po si kërkon t'i binden ndërmarrjet atij që nuk e justifikon vendin e

punës? Sigurisht që nuk i shkon fort fjala, në qoftë se nuk është në krye të detyrës, nuk i kupton si duhet këto gjëra dhe është i quillët. «Përse të vemi tek ai, — thonë ato, — çfarë na ka thënë? A na ka kërkuar llogari? Na ka dhënë ndonjë ndihmë?» etj. Se nuk ka se si të kuptohet ndryshe shprehja e tij që «nuk më mbildhen dhe nuk më dëgjojnë». Nuk të dëgjojnë, po përse të të dëgjojnë?

Ju thatë se edhe ministria interesohej më tepër për tonët e naftës dhe për metrat e shpimit sesa për gjithë këto probleme që po trajtojmë.

Jemi lodhur duke ua thënë vazhdimisht se nuk duhet vepruar kështu!

Kam një material që më ka ardhur nga Këshilli i Ministrave. Nuk e di në të ka ardhur edhe ty, shoku Prokop, është për rishikimin e disa normave në planifikim, për kompetencat etj., etj. Por, sidoqoftë, ti duhet ta studiosh, për arsyen se ke edhe eksperiencën e rrethit. Shokët thonë se kanë pyetur edhe rrethet, të cilat kanë dhënë mendime të ndryshme. Prandaj studioje edhe ti se si janë bërë këto interpretime të kompetencave, si kanë kaluar këto fonde nga një zë në tjetrin, si janë tejkaluar normat e buxhetit etj., etj. Këtë formulim që kanë bërë ata, shikoje një çikë me sy kritik. Kur ta mbarosh, mund të më thuash edhe mua përvërejtjet që do të kesh.

Në parim çështja është këtu, mendoj unë, që rretheve nuk duhet t'ua lidhim duart krejtësisht. Ato duhet të kenë kompetenca, por jo siç i kanë pasur më parë, se edhe kanë abuzuar me to. Nuk duhet ta lejojmë

më një gjë të tillë. Kompetencat t'i reduktojmë në atë mënyrë që të nxitet prodhimi dhe të mos bëhen shpenzime joprodhuese. Shpenzimet joprodhuese të janë shumë të kufizuara. Por edhe shpenzimet prodhuese që do të lihen në kompetencë të komiteteve ekzekutive dhe të ndërmarrjeve, të janë sa më të arsyeshme dhe të përcaktuara saktë. Në qoftë se jepen për kullime ose për bonifikime, këto investime të venë në bonifikim, dhe jo me këtë fond të bëhen shtëpi kulture. Këtë duhet ta kemi të qartë.

Rëndësi ka që të jepen fonde aq sa është e nevojshme dhe jo të thotë nesër ai i komitetit ekzekutiv të rrëthit: «M'u dogj fondi». Po pse iu dogj? Atëherë, kur këtë fond nuk e përdori, por e la që t'i digjet, pse e kërkoi ai shok? Kjo tregon se ka vepruar sipas dëshirës dhe për këtë do t'i jepet më pak.

Të kemi, gjithashtu, kujdes se, në vend që të vëmë vetulla, mos nxjerrim sytë. Ne vërtet duhet t'i përbahemi parimit të centralizmit demokratik, por një-kohësisht të evitohet absolutisht centralizmi burokratik, domethënë, jo për çdo gjë të pyetet në Qeveri apo në ministri. Kjo varet edhe nga fakti se sa kompetenca u lihen shokëve të bazës. Në qoftë se grumbullohen në qendër më tepër kompetenca se ç'duhet, atëherë ministria ka rrezik të kthehet në një aparat burokratik, çdo gjë do të varet nga ajo. Kurse, kur lihet një marzh, është ndryshe puna. Atëherë, për të vendosur nëse ua japim ose nuk ua japim një gjë, duhet të vihet dhe të shikohet në vend për t'u bindur se ai që ka kërkuar këtë, ka apo s'ka arsyë. Pra, jo të nisemi nga fakti se,

meqenëse unë kam ligjin, nuk ta jap ty këtë apo atë, por të krijojmë bindje te njëri-tjetri se cila zgjidhje është më e leverdishme nga ana ekonomike.

Po pse i themi këto? I themi se na kanë ngjarë shumë gjëra. Shumë herë veprimet bëhen në mënyrë automatike: «Jo, nuk ka të drejtë, unë nuk t'i jap, se ashtu është ligji!» etj. Vërtet ligji mund të jetë që të mos jepet jashtë kësaj shume, por kjo çështje duhet studiuar, sepse mund të jetë shumë më e leverdishme që edhe të jepet sa kërkohet.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

## **KUSHTETUTA E RPSSII — VEPËR E MADHE E PARTISË DHE E POPULLIT**

*Fjala në mbledhjen e fundit të komisionit të posaçëm  
për hartimin e Projektkushtetutës së RPSSH*

**15 dhjetor 1976**

Shokë dhe shoqe,

Ne sot bëjmë mbledhjen e fundit të komisionit që zgjodhi Kuvendi Popullor për të drejtuar punimet e gjera dhe për t'i dhënë dorën e fundit Projektkushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror, siç është dini, u zhvillua një diskutim jashtëzakonisht i gjerë, i gjallë, revolucionar, në forma nga më demokratiket për pasurimin dhe përsaktësimin nga çdo pikëpamje, politike, ideologjike, organizative, juridike etj., të Ligjit Themeltar të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit. Projektkushtetutën së shpejti duhet t'ia paraqitim Kuvendit Popullor përmiratim.

Vetë diskutimi në popull, i zhvilluar me metodë

dhe stil pune nga më të efektshmit, po i jep vendit tonë socialist një kushtetutë nga më demokratiket, nga më të përshtatshmet, nga më revolucionaret, një kushtetutë që në çdo nen të saj është e frymëzuar nga idetë fitimitare të marksizëm-leninizmit, të Partisë sonë dhe nga realiteti ynë i gjallë i së tashmjes. Gjithë periudha e diskutimit të Projektkushtetutës u kthye në një shkollë të madhe teoriko-politike e morale, që u dha hov të paparë prodhimit, mendimit progresist dhe veprimit revolucionar të masave punonjëse, gjë që hapi perspektiva të shkëlqyera për ndërtimin e mëtejshëm të socializmit në vendin tonë.

Kjo vepër e madhe e Partisë, e klasës punëtore, e fshatarësë kooperativiste dhe e inteligjencies popullore është pasqyrë e shkëlqyer e vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, e pjekurisë së madhe politike dhe ideologjike të saj e të popullit. Ajo tregoi vitalitetin, guximin, vendosmërinë e tyre të pallëkundshme dhe konsekuencën për t'i çuar përpara fitoret e arritura në të gjitha frontet, për lulëzimin e begatinë e atdheut tonë socialist, për zhvillimin e kultrës dhe forcimin e mbrojtjes së tij.

E tërë kjo punë madhështore që u zhvillua, u kurorëzua me sukses në Kongresin e 7-të të Partisë, i cili, me një entuziazëm të papërshkruar, e vlerësoi lart njëzëri Projektkushtetutën që do t'i paraqitim Kuvendit Popullor.

Dëshiroj, gjithashtu, të theksoj se Projektkushtetuta jonë ka bërë një jehonë shumë të madhe pozitive në botë. Shtypi botëror e ka komentuar gjerësisht për-

mbajtjen e saj, gjë që e ka ngritur edhe më lart prestigjin e vendit tonë, ka bërë të njohur në një shkallë shumë të gjerë rëndësinë, thellësinë e mendimeve dhe cilësinë e lartë e të padiskutueshme shkencore të bredisë së neneve të Kushtetutës sonë. Shkencëtarë, juristë, sociologë, publicistë përparimtarë e të tjerë kanë shkruar dhe kanë folur në seanca shkencore të veçanta përfrymëzimin dhe drejtimet aq të qarta të këtij Ligji Themeltar të madh të një populli të vogël.

Në mbledhjen e parafundit të komisionit u bënë një sërë vërejtjesh plotësuese dhe saktësuese. Sekretari i komisionit, shoku Hekuran Isai, ka paraqitur një pasqyrë të këtyre amendamenteve, si dhe mënyrën e inkludimit të tyre në nenet përkatëse të Projektkushitetutës. Me aprovimin e tyre dhe në qoftë se nuk ka objeksione të tjera ose diskutime, detyra e komisionit merr fund, por jo ajo e kryetarit të komisionit<sup>1</sup>, i cili, duke u bazuar në vendimet e Kongresit të 7-të, të diskutimit popullor është punimeve të këtij komisioni, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe tuajin, duhet të përgatitë dhe t'i paraqitë raportin Kuvendit Popullor për diskutimin dhe miratimin e Kushtetutës së re të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë<sup>2</sup>.

Ka vërejtje për relacionin që ju është shpërndarë,

---

1. Kryetar i komisionit të posaçëm të Kuvendit Popullor për hartimin e Projektkushitetutës ishte caktuar shoku Enver Hoxha.

2. Shih në këtë vëllim, f. 136.

ka vërejtje për sa thashë dhe kush dëshiron të diskutojë?

Atëherë u japim fund punimeve të këtij komisioni dhe e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# AGJENTËT E KINËS PO I NXJERRIN VESIIËT

Shënimë

16 dhjetor 1976

Duke u bazuar në një përbledhje të shkurtër që ambasadori ynë në Paris i bëri letrës së krytarit të Partisë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste), E. Hillit, në Ditarin tim kam bërë disa shënime. Në përgjithësi këto u përgjigjen çështjeve që pasqyrohen në përkthimin e përbledhur që na dërgoi ambasadori.

Tash na ra në dorë gjithë materiali i dërguar prej Hillit. Ai shoqërohet me një letër të shkurtër drejtuar shokut Ramiz. Ky material prej 15 faqesh është shkruar me një stil konciz, me një ngjyrë gjoja teorike, me citate etj. dhe në një kohë rekord prej një dite, pas largimit të Hillit nga Tirana në Londër. Kjo të lë të dyshosh shumë se materiali duhet të jetë përgatitur prej tij ose prej ndokujt tjeter që më përpara, bile disa nga «tezat» e tij kryesore edhe përpara se Hilli të vinte në Kongresin tonë. Materialin, sa mbërriti Hilli në Londër, do ta ketë gjetur të gatshëm dhe, të nesërmën, e ka përcjellë menjëherë me gruan e tij në Paris për t'a dorëzuar ambasadorit tonë.

Qëllimet e autorit, të cilat i kam shprehur në këtë Ditar përpara se të na vinte teksti i plotë i materialit, pavarësisht se përkthimi ishte i dobët dhe ambasadori ynë na dërgoi vetëm një përbledhje të tij, janë të kuptueshme për ne. Tani, duke e lexuar tekstin e tij të plotë, del akoma më qartë se thelbi kryesor i pikëpamjeve të Hillit qëndron në atë që Partia e Punës e Shqipërisë nuk paska pasur të drejtë të shtronte pikëpamjet e veta në Kongresin e 7-të për sa i përket lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ai lë të kuptohet në material se nuk i përkiste Partisë së Punës të Shqipërisë ta bënte një gjë të tillë.

Hilli na shkruan se në raportin e Komitetit Qendror të Partisë sonë ne i bëjmë një analizë veprimtarisë së Kominternit, analizë që, sipas mendimit të tij, nuk qenka e drejtë. Lidhur me këtë çështje, jo pa qëllim, ai lë në heshtje atë që theksojmë ne në raport, se aty nuk kemi aspak për qëllim të bëjmë analizën e veprimtarisë së Kominternit, por dëshirojmë të themi vëtëm se përpara rrezikut të madh që u kërcënohet partive komuniste marksiste-leniniste nga ana e revizionizmit modern dhe e dy superfuqive, ato duhet medocemos të bëjnë mbledhje jo vetëm dypalëshe, por edhe shumëpalëshe, ku të diskutohen problemet e përbashkëta. Vumë gjithashtu në dukje se, me punën që pati bërë në kohën e vet, Kominterni kontribuoi shumë në forcimin e partive të reja marksiste-leniniste. Më së fundi në rapport ne theksuam qartë se nuk është në asnje mënyrë koha që të krijohet sot një organizatë e tillë ndërkombëtare si ajo e Kominternit. Ne nuk kemi qenë, as nuk jemi për

një gjë të tillë, por mbledhjet e përsaqësuesve të partive marksiste-leniniste duhet të bëhen një praktikë e zakonshme.

Nga ky konkluzion i bërë prej nesh, Hilli del me mendimin se pikëpamja jonë për të bërë mbledhje shumëpartish ka për qëllim «të sjellë në rrugë të drejtë Partinë Komuniste të Kinës». Hilli sikur na tërheq vërejtjen që ne mendojmë se Partia Komuniste e Kinës po devijon. Për këtë ai nuk ka asnë fakt, sepse në Kongresin tonë ne nuk e atakojmë Partinë Komuniste të Kinës, pavarësisht nga mendimet që kemi për shumë pikëpamje dhe qëndrime të saj. Përkundrazi, është Hilli ai që atakon me këtë rast Kominternin, duke e akuzuar se ai ka bërë gabime të rënda, të cilat, sipas tij, i paska njojur edhe Lenini. Ai na akuzon edhe ne duke na thënë se nuk mund të shfajësohet Kominterni me aq pak sa folëm ne për të në Kongresin e 7-të të Partisë sonë, ku pohojmë se nuk përjashtohet që ai të ketë bërë gabime. Zoti Hill do të dëshironë që në raport ne t'i analizonim se ku kanë qenë gabimet e Kominternit dhe sa të rënda kanë pasë qenë ato. Por nuk ishte aspak rasti ta bënim ne një gjë të tillë. Megjithatë Hilli e ka qëllimin gjetkë.

Njëkohësisht me Kominternin Hilli atakon edhe Dimitrovin. Sipas tij, Dimitrovi paska bërë gabime, se fjalimi i tij i famshëm qenka kritikuar nga Stalini, mbasi atje nuk flitej për diktaturën e proletariatit. Siç dihet, Dimitrovi në këtë fjalim zhvilloi tezën e luftës kundër fashizmit. Ai foli për nevojën e krijimit të fronteve populllore me elementë dhe parti progresiste,

me qëllim që t'i pritej hovi trecikut tē fashizmit gjerman dhe italian që nē atē kohē bēhej kērcēnues pēr popujt. Ne gjer sot nuk dimē që Stalini ta ketē kritikuar fjalimin e Dimitrovit pēr kêtē çeshtje.

Nga ana tjetër, Hilli del me pērfundimin se Dimitrovi me kêtē fjalim «ka shkaktuar konsekuenca tē mëvonshme nē devijimin dhe nē degjenerimin e partive marksiste-leniniste» dhe pērmend këtu ish-udhëheqësit e këtyre partive si: Toliatin, Torezin, Harri Politin, Sharkin e tē tjerë. Ai harron se fjalimi i Dimitrovit pati bërë një jehonë jashtëzakonisht tē madhe nē atē kohē nē tē gjithë botën, harron se ai u dha një hov tē madh luftës kundër fashizmit dhe krijimit tē fronteve popullore nē Francë e veçanërisht nē Spanjë, tē cilat u rezistuan politikisht dhe me armë fashizmit gjerman edhe atij italian. Hilli harron, gjithashtu, se këto fronte dhe luftën që propagandonte Kominterni kundër fashizmit i organizonin partitë komuniste tē Perëndimit. Më vonë, kur vendet e tyre u pushtuan nga nazifashizmi, borgjezia reaksionare e këtyre vendeve kapitulloi dhe nē mal nuk dolën dhe nuk luftuan veçse partizanët francezë dhe ata italianë. Ai harron tē thotë se nē luftën e Spanjës as Toliati, as Dykloï, as Martia, as Longoja nuk tradhtuan, por luftuan kundër fashizmit nē rrugën marksiste-leniniste, nē rrugën e Kominternit.

Kështu kritika e Hillit kundër Kominternit, që paraqitet gjoja reale dhe e bazuar, është një flluskë sa-puni. Ai e lufton Kominternin se mendon që ne synojmë tē marrim flamurin e tij dhe tē organizojmë partitë

marksiste-leniniste të botës kundër Partisë Komuniste të Kinës. Kjo duket në kundërshtimin që ai i bën idësë që hodhëm ne në Kongres për mbledhje shumëpalëshe. Sipas tij, mund dhe duhet të bëhen vetëm mbledhje dypalëshe.

Hilli, gjithashtu, del kundër Partisë sonë edhe për një çështje tjeter. Sipas tij, partitë marksiste-leniniste motra të mos stohen në kongreset e njëra-tjetrës. Argumenti «teorik» që sjell ai kundër kësaj praktike është se këto parti, në kongresin e partisë që i thërret, vihen në pozita të vështira përpara pikëpamjeve të partisë mikpritëse dhe nuk qenkan në gjendje të shprehin aty për aty mendimet e tyre për to. Pra, sipas tij, as mbledhjet shumëpalëshe të partive marksiste-leniniste nuk janë me vend, po ashtu në kongresin e një partie motër nuk duhet të marrin pjesë përfaqësues të partive të tjera. Këtej Hilli del me konkluzionin se personalisht ai dhe partia e tij janë kundër praktikave të tilla, dhe, po ta dinte se në Kongresin tonë të 7-të do të shtroheshin ato probleme që u shtruan, ai do të mendohej para se të vinte që të merrte pjesë në këtë Kongres.

Historikisht çështja me Hillin qëndron kështu: Një vit e gjysmë a dy vjet më parë, me saktësi nuk e përcaktoj dot, ne kemi pasur një bisedim dypalësh me të, gjatë të cilët shtjelluam të gjitha ato pikëpamje që shtruam edhe në Kongresin e 7-të të Partisë sonë. Ai nuk foli veçse 10 minuta dhe as i preku fare çështjet kardinale që shtruam ne me këtë rast me të dhe që përbënин vijën e Partisë sonë, të cilën ne e shtruam edhe në Kongres. Pra blofi i tij është i qartë. Hilli në atë

kohë ose ka pasur frikë, ose nuk ka dashur të shprehë haptazi pikëpamjet e tij kundër Partisë sonë dhe i kaloi çështjet pa mbajtur asnje qëndrim. Kështu që teza e tij se është për bisedime dypalëshe nuk qëndron, sepse edhe në bisedimin dypalësh që bëmë ne së bashku me të, ai nuk shfaqi nga ana e vet asnje mendim kritik kundër pikëpamjeve të Partisë sonë.

Hilli shqetësohet pse nuk ndjekim vijën politike, ideologjike dhe organizative të Partisë Komuniste të Kinës, pse dalim nga radha me të. Sipas tij, ne duhet të jemi të bindur në vijën e kësaj partie. Personalisht ai përpinqet të hiqet si «shumë indipendent», me duar «të zgjidhura», kurse të gjitha partitë e tjera komuniste marksiste-leniniste motra që dërguan përfaqësuesit e tyre për të marrë pjesë në Kongresin e Partisë sonë dhe që shprehën fjalët më të mira për vijën e saj, ai i konsideron si parti lake. Qëndrimi që mbajtën ato parti në Kongresin e 7-të të Partisë sonë, sipas Hillit, nisej vetëm nga qëllimi për t'i bërë qejfin Partisë së Punës të Shqipërisë. Me fjalë të tjera, Hilli do që të tregojë se edhe ato që ai vetë tha personalisht në Kongresin tonë nuk përfaqësojnë mendimet e tij, sepse mendimet e tij të vërteta janë të shprehura në materialin që na dërgoi nga Londra, ku thotë se nuk pajtohet me shumë pikëpamje bazë të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Hilli ka pikëpamjen se çdo parti duhet të bëjë kongresin e saj, por, sipas tij, ajo nuk duhet të flasë atje veçse për misrin, për kungujt dhe për kastravecat, e jo të mbajë qëndrime politike dhe ideologjike, jo të shfaqë

mendime kritike ndaj njërit ose tjetrit. Kjo do të thotë se partia që bën kongresin duhet të mos jetë e singertë në shprehjen e pikëpamjeve të saj marksiste-leniniste. Hilli dëshiron që të gjitha partitë marksiste-leniniste të botës të ndjekin pa asnje kundërshtim vijën e Partisë Komuniste të Kinës. Për të, vetëm në këtë rast, çdo gjë është në rregull nga ana e atyre partive.

Nga njëra anë, Hilli hiqet si mbrojtës i pikëpamjes se çdo parti ka të drejtën të shprehë mendimet e veta; nga ana tjetër, ai bie në kontradiktë me veten, kur thotë se partia nuk ka asnje të drejtë t'i shpallë botërisht mendimet e saj. Fakt është se në materialin që na dërgon, ai kritikon kapitullin e pestë dhe të gjashtë të raportit të Komitetit Qendror të Partisë sonë, ku bëhet fjalë për situatën ndërkombëtare dhe për disa probleme të lëvizjes komuniste botërore. Kjo u djeg shumë atij dhe miqve të tij. U djeg, nga njëra anë, për arsyo se, siç e dimë, në këta dy kapituj parashtronhet gjerësisht dhe qartësisht vija jonë marksiste-leniniste, e cila bie në kundërshtim me shumë pikëpamje të Partisë Komuniste të Kinës, megjithëse nga ana jonë nëasnje vend nuk flitet me emër kundër kësaj partie. Nga ana tjetër. Hilli nuk është dakord që një Parti si jona të marrë mundimin të thotë mendimin e saj përluftën që bëjnë e duhet të bëjnë partitë e tjera marksiste-leniniste, përmes metodat e punës së tyre, për aleancat e tyre në luftën që bëjnë dhe përtë tjera probleme që dalin nga përvaja e fituar.

Hilli thotë se pjesëmarrja e parëve të tjera në kongreset e partive motra i komprometlon ato. Ky është

një blof. Një praktikë e tillë ato nuk i komprometon aspak. Ja, pér shembull, u komprometuan gjë partitë e Vietnamit, të Korcsë apo të Laosit në Kongresin e Partisë sonë? Jo! Delegacionet e tyre i shprehën fare lirisht në Kongres pikëpamjet që kishin dhe ne mendojmë se, po të kishin kundërshtime me Partinë tonë, fare lehtë ato mund të kërkonin edhe takim me udhëheqësit tanë, ku të shpjegoheshin pér mendimet e kundërtat që mund të kishin me ne. Ato nuk e bënë këtë. Në rast se kanë pasur gjë pér të thënë e nuk e thanë, pér këtë faji nuk është yni.

Ne jemi dakord se, siç thotë Hilli, gjatë zhvillimit të Kongresit këto vërejtje nuk mund të bëhen, por nuk kemi kundërshtim që, në qoftë se dikush nuk dëshiron të bëjë elozhe pér veprimtarinë dhe pér qëndrimet e partisë mikpritëse, le të mos bëjë. **Zaten Partia jonë nuk i dëshiron clozhet e tepruara që i bëhen, por kërkon të flitet realisht pér veprimtarinë e saj.** Bile, në qoftë se ndonjëri do të kishte vërejtje pér të na bërë, siç thashë më sipër, fare lehtë mund të kërkonte një takim me ne dhe të bëheshin sqarime në mënyrë dypalëshe pér çështjet që e preokupojnë. Këtë gjë as Hilli nuk e bëri.

Ai pretendon se pjesëmarrja në punimet e kongresit të një partie i vë në pozita të vështira partitë e tjera komuniste të stuara, por ne mendojmë se nuk i vë aspak në vështirësi, përkundrazi, përfitimet nga pjesëmarrja në këto raste mbizotërojnë. Këto përfitime i përcakton edhe Hilli, por ai i nënveftëson këto dhe mbi-vlerëson shumë pikëpamjen që kërkon të mbrojë, sipas

së cilës nuk u duhen bërë ftesa partive të tjera në kongrese. Kjo do të thotë të bësh kongres në një vazo të mbyllur, që të mos të marrë vesh njeri ç'mendon. Dëshira e zjarrtë e revisionistëve modernë, e sovjetikëve, njëkohësisht edhe dëshira e zjarrtë e imperialistëve është që këta të lihen të gjithë në rehati, të mos flitet nga ana jonë për veprimtarinë që zhvillohet kundër komunizmit, kundër popujve, kundër vendeve socialiste. Ky është i tërë përfundimi që mund të nxirret nga një trajtim i tillë antimarksist i këtij problemi që ngre Hilli në materialin që na dërgon, në të cilin ai merr pozicion të hapët kundër Kongresit të 7-të të Partisë sonë.

Në lidhje me këtë çështje Hilli përpinqet të shtrembërojë realitetin për sa i përket qëndrimit të Çu En Lai në Kongresin e 22-të të partisë revisioniste sovjetike. Në të vërtetë Çu En Lai në Kongresin e 22-të kërkoi të pushohej polemika kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, gjë që ishte e padëshirueshme nga ana jonë dhe nga shumë të tjerë. Drejtësinë e qëndrimit të Partisë sonë tashmë e ka vërtetuar koha. Çu En Lai, gjithashu, u largua nga Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në shenjë proteste jo për arsy se aty u sulmua Partia e Punës e Shqipërisë, por sepse ekzistonin mosmarrëveshje për probleme të brendshme strategjike të mëdha mes Partisë Komuniste të Kinës dhe asaj të Bashkimit Sovjetik, siç janë mosdhënia e bombës atomike Kinës, problemi kufitar me Indinë etj., etj. Qenë pikërisht këto probleme midis të dyja palëve që e bënë Çu En Lai të largohej nga Kongresi i 22-të.

Këto preokupacione e shpresa e bënë atë më vonë, pas rrëzimit të Hrushovit më 1964, që të kërkonte të shkonte përsëri në Bashkimin Sovjetik dhe të lidhte miqësi me revizionistët sovjetikë. Prandaj shembujt dhe tezat e Hillit nuk kanë asnje vlerë, as historike, as teorike, as praktike.

Sipas Hillit, një parti, kur ka ndör mend të shtrojë një problem me karakter ndërkontrolltar që i intereson gjithë lëvizjes komuniste në botë, duhet të bëjë më parë një xhiro të madhe, të marrë kontakte e të zhvillojë biseda të dyanshme me një numër të madh partish marksiste-leniniste dhe vetëm në rast se do të bien dakord pér këtë ose pér atë çështje, atëherë mund ta shtrojë këtë ose atë problem në kongresin e vet, kurse, në qoftë se do të gjejë kundërshtime, nuk duhet ta shtrojë fare. Kjo është një nga pikat kryesore të kritikave absurdë dhe antimarksiste të këtij provokatori revizionist australian, i vënë apostafat nga revizionistët kinezë pér të provokuar Partinë e Punës të Shqipërisë.

E thashë më parë se Partia Komuniste e Kinës dhe provokatori Hill nuk deshën dhe nuk duan që Partia e Punës e Shqipërisë të shprehë pikëpamjet e veta se si duhet forcuar uniteti ndërkontrolltar i komunistëve dhe i proletarëve. Ata janë në kundërshtim me këtë. Mirëpo uniteti internacionalist i proletariatit dhe i partive marksiste-leniniste është një problem i madh i marksizëm-leninizmit. Edhe Partia Komuniste e Kinës e ka hedhur këtë parullë, por, në fakt, në praktikë është kundër saj dhe e lufton. Këtë moto të madhe ajo e ka inkadruar në unitetin e «botës së tretë», ku është in-

kluduar edhe vetë. Ne nuk mund të pajtohem i me asnje pikëpamje të tillë, as me qëndrimin që mbahet.

Me pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës për «botën e tretë» ne jemi në kundërshtim, pse ato janë antimarksiste, janë pikëpamje revisioniste. Ne e trajtuam këtë problem në Kongresin e 7-të në prizmin klasor, në bazë të ideologjisë sonë, të marksizëm-léninizmit. Parullën e «botës së tretë» e kanë përdorur që përpëra vitit 1960 edhe Hrushovi, edhe Titoja, me emra të ndryshëm, si «vendet e paangazhuara» etj., që Partia jonë i ka luftuar si nocione, si grumbullime të shikuara e të sajuara jashtë kriterit klasor. Partia jonë e shpjegoi në Kongresin e 7-të se ajo është për mbrojtjen e të gjitha shteteve që janë shpallur të lira dhe të pavarura, por që në fakt ekonomikisht dhe politikisht janë të varura. Pak shtete të «botës së tretë» mund të quhen të pavarura, sepse, në fakt, në një mënyrë ose në një tjetër, secili prej tyre është i varur nga kjo ose ajo fuqi imperialiste. Edhe në qoftë se quhet i pavarur politikisht, është i varur ekonomikisht, dhe, sipas mësimave të klasikëve tanë të shkencës marksiste-léniniste, po të jesh i varur ekonomikisht. S'mund të jesh i pavarur politikisht. Ne jemi për mbrojtjen me të gjitha forcat tona të këtyre shteteve dhejeta ka treguar se luftën për mbrojtjen e tyre e kemi bërë vazhdimisht e me vendosmëri, por ne nuk mund të jemi dakord me konkluzione të tillë «teorike», që ka arritur Partia Komuniste e Kinës. Pikërisht këtu qëndron një nga kundërshtimet tona kryesore me të.

Kundërshtimet tona kryesore me kinezët janë për

çështje që lidhen ngushtë njëra me tjetrën: për çështjen e «botës së tretë», për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj dy superfuqive dhe për internacionalizmin proletar, domethënë për forcimin e unitetit të partive komuniste marksiste-leniniste. Partia Komuniste e Kinës, sipas mendimit tonë, i shikon këto çështje në rrugë oportuniste, revizioniste, kurse ne i shikojmë në rrugën marksiste-leniniste. Ne jemi për internacionalizmin proletar, për forcimin e unitetit me partitë marksiste-leniniste, si dhe për një ndihmë sa më të madhe e të vazhdueshme për të gjitha vendet e së ashtuquajturës botë e lirë dhe e pavarur, por që në fakt është e varur dhe nën influencën e kapitalit amerikan, sovjetik etj. Që këto vende të mundin të arrijnë në çlirimin e plotë të tyre, siç thotë Lenini, duhet të luftojnë më përpara armikun në vendin e vet, pastaj edhe armikun e jash-tëm. Ne themi se duhet luftuar me të gjitha forcat revizionizmi modern, duhet luftuar, gjithashtu, edhe borgjezia reaksionare, që e var lirinë dhe pavarësinë e vendit të vet në qafën e imperializmit amerikan ose të socialimperializmit sovjetik. Prandaj ne mendojmë se është e domosdoshme të luftohet me të dyja këto super-fuqi, kurse kinezët nuk e shikojnë çështjen në këtë platformë.

Një çështje tjeter që shtjellon Hilli, është konkurrenca që gjoja, pa e shpallur, po bëhet mes Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Viktimat e kësaj loje qenkan të gjitha ato parti marksiste-leniniste që janë krijuar si reaksion kundër revizionizmit modern. Sipas Hillit, ato parti marksiste-

-leniniste që flasin mirë për Partinë e Punës të Shqipërisë, janë parti lake, parti që duan t'i bëjnë qejfin Partisë sonë. Ai e shtron çështjen në këtë mënyrë: të gjitha ato parti marksiste-leniniste që kanë dashuri, respekt dhe janë dakord me pikëpamjet teorike dhe politike të tyre me Partinë e Punës të Shqipërisë, nuk janë parti të vërteta marksiste-leniniste. Sipas Hillit, vetëm partia e tij qenka «e kulluar dhe marksiste-leniniste»!

Hilli thotë se partitë e reja marksiste-leniniste përpiken si e si të njihen. Po nga kush, nga Partia e Punës e Shqipërisë? Për Hillin lidhjet e këtyre partive me Partinë Komuniste të Kinës janë rruga më e drejtë dhe e domosdoshme, prandaj këtë rrugë duhet të ndjekin. Por shumë prej tyre kërkojnë të njihen edhe nga Partia e Punës e Shqipërisë, dhe ai tjerr gjoja anën teorike, se nga kjo lind pastaj çështja e partisë «mëmë» dhe e partisë «bijë». Kjo, sipas Hillit, do të thotë se Partia e Punës e Shqipërisë i jep të drejtën vetes të përcaktojë se cila nga partitë e reja është marksiste-leniniste dhe cila nuk është marksiste-leniniste.

Ku synon të dalë Hilli me këtë? Ai me këtë përpinqet të dëmtojë unitetin internacionalist të partive komuniste marksiste-leniniste të botës, përpinqet ta shpartallojë këtë unitet dhe t'ia lërë spontaneitetit forcimin dhe zgjerimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Për sa i përket pozitës së Partisë sonë në lëvizjen komuniste botërore, ajo kurrë dhe asnjëherë nuk e ka konsideruar veten si një parti «mëmë» dhe partitë e tjera si parti «bija». Partia jonë kurrë dhe në asnjë rast nuk ia ka imponuar mendimet e veta ndonjë partie motër,

bile vazhdimisht, sa herë që ne kemi rast tē bisedojmë dhe t'u shprehim mendimet tona shokëve përfaqësues tē partive tē tjera motra, u bëjmë atyre tē njojur se cilat janë pikëpamjet tona pér këtë ose pér atë problem, cila është përvoja që kemi ne, pastaj secila parti ka mendimet e veta tē pavarura, gjykon e vendos vetë pér çdo gjë.

Mbi tē gjitha, ne vazhdimisht kemi theksuar dhe theksojmë se çdo mendim dhe çdo veprim i partive motra duhet tē bazohet në marksizëm-leninizmin dhe vetëm në marksizëm-leninizmin. Kjo është e drejtë. Këtë e theksuam me forcë edhe në Kongresin e 7-të. Por Hillit kjo nuk i leverdis dhe nuk i leverdis pikërisht pér arsyë se Partia e Punës e Shqipërisë nuk mendon ta barazojë marksizëm-leninizmin me maocedunidenë, se Mao Ce Dunin ne nuk e kemi vënë në radhën e katër klasikëve tē mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Hilli është në kundërshtim me këto pikëpamje e qëndrime tē Partisë sonë dhe flet në çdo rast pér Maon. I bën këtij ditirambe tē mëdha, pa i njojur si duhet pikëpamjet e tij pér tē gjitha problemet, në mjaft nga tē cilat, siç e dimë, ai ka gabuar. Maoja pér ne nuk është një marksist i vërtetë. Këtë pikëpamje ne nuk e kemi deklaruar, por bindja jonë kjo është, kurse bindja e Hillit është e kundërt me tonën.

Pér t'ia rritur vlerën Mao Ce Dunit, Hilli sulmon me këtë rast Engelsin, duke thënë se ky ka gabuar, prandaj ka rënë nga rangu i tē katërve. Të njëjtën pikëpamje ka Hilli edhe pér Stalinin. Në vend tē këtyre dy marksistëve tē mëdhenj, Engelsit dhe Stalinit, ai ngre Maon

dhe thekson se ky është një marksist-leninist në përmasat e Marksit dhe të Leninit. Ashtu sikundër në kohën e vet Lenini ka pasuruar marksizmin, teorinë e Marksit, po kështu, sipas Hillit, e ka pasuruar atë edhe Maoja gjatë jetës së tij. Këtu qëndron theibi i gjithë teorisë së Hillit që na e shtron neve në materialin e tij me termë gjoja miqësorë, por që, në fakt, janë sulme, shpifje dhe kritika të pabazuara jo vetëm kundër Partisë sonë, por edhe kundër Kominternit, kundër Engelsit, Stalinit dhe Dimitrovit. Po kështu mund të themi edhe për të tjera çështje, pse ka edhe mjaft teza të tjera antimarksiste në letrën e këtij demagogu revizionist.

Hilli vë në dukje se krizën botërore ne gjoja nuk e shikojmë si duhet, se kjo, sipas tij, nuk është një krizë e përgjithshme e sistemit botëror kapitalist, por një krizë superprodhimi dhe këtë ai gjoja e mbështet në teorinë e Marksit. Me një fjalë, veç akuzave të tjera pa baza që bën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, ai përpinqet të futë edhe disa kritika, gjoja terike, për sa i përket përcaktimit të disa problemeve të mëdha ndërkombëtare, njëra prej të cilave është edhe kriza e tanishme botërore e kapitalizmit.

Si konkluzion mund të themi se është e qartë që provokatori Hill erdhi në Kongresin tonë të 7-të jo pa qëllime. Por këto qëllime që i kishte vënë veles, ai nuk i arriti dot në sallën e Kongresit. Atij iu desh të merrte avionin, të largohej nga vendi ynë dhe të na e dërgonte nga Londra këtë material me përbajtje revizioniste. Prej andej ai u kthye pastaj në Australi dhe, menjëherë, pa humbur fare kohë, u degdis në Pekin, ku, siç jemi

në dijeni, iu bë një pritje shumë e nxeh të. Atë e priten me radhë që nga Li Hsien Nieni dhe deri te Hua Kuo Feni. Hilli i bëri vizitë bile edhe gruas së Çu En Lait. Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi për pritjen që iu bë Hillit nga Hua Kuo Feni, për bisedimet e përzemërtë që bënë me të lidhur me shumë probleme ndërkombëtare dhe theksoi se, për të gjitha, të dyja palët kanë qenë plotësisht të një mëndimi.

HSINHUA-ja transmetoi edhe fjalimin e shkurtër të Li Hsien Nienit në këtë pritje, nëpërmjet të cilit hipokritët kinezë folën me terma korrektë, duke u përpjekur të vënë në dukje se Partia Komuniste e Kinës është kundër dy superfuqive, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai flet edhe për internacionalizmin proletar, pa harruar të vëré në dukje miqësinë e Partisë Komuniste të Kinës me Partinë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste) dhe me popullin e Australisë.

Pas Li Hsien Nienit, me këtë rast, e mori fjalën Hilli, i cili tërthorazi sulmoi Kongresin e 7-të të Partisë sonë. Ai vuri në dukje se Hua Kuo Feni ka vepruar si një «marksist-leninist i madh», si nxënës besnik i Mao Ce Dunit, të cilin, siç thashë, e ngre në përmasat e Marksit dhe të Leninit. Hua Kuo Feni, thotë Hilli në fjalimin e tij, shpartalloi në masë elementët tradhtarë, me «katërsjen» në krye. Ai nën vizon se vija që ka diktuar Mao Ce Duni, është vija e vërtetë marksiste-leniniste, teoria marksiste-leniniste është maocedunideja dhe nën vizon se ata elementë ose ato parti që e kundërshtojnë këtë vijë, që kundërshtojnë maocedunidenë, do të shpar-

tallohen, siç u shpartallua «katërshja» me shokët e vet nga Partia e madhe Komuniste e Kinës, dhe përfundon se partitë marksiste-leniniste të botës do të ndjekin me besnikëri vijën e drejtë marksiste-leniniste të kryetarit Mao Ce Dun.

Këto thotë, me pak fjalë, në fjalimin e vet kryetari i partisë revizioniste prokineze australiane. Këto ide janë shprehur edhe në materialin që ai na ka dërguar neve. Ai me këtë dokument tregoi kështu sytyrën e tij të vërtetë prej renegati. Me këtë rast u vërtetua dedukzioni ynë se Partia Komuniste e Kinës do të përpinqet të nxitë njerëz të tillë që ta sulmojnë tërthorazi vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë për të dëmtuar në këtë mënyrë unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për të shtrembëruar marksizëm-leninizmin e vërtetë, për të çoroditur proletariatin dhe për të shpartalluar partitë marksiste-leniniste në të gjitha vendet e botës. Zaten këtë punë e kanë filluar me kohë kinezët.

Për sa i përket asaj që thotë Hilli, se partitë komuniste marksiste-leniniste të botës konkurrojnë të marrin njohjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, në realitet është Partia Komuniste e Kinës që e kërkon dhe e praktikon një gjë të tillë, është ajo që mban lidhje me të gjitha ato fraksione që dalin nga gjiri i atyre partive të reja komuniste marksiste-leniniste, të cilat mbajnë qëndrim të drejtë; është ajo që nxit të dalin të tilla fraksione në shumë nga këto parti të reja, siç janë ajo e Portugalisë, e Italisë, e Uruguait, e Francës etj., etj. Partia Komuniste e Kinës vepron haptazi dhe fshchta-

zi nē këtë drejtim, me qëllim që tē gjitha këto parti t'i pérçajë dhe tē krijojë nga fraksionet që lindin nē gjirin e tyre, një sërë grupesh maoiste, që gjoja janë marksiste-leniniste, me qëllim që t'i përdorë si agjenturat e veta.

Hilli, nē letrën që na ka dërguar, akuzon Kominternin dhe Stalinin se i kishin vënë partitë komuniste dhe punëtore tē botës para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore nē shërbim tē Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Këto parti, sipas Hillit, «nuk mund tē vepronin dhe tē luftonin nē bazë tē marksizëm-leninizmit», i cili, siç e dimë, zbatohej drejt nga Lenini, nga Stalini dhe nga Partia Bolshevikke. Për Hillin ato nuk ishin gjë tjeter vecse agjentura tē Partisë Bolshevikke dhe tē Stalinit. Kjo që thotë Hilli, përputhet me tezat që propagandon borgjezia reaksionare botërore për tē luftuar partitë komuniste dhe punëtore tē botës dhe për tē diskredituar komunizmin.

Por teza që mbron Hilli është e njëanshme. Për atë, tē jesh i lidhur me maocedunidenë dhe me Partinë Komuniste të Kinës nuk do tē thotë aspak se je një parti e varur nga Partia Komuniste e Kinës, ndërsa faktet tregojnë tē kundërtën.

Hilli, pra, është një provokator, një agjent i kinezëve, prandaj nuk e meriton tē flitet më shumë për tē dhe për partinë e tij tō ashtuquajtur marksiste-leniniste. Për këtë parti vihet pyetja nëse ekziston apo nuk ekziston fare. Se sa anëtarë ka kjo parti, ne asnjëherë nuk e kemi mësuar dot, por mendimi ynë është se kjo parti nuk ekziston as nē numër, pa lëre që tē ketë një ideo-

logji të qartë marksiste-leniniste, e cila ta udhëheqë drejt në veprimtarinë e saj.

Këto shpjegime ua bëra sot shokëve sekretarë të Komitetit Qendror. Si përfundim u thashë atyre se Partia e Punës e Shqipërisë duhet të parashikojë një luftë të ashpër nga ana e revisionistëve kinezë dhe e veglave të tyre. Taktika kineze tani është e qartë për ne. Përveç notës verbale që na dërguan, ne mendojmë se ata nuk do t'i përgjigjen letrës që do t'u dërgojmë. Qëndrimin që do të mbajnë ndaj nesh, ata e theksojnë që më parë në notën verbale të datës 8 dhjetor, ku thonë se nuk do t'u përgjigjen «akuzave» tonë, por do të vazhdojnë miqësinë etj., etj. Në realitet, ata do të vënë të tjerët, si Hillin me shokë, që të na sulmojnë, por do të dështojnë kurdoherë.

**Luftrën kundër Partisë sonë revizionistët kinezë do ta fillojnë në dy drejtime: në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe brenda vendit tonë.** Brenda vendit lufta e kinezëve do të marrë karakterin e sabotimit ekonomik. Ky sabotim do të konkretizohet me ngadalësimin e realizimit të kredive të kontraktuara zyrtarisht nga të dyja palët. Dërgimin e objekteve të parashikuara për planin e pesëvjeçarit të kaluar, siç e dimë, këto vitet e fundit kinezët e kanë ngadalësuar pa masë. Ka nga këto objekte që duhej të përfundonin dy dhe tre vjet më parë, por ato akoma presin, sepse nuk na janë dërguar makineritë dhe pajisjet. Ky është një dëm shumë i madh që po i bëhet vendit tonë nga ana ekonomike.

Megjithatë, ne i kemi përballuar vështirësitë që na

kanë krijuar kinezët dhe nuk kemi folur botërisht pér to. Por në tē ardhmen ta kemi tē qartë se një punë tē tillë ata do ta bëjnë nē mënyrë edhe më tē theksuar. Udhëheqësit revizionistë kinezë synojnë që ne tē mbushim sirtaret e tyre me letra proteste, tē cilave, siç e kanë zakon, asnjëherë nuk do t'u përgjigjen. Mirëpo këto vepra tē mëdha, pér ndërtimin e tē cilave ne kemi investuar djersën dhe gjakun e popullit tonë, natyrisht nuk do t'i lëmë gërmadha. Me aq sa do tē mundemi, nē mungesë përgjigjeje nga ana e kinczëve, ne do tē marrim masa pér realizimin e planit, duke u përpjekur që veprat tē mbarohen me mundësitë dhe me mjetet tona. Kështu do tē lindë konflikti i tyre me ne. Ata do tē gjejnë rastin tē na akuzojnë se «ju, me gjithë këtë ndihmë tē madhe që po ju japid, nuk pritet sa tē përfundonim ne eksperimentimin etj., etj., po vazhdoni t'i realizoni vetë këto vepra pa u marrë vesh me ne; atëherë edhe ne po i térheqim specialistët». Kështu do tē bëhet térheqja e specialistëve dhe mosdërgimi i ndihmave nga ana e tyre. Natyrisht, kjo punë nga ata do tē marrë karakterin e një lufte politike dhe ideologjike. Ne, nga ana jonë, do tē përpinqemi që këtë luftë me ta tē mos e hapim publikisht.

Por veprimtaria e revizionistëve kinezë kundër Partisë sonë do tē bashkërendohet edhe me luftën që ata do tē na bëjnë nga jashtë. Se si do tē zhvillohet kjo luftë e tyre nga jashtë, ua shpjegova shokëve. Dy drejtimet e luftës kanë tē njëtin qëllim:

Së pari, tē izolojnë Partinë e Punës tē Shqipërisë nga gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, nē mënyrë

që zëri i drejtë marksist-leninist i Partisë sonë të mos dëgjohet në këtë lëvizje.

Së dyti, të krijojnë grupime të ndryshme që vetëquhen marksiste dhe që përbëhen nga provokatorë, të cilët kanë dalë si rezultat i veprimtarisë së tyre përçarëse në radhët e partive komuniste marksiste-leniniste. Kinezët, ashtu siç bënë edhe hrushovianët, do të krijojnë të tilla grupime në favorin e tyre, të cilat do të financohen nga ata vetë, si dhe nga borgjezia e vendeve ku krijohen. Me këta provokatorë ata do të përpilen të zhvillojnë një propagandë të shfrenuar kundër marksizëm-leninizmit; propaganda e tyre do të drejtohet veçanërisht kundër Partisë sonë dhe pro vijës revizioniste kineze. Do të ngjasë përsëri ashtu siç ngjau me hrushovianët. Kundër tyre në fillim u gjend në luftë të hapët vetëm Partia e Punës e Shqipërisë. Atëherë u gjend, gjithashtu, së bashku me ne, në luftë me hrushovianët edhe Partia Komuniste e Kinës, por jo duke u nisur nga pozita të qarta marksiste-leniniste. Në disa momente të zhvillimit të ngjarjeve, kinezët sulmuan krah për krah me ne, pastaj ata devjuan dhe ky devijim i tyre nga marksizëm-leninizmi po vazhdon. Në veprimtarinë aktuale revizioniste Partia Komuniste e Kinës ka për qëllim të krijojë parti të ashtuquajtura marksiste-leniniste, që ato të kthehen në shërbëtore të revizionizmit kinez, kundër marksizëm-leninizmit.

Detyra jonë është ta parashikojmë këtë luftë, qoftë në platformën e brendshme, qoftë në platformën e jashtme. Lufta jonë do të bëhet në bazë të marksizëm-leninizmit, që është teoria jonë, në bazë të orientimeve

që ka dhënë Kongresi i 7-të i Partisë. Prandaj duhen pasur parasysh dhe në asnjë moment nuk duhen lënë pas dore ato çka u thashë dy ditë më parë shokëve në lidhje me përvetësimin si duhet të ideve që u zhvilluan në Kongres dhe me shpjegimin si duhet të problemeve që lidhen me to.

Shumë probleme themelore politike, ideologjike, ekonomike etj. që trajtojnë raportet e Kongresit, duhet të zbërthehen dhe të gjitha këto të trajtohen, të zhvillohen e të bëhen sa më të kuptueshme për komunistët dhe për masat e gjera të popullit tonë. Ato të shërbejnë njëkohësisht në dy drejtime, edhe për jashtë, edhe për brenda vendit, me qëllim që t'u dalim kështu përpara qëllimeve djallëzore, armiqësore, antimarksiste të revisionistëve kinezë. Për këtë qëllim mendoj të krijojmë grupe të caktuara me kuadro të kualifikuar që të mendojnë thellë e të nxjerrin teza për probleme të ndryshme, të cilat t'i shqyrtojmë, dhe ato teza të tyre që do të janë racionale, t'i aprovojmë. Duke u trajtuar në mënyrë teorike dhe politike, këto teza të bëhen bazë e përgatitjes ideopolitike të kuadrove tanë komunistë dhe të masave të gjera të popullit. Gjithashtu këto materiale duhet të shtypen nga ne, të përkthehen e të dërgohen edhe jashtë për t'ua dhënë partive marksiste-lininiste si shpjegime të mëtejshme të dokumenteve të Partisë sonë për problemet themelore që ngriti Kongresi i 7-të. Kështu, mendoj se do t'ia dalim si duhet punës në krye për t'i ardhur në ndihmë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, më përpara se agjentët e revizionistëve kinezë të veprojnë, për arsyé se duhet parashikuar.

kuar që në këtë luftë që po u bëjnë marksizëm-lininizmit dhe Partisë sonë, kinezët do të përdorin mjete të shumta dhe të fuqishme propagandistike.

Jam i sigurt që në rast se do ta organizojmë luftën si duhet (dhe duhet absolutisht ta organizojmë sa më mirë këtë luftë, pse është një çështje jetike), ne do t'i demaskojmë revisionistët kinezë, edhe pa i zënë në gojë haptazi. Kjo nuk do të thotë që ne të mos i përgjigjemi njëfarë Hilli, iksi ose ipsiloni, të cilët, pa na përmendur fare me emër, do të sulmojnë në kor tezat e Kongresit tonë të 7-të. Ne do të gjejmë rastin apo momentin e volitshëm që përnjëherë t'u përgjigjemi të gjithë këtyre, ose atyre që do të kenë vënë revisionistët kinezë pér të sulmuar tezat e Kongresit tonë të 7-të. Përgatitja që thashë më parë, i shërben kësaj çështjeje. Në rast se ata do të na sulmojnë me emër, atëherë edhe ne duhet të mendojmë nëse duhet të hyjmë në polemikë me njërin ose me tjetrin, apo nuk duhet të hyjmë në polemikë. Çështja është të marrim masa të menduara me kohë, që të shpjegojmë sa më qartë dhe të mbrojmë fuqimisht e në mënyrë të drejtë, marksiste-leniniste, tezat e Kongresit tonë. Mbrojtja e tyre bëhet duke shpjeguar qartë e duke zbërthyer në mënyrë sa më të kuptueshme çdo tezë, sepse ka dhe do të ketë njerëz në radhët e partive marksiste-leniniste që nuk i kuptojnë si duhet tezat tona. Bile shumë prej këtyre njerëzve qysh tani i kanë nxjerrë veshët, sepse në partitë ku bëjnë pjesë ata, ecet drejt rutinës, domethënë ecet me tezat e pompuara nga kinezët.

Sic e shohim, kinezët dhe Hilli në rrugën e tyre

janë socialdemokratë. Ata nuk e kuptojnë se partitë komuniste marksiste-leniniste luftojnë në kushte jash-tëzakonisht të vështira kundër një borgjezie të armatosur deri në dhëmbë, kundër imperializmit amerikan edhe revizionizmit modern, me socialshovinizmin sovjetik në krye. Ata nuk e kuptojnë që duhet absolutisht të punojnë, të përgatiten dhe të praktikojnë të dy format e luftës, edhe legalen, edhe ilegalen, dhe duhet të dinë si t'i kombinojnë që të dyja, ashtu siç na mëson Lenini. Kinezët me fjalë e pranojnë një gjë të tillë, por në realitet ata janë vetëm për forma pune të hapëta, socialdemokrate, pse, natyrisht, edhe vetë janë socialdemokratë, por të maskuar me parulla «marksiste-leniniste», që në fakt janë antimarksiste.

Çështja tjetër që duhet të parashikojmë, ka lidhje me punën brenda vendit. Ne duhet çdo ditë e më shumë t'ua bëjmë mirë të qartë të gjithçëve se, derisa ekzistojnë elementë armiq të klasës, këta do të punojnë. Në rast se armiku i klasës do të orvatet t'i shfrytëzojë tërthorazi kontradiktat që kemi ne me Partinë Komuniste të Kinës dhe luftën që po i bëhet Shqipërisë në-përmjet radiove të huaja, me një punë të mirë sqaruese nga ana e Partisë, veprimtaria e tij nuk do të zërë vend, përkundrazi do të ndihmojë që të shtohet vigjilanca e komunistëve dhe e punonjësve dhe të përgatitet si duhet terreni për të përballuar ditë edhe më të vësh-tira.

Problem tjetër për ne janë çështjet ekonomike. Në asnjë mënyrë nuk duhet të mendojmë se një luftë e tillë, që po na bëjnë Kina dhe satelitët e saj, nuk do

të ketë efekte negative për ne. Pasojat negative të kësaj pune ne duhet t'i paramendojmë me kohë, t'i parashikojmë dhe t'u dalim përpara. Kjo kërkon që, përsaq u përket planeve, të mobilizohemi tërësisht për realizimin frontal të të gjitha detyrave të shumta pa përjashtim, në gjithë sektorët e ekonomisë dhe të jetës në vendin tonë.

Veçanërisht rëndësi të padiskutueshme merr në këto situata realizimi i detyrave në sektorin e bujqësisë dhe të minicerave, në radhë të parë në nxjerrjen e naf-tës. Në naftë ne duhet të bëjmë kujdes të madh, të zbulojmë fusha të reja, të mos lejojmë të ndodhin avari, sepse, ta kemi të qartë, pa naftë do të na mbetet prapa çdo sektor i ekonomisë. Mineralet e tjera na sigurojnë të ardhura të mira, qoftë duke bërë përpunimin e tyre brenda, qoftë edhe me eksportimin e tyre bruto. Por në drejtim të eksportimit të mineralevë armiqtë mundet edhe të na sabotojnë, duke shfrytëzuar, për shembull, qoftë edhe me fshtësinë e disa njerëzve tanë të tregtisë dhe të mos gjejmë dot treg.

Duhet të kuptojmë se ne nuk jemi një shtet i tillë që mund të krijojmë për një kohë rezerva të mëdha mineralesh pa i shitur. Po të mendojmë kështu, do të na krijohen situata të vështira. Prandaj në këtë drejtim duhet të mendohet thellë. Jo vetëm të kemi plane të veçanta për këto situata të vështira që parashikojmë të na krijohen, por është e domosdoshme të veprohet me një shkathësi më të madhe si në zhvillimin e minicerave, ashtu edhe në eksportimin e mineralevë, qofshin këtë të përpunuara, qofshin gjysmë të përp-

nuara, qofshin si lëndë e parë. Të bëjmë përpjekje të gjithanshme që të mos na mbeten minrale e mallra të tjera stoqe nëpër depot dhe nëpër portet tona.

Sektor tjetër me rëndësi jetike për ne është bujqësia. Këtë duhet ta zhvillojmë në mënyrë intensive, që populli të ketë të hajë, të vishet e të mbathet, pra të mos ulet niveli ekonomik i punonjësve tanë.

Në realizimin e planeve tona duhet të ecim frontaliste, por ka edhe disa objekte që vërtet mund t'i kemi parashikuar në këto plane, por ndërtimi i tyre mund të presë, prandaj të mos hezitojmë për t'i lënë mënjanë përkohësisht, përpara këtyre dy problemeve kyç që kërkojnë zgjidhje në situatat e krijuara.

Prandaj u rekomandova shokëve që për këto çështje të mendojnë seriozisht dhe sa më parë, të mos i lihen spontaneitetit, as të kënaqen me marrjen e disa masave gjysmake. Është e domosdoshme të mendohet mirë programi i punës që duhet bërë për të gjitha këto probleme të mëdha.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shë-  
njime për Kinën», vëll. II,  
f. 337*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënjime për  
Kinën», vëll. II, f. 337*

## **PROBLEMET ZGJIDIHEN ME STUDIM TË THELLË E JO ME FJALE TË PËRGJITHSIIME**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**17 dhjetor 1976**

Nuk kuptohen dhe nuk zbatohen gjithmonë si duhet ato që thotë Partia se «jemi në rrethim» e se «do të hamë edhe bar, po nuk do të gjunjëzohemi». Shprehja se «do të hamë edhe bar» tregon qëndrimin tonë të vendosur edhe në kushtet më të vështira. Kjo nuk do të thotë që të rrimë duarkryq dhe të mos përpinqemi përmë mirë. Jo, kështu nuk ka menduar asnjeherë Partia. Fakti tregon se pas viteve 60 ajo mori menjëherë masa të tilla politike, ideologjike e organizative, të cilat bënë të mundur që bujqësia jonë të prodhojë bukën në vend, që çmimet jo vetëm të mos ngrihen, por edhe të përmirësohet furnizimi i popullit e zonat malore të lehtësohen nga disa detyrime. Ky është qëndrim marksist-leninist ndaj parullave që hedh Partia.

Drejt duhet kuptuar edhe shprehja tjetër që themi ne: «Jemi në rrethim». Na duket që, si përmobilizimin

brenda vendit, ashtu edhe për marrëdhëniet me botën e jashtme (sidomos ato tregtare), shpesh ka një kuptim të ngushtë në këtë drejtim.

Duke u ekzagjeruar e duke u keqkuptuar shprehja «jemi në rrethim», anohet vetëm nga kjo, mendohet gabimisht sikur jemi të izoluar, jemi vetëm dhe kështu ka mundësi të na krijohet pa të drejtë një frysë pësimizmi.

Thëniet «jemi në rrethim», «jemi në blokadë» disa shokë i përdorin për të justifikuar dobësitë e tyre, përpjekjet e pakta që bëjnë për të siguruar ato mallra që duhen importuar ose për gjetjen e tregut për ato që duhen eksportuar.

Partia, duke theksuar një realitet, se jemi në rrethim, asnjëherë nuk ka menduar për autarki. Pastaj, dihet se ne, në fakt, nuk jemi të izoluar nga bota. Me ne janë popujt që lustojnë për liri e pavarësi, kundër shfrytëzimit; me ne janë partitë komuniste marksiste-leniniste në vendet e ndryshme të botës; ne kemi miq personalitete të shquara, organizata shuqërore e shoqata të miqësisë që kanë simpati për Shqipërinë e propagandojnë sukseset tona. Ne kemi marrëdhënie diplomatike me tërë ato shtete, shumë nga të cilat përkrahin qëndrimet tona në arenën ndërkombëtare. Përkthimi e botimi në shumë vende i materialeve të Kongresit të 7-të të Partisë sonë është një inkurajim për ne.

Pra, edhe thënien «jemi në rrethim» duhet ta kuptojmë në mënyrë marksiste. Kjo do të thotë që, krahas fjalëve të përgjithshme, të merren edhe masa të forta

organizative për ta çarë këtë rrithim politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht.

Duhet të gjemë forma akoma më të përshtatshme për të propaganduar Shqipërinë në botën e jashtme. Në këtë drejtim vihet re se ndonjëherë është i ngushtë qëndrimi i kuadrove drejtues të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, që thonë në ndonjë rast: «Më mirë të mos e çojmë këtë grup kulturor-artistik jashtë». Ne u kemi dhënë porosi që këto çështje të mos i shohin ngushtë. Ne nuk i çojmë grupet tona jashtë shtetit për të fituar para, ndaj lidhjet tona kulturore me botën e jashtme duhen kuptuar më drejt.

Konstatohet, gjithashtu, se disa herë qëndrimi i ekspertëve tanë të tregtisë në kontaktet që kanë me përfaqësuesit e firmave të ndryshme të vendeve të tjera është shumë kategorik. Ne kemi nevojë për të blerë e për të shitur, prandaj duhen peshuar mirë hapat që bëjmë, duhen bërë mirë llogaritë, duhen njojur situatat dhe duhen bërë përpjekje për të gjetur jo një, por sa më shumë tregje. Të gjitha këto t'i kenë mirë parasysh kuadrot tanë që merren me tregtinë brenda dhe jashtë vendit. Në radhë të parë, është e domosdoshme që të plotësohen me kuadro tërë organizmat e tregtisë së jashtme, sepse ka më shumë se një vit që po zvarritet ky problem.

Kuadrot e tregtisë së jashtme nuk janë sa duhet aktivë në kërkimin e sigurimin e tregjeve, por më shumë presin që t'ua kërkojnë të tjerët mallrat tona, atje ku janë. Ata ndoshta mendojnë se, po t'i themi tjetrit për t'i shitur një mall, ai mund të mendojë se paskemi

ne nevojë dhe do të përpinqet të na e blejë lirë, kurse, po të vijë vetë te ne, mund t'i kërkojmë për t'ia shitura më shtrenjtë.

Çështjet e tregtisë janë të ngatërruara dhe ato nuk mund të shkojnë mirë po qe se njerëzit tanë jashtë shtetit, të ngarkuar për këtë qëllim, rrinë nëpër zyra e nuk venë nëpër firma të ndryshme. Ata që kemi në Francë, ta zëmë, nuk dinë se sa fabrika e uzina ka ky vend që punojnë me mineral kromi, ku e blejnë këtë sasi kromi që u duhet dhe sa e blejnë atje një ton. Eksperi ynë, duke njohur koniunkturat e çmimeve, mund të shkojë te përfaqësuesit e këtyre firmave t'u ofrojë kromin tonë dhe të hapë tregje të reja për këtë artikull. Kështu, në qoftë se njëri nga blerësit aktualë nuk e domë kromin tonë, neve nuk na krijohen shqetësimi, sepse tregun tjeter e kemi gati. Prandaj shokëve tanë u duhet kërkuar që të zbulojnë e të sigurojnë tregje të reja e jo llafe, në mënyrë që, porsa të humbasim një treg, të kemi gati tregun tjeter. Mirëpo nuk ndodh kështu gjithmonë, prandaj disa herë na krijohen anomali në ekonomi.

Duhet kuptuar një herë e mirë se tregu kinez është i rëndësishëm për gjithë botën, por tani për tani ai ka rëndësi veçanërisht për ne. Në vijën ideologjike e politike ne nuk jemi dakord me kinezët, por edhe ata nuk janë dakord me ne. Ne jemi të bindur se ku po shken Kina me këtë kurs që po ndjek. Mirëpo disa shokë duket sikur ose nuk e kuptojnë këtë situatë, ose nuk e kanë parasysh kur shtrohen për bisedime me kinezët. Këta shokë i zhvillojnë sot bisedimet në atë mënyrë

sikur të kishin përpara përfaqësues të një partie që dëshiron të na ndihmojë me gjithë zemër. Ca më keq mund të themi për qëndrimin e prerë të disa shokëve të tjerë që hiqen si parimorë e se gjoja nuk bëjnë lëshime.

Duhet kuptuar drejt se, kur është çështja për të mbrojtur vijën, Partinë tonë, atëherë ka me të vërtetë vend pér një qëndrim të prerë. Por, kur vjen puna që përfaqësuesi kinez bashkëbisedon me përfaqësuesin tonë pér furnizimin e këtij apo të atij malli, pér afatet etj., ndryshon puna, se ne e dimë që ai s'ka qejf të na japë fare. Kinezëve edhe mund të mos u prishet shumë puna në rast se nuk zhvillojnë marrëdhënie tregtare me ne. Prandaj, duke mbrojtur vijën, marrëdhëniet në fushën e tregtisë nuk duhen acaruar. Kjo nuk duhet të ndodhë, sidomos tani që ne e dimë mirë se ata e dëshirojnë një gjë të tillë, tendencë kjo që është vërtetuar disa herë me ta.

Ka kohë që kinezët na ngrenë problemin e çmimave stop. Ata kërkojnë që ta shikojmë këtë çështje, por ne u themi se nuk jemi dakord, se ndryshimi i këtyre çmimave do të qe në favor të tyre. Por është detyra jonë që të mendojmë çfarë duhet bërë, sepse ata po na i vonojnë mallrat. Ka dhe çështje të tjera që kanë mbetur pezull ndërmjet të dyja palëve.

Të gjitha kërkkesat tona ne duhet t'i bëjmë të studiuara mirë. Me gjithë qëndrimet e tyre negative karshi nesh, ne vetë të mos u japim asnje shkak pér të acaruar lidhjet e përbashkëta tregtare. Acarimi artificial e para kohe i marrëdhënieve tregtare me ta i sjell dëm vendit tonë.

Ne duhet të kemi informacione konkrete e të sakta në lidhje me marrëdhëniet tregtare me Kinën për të nxjerrë konkluzione në përshtatje me gjendjen dhe kohën: çfarë u nënshkrua, çfarë mallrash u siguruan atje, çfarë nuk na dhanë dhe për cilat mallra na shtyjnë afatet etj. Janë ministritë tona ato që do ta bëjnë këtë bilanc. Ato duhet t'i dalin Qeverisë me propozime konkrete se ç'duhet bërë në këtë situatë. Duhet gjikuar thellë e me kujdes nëse mund të blihen nëpër shtetet perëndimore disa pajisje të vogla që s'na kanë ardhur akoma nga Kina për Ballshin<sup>1</sup> apo të presim derisa të na i dërgojnë kinezët e ta lëmë akoma pa e vënë në punë Uzinën e Ballshit. Problemin e shtyrjes së furnizimeve, të pajisjeve dhe të materialeve të tjera kinezët e kanë gjetur dhe po e përdorin si një formë kundërshtimi ndaj nesh, duke paraqitur si «argumente» justifikimi tërmetin<sup>2</sup>, sabotimet e «katershës» etj. Si formë kontaktesh me ne kanë gjetur futbollin, ping-pongun dhe sportin në përgjithësi, kurse për ballafaqim problemesh të rëndësishme ata kanë hequr dorë fare. Ne i kuptojmë këto pçngesa që po na krijojnë ata, prandaj edhe disa nevoja që kemi po i plotësojmë me vështirësi.

Ndonjë shtet tjetër ndoshta nuk e ngre me ne problemin e çmimeve, por megjithatë kjo të mos na duket shumë e mirë, sepse ai mund të jetë ndaj nesh me saldo

1. Është fjalë për Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës që po ndërtohej në Ballsh.

2. Tërmeti që goditi Kinën Veriore më 28 korrik 1978.

pozitive. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ai të mos na i japë në kohë mallrat që duhej të na dërgonte, se ato mund t'i ketë shitur me çmime më të shërenjta në vendet e tjera. Këtë ai edhe mund të mos e thotë drejt-përdrejt, por, përkundrazi, përpinqet të justifikohet se ka pasur vështirësi etj. Me diferencën e çmimeve që do të sigurohen nga paratë që do të merrnim ne, ai krijon interesa të konsiderueshëm, kështu që pas gjashtë muajsh fillon të na dërgojë mallrat që duhej të na i dërgonte tani. E kemi thënë edhe herë të tjera se saldo pasive nuk u duhet lejuar partnerëve, sepse ata kështu fitojnë me paratë tona. Borgjezia i bën mirë llogaritë për veten e saj. Çekët kanë përfituar nga situatat dhe kanë ndërtuar për mineralin tonë të hekurit një metalurgji të tërë. Jo vetëm kaq, por ata kanë krijuar edhe rezerva minerali për këtë objekt që do të punojë me mineralin tonë, të cilin ua shesim aq lirë.

Ne duhet të përfitojmë nga eksperiencia e derilanishme është të bëjmë përpjekje për t'i dalë përpëra çdo të papriture e të mos lejojmë të na krijohen situata të rënda. Çështjeve që lindin me kinezët, si për çmimet etj., duhet t'u bëhet analizë dhe pastaj të vendosim. E dimë që këto, që po na bëjnë ata, janë në disfavorin tonë. Prandaj ne duhet të gjemë varlantin që do të na dëmtojë më pak.

Të kemi parasysh se vendet e Evropës Lindore do të bëjnë me ne të kundërtën e Kinës. Ndërsa kjo do të vijë duke na i kufizuar gjithnjë e më shumë lidhjet tregtare, këta të Evropës do të bëjnë përpjekje të na afrohen. Kina, me qëndrimet që po mban ndaj nesh

e që në fakt janë nuhatur nga bota, do të tregojë se po largohet nga Shqipëria, prandaj atë do të përpiken ta tërheqin në gjirin e tyre shtetet e tjera ballkanike. Qëndrimi ynë ndaj vendeve të Evropës Lindore është i qartë: ato nuk do t'ia arrijnë kurrë ndonjë qëllimi të keq që mund të kenë ndaj Shqipërisë. Në këto kushte duhet thellësi mendimi e zgjuarsi që armiqve të mos u japim kurrë mundësi të na dëmtojnë.

Në vendet kapitaliste e revizioniste është e vërtetë që ka superprodhim. Superprodhimi në kapitalizëm dihet se shkakton pushimin e punëtorëve nga puna, pra, shton papunësinë, ul fuqinë blerëse, mallrat nuk shiten dhe, pas gjithë këtyre të këqijave, vjen edhe mbyllja apo falimentimi i ndërmarrjeve. Edhe në vendet revisioniste ky fenomen shfaqet me të dyja të këqijat: së pari, mallrat e tyre janë me cilësi dhe kosto jo të niveleve botërore; së dyti, ato nuk kanë siguruar tregje të mjaftueshme dhe nuk kanë forcën e duhur konkurruce në treptinë ndërkombëtare. Për këto arsyе nuk u shiten mallrat, mbyllin fabrikat dhe janë të detyruar të eksportojnë krahun e punës në vendet e ndryshme kapitaliste, në Perëndim.

Për disa artikuj, ngaqë nuk njohim mirë nevojat ose për arsyë të ndryshme, mund të na krijohen mallra mbi normativë, të cilat gradualisht kalojnë në stoqë etj., gjë që i krijon vështirësi ekonomisë sonë socialistë. Atëherë, ç'duhet të bëjmë? Sigurisht, që të mos lëmë punëtorët pa punë, kjo çështje duhet studiuar me kujdes, por jo «oburra të kalojmë çdo lloj ndërmarrje që të punojë me tri turne!». Këto çështje duhen parë në

kohën e duhur, jo si një qëllim në vetvete, por të lidhura me kërkesat e tregut të jashtëm e të brendshëm, me kërkesën dhe ofertën. Komi shumë mallra stoqë e mbi normativë. Mos vallë për këto mallra ka nevojë ndonjë shtet i huaj? Mund t'u themi atyre se këto mallra kanë nga pak defekte, prandaj po jua shesim edhe më lirë. Edhe paratë mund të mos ua kërkojmë njëherësh, por të na i paguajnë pjesë-pjesë, për disa vjet.

Flasim se qymyri po na digjet, kurse plani për prodhimin e tij shtohet. Po ç'të bëjmë? Të ulim prodhimin? Po punëtorët ku do t'i çojmë? Të gjitha këto çështje duhen lidhur e duhen menduar mirë, para se të vendosjen.

Dyqanet tona, në fshat dhe në qytet, janë plot me mallra. Populli ka para nëpër xhepa. Nevojat kryesore ai i plotëson me mallrat që kanë dyqanet. Në këto kushte duhen gjetur forma më elastike për prodhimin, për qarkullimin dhe për shpërndarjen e mallrave. Të gjitha këto çështje duhet të studiohen nga ekonomistë e nga specialistë të dikastereve, duke u mbështetur në politikën ekonomike të Partisë sonë. Me siguri, po të studiojnë gjendjen e t'u futen mirë problemeve, do të dilet me propozime konkrete se cilat prodhime të shtohen, cilat të pakësohen etj. Prandaj duhen bërë studime të thella dhe jo të botohen artikuj me fjalë të përgjithshme.

Si situata në botën e jashtme, ashtu dhe realizimi i detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë, kërkojnë një ekonomi të fortë. Në këto kushte që jemi, çështja e devizës së lirë ka rëndësi të madhe. Ajo nuk duhet

prekur në asnjë mënyrë për gjëra të vogla. Të gjitha këto probleme duhet t'i shqyrtojë Qeveria me imtësi dhe, qoftë për çështjet me Kinën, qoftë për gjithë të tjera, duhet t'u japë rrugëzgjidhje dhe të mos lejojë që shumë gjëra të mbeten pezull.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## MENDIMI I MASËS — DOMOSDOSHMIERI PËR PRANIMET NË PARTI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 dhjetor 1976

Gabimet e vërtetuar në pranimet në Parti ne i kemi kritikuar edhe këtu në Byronë Politike. Për këtë kemi analizuar edhe arsyet pse kanë ndodhur ato dhe na është thënë se kanë ndikuar nevojat që kemi pasur për të mbuluar me komunistë të gjithë sektorët. Të nisur nga kjo, ka pasur disa vite që e kemi intensifikuar pranimin e njerëzve të rinj në Parti. Pikërisht gjatë kësaj periudhe ka ndodhur që janë futur në Parti edhe persona që nuk e meritonin.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Pranimet i kemi intensifikuar sidomos në periudhën kur u ngrit problemi i emancipimit të plotë të gruas. Po kështu edhe kur u

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti për disa cështje të forcimit të përbërjes së Partisë dhe për problemet që dolën nga ndërrimi i dokumenteve të Partisë, paraqitur nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH.

nxit pranimi nga radhët e të rinjve apo mbulimi me komunistë i disa zonave në të cilat ata mungonin, si dhe në arsim e në disa sektorë të tjera. Në këtë kohë e në këta sektorë u vërejtën edhe pranime në Parti të disave që nuk e meritonin. Por është një gjë e mirë që kjo u korrigjua. Megjithatë, gjithmonë duhet ta kemi vigjilencën të ngritur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Desha të shtoj edhe dëcka tjetër. Lëvizja e kuadrove është e padiskutueshme, po rregullat janë rregulla dhe duhen zbatuar me rigorozitet të madh. Për shembull, dikush që vjen nga Tërbaçi në një ndërmarrje a qendër pune, do të bëjë biografinë e tij, në të cilën edhe mund të gënjejë. Por është detyrë e organizatës së Partisë që të pyesë në fshat byronë e Partisë, organizatat e masave etj. dhe të sqarojë biografinë e atij që e ka paraqitur. Ka shumë rëndësi dhe është e domosdoshme që më parë të merret mendimi i fshatit dhe pastaj edhe mendimi i punonjësve të qendrës së punës. Ky rregull duhet të zbatohet mirë në Parti, sepse në këtë rrugë mendimi i masës tërhiqet i plotë. Pasi merret mendimi nga fshati për origjinën e personit që do të pranohet në Parti, jepet vlerësimi edhe nga kolktivi i ndërmarrjes apo i institucionit për punën, për sjelljet e për karakterin e tij. Në qoftë se opinioni për të nga të dy këto burime është i mirë, atëherë e pranojmë, ndryshe nuk duhet të pranohet në Parti.

Në të ardhmen, ndoshta, mund të paraqiten edhe mendime të tjera, për të përcaktuar një vijë sa më të drejtë për pranimet e reja në Parti.

Tani për tani ne duhet ta bëjmë rregull marrjen e mendimit të masës, se, në mjaft raste, ai që do të pranohet kandidat partie nuk ka as biografi të shkruar, për më tepër, ndodh që as në fshat të mos ketë ndonjë dokument zyrtar për familjen e tij. Atëherë «dokumenti» më i mirë në fshat për atë që do të pranohet është mendimi i masës që e njeh.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## HALLKAT E TEPERTA PENGJUNE ZGJIDUJEN E PROBLEMEVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 dhjetor 1976

Mua më duket se të gjitha problemet që ngrihen në materialin që na është paraqitur, nuk kanë mbetur pa u zgjidhur. Për këtë qëllim shokët e komitetit ekzekutiv mblidhen çdo dy ditë. Natyrisht, jo i gjithë komiteti, po kryetari me nënkyrjetarët. Nuk ka asgjë të keqe që ata të bëjnë takime të përbashkëta e të diskutojnë për probleme operative, të ditës, por kompetenca të mos u japim. E theksoj, ata të mos merren me probleme të tilla, për të cilat duhet të vendosë ndonjë organ tjetër. Fjala vjen, ndarjen e banesave për qytetarët nuk e bën komiteti ekzekutiv, por një komision i posaçëm, bile vetë lagjja ose qendra e punës. Këtu çështja është për

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për relacionin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave për kryesitë e komiteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

vendime që duhet të marrë komiteti ekzekutiv dhe jo kryetari me nënkyretarët nën pretekstin se «qytetari do përgjigje». Po çfarë shqetësimi do të krijohet sikur personi të presë edhe një muaj, derisa të mblidhet komiteti ekzekutiv, kur është puna për probleme që janë në kompetencën e tij? Kjo vonesë nuk është ndonjë gjë e madhe, sepse komiteti ekzekutiv mund të vendosë pas një muaji dhe për kaq kohë personi në fjalë nuk ka pse të mërzitet e të ankohet. Pra, mua më duket se këto çështje zgjidhen. Për këtë arsyе mendoj që të mos krijojmë një hallkë të tepërt, siç paraqitet në relacion, duke shtuar kryesinë e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Për gjithë këto arsyë unë e përsëris se të gjitha problemet zgjidhen nga hallkat ekzistuese dhe s'ka pse të krijojmë të tjera.

Problemin duhet ta shohim më gjerë. Ndjekjen operative të zbatimit të vendimeve duhet ta kryejnë frontalisht të gjitha organet dhe të mos i profilizojmë tërë punët, se, në vend që të ndreqim, do të prishim.

E dini se ç'na ngjet ndonjëherë me aparatet e komiteteve të Partisë që kemi në rrethe? Ndodh që instruktorët, të cilët, në fakt, janë instruktorë për të gjitha problemet, kanë midis tyre një ndarje vetëm me zona. Për shembull, një ka Kuçin, tjetri Himarën, domethënë i kanë këto zona për të gjitha çështjet. Tani, në praktikë, ka raste që nuk zbatohet më kjo ndarje, por po veprohet sipas profilit të sekretarëve të komitetit të Partisë dhe jo për të gjitha problemet. Kështu që kur vete, fjala vjen, një sekretar i komitetit të Partisë në pusin e naftës ku u bë avaria, shkon vetëm ai

instruktor që merret me ekonominë. Mirëpo instruktori i zonës ose ai që merret, për shembull, me propagandën, çfarë bëjnë? Këta nuk merren, ose merren rrallë. Pra, ka njësarë profilizimi dhe nuk sigurohet bashkëveprimi.

Kështu do të ndodhë edhe po të krijojmë kryesinë e komitetit ekzekutiv. Po ta bëjmë këtë, mua më duket se do të krijojmë një hallkë të tepërt dhe do të lindë tendenca që të profilizojmë tërë punët<sup>1</sup>.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Byrosë*

*Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

---

1. Për këtë problem është diskutuar edhe në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH më 25 maj 1978. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll 57, f. 357.)

# **NË NDËRTIMIN E PORTIT TË RI TË VLORES TË MBAHEN PARASYSH NEVOJAT E EKONOMISE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**20 dhjetor 1970**

*Para se të diskutohej për këtë çështje<sup>1</sup>, shoku Enver Hoxha drejtoi disa pyetje:*

Si janë studiuar të dhënrat konkrete që është arritur në këto konkluzione? Na intereson të dimë metodën që është përdorur për parashikimin e ndërtimit të këtij porti të ri, se ky është i pari port që ndërtohet te ne që nga themelat. Nga kush përbëhej komisioni që u krijua me këtë rast dhe cilat kanë qenë orientimet e studimeve që ka bërë ai? Të gjitha këto studime a i janë paraqitur Qeverisë, me relacione të veçanta, sepse ndërtimi i këtij porti ka shumë probleme që duhen zgjidhur.

*Pasi iu dha përgjigje pyetjeve të bëra dhe pas diskutimeve të shokëve të tjerë, shoku Enver Hoxha tha:*

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për projektidenë e portit të ri të Vlorës.

Unë po shtroj mendimin tim, pastaj e diskutojmë.

Ne duhet medoemos të ndërtojmë një port të ri në Vlorë. Kjo është e padiskutueshme, për arsy se nuk mund të qëndrojmë vetëm me Portin e Durrësit, sepse tani na janë shtuar vështirësítë për përballimin e transportit të mallrave. Këtë port duhet ta ndërtojmë në bazë të studimeve të bëra.

Së pari, ne duhet të zgjidhim se ç'kapacitet do të ketë porti. Kuptohet se përcaktimi i kapacitetit ka rën-dësi të madhe. Ai ka të bëjë jo vetëm me çështjen se cilët vaporë do të vijnë këtu, të ç'tonazhi do të jenë dhe cilat mallra do të shkarkohen e do të ngarkohen nga ky port, por edhe me studimin e problemit se nga do të vijnë këto mallra që do të përpunohen aty. Bile, kur them kështu, kam parasysh si drejtimin e mallrave që do të vijnë nga jashtë për në portin e Vlorës, ashtu edhe drejtimin nga porti i Vlorës për në brendësi të vendit. Kjo çështje duhet të studiohet në baza ekonomike, duke parë sidomos se cilat minerale dhe prodhime tonat të tjera do të imbarkohen në portin e Vlorës dhe ç'mallra do të zbresin në port e në ç'drejtime do të shpérndahen ato.

Nga studimi i këtyre çështjeve ne duhet të nxjerrrim edhe leverdinë e portit, e cila duhet të shikohet edhe në lidhje me hekurudhat. Kjo duhet kuptuar jo vetëm në aspektin që ta lidhim Vlorën me hekurudhë (gjë që është më se e domosdoshme), por edhe në raport me perspektivën e zhvillimit të rrjetit tonë hekurudhor në përgjithësi. Ne kemi, për shembull, qymyret, kemi, gjithashtu, zonën e Qytetit Stalin dhe të Fierit etj. Du-

het menduar për të tëra mallrat që do të mbartim nga kjo zonë dhe për ato që do të shpërndajmë në këtë zonë, pra, të bëhet një llogari aproksimative për afate relativisht të gjata, bile edhe 40-vjeçare, lidhur me sasinë, me transportin e përpunimin e tyre, se porti do të bëhet për tërë jetën. Për studimin e problemeve që kanë të bëjnë me kapacitetin dhe me levordinë e portit, ne mund të marrim si marzh një kohë, fjala vjen, proj 15 vjetësh. Por do të lëmë edhe vende për të bërë shitesa të portit pas këtyre 15 vjetëve.

Fillimi i shikojmë se si do të na dalë ndërtimi i portit sipas këtyre studimeve. Pastaj, nëse nevojat tonë në atë kohë nuk do t'i plotësojë dot porti i ndërtuar, ne e zgjerojmë atë. Nuk mund të bëjmë qysh sot një port shumë më të madh nga ç'na duhet gjatë kësaj periudhe, sepse investimet për të janë tپer të mëdha. Ne sigurisht që do ta shikojmë nevojën që kemi për portin e ri, por, krahas kësaj, të përpinqemi që edhe shpenzimet për të të jenë sa më të pakta e t'u përgjigjen importit dhe eksportit tonë.

Ndërtimin e portit ta mendojmë në një mënyrë të tillë që aty të mos na vijnë për t'u shkarkuar vaporë që sjellin mallra për Shkodrën, se atëherë një transport i tillë bëhet i paleverdishëm. E kam fjalën që në këtë port të na vijnë mallra për t'u shpërndarë deri në një kufi të caktuar dhe jo për kudo. Kjo nuk do të thotë se një çështje e tillë do të pritet me thikë; do të ketë edhe raste të veçanta që mund të dilet nga ky rregull, gjë që varet edhe nga drejtimi i vaporëve etj. Por, ama, që të na vijnë, fjala vjen, vaporë të vegjël në një port

ku kemi investuar kaq fonde të mëdha, kjo nuk është e leverdishme. Prandaj bëra edhe pyetjen nëse këto probleme janë studiuar dhe nëse i janë paraqitur Qeverisë këto studime për disa periudha të caktuara, se, përvèç kostos e problemeve të tjera, duhen studiuar edhe çështjet gjeologjike, erërat, valët etj. Studimet për këto probleme janë shumë të rëndësishme nga ana teknike, përderisa është fjala që ne do të ndërtojmë një port modern. Në qoftë se janë studiuar mirë thellësitë, erërat, dallgët etj., e pranojmë variantin që porti i ri të ndërtohet afër Uzinës së Sodës Kauštikë.

Fillimisht porti i ri që do të ndërtojmë në Vlorë mund të jetë edhe më i vogël se i Durrësit, por me pikësynimin që thashë edhe më lart, që të janë mundësitë për ta zgjeruar atë në një perspektivë të ardhshme. Ky zgjerim kuptohet se do të varet nga vëllimi i mallrave që do të kalojnë në këtë port. Pra të ndërtojmë një port sipas nevojave të ekonomisë sonë.

Zhvillimi i ekonomisë dhe i ndërtimeve tona do të ketë edhe në të ardhmen pak a shumë këto ritme të mëdha që ka pasur deri tani. Nga kjo do të varet edhe volumi i qarkullimit të mallrave. Po të marrim për bazë këto ritme të qarkullimit të mallrave, del se i përballojmë nevojat edhe me një port të ri më të vogël se ai i Durrësit. Ky për ne është problem i rëndësishëm, se ndërtimi i një porti të madh, siç u tha edhe këtu, kërkon shumë investime. Ne duhet të caktojmë, gjithashtu, edhe vendin se ku do të ndërtohet ky port i ri dhe thellësinë e tij.

Ndërtimi i portit, siç dihet, nuk do vetëm gurë,

prandaj duhet parashikuar edhe sasia e çimentos dhe e materialeve të tjera që do të na nevojiten për ndërtimin e tij.

Të dhënat që na japid ata që janë marrë me këtë punë nga studimet që kanë bërë, si dhe problemet që u ngritën këtu, janë garanci se edhe për projektimin e ndërtimin e këtij porti do të gjenden zgjidhjet më të mira.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **NUK JEMI NE ATA QE SULMOJNE PARTINE KOMUNISTE TE KINES, POR JANE UDHEHIEQESIT E SAJ QE SULMOJNE PARTINE TONE**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 dhjetor 1976**

Më 8 dhjetor 1976 ambasadori ynë në Pekin u thirr dhe iu dorëzua një notë verbale nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku bëhen sulme pa baza në adresë të Kongresit të 7-të të Partisë sonë. Për t'iu përgjigjur këtyre sulmeve në përgatitëm një projektletër, e cila iu është shpërndarë gjithë shokëve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë sonë, me qëllim që të diskutohet ky qëndrim i mbajtur nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe t'i jepet përgjigjja përkatëse.

Me këtë rast më lejoni, shokë, të jap disa sqarime

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua letra që Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë do t'i dërgonte KQ të Partisë Komuniste të Kinës, në përgjigje të notës verbale.

sidomos për anëtarët e rinj të Byrossë Politike, të cilët nuk janë tërësisht në korenë lidhur me praktikën që ka ndjekur Partia jonë për këtë problem dhe si janë zhvilluar marrëdhëniet ndërmjet saj dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Sikurse e keni parë, në notën verbale që na ka dërguar udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës në-përmjet ambasadorit tonë në Pekin, shokut Behar Shtylla, udhëheqësit kinezë sulmojnë Kongresin tonë të 7-të. Në projektletrën që është përgatitur, kemi menduar t'u përgjigjemi e t'u themi se nuk jemi ne ata që sulmojnë Partinë Komuniste të Kinës, por janë udhëheqësit e saj që sulmojnë Partinë tonë etj. Me këtë nuk duam të themi se midis Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës nuk ka pasur dhe nuk ka kontradikta. Jo. Kontradikta midis dy partive, gjatë zhvillimit të marrëdhënieve midis tyre, ka pasur dhe ka, po kjo është diçka tjetër. Pikërisht për këtë mund të bëj një përbledhje të shkurtër.

Veçanërisht që nga viti 1956, ne kemi pasur kontradikta me Partinë Komuniste të Kinës për çështje të rëndësishme parimore. Përfaqësues të Partisë së Punës të Shqipërisë kanë qenë të pranishëm disa herë në mbledhje të ndryshme të përsaqësuesve të partive komuniste e punëtore motra, ku kemi konstatuar qëndrime jo të drejta nga ana e anëtarëve të delegacioneve të Partisë Komuniste të Kinës, qëndrime me të cilat nuk kemi qenë dakord. Atëherë kur janë bërë këto mbledhje, në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka qenë revizionisti me damkë Nikita Hrushov

me pasuesit e tij. Duhet t'ua themi shokëve që nuk janë në korent se në këto mbledhje ka qenë i pranishëm edhe Mao Ce Duni.

Me udhëheqjen revizioniste hrushoviane ne kemi pasur kontradikta që pas vdekjes së Stalinit. Këto kontradikta ndërmjet dy partive janë zhvilluar vazhdimisht në rritje. Në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që u bë në vitin 1957 në Moskë, Mao Ce Duni doli në përkrahje të Hrushovit, në mbrojtje të tij, duke sulmuar Stalinin, ndërsa për grupin «antiparti» të Molotovit me shokë ai pohoi se «shoku Hrushov ka vepruar shumë drejt». Delegacioni i Partisë sonë në atë mbledhje nuk tha gjë, por, në fakt, nuk ishte dakord, sepse pikëpamjen e vet ia pati shprehur një vit më parë personalisht Mao Ce Dunit, me anë të përfaqësuesve të saj që kishin shkuar në Pekin për të marrë pjesë në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës. Në këtë kongres raportin në emër të Komitetit Qendror të Partisë e mbajti Liu Shao Çia. Përpara se të fliste Liu, sintezën e raportit e paraqiti me një fjalim të shkurtër vetë Mao Ce Duni. Pra, ky raport ka qenë aprovuar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës dhe nga Mao Ce Duni.

Ne e dëgjuam me vëmendje raportin, por si mua, Ramizit, Beharit e shokëve të tjerë që asistonim në kongres, na ra në sy se përbajtja e tij kishte shumë devijime të natyrës oportuniste. Dukej shumë qartë se në Kinë po i bëheshin lëshime borgjezisë, bile borgjezisë kompradore e guomindaniste. Jo vetëm kaq, por kur u ngrit Mikojani të fliste, ky arriti të citonte

renegatin Kautski, duke e cilësuar këtë me termin «shoku Kautski», dhe ne nuk pamë as reagimin më të vogël kundër Mikojanit nga shokët kinezë që ishin në presidium të kongresit.

Nuk mjaftuan vetëm këto. Gjatë punimeve të kongresit, në një nga pushimet midis seancave, na thirri në një sallë për bisedime Mao Ce Duni. Në bisedë e sipër, midis të tjerash, ai na tha se «shoku Stalin ka gabuar në drejtim të Jugosllavisë dhe shoku Tito nuk ka gabuar». Natyrisht, kjo ishte teza e Hrushovit. Kur dëgjuam këto pikëpamje të Mao Ce Dunit, me gjithë respektin që ushqenim personalisht për të, iu përgjigjëm përnjëherë se ne nuk ishim dakord me mendimet e tij, për arsy se shoku Stalin nuk kishte gabuar aspak kundër Titos, i cili është tradhtar e renegat i komunizmit. «Mirë, — na tha Mao Ce Duni, — ky është mendimi ynë, ju mbani mendimin tuaj». Dhe kështu u ndamë. Sidoqoftë, për këtë rast ne ua thamë hapur shokëve kinezë pikëpamjet tona. Edhe Mao Ce Duni na i tha haptazi pikëpamjet e tij.

Më vonë, në vitin 1960, ndodhën ngjarjet e Bukureshit. Qëndrimet e Partisë sonë me këtë rast ju të gjithë i keni njojur duke lexuar vëllimin e 19-të<sup>1</sup>. Megjithatë, në këtë vëllim nuk është thënë gjithçka që ka ndodhur atëherë, për arsy se na duhej të mos dilnim publikisht se kemi kontradikta me Kinën. Në fakt, në Mbledhjen e Bukureshit, shoku Hysni [Kapo], në emër

1. Vëllimi i 19-të i Veprave të shokut Enver Hoxha doli në qarkullim më 8 nëntor 1975.

të Partisë sonë, e zhvilloi fare i vetëm luftën kundër Hrushovit. Partinë Komuniste të Kinës atje e mbrojti vetëm Partia jonë. Partia Komuniste e Kinës nuk u mbrojt as vetë. Delegacioni i saj, që kryesohej nga Pen Çeni, në vend që të ngrihej dhe ta mbronte partinë e vet nga sulmet e Hrushovit dhe të hrushovianëve, u kufizua vetëm me shprehjen «po mbaj shënim dhe këto që po ngrihen këtu do t'ia transmetoj udhëheqjes së partisë sime». Ishte qëndrimi i vendosur marksist-leninist i Partisë sonë, të përsaqësuar në Mbledhjen e Bukureshtit nga shoku Hysni Kapo, që e pengoi këtë mbledhje antimarksiste të merrte vendim kundër Partisë Komuniste të Kinës, jashtë praktikave e normave marksiste-leniniste të marrëdhënieve midis partive. Pra, Partia e Punës e Shqipërisë edhe në këtë rast mbrojti me vendosmëri marksizëm-leninizmin dhe Partinë Komuniste të Kinës. Dhe në fakt në Mbledhjen e Bukureshtit nuk u arrit ajo që dëshironin dhe kishin vendosur hrushovianët, që të merrej një vendim për përjashtimin e Partisë Komuniste të Kinës nga kampi socialist.

Pas Mbledhjes së Bukureshtit, kur delegacioni i Partisë sonë u dërgua në Moskë për të marrë pjesë në punimet e komisionit përgatitor për hartimin e dokumenteve që do të aprovonte Mbledhja e 81 partive, në nëntor 1960, në krye të delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës, që, gjithashtu, do të merrte pjesë në këtë komision, ishte Ten Hsiao Pini. Ky, me udhëzim të Komitetit Qendror të Partisë së vet dhe personalisht të Mao Ce Dunit, kishte ardhur në Moskë me një fjalim të

përgatitur, ku pasqyroheshin shumë pikëpamje oportuniste. Udhëheqësit kinezë ishin për pajtim me grupin revizionist tradhtar të Nikita Hrushovit. Ten Hsiao Pini ua dha shokëve të delegacionit tonë fjalimin, që të merrnin dijeni për përbajtjen e tij përpara se të mbahej. Këtë ai e bëri me shpresë se ne do të vihem në të njëjtën rrugë me ta. Por shokët tanë, Hysniu dhe Ramizi, u thanë kinezëve se Partia jonë nuk ishte aspak dakord me përbajtjen e këtij fjalimi që do të mbante Ten Hsiao Pini, për arsy se ajo nuk është për pajtim me revizionistët hrušovianë, përkundrazi, është për luftë pa asnjë kompromis kundër tyre dhe gjithë revizionistëve modernë.

Më pas hrušovianët u shpërndanë të gjitha delegacioneve që do të merrnin pjesë në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore, një dokument të gjatë zyrtar, ku sulmoheshin si Partia Komuniste e Kinës, ashtu edhe Partia jonë. Në këtë dokument të hrušovianëve Shqipëria nuk përmendej fare si një vend socialist. Dokumenti ishte shpërndarë kur nuk kishte filluar akoma Mbledhja e përfaqësuesve të 81 partive. Se si u zhvillua situata në këtë mbledhje dhe për qëndrimin e Partisë sonë ju tashmë jeni në dijeni.

Pikërisht në këto situata Ten Hsiao Pini u detyrua ta ndryshonte ca tonin e fjalimit që kishte sjellë të gatshëm nga Pekini. Në këtë rast një qëndrim shumë të mirë nga ana e delegacionit kinez mbajti anëtari i këtij delegacioni, shoku Kan Shen<sup>1</sup>. Qëndrim korrekt

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 180.

kishte mbajtur ky edhe në mbledhjen e komisionit përgatitor gjatë debateve të zjarra që ishin zhvilluar. Kur, në një rast, Hrushovi e kërcënoi Kan Shenin me termin «dogmatik», Kan Shenin i tha hapur atij «revisionist». Kan Shenin ishte i vetmi element pozitiv që bënte pjesë në delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960, sepse gjithë të tjerët notonin në oportunizëm, në revisionizëm, ishin për pajtim dhe miqësi me hrušovianët.

Në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Hrushovi e sulmoi hapur Partinë tonë. Edhe pse ky sulm u bë publikisht nga tribuna e këtij kongresi, Çu En Lai, që kryesonte delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës, nuk doli aspak në mbrojtje të Partisë sonë. U fol se në shenjë proteste Çu En Lai u largua nga kongresi gjoja për shkak të sulmit që bëri Hrushovi kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Kjo nuk është aspak e vërtetë, të vërtetën do ta tregojë historia. Hrushovi e nisi polemikën, ai na sulmoi nga Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pastaj kërkonte të pushonte polemika me Partinë e Punës të Shqipërisë. Këtë kérkesë e kishin edhe udhëheqësit kinezë. Mirëpo nuk duhet harruar se një kérkesë e tillë ishte në favor të Hrushovit. Partia jonë nuk ishte për këtë rrugë, por për vazhdimin e luftës deri në fund me revisionistët modernë dhe me hrušovianët. Përderisa lufta me armiqtë e komunizmit ishte hapur botërisht, ajo duhej çuar deri në shpartallimin e tyre të plotë, dhe kinezët e kishin kuptuar fare mirë këtë qëndrim të vendosur të Partisë sonë. Ne ua thamë

hapur atyre se nuk ishim aspak dakord që të pushohej polemika me antimarksistët, me revisionistët modernë hrušovianë. Prandaj ajo që pretendohet sikur Çu En Lai në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik doli në mbrojtje të Partisë sonë, nuk është aspak e vërtetë.

Po pse e bënë këtë kinezët? Po të arsyetojmë mbi faktet që përmenda më lart, del qartë se udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës dhe vetë Mao Ce Duni, duke parë se udhëheqjen sovjetike, me Hrušovin në krye, nuk po e futnin dot nën sjetull, bënë përpjekje që të paktën të kishin miqësi me të, të bashkëpunonin ngushtë në ndarjen e sferave të influencës dhe për ta furnizuar Kinën me ndihma të pakufishme. Por Hrušovi, si forcoi pozitat e tij në parti dhe në shtet, u ktheu bërrylin kinezëve. Për këto arsy, mendojmë se, duhet të jetë larguar Çu En Lai nga Kongresi i 22-të dhe jo se Hrušovi sulmoi hapur Partinë tonë. Udhëheqësit kinezë e panë se hrušovianët nuk po i respektiton zotimet, qoftë për t'i ndihmuar kinezët për prodhimin e bombës atomike, qoftë për luftën kino-indiane, ose edhe në drejtim të zhvillimit të ekonomisë etj. Pas këtyre ngjarjeve nisi polemika midis tyre. Kinezët filluan nga botimi i artikujve tanë, që, në fakt, ishin shumë «të kripur». Me këtë ata donin të krijonin përshtypjen sikur ishin kundër hrušovianëve. Në të njëjtën kohë mendonin, gjithashtu, të linin përshtypjen tjetër se Shqipëria ishte nën sjetullën e tyre, ashtu siç propagandonte gjithë shtypi reaksionar botëror, i cili për-

piqej t'i bindte njerëzit se ne qenqëshim «zëdhënësit e Kinës».

Ne vazhduam pa asnje lëkundje luftën kundër revizionizmit modern, por është fakt se edhe kinezët, kur panë që nuk kishte më shpresë për t'u pajtuar me sovjetikët, filluan edhe vetë nga propaganda e drejtpërdrejtë dhe botuan nga dhjetë artikuj, të cilët, për mendimin tonë, duke gjykuar sipas asaj periudhe kur i kemi lexuar (se po t'i lexojmë përsëri, mund të ketë në ta edhe ndonjë gjë që nuk shkon), mund të themi se kishin përbajtje në përgjithësi të drejtë.

Pas botimit të këtyre dhjetë artikujve filloi përsëri zbutja e luftës, shkarja e kinezëve nga e djathta. Kjo ndodhi se udhëheqësit kinezë nuk kanë qenë kurrë në rrugë të drejtë, në pozita të shëndosha marksiste-leni-niste, vetëm se rrethanat i detyruan të mbanin pozita të drejta për një periudhë të caktuar, duke botuar 10 artikujt e tyre.

Në këto situata, kur po zhvillohej një luftë e ash-për kundër revisionistëve sovjetikë dhe revisionistëve modernë në përgjithësi, Liu Shao Çia, në takimin që bëri me shokët e delegacionit tonë, kur ishin në Kinë në vitin 1962, propozoi që të formohej një front i përbashkët kundër imperializmit amerikan, ku të bënin pjesë edhe revisionistët sovjetikë, edhe Titoja, edhe gjithë revisionistët e tjerë me radhë<sup>1</sup>. Shokët tanë ia hodhën poshtë Liut këtë propozim, duke i thënë se ne nuk pranojmë në asnje mënyrë të bashkohemi me re-

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vëll. I, f, 116.

vizonistët për të luftuar së bashku me ta kundër imperializmit amerikan. Kjo idc, theksuan shokët tanë, është e gabuar, prandaj ne do ta vazhdojmë luftën si kundër imperializmit, ashtu edhe kundër revizionizmit. Në këtë luftë do të bashkëpunojmë vetëm me partitë marksiste-leniniste dhe me popujt revolucionarë të botës.

Pas kësaj përgjigjeje që i dhanë shokët tanë Liu Shao Çisë, Çu En Lai filloi menjëherë nga presionet. Kur kishte shkuar shoku Spiro Koleka në Kinë për çështje ekonomike, Çuja kishte nxjerrë një mijë e një arsy e dhe pengesa duke thënë «këtë s'jua japim», «këtë nuk e bëjmë», «ju jeni duke braktisur fshatin» dhe të tjera e të tjera histori, për të justifikuar qëndrimet e tyre. Të gjitha këto janë të shkruara në dokumente. Kur shokët e delegacionit të Partisë sonë u takuan me Mao Ce Dunin, ia thanë këtij mendimin e Partisë sonë për propozimin që kishte bërë Liu Shao Çia, ata i folën Maos edhe për pengesat që po na silleshin në fushën e marrëdhënieve ekonomike. Dhe Mao Ce Duni, ashtu sikurse e kishte zakon, duke e hequr veten si perëndi, tha: «Kjo që ju kanë thënë, s'është për t'u bërë kurrë. Edhe ndihmat që keni kërkuar do t'ju jepen».

Kjo ngjarje përmendet edhe në projektletren e përgjigjes që po u bëjmë udhëheqësve kinezë, por aty ne vetëm sa e prekim, sa i nxjerrim veshët kësaj çështjeje, përmendim vetëm datën kur është bërë takimi me Liu Shao Çinë.

Në vitin 1964 doli një kontradiktë tjetër me shokët kinezë, që kishte të bënte me çështjen e kufijve, që

edhe këtë e përmendim në letër. Në gusht të vitit 1964 kinezët ngriten përpara sovjetikëve dhe përpara gjithë botës tezën e rishikimit të të gjithë kufijve që ishin caktuar pas Luftës së Dytë Botërore. Por kryesorja përtat, që e ngriten këtë tezë, ishte çështja e Siberisë, çështja e tokave kineze të grabitura në të kaluarën nga ana e carëve të Rusisë. Kinezët e ngriten këtë problem kur ishte në zhvillim e sipër lufta e hapët ideologjike kundër revizionizmit modern, gjë që e dëmtonte shumë këtë luftë, sepse largonte vëmendjen e njerëzve prej saj, largonte vëmendjen e popujve të Bashkimit Sovjetik kundër udhëheqjes së tyre revisioniste e tradhtare. sepse revisionistët sovjetikë do ta shfrytëzonin rastin që kjo çështje të bëhej një armë e fortë në duart e tyre përtë nxitur shovinizmin rus kundër Kinës.

Po si e ngriten këtë problem udhëheqësit kinezë? Sipas tyre, ata e ngriten jo se ushqenin rivendikime tokësore ndaj Bashkimit Sovjetik, por se sovjetikët duhej të njihnin që këto toka qenë të grabitura! Kjo është tamam siç thonë në Gjirokastër: «jo ve, po kokove», pra e njëjtë gjë.

Ne, duke parashikuar rrezikshmérinë e kësaj teze, që conte në devijimin e luftës përdemaskimin e revizionizmit modern, i dërguam një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit, ku, në mënyrë shoqërore, vinim në dukje se këto grabitje tokash kincze nga ana e reaksionit carist rus i kishin pranuar edhe Lenini dhe Stalini, por në këto momente luftë kundër revizionizmit hruščovian etj., etj. shpreh-nim mendimin se nuk ishte e përshtatshme shtruarja e

kësaj teze. Kopjen e kësaj letre e kemi në Arkivin e Komitetit Qendror, prandaj kush të dëshirojë nga shokët e Byrosë Politike mund ta lexojë.

Në vitin 1969, kur ndodhej në Shqipëri Li Hsien Nieni, Partia jonë zhvilloi me të bisedime të hapëta shoqërore. Në këto bisedime ne i thamë atij se mendimi ynë është që Kina e madhe, për të forcuar pozitat e saj etj., etj., nuk duhet të qëndrojë e mbyllur në guaskën e vet dhe çështjen e Tajvanit, që është një çështje e drejtë e saj, të mos e vëré si kusht për t'u lidhur ose jo me shtetet e ndryshme të botës. Deri në këtë kohë, lidhur me çdo shtet që kërkonte të vendoste marrëdhënie diplomatike me Kinën, udhëheqësit kinezë vinin si kusht që mund të vendoseshin marrëdhënicë në rast se nga pala tjeter Tajvani njihej si tokë kineze, ndryshtet nuk pranoheshin marrëdhënie. Tajvanin ata e vinin si një barrikadë, por edhe këtë barrikadë, që kishin ngritur vctë, e shkermuan. Për sa u përket Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe revizionistëve sovjetikë, i theksuam Li Hsien Nienit se ne duhet ta vazhdojmë të rreptë luftën kundër të dyve. Ky nuk donte të bisedonim për këtë gjë dhe, kur ia thamë mendimin e Partisë sonë, u shpreh me frazën: «Kjo është çështja jonë». Megjithatë, ia thamë ato që kishim për t'i thënë.

Kur pamë këtë manovër që bëri udhëheqja kineze, e cila ishte në kundërshtim me deklaratat e përbashkëta të nënshkruara nga kryeministrat e të dy vendeve tonë, në të cilat flitet qartë për luftë të pamëshirshme si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër revizionizmit sovjetik, kundër Titos dhe titizmit, kun-

dër revizionizmit modern, dhe ky formulim ishte bërë si një akordim i pikëpamjeve të përbashkëta të të dyja palëve, të të dyja partive tona, dërguam për Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe për Mao Ce Dunin një letër tjetër shumë shoqërore, ku vinim në dukje, ndër të tjera, se nuk ishim dakord që ata të pranonin dhe të zhvillonin bisedime me Niksonin, që është kreu i imperializmit amerikan, armik i egër i popujve, që kishte bërë gjithë ato zullume mbi popujt, që edhe në atë kohë ishte duke vrarë e duke gjakosur popullin vietnamez etj., etj., bile në një kohë që ai nuk pranonte as të njihte Republikën Popullore të Kinës si shtet dhe Tajvanin si tokë kineze. Letra ishte shumë precise, korrekte, vëllazërore e shoqërore.

Veç këtyre është edhe një çështje tjetër me rëndësi shumë të madhe, e cila duhet të mbetet midis nesh: kur shkoi Beqir Balluku në vitin 1968 në Kinë, Çu En Lai ka zhvilluar bisedime sekrete me të. Ndërmjet të tjerës, ai i kishte thënë Beqirit: «Ju shqiptarëve nuk ka ç'u duhen armatimet e rënda, mbasi keni nevojë vetëm për armatime të lëhta, sepse nuk mund t'i rezistoni dot një sulmi eventual të sovjetikëve ose të çdo ushtrie tjetër të rregullt. Rezistenca juaj do të jetë e kotë, prandaj, në rast sulmi, duhet t'ua lëshoni territoret e qyteteve dhe bregdetin atyre që do t'ju sulmojnë dhe të ngjiteni në male. Lufta juaj duhet të jetë vetëm një luftë partizane, të cilën nuk duhet ta bëni vetëm, po të bashkëpunoni e të lidheni në aleancë me Jugosllavinë e Titos dhe me Rumaninë e Çausheskut». Beqir Balluku, kur

u kthye nga Kina, na i lëshoi këto pikëpamje në Byronë Politike dhe, kur ne i hodhëm poshtë, ai, si një tradhtar i kamufluar dhe hipokrit që ishte, e drodhi dhe u solidarizua me ne! Por faktet treguan se Beqir Balluku ishte duke zbatuar planin e Çu En Lait për të gjitha ato gjëra që dimë, deri edhe për likuidimin fizik të udhëheqjes sonë. Në këtë drejtim kanë punuar shumë Çu En Lai, Liu Shao Çia, Ten Hsiao Pini dhe të tjera. Kur të gjithë këta qenë në këto pozita, në këto pozita ka qenë me siguri edhe Mao Ce Duni, i cili na quante «sektarë». Të gjithë këta ishin për likuidimin tonë fizik. Mirëpo, siç e dimë, ngjau ajo që armiqtë puçistë e tradhtarë u zbuluan dhe që atëherë nga ana e kinezëve filluan më të forta shtrëngimet në drejtim të marrëdhënieve ekonomike me Shqipërinë.

Në muajin qershor të vitit të kaluar vajti në Kinë shoku Adil Çarçani<sup>1</sup> për të biseduar lidhur me kreditë që do të kërkonim nga Kina për pesëvjeçarin e gjastë, por, sikurse jeni në dijeni, atje ai e gjeti «gardh». Ne i dërguam një mesazh Mao Ce Dunit për furnizimet e ushtrisë dhe për çështje ekonomike, por as për këtë nuk morëm ndonjë përgjigje nga ana e tij, ashtu siç nuk kishim marrë përgjigje për letrën që u dërguam lidhur me bisedimet që kinezët bënë me Kisingerin dhe me takimin që do të bënин me Niksonin, si edhe për çështjen e konfliktit kufitar me sovjetikët. Për të gjitha këto ka dokumente të shkruara.

Kur kinezët panë qëndrimin tonë të vendosur, Çu

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vell. II, f. 107.

En Lai thirri Adilin në takim dhe i tha: «Po të pres pak. kështu, në këmbë, sepse do të futem në sallën e operacionit dhe nuk dihet nëse do të dal i gjallë apo jo. Por edhe një herë po ju them që ju të lini mënjanë divergjencat ideologjike, të merreni vesh e të lidheni me Titon dhe me Çausheskun». Adili iu përgjigj që ne nuk jemi dakord me mendimin tuaj dhe u ndanë. Pra, edhe në momentin e fundit, para se të operohej, Çu En Lai bëri presion ndaj nesh. Ky qëndrim donte të thoshte: «O pranoni kushtet tona dhe bashkohuni me Titon e me Çausheskun, pra ejani në vijën tonë (gjë që do të thotë të bëhem revizionistë), ose ne do t'ju presim ndihmat». Dhe në fakt kreditë për ne u prenë, ato u reduktuan në 25 për qind të nevojave tona të domosdoshme.

Këto kanë qenë divergjencat midis Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës, divergjenca të mëdha parimore. Përballë kësaj situate ne kemi vepruar duke ndjekur rrugën e Partisë, që u ka qëndruar kurdoherë besnikë parimeve marksiste-leniniste. Asnjëherë këto mosmarrëveshje që kemi pasur me udhëheqësit kinezë nuk i kemi ekspozuar, por kemi vepruar me takt dhe në mënyrë shoqërore, ua kemi shkruar në letra pikëpamjet tona, megjithëse ata nuk kanë denjuar t'i përgjigjen një partie motër marksiste-leniniste, të barabartë, e cila ka vijën dhe strategjinë e saj, ku shprehët edhe miqësia jonë marksiste-leniniste me Kinën.

Sikurse jeni në dijeni, këtë vijë ne nuk e kemi shtruar për herë të parë në Kongresin e 7-të, por shumë kohë më parë, dhe po e zbatojmë gjatë gjithë jetës së Partisë sonë. Kështu që nuk ka asnje arsy që

kinezët të na akuzojnë dhe të thonë se Kongresi i 7-të i Partisë së Punës të Shqipërisë na sulmoi haptazi, publikisht, apo tërthorazi. Por argumentet e tyre nuk qëndrojnë në këmbë.

Kongresi i 7-të i Partisë sonë shtroi vijën dhe strategjinë tonë, tha haptazi mendimet, pavarësisht se me kë bien në kundërshtim këto. Asnjë parti s'ka të drejtë të ndërhyjë në çështjet tona, dhe këtë ua theksojmë edhe udhëheqësve kinezë në përgjigjen e letrës që kemi përgatitur.

Letrat që i kemi dërguar udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe kërkesat e herëpashershme që kemi bërë për të shkuar në Kinë një delegacion i Partisë sonë për bisedime miqësore dhe këmbim mendimesh, kanë një rëndësi të madhe. Tre vjet me radhë ne kemi kërkuar të vejë atje një delegacion qeveritar jo për të kërkuar ndihma, se për këtë dërguam vjet shokun Adil, po për të biseduar miqësish me ta për çështjet që përmenda. Tri herë e kemi përsëritur kërkesën dhe udhëheqësit kinezë tri herë na e kanë refuzuar, duke shtyrë kohën e vajtjes së delegacionit tonë me pretekstin se «jemi të zënë», kurse ata gjatë këtyre tre vjetëve kë nuk kanë pritur në Kinë. Ky qëndrim nga ana e tyre do të thotë se ata nuk janë të prirë dhe nuk dëshirojnë të bisedojnë me ne, se janë kundër pikëpamjeve tona. Në të gjitha këto qëndrime dhe veprime të tyre, Partia jonë nuk u ka ndonjë saj, ne kemi mbajtur kurdoherë qëndrim korrekt marksist-leninist ndaj tyre.

Kongresi i 7-të i Partisë sonë shtroi disa çështje të rëndësishme politike dhe ideologjike. Për situatën

ndërkombëtare ai tregoi rrugët që duhen ndjekur, devijimet që janë bërë, por nuk vuri gishtin të theksonte se këto devijime kanë ndodhur në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës. Marksistë-leninistët e vërtetë i kuptojnë drejt këto çështje, dhe kjo u ka therur udhëheqësve kinczë. Pse? Se janë në rrugë të shtrembër revizioniste, prandaj na bënë një copë letër, sa për të na lënë neve në kurriz çdo gjë. Por ne do t'u dërgojmë përgjigje. Natyrisht, secili nga ju, shokë, duhet të thotë dhe do ta thotë mendimin e vet për projctin e letrës që kemi përgatitur, ku kemi vënë në dukje disa nga çështjet më të rëndësishme dhe u themi troç se nuk jemi ne që po i sulmojmë, por janë ata që po na sulmojnë. Ne kemi strategjinë tonë dhe nuk pranojmë të na ndërhyjnë të tjerët në punët tona. Ne pranojmë kritikat e drejta marksiste-leniniste nga partitë motra, por, gjithashtu, kemi të drejtë që edhe ne t'i kritikojmë ato, kur vëmë re qëndrime dhe pikëpamje me të cilat nuk jemi dakord. Se si do të na përgjigjen nuk jemi në gjendje ta parashikojmë. Ka mundësi të mos na përgjigjen, se e dinë që, po të hapësh polemikë me Partinë e Punës të Shqipërisë, nuk është një punë e lehtë.

Disa nga çështjet kapitale mendojmë t'ua themi në letër, por kemi edhe shumë çështje të tjera që nuk i kemi prekur fare. Në rast se do të fillojë polemika me ta, atëherë do të vihen të gjitha në dukje. I leverdis një gjë e tillë udhëheqjes kinezë, që ka ardhur tanë në suqi dhe është në pozita kaq të lëkundshme pse akoma nuk është konsoliduar? Logjika ta do që ata të mos e hapin polemikën, megjithatë nc jemi të përgatitur.

Udhëheqësit kinezë janë revizionistë dhe si të tillë mund të gjykojnë e të thonë: «Punë e madhe se do të hapim polemikën me këta, ne me një gjysmë faqe letër i mbytimit». Do të shohim. Të mbajmë parasysh edhe anën tjetër që polemikën të mos e fillojmë ne.

Natyrisht, udhëheqësit kinezë kanë interes të mos i prishin marrëdhëni me ne, po deri ku shkon interes i tyre, këtë nuk e dimë. Sigurisht, fjala është për pamjen e jashtme të marrëdhënieve, si dhe për marrëdhëni ekonomike, për dërgimin e ndonjë grupei sportiv ose për vizitën e ndonjë zëvendësministri, që, kur shkon në ndonjë vend tjetër, të kthehet edhe në Shqipëri. Edhe ne nuk jemi për t'i prishur, sidomos marrëdhëni tregtare me ta. Por në këtë rrugë jemi të bindur se do të gjejmë shumë vështirësi. Udhëheqësit kinezë mund të na sjellin pengesa, ashtu si dhe në çështjen e përfundimit të ndërtimit të objekteve. Vështirësi të mëdha do të kemi sidomos për livrimin në kohë të mallrave. Ata do të na zgjatin sa më shumë afatet, që të na mërzitin, me qëllim që të sulmojmë ne të parët. Kështu mendojnë ata, të na nxitin që ta hedhim ne të parët «bombën», pastaj të na përgjigjen. Por kësaj do t'i ruhem. Ne do t'u shkruajmë letra, të cilat jemi të bindur se do të qëndrojnë të mbyllura në dosjet e tyre, por këto letra nesër do të na shërbejnë.

Të kemi parasysh edhe faktin që kreditë edhe mund të na i japidh, po kurrë të mos mendojmë se ata do t'i realizojnë në afat, sepse do të përpilen me të gjitha mënyrat të na pengojnë. Ne nuk do të bëjmë anjë lëshim ideologjik dhe politik.

Në këtë rrugë nuk do të ecim qorrazi. Për t'i dalë përpara çdo të papriture që mund të ndodhë nga ana e tyre, duhet të mendojmë dhe të marrim masa të atilla që të mos zihemi në befasi. E kam kurdoherë fjalën në çështjen e kredive. Për këtë qëllim të kemi një plan duke parashikuar variantin më të keq, sikur kreditë nuk do të na i japin fare, prandaj të parashikojmë se çfarë mund të prodhojmë vetë. Neve do të na duhet të marrim masa serioze për të realizuar e për të tejkaluar planet tonë, me qëllim që të disponojmë sa më shumë kliring ose devizë për t'i siguruar në vende të tjera ato që nuk do të na japin kinezët. Vetëm kështu do të mund të përballojmë me sukses vështirësitë që do të na sjellin kinezët, në rast se nuk do të na i japin kreditë për nevojat më të domosdoshme për zhvillimin e forcave prodhuese të vendit tonë...

Çështja tjetër është ajo e marrëveshjeve me kliring. Situata për kliringun është akoma më e zorshme me ata, se na kanë vënë disa norma. **Së pari**, duke u bazuar në normat e tyre, ata duan që kontratat me ta t'i bëjmë dy herë në vit, në muajt prill dhe tetor. Kjo do të thotë që të shtyjnë livrimet dhe të frenojnë zhvillimin ritmik e në kohë të ekonomisë sonë. **Së dyti**, ata kanë ngritur çështjen e çmimeve stop. Kinezët janë për përdorimin e çmimeve ndërkombëtare. Ne u kemi thënë që të aplikohen ndërmjet të dyja palëve çmimet stop, ata na përgjigjen negativisht. Çfarë bëjnë ata? Bëjnë këtë që mallrat, të cilat duhet të na livrojnë, jo vetëm i mbajnë për të na vonuar, por bile dhe i shesin, i qar-

kullojnë për hesap të tyre dhe ne na njoftojnë se nuk na i kanë siguruar, se gjoja u ka krijuar vështirësi në ekonomi një herë tërmeti, herën tjetër grupi i të katërve etj., por në realitet ata i shesin gjetkë me çmime ndërkombëtare mallrat që duhej të na dërgonin neve në bazë të kontratave dhe kështu fitojnë valutë. Ne nga ana jonë ua dërgojmë mallrat në rregull, në bazë të marrëveshjeve. Së treti, është çështja e vaporëve, e dorëzimit të mallrave fob. Kinezët na thonë të gjejmë më parë vetë vaporë, pastaj të vemi të marrim mallrat sipas marrëveshjeve. Vaporë në botë ka plot, thonë ata, prandaj gjejini, u paguani qiranë, pastaj ejani të tërhiqni mallrat në portet kineze.

Një vështirësi tjetër në çështjen e ofrimit të mallrave me kliring është se kinezët mund të na thonë: «Ne do t'ju marrim këtë dhe atë mall, kurse këtë dhe atë tjetrin që na ofroni ju, nuk i marrim». Këtu bëjmë tregti, s'ke ç'thua. Ne do t'u kërkojmë që të na furnizojnë me këtë apo me atë mall, kurse ata mund të na thonë: «Këtë e kemi dhe jua japim, kurse këtë tjetrin nuk e kemi». Këtu është fjala për mallrat tradicionale që kemi shkëmbyer me kinezët deri sot. Pra, të gjitha këto vështirësi e pengesa ne duhet t'i parashikojmë me kohë dhe një nga një. Këto çështje duhen zgjidhur me kujdes.

Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që të eliminojmë sa të jetë e mundur vështirësitë që do të na nxjerrin udhëheqësit kinezë. Tregu kinez ka shumë rëndësi për ekonominë e vendit tonë, mbasi në Kinë ne eksportojmë një numër të madh mallrash. Prandaj të

kujdesemi që të mos e humbasim këtë treg, pavarësisht se ideologjikisht jemi në kundërshtim me udhëheqësit kinczë. Në qoftë se ata i presin fare marrëdhëniet tregtare me ne, kjo është punë tjeter.

Këto janë probleme shumë të rëndësishme, që duhet t'i kapërcejjmë me punë, me luftë, pa kompromise ideologjike dhe politike, por edhe duke bërë përpjekje të shumta për sigurimin e tregjeve në vende të tjera. Kjo nuk është një punë kaq e lehtë, siç mendojnë disa, por kërkon që të merren masa të forta organizative. Është e domosdoshme të bëhet një punë e tërë shkencore në sektorin e tregtisë së jashtme, që nga ministria e deri në bazë.

Ky ishte një shpjegim i shkurtër që desha t'ju bëja, më shumë për të sqaruar shokët e rinj të udhëheqjes për këtë çështje, që ta dinë edhe ata se e tillë është situata e marrëdhënieve me Partinë Komuniste të Kinës.

Për lctrën keni ndonjë vërejtje, shokë?

*Të gjithë anëtarët e Byrosë Politike njëzëri u shfaqën se janë dakord me projektlet rën e paraqitur për shqyrtim dhe nuk kanë asnjë vërejtje.*

Letrën t'ia dërgojmë ambasadorit tonë në Pekin për t'ia dorëzuar Li Hsien Nicnit. Këtij ai t'i komunikojë se është i ngarkuar nga ana e Komitetit Qendror të Partisë sonë për t'i dorëzuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës përgjigjen e notës së tyre verbale të datës 8 dhjetor.

Me këtë rast dua të theksoj që vigjilencia jonë në këto situata duhet të jetë e madhe. Këtu punojnë spe-

cialistë kinezë. Sjellja me ta duhet të jetë si kurdoherë miqësore, korrekte, në fryshtë e bashkëpunimit, por edhe vigjilentë të jemi.

*Botohet për herë të parë, me  
disa shkurttime, sipas tekstit të  
nxjerrë nga procesverbali i  
mbledhjes së Byrosë Politike  
të KQ të PPSH, që gjendet  
në AQP*

# TUFËZIMI I BAGËTIVE BËNET PËR TË PËRMIRËSUAR JETESËN E KOOPERATIVISTËVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**22 dhjetor 1976**

Në materialet që na janë paraqitur ka disa gjëra që më ngjan se nuk janë shprehur qartë. Për shembull, në një vend në materialin e paraqitur nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës thuhet: «Çdo familje mishin dhe leshin i merr nga bagëtitë e veta». Kjo do të thotë që sasinë e leshit e merr sipas numrit të krerëve që ka në tufë apo pikërisht nga bagëtitë që ka dorëzuar?

Do të ishte mirë që shokët e rretheve të na jepnin disa shpjegime për lopët, sidomos për ato që janë të sistemuara në stalla të përbashkëta, në lidhje me çmimin e ushqimeve që përdoren për to dhe me furnizimin

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për problemet që dilnin nga përvoja e deriatëhershme e të ushqyerit dhe e ruajtjes kolektive të bagëtive të oborreve kooperativiste.

me qumësht të të zotërve të tyre, përvçë mishit, lëkurëve etj.

Lopët te ne, përgjithësisht, ndahen në tri kategori: në lopë të vendit, gjysmë të përmirësuara dhe lopë të racës. Po çfarë të ardhurash kanë konkretisht kooperativistët nga një lopë, në secilën nga këto tri kategori? E keni bërë ju këtë llogari apo jo? Me këtë rast na sqaroni edhe diçka që ka të bëjë me rritjen e viçave. Sa është pjellshmëria në këto lopë dhe sa ka qenë para tufëzimit të tyre? A i keni nxjerrë këto të dhëna? Ju thoni se kooperativistët fitojnë nga pjellshmëria e lopëve. Atëherë bëjmë pyetjen: Sa për qind është pjellshmëria e këtyre lopëve, sa është e atyre që janë të kooperativës dhe sa ka qenë më parë? Kështu do të shikojmë se çfarë përfitojnë kooperativistët.

Problem tjetër është se ku i ushqejnë kooperativistët lopët e oborreve. Teorikisht e dimë që caktohen vende të veçanta për tufën e kooperativës dhe vende të tjera për lopët e oborreve. Dimë, gjithashtu, se ka dhe rregulla të posaçme për t'u zbatuar në praktikë ky orientim. Por çështja është se a ka shkelje e dëmtime të pronës kooperativiste nga këto tufa. Kullotin lopët e oborreve në vendet ku nuk duhet të futen, apo jo? Vërtet që puna politike ka luajtur rolin e saj, por nga ana tjetër të kemi parasysh se u ngushtua dhe vendi ku mund të kullotin bagëtitë. Kjo çështje është objektive.

Po ngordhjet e bagëtive dhe dëmtimit e tyre nga kafshët e egra në tufat e kolektivizuara a janë pakësuar? Lidhur me këtë problem duhet bërë me njerëzit punë sqaruese që të kemi sa më pak dëmtime.

Vëmendje të veçantë kërkon edhe administrimi i të ardhurave nga bagëtitë e tufëzuara. Si bëhen llogaritë për to? Në cilat periudha të vilit kooperativistët e marrin çdo ditë prodhimin dhe a shpërndahet drejt ai? Këtu e kam fjalën sidomos për qumështin. Pra, desha të di se si bëhet shpërndarja e prodhimeve anëtarëve, çdo ditë apo një herë në muaj, në mënyrë të barabartë, duke caktuar sasinë e qumështit sipas numrit të krerëve të bagëtive? Për shembull, i thuhet secilit kooperativist se, duke zbritur shpenzimet, ty të bie për të marrë kaq apo aq qumësht dhe, po të dojë, ta marrë sot, po të ketë qejf, le ta marrë një ditë tjeter, ose më vonë, djathë apo gjalpjë? Po nuk i pëlqeu as kështu, në fund, atë që i takon mund ta marrë në para. Po për shpërndarjen e mishit nga këto tusa përsëri llogaritet mesatarja e peshës së bagëtisë? Kurdoherë me mesatare shpërndahen produktet blegtoriale? Si mendoni ju, cila duhet të jetë në të ardhmen tendanca për zhvillimin e kafshëve të oborreve? Keni menduar ndonjë gjë ju, në rrethet tua-ja, rreth këtyre çështjeve? Si del më mirë: të shtojmë lopët dhe të mbetemi me këtë numër bagëtish të imëta që kemi, apo të shtojmë bagëtitë e imëta dhe të ulim numrin e lopëve? Lopët kemi mundësi t'i përmirësojmë që të na pjellin viça të mirë, të cilët t'i blejë kooperativa. Nuk duhet të harrojmë se lopa me kalimin e kohës do të plaket. Sigurisht ky problem nuk është për një, dy, as edhe për dhjetë vjet, por i vazhdueshëm. Sido-qoftë, në këtë drejtim duhet ecur me llogari dhe se si do të vejë zëvendësimi i tufave të lopëve në të ardhmen duhet të studiohet që tani.

A keni ndonjë plan konkret ju për shtimin e lopëve dhe për përmirësimin e racës së tyre? Nuk e kam fjalën për ta shtuar lopën jashtë masës, por për të mbajtur një numër të arsyeshëm, në bazë të kushteve të rrethit tuaj, për të përmirësuar racën dhe për të shtuar ushqimet. Ç'bëhet praktikisht për këtë? I keni stacionet e ndërvzimit? Sa zooveterinerë keni në të gjithë rrethin? A ka përmirësim të racës dhe, nëse ka, ky përmirësim a reflektohet në prodhim, për shembull, në rritjen e sasisë së qumështit, të mishit etj.? Për shtimin e bagëtive të imëta në kooperativa janë caktuar ritme, por kjo shtesë do të bëhet me blerjen e bagëtive nga oborret? A kërkojnë kooperativistët shumë qengja nga të oborreve për të therur? Bagëtitë e tufëzuara në disa vende i mbajnë me nishan. Por, kam mendimin se atje ku janë me nishan, ndjenja e pronës është më e theksuar, prandaj në këto fshatra duhet të punohet më shumë ideopolitisht.

Lidhur me stallat për këto bagëti, është e mira që të bëhen të thjeshta dhe të hiqet dorë nga mania pér t'i bërë të kushtueshme. Ju e dini që stallat pér bagëtitë e imëta duhet të jenë të ajrosura.

Edhe pér përmirësimin e kullotave duhet të punohet më shumë. Kudo ekzistojnë mundësi akoma më të mëdha pér të rritur rendimentet, prandaj t'i përvise mi punës dhe të përmirësojmë kullotat, bagëtitë, organizimin e tufave; të sigurohen farëra të llojeve të mira etj.

Rol të madh në këtë drejtë luajnë specialistët e bujqësisë. A kontrollohen këta pér të parë nëse e kanë me pasion punën, apo jo? Ju, si sekretarë të komiteteve

të Partisë të rretheve për ekonominë, kujt i jepni kohë më tepër, bujqësisë, industrisë apo tregtisë? A e përdorni kontrollin punëtor e fshatar për të verifikuar zbatimin e rregullave e të vendimeve, që të lehtësoni kështu punën tuaj si komitet partie? Njerëzit që bëjnë pjesë në grupet e kontrollit punëtor e fshatar duhet t'i mësoni dhe t'i instruktoni se si të punojnë për ta kryer këtë detyrë dhe të bëni seminare me ta. Për këto seminare aktivizoni specialistët, se këta i njohin dhe i dinë ligjet. Komiteti Qendror i Partisë, që ka marrë vendimin për të organizuar kontrollin punëtor e fshatar, është bazuar në mësimet e Leninit, i cili thekson se specialistët, sidomos juristët, duhet të përdoren për të organizuar seminare të vecanta, ku të instruktojnë pjesëtarët e grupeve të kontrollit punëtor e fshatar. Edhe ju në rrethet tuaja duhet t'i aktivizoni për këtë qëllim juristët e specialistët që keni. Me këtë nuk dua të them që sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit nuk i dinë ligjet, por si e di zanatin e vet prokurori apo gjykatësi, nuk mund ta dinë sekretarët e komitetit të Partisë apo shokët e tjerë të byrosë.

*Pasi iu dha përgjigje pyetjeve të bëra e pas diskutimeve të pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

Problemi i ruajtjes dhe i të ushqyerit kolektiv të bagëtive të oborreve kooperativiste nuk është aq i thjeshtë, përkundrazi, është mjaft i komplikuar. Prandaj vështirësitë e komplikacionet duhen studiuar me kujdes dhe duhen pasur parasysh në punën që bëhet për kapërcimin e tyre.

Sigurisht, ne kemi luftuar dhe do të luftojmë që ta shtojmë prodhimin e drithit, sepse kjo, në radhë të parë, do të na japë mundësi të sigurojmë bukën. Me një pjesë të tij do të ushqejmë edhe bagëtitë, që të marrim sa më shumë prodhime edhe nga blegtoria. Por në qoftë se prodhimi i foragjereve do të shtohet me këto ritme që po shtohen drithërat e bukës, atëherë do të arrijmë t'u afrohemë kuotave të racioneve ushqimore për bagëtitë. Them do t'u afrohemë, sepse prapë edhe për një kohë mendoj se do të jemi larg asaj që t'i ushqejmë ato si duhet; kam parasysh jo vetëm bagëtitë e oborreve, por edhe tufën kolektive të kooperativës. Prandaj të luftojmë për zbatimin e direktivës që kemi dhënë për përdorimin e drejtë të fondit të tokës që kemi siguruar nga shkurtimi i oborreve kooperativiste. Pavarësisht se, siç u tha këtu, plani mund të jetë realizuar e tejkaluar, ai është i pamjaftueshëm. Sigurisht, foragjeret bagëtitë i hanë, po mos u ngopni me lugë të zbrazët. Çështja është që planet e foragjereve dhe të mbjelljes intensive të kullotave nuk po realizohen. Dhe kjo duhet zgjidhur, pse tjeter rrugë nuk ka. Mos kërkoni toka të tjera për t'i mbjellë me foragjere apo për t'i bërë kullota, se nuk ju jepen.

Këto organizime, që kanë të bëjnë me tufëzimin e bagëtive të oborreve kooperativiste, janë forma paraprake dhe të mira, por do të mbeten vetëm forma, në qoftë se, siç tha zëvendësministri i Bujqësisë, shoku Spiro Lengo, nuk do të shoqërohen edhe me një organizim të fortë, me një disiplinë të shtrënguar në të gjitha drejtimet: në dhënien e ushqimeve, në ndarjen e

të ardhurave, në uljen e kostos së shpenzimeve etj. Dhe të gjitha këto nuk mund të zbatohen kudo në mënyrë të njëllojtë. Këtë ta ketë mirë parasysh Partia.

Pra, qëllimi i tufëzimit është shumë i mirë. Bagëtitë personale të kooperativistëve të grumbullohen në për stalla kolektive e të kategorizohen. Krahas kësaj, të bëhen përpjekje, sa të jetë e mundur më shumë, edhe për përmirësimin racor të tyre, me qëllim që prodhimet blegtoreale të rriten jo vetëm nga ushqimi që do të hanë bagëtitë, që është kryesorja, por edhe nga përmirësimi i racës.

Në çështjen e tufëzimit të bagëtive personale ka edhe gjëra që nuk zbatohen sipas normave që kemi diskutuar. Konkretisht, stallierit që kujdeset për këto lopë, i intereson më shumë të jetë në rregull me kooperativën e me lopët e saj, sesa me anëtarin e kooperativës e me lopën e tij. Me këtë dua të them se racioni i ushqimit që u është caktuar nga kooperativa tri kategorieve të lopëve, u vete përgjysmë, ose treçerek; çereku tjetër u vete lopëve të kooperativës, domethënë lopëve të racës. Këtë brigadieri e stallieri e bëjnë sepse nga lopët e oborreve s'marrin asgjë veç rrogës që u është caktuar, ndërsa nga ato të kooperativës marrin normën e të tjera shpërblime që kanë të bëjnë me pjellorinë, me prodhimin e qumështit etj. Domethënë, merr 1 500 litra qumësht anëtar i kooperativës nga lopa apo merr 1 000 litra, aq u bën brigadierit e stallierit.

Çështja tjetër është që, derisa pranojmë grumbullimin e këtyre bagëtive (dhe duhet t'i grumbullojmë), ne duhet të bëjmë llogaritë e nevojshme. Po si dhe çfarë

të llogaritim? Duhet të llogaritim atë leverdi të domosdoshme që na shtyn t'i mbajmë këto lopë të grumbulluara në tufë, se kështu rritim sasinë e qumështit, të mishit etj. Të gjitha këto duhet t'i parashikojë një kooperativë moderne dhe e organizuar mirë. Pavarësisht se këto lopë nuk janë të sajat, por të oborreve, ato duhet t'u sjellin anëtarëve të ardhura dhe t'u sigurojnë qumështin e prodhimet e tjera blegtoreale që u nevojiten. Vetëm kështu kooperativistët do t'i lënë me dëshirë bagëtitë në tufën kolektive, sepse këtë tufëzim ne e bëjmë për të përmirësuar jetesën e tyre.

Duhet të kemi, gjithashtu, parasysh edhe çështjen që ngriti shoku Hysni: në qoftë se kooperativisti nuk i çon bagëtitë e tij në tufë, ku do të hanë ato dhe a ka dëme prej tyre kooperativa? Unë mendoj se me siguri ka dëme, të cilat mund të llogariten edhe në të holla. Po kush i llogarit këto dëme? Asnjëri, bile as kooperativa. Përkundrazi, kjo, në këto raste, si i thonë fjalës, mbyll sytë. Në qoftë se nuk është djali i xhaxhait ai që e kullot lopën ku nuk lejohet dhe që bën dëme, mund të jetë vëllai i gruas së djalit etj. Të kemi parasysh se në fshat njerëzit janë të pleksur me njëri-tjetrin dhe, për pasojë, para rasteve të tillë mbyllët syri. Pra, të kemi parasysh që, në qoftë se anëtari nuk e çon lopën në tufë, mund të na dëmtojë kooperativën.

Kooperativisti vetë mund të shkojë edhe në punë e të mos harxhojë kohën me lopën, se, për ta kullotur atë, jo rrallë, dërgon kalamanin që ka në shtëpi. Dhe kalamanin kooperativa s'po ra e kontrollon dot se ku e kullot lopën. Ndoshta as mund ta dënojë për dëmet që

bën, se del i ati e zë e thotë: «Po ja, e bëri kalamani dëmin, çfarë t'i bëj unë atij, i kam thënë, i kam tërhequr veshin, bile i kam futur edhe nja dy pëllëmbës etj., etj., por, ama, kalamani e bëri dëmin dhe lopën e ushqeu!

Janë një sërë faktorësh që duhet të studiohen më me kujdes e me llogari, që të gjendet rruga më e përshtatshme e më ekonomike si për kooperativën, ashtu edhe për ekonominë e oborrit. Çështja është që të mos dëmtohet as kooperativa, as anëtari i saj, përkundrazi, edhe kooperativistit t'i përmirësohet jetesa, por edhe shtetit e kooperativës t'u rriten të ardhurat.

Zëvendësministri i Bujqësisë foli këtu për çështjen e oborreve kooperativiste. Derisa Partia e ka lejuar oborrin kooperativist, është e nevojshme që ky të ekzistojë akoma edhe për një kohë, që t'u shërbuje familjeve kooperativiste për të plotësuar një pjesë të nevojave të tyre. Unë mendoj se është mirë që sipërfaqja e tokës, e siguruar nga shkurtimi i oborreve që u bë vite më parë, të ndahet, duke u dhënë orientim kooperativave që një pjesë të kësaj ta mbjellin me foragjere, për të siguruar ushqim për bagëtinë e tufëzuar nga oboret, dhe pjesën tjetër me perime apo me bimë të tjera për nevojat e anëtarëve. Kjo punë duhet llogaritur mirë, duke mbajtur parasysh si anën materiale, ashtu edhe atë psikologjike, sidomos mentalitetin e fshatarësisë. T'u shpjegohet kooperativave që ndarja e kësaj sipërfaqeje në këtë mënyrë është e nevojshme të bëhet. Bile kjo jo vetëm t'u shpjegohet, por edhe të punohet në mënyrë të tillë që kooperativisti ta shohë në praktikë

dobinë e kësaj mase, si të thuash, «ta prekë me dorë», se po i sjell më shumë mish, qumësht, gjalpë etj., pra ta ndiejë se ky organizim i ri i siguron tani atij më shumë prodhime. Në qoftë se fshatari do të bindet përkëlë, atëherë ne do të kemi sukses dhe do të ecim më tej, duke e përhapur kudo këtë formë organizimi. E them këtë se tokat që morëm nga shkurtimi i oborreve kooperativiste, duhej të përdoreshin përmblotjet e atyre bimëve që do të shërbenin përtë furnizuar kooperativistët me zarzavate, foragjere e ndonjë prodhim tjetër. Por fakt është se kjo që vendosëm nuk u zbatua siç duhet. Pse nuk u zbatua? Mos vallë nuk deshën kooperativistë?! Mos nuk deshën kryetari i kooperativës, sekretari i Partisë apo asambleja?! Këtu ka shumë probleme që kanë penguar realizimin e kësaj direktive, por kryesorja është se nuk arriheshin rendimentet e bimëve të ndryshme nga kooperativa. Jo vetëm kaq, por nuk realizoheshin as planet e parashikuara. Atëherë arriti puna që këto toka të destinuara përfurnizimin e kooperativistëve të përdoreshin përqëllime të tjera.

Çështja tjetër që u ngrit këtu ka të bëjë me tokën e oborreve që kjo t'i kalojë e tëra kooperativës. Një masë e tillë do të kishte pasoja jo të mira. Po të bëhet ky hap, do të lindë pikërisht ai dyshim përtë cilin na foli këtu shoku nga Skrapari. Me këtë rast fshatarit do t'i rritet akoma më shumë dyshimi, sepse toka, qoftë edhe në atë masë që i është lënë, ka shumë më tepër rëndësi përtë sesa pesë kokë bagëti. Prandaj, siç ka theksuar vazhdimit Partia, ne duhet të ecim

gradualisht e me kujdes në këtë drejtim. Edhe në fillim, kur morëm masën për ngushtimin e oborreve kooperativiste, ne patëm shqetësimë. Pati atëherë fshatarë që thanë se «tani një copë tokë sa një shami xhepi na latë». Sidoqoftë, në sajë të patriotizmit të madh të fshatarësës së Partisë, si dhe të një organizimi më të mirë të punës në kooperativat, u arrit që të mos zinte vend ajo pikëpamje mikroborgjeze e theksuar te fshatarësia në lidhje me tokën.

Tash, në rast se do ta merrnim këtë masë të re, kjo nuk do të ishte në favorin tonë. Tokat që do të grumbullonim, kooperativat mund të na i mbillnin me bimë të tjera, fshatari nuk do të merrte dot nga lopa ose nga bagëtitë e imëta të tufëzuara nga oborri as atë sasi të vogël prodhimesh që merr tash. Kështu do të prishej ekuilibri në të ardhurat e tij, do të dëmtohej vija e Partisë dhe mund të krijohej pakënaqësi. Por kjo nuk do të thotë që të mos punojmë me kujdes për t'i bindur fshatarët se në të ardhmen oborri mund të ngushtohet edhe më, kur të rriten prodhimet e kooperativës. Po, një propagandë të tillë ta bëjmë. Vetëm se këto punë duhet t'i bëjmë me llogari. Pra, vetëm atëherë kur të na dalë që atij që jep gjysmën e sipërfaqes së tokës të oborrit, kooperativa, në mënyrë të sigurt, në bazë të llogarive, t'i sigurojë po aq të ardhura sa merrte kur e administronte vetë këtë sipërfaqe. Po të veprohet kështu, atëherë ai s'ka çfarë të thotë. Prandaj marrja e sipërfaqes së tokës së oborreve të kooperativistëve dhe përdorimi i saj si për të sigruar ushqime për bagëtitë e tufëzuara, ashtu edhe për të plotësuar me pe-

rime nevojat e anëtarëve, nuk duhet bërë tani, më duket mua, ndërsa të gjitha masat e tjera që propozohen, mendoj se duhen zbatuar.

Në këtë mbledhje na u bë një pasqyrë më e qartë e gjendjes së këtij problemi në rrethet që kemi thirrur në raport; shkëmbyem mjaft mendime me shokët e këtyre rretheve dhe krijuam një ide se si duhet të jetë afërsisht gjendja në gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, me këtë rast shkëmbyem eksperiencë edhe midis njërit-tjetrit. Tani të thellohemi, që problemi i organizimit të tufave kolktive të bagëtive të oborreve të ecë përpara gradualisht dhe të sjellë rezultate sa më të mira si përfamiljet kooperativiste, ashtu edhe për pronën e përbashkët.

—  
*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# TE SIGUROHET KURDOHERË NJË BASIKËPUNIM I PËRSOSUR MIDIS TERRENIT DIJE USHTRISE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 dhjetor 1976

Jam dakord me vërcjtjet e shokëve që diskutuan në këtë mbledhje.

Për sa i përket çështjes së bashkëpunimit midis organeve dhe organizatave të Partisë në terren me ato të ushtrisë, vërehet se ka përmirësimë në krahasim me të kaluarën, por duhen bërë përpjekje që këto përmirësimë të jenë akoma më të mëdha.

Duke lexuar materialet, vërej se, pavarësisht nga fakti që ky bashkëpunim është forcuar, në disa raste ai bëhet vetëm midis kuadrove të terrenit dhe atyre të ushtrisë dhe jo edhe midis organizatave-bazë të Partisë. Por kjo çështje ka rëndësi parimore.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e udhëzimit të Byrosë Politike për forcimin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit midis organeve dhe organizatave të Partisë në terren me ato të ushtrisë».

Në materialet e paraqitura këtu flitet për ndihmën konkrete që japid shokët drejtues, por nuk u bëhet një analizë e thellë problemeve që duhet të ketë gjithë Partia, dhe kryesisht organizatat-bazë të saj, për mbarëvajtjen e punëve në ushtri.

Problemi i madh i bashkëpunimit midis ushtrisë e terrenit duhet të jetë i planëzuar. Drejtuesit e organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë në terren dhe në ushtri të përcaktojnë dhe të koordinojnë mbledhjet, takimet, aktivitetet dhe temat e përbashkëta dhe t'i përfshijnë ato në planet e tyre të punës.

Të mos harrojmë se kryesisht në terren edukohet pjesa më e madhe e ushtrisë dhe kjo edukatë masive ndihmon shumë në forcimin e saj. Nuk e ndihmon forcimin e ushtrisë vetëm dërgimi atje i katër ose pesë kuadrove nga terreni, sado të zotë që të jenë këta. Në qoftë se nuk e kemi kuptuar drejt këtë çështje, atëherë nuk kemi kuptuar si duhet teorinë për Shkollën e Lirë Ushtarake.

Shkolla e Lirë nuk mund të përparojë ashtu siç kërkohet, në rast se organet dhe organizatat e Partisë në terren nuk marrin në analizë në mbledhjet e tyre, duke vënë në rendin e ditës, edhe problemet ushtarake. Në këto mbledhje është e nevojshme të flitet konkrektisht se si duhet të bashkëpunojnë kuadrot drejtues e komunistët e terrenit me ata të ushtrisë. Po nuk u veprua kështu, organizatat e Partisë, sipas mendimit tim, nuk do të dinë se çfarë problemesh do të shtrojnë në organizatat e masave, se vetë ato nuk janë marrë me to siç kërkohet dhe siç pretendohet të bëhet.

Në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës bëhet një numërim i gjatë i «fakteve» të një bashkëpunimi, ndihme, kontrolli «të përsosur» mes shokëve drejtues të organeve e organizatave të Partisë të terrenit dhe atyre të ushtrisë. Por ne të gjithë e dimë se për të arritur përsosmërinë na duhet akoma shumë punë dhe nuk na lejohet që të vetëkënaqemi, që mbas sukseseve të mos shohim të metat e dobësitë në punë, siç u veprua në një njësi ushtarake, drejtuesit e së cilës nuk na njoftuan për disa dobësi që kishin ndodhur. me pretekstin «për të mos shqetësuar udhëheqjen». Ne nuk duhet të lejojmë qëndrime të tillë, por t'u presim rrugën raporteve euforike. Nuk duhet të harrojmë që akoma kemi dobësi e të meta. Që t'i mënjanojmë ato, duhet të bëjmë akoma shumë. Për të ecur gjithnjë përpresa, duhet luftuar vazhdimeshi e vazhdimeshi.

Kur flasim për bashkëpunim, kemi parasysh çështjen e integrimit të punës ushtarake në jetën e Partisë dhe të masave, pse tërë populli ynë është ushtar dhe si i tillë ai duhet të edukohet e të përgatitet edhe ushtarakisht.

Një nga shokët ushtarakë këtu ngriti një problem që më duket se është i drejtë. Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore duhet të futet në programet mësimore të shkollave në mënyrë sa më konkrete. Për shembull, ai mund të futet edhe në programin e lëndës së historisë. Por mendoj se duhet studiuar se si mund të futet ky art në programin e kësaj lënde. Sepse në qoftë se Artin tonë Ushtarak e futim në programin e kësaj lënde ashtu

siç mendojnë disa nga shokët ushtarakë, atëherë nuk do të ketë më histori.

Për të konkretizuar çështjen për të cilën po flas, më lejoni të jap një shembull. Gjysmë shekulli më parë, kur isha nxënës në Liceun francez të Korçës, kisha vënë re që në tekstet e historisë flitej edhe për çështje politike e ideologjike. Le të marrim, bie fjala, periu-dhën e feudalizmit në Francë në kohën e monarkisë së pakufizuar të Luigjit të 14-të. Në ato tekste kishte mendime të shprehura për karakterin e regjimit, për luftën që ka bërë mareshali i Luigjit të 14-të, i quajtur Vilar, kundër kamizarëve, të cilët ishin fshatarë që mundën mareshalët e mbretit të Francës dhe që udhë-hiqeshin nga një lopar. Në histori tregohej për planet e luftës së mareshalit Vilar dhe të komandantit të kamizarëve. Po kështu, për politikë dhe ideologji flitej edhe në tekstet e historisë së Revolucionit Francez. Po të shikoje historinë e këtij revolucioni, aty flitej për karakterin e tij, për klasat, për forcat lëvizëse, për qëllimet, për luftën midis fraksioneve etj., por bëhej fjalë edhe për betejat që u zhvilluan nga revolucionarët me shtetet aleate në kohën e revolucionit.

Po të studiohet historia e Napoleonit dhe e betejave të tij, aty duken gjithë karakteri i regjimit, si dhe strategjia e taktika e luftërave që bënte ai.

Më kujtohen akoma nga shkolla se si sulmoi Vilari dhe si sulmuan kamizarët kundër tij, si sulmuan Brunsviku, Bugurjeku, si u zhvillua beteja e Vaterlosë, ku ishin anglezët, francezët dhe nga erdhën prusianët. Të tëra këto veprime në tekst tregoheshin në hartë me

shigjeta e me skica, ashtu siç bëni ju ushtarakët sot. Ata paraqitnin skica të tilla që pasqyronin qartë tak-tikat dhe strategjinë.

Luftën tonë Nacionalçlirimtare ne e shpjegojmë nga ana politike dhe ideologjike, por duhet ta shpjegojmë më mirë edhe nga ana ushtarake. Duhen zgjedhur luftimet dhe betejat më karakteristike të zhvilluara, me qëllim që momentet, ku tregohet taktika ushtarake e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, të pasqyrohen në mënyrë të shkurtër e të harmonishme në Historinë e Shqipërisë.

Historinë e Skënderbeut e studiojnë në shkolla si përrallë, pa folur për strategjinë dhe për taktikat e luftërave të tij fitimtare. Të mësohen te ne taktika dhe strategjia e Napoleonit në beteja, pa ditur më parë ato të Skënderbeut, kjo nuk na lejohet. Prandaj e theksova që e gjej të drejtë mendimin që u hodh këtu për futjen e Artit Ushtarak të Luftës Popullore në programet e shkollave, vetëm se problemet duhen përpunuar në mënyrë të përshtatshme. Këtë çështje që përmenda për luftërat në periudha të ndryshme të historisë së Francës, nuk i përgatitnin ushtarakët, por i studionin e i shkruanin pedagogët e historisë. Ushtarakët në shkolla kanë detyra të tjera, të cilat duhet t'i kryejnë mirë. Arti Ushtarak i Luftës Popullore të futet në procesin mësimor aq sa është e nevojshme për një tekst historie. Kjo gjë duhet bërë. Këta shembuj i solla për të argumentuar atë që thashë në fillim: që puna ushtarake duhet të integrohet në jetën e Partisë dhe të masave.

Të mos mendojmë për asnjë çast se është zhdukur

plotësisht fryma e vjetër e ushtrisë së kazermës, e «hierarkisë» dhe e «superiorit» arrogant, që u kundërvihet normave të reja që ka futur Partia në ushtri. Mësimet e Partisë për punën në ushtri po zënë vend gjithnjë e më shumë, por tendencat e punës jo të mirë të mëparshme nuk janë zhdukur plotësisht. Në këtë drejtim këtu u bënë vërejtje të drejta, me të cilat jam dakord. Edhe kuadrot që shkojnë nga terreni në ushtri të mos mendojnë asnjëherë se janë ata që «do ta shpëtojnë situatën». Duhet njojur fakti që disa prej tyre nuk kuptojnë se c'kanë për detyrë të venë, siç u tha edhe këtu, të marrin pjesë në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë në ushtri. Në qoftë se kuptohet e zbatohet kështu ndihma ndaj ushtrisë, atëherë puna jo vetëm nuk do të shkojë përpara, si e dëshiron Partia, por do të mbetet në vend ose do të përparojë më ngadalë. Vendin e mendjemadhësisë te disa kuadro duhet ta zërë modestia.

Mes kuadrove ushtarake dhe atyre të terrenit është e domosdoshme të krijojen marrëdhënie të ngrohta, shoqërore, komuniste. Kuadrot ushtarake mund të mendojnë: «Ja, erdhën këta të terrenit që të ndreqin të metat në ushtri, por ne jemi më të zotë, se i njohim me themel çështjet ushtarake». Kurse kuadrot e terrenit mund të mendojnë: «Ne jemi më të zotë dhe më me përvojë në çështjet e Partisë sesa ushtarakët». Jo, shokë, këto gjykime përcmuese të njërsë palë kundrejt tjetrës nuk duhet të ndodhin. Këtu duhet të bëhet një integrim i shëndoshë marksist-leninist. Prandaj insistoj që ky problem i madh nuk është vetëm i disa kuadrove, por është i gjithë Partisë, në terren e në ushtri. Ko-

unistët, qofshin në organizatën-bazë të Partisë të terrenit, qofshin në atë të repartit ushtarak, që të gjithë të përgatiten seriozisht ushtarakisht për kohën e luftës eventuale. Është e drejtë ajo që tha sekretari i komitetit të Partisë të një njësie këtu, se të gjithë komunistët duhet ta dinë që, kur të bëhet mobilizimi në kohën e luftës e kur të bjerë borja, siç i thonë fjalës, ata të jenë në ballë të luftës e të qartë për detyrat e reparteve dhe të organizatave-bazë të Partisë të ushtrisë ku bëjnë pjesë. Prandaj që më parë ata, nëpërmjet stërvitjes, të kenë fituar zotësinë ushtarake, politike e ideologjike që të udhëheqin luftën në momentet krucale që kalon atdheu, ndryshtë nuk mund ta kryejnë detyrën si duhet.

Edhe një herë e theksoj se nuk mjafton të interesohen vclëm njerëzit e udhëheqjes së Partisë dhe të pushtelit në rreth për çështjet ushtarake. Ata duhet absolutisht të interesohen, por duhet të interesohen gjithë Partia dhe masat e jo vetëm gjatë kohës që zhvillojnë stërvitjen në Shkollën e Lirë Ushtarake, por të gjenden koha dhe mënyrat për t'i nxitur njerëzit të interesohen vazhdimisht për çështjen e mbrojtjes edhe jashtë kohës së planëzuar.

Për bashkëpunimin midis organizatave të Bashkimit të Rinisë të terrenit me ato të ushtrisë, është i njëjtë problem dhe e njëjtë zgjidhje si me Partinë.

Mund të mos jetë plotësisht kështu, por mendoj që në organizatat-bazë të Partisë në terren, me përrashtim të disa rasteve, nuk janë bërë mbledhje për çështje ushtarake. Mbledhje të tillë duhet të bëhen herë pas

here. Forumet e Partisë në terren nuk e kanë bërë ende metodë pune dhe rregull që problemet ushtarake t'i shqyrtojnë të planëzuara. Gjithashtu edhe forumet në ushtri nuk e kanë vënë ndonjëherë në rendin e ditës ndonjë problem shqetësues që ka terreni dhe këto, bashkë me konkluzionet përkatëse, t'ia kenë shtruar për të marrë masa komitetit të Partisë të terrenit ose komitetit ekzekutiv të këshillit popullor kompetent. Problemi të shtrohet duke shkuar në komitetet e Partisë dhe jo duke biseduar, siç u tha këtu, vesh më vesh me disa persona. Në këto takime të ngrihen jo vetëm problemet apo ankesat e një personi, që mund të zgjidhen sipas rregullave të caktuara, por çështje të rëndësishme të Partisë. Po kështu edhe komiteti i Partisë i terrenit e ka për detyrë të ngrejë probleme në komitetin e Partisë të njësisë ushtarake.

Për sa i përket pjesëmarrjes reciproke në aktivitet e organizuara në terren dhe në ushtri, dëshiroj të theksoj që në to të mos merret pjesë sa për të thënë që «vajtëm», por atje të kërkohet llogari deri në një përzbatimin e vendimeve, të sqarohen vazhdimesht kërkosat reciproke, të caktohen afatet e kryerjcs së punëve të planëzuara nga të dyja anët.

Aktive dhe mbledhje duhet të bëhen, por këto të kenë karakter pune dhe jo të organizohen si paradë raportesh vetëm informative, me fjalë dhe me ide të përgjithshme, pa kritikë dhe autokritikë ndaj veprimeve të gabuara dhe pa i vënë gishtin personit ose forumit që ka gabuar. Të mos ketë raporte pa propozime dhe detyra. Diskutimet e shokëve të ushtrisë ose të terrenit

që marrin pjesë në këto mbledhje, të përgatiten seriozisht që më parë. Një përgatitje e tillë është e arsyeshme dhe e drejtë të bëhet. E them këtë se, në bazë të të dhënave që kemi, disa nga shokët shkojnë në këto mbledhje vetëm që të dëgjojnë, ashtu sikurse ka dhe disa që bëjnë sikur dëgjojnë. Janë të paktë ata që mbajnë shënimë nga konkluzionet e raportit kryesor. Ka, gjithashtu, raste që disa nga pjesëtarët e mbledhjes nuk e marrin mundimin të korrigojnë ose të pasurojnë, në bazë të atyre që dëgjojnë, diskutimin që kanë përgatitur dhe që e kanë në xhep, por presin me «serenitet» t'u jepet fjala e të dalin në tribunë, ku të lexojnë ato që kanë shkruar më parë. Pikërisht një gjë e tillë nuk është e arsyeshme dhe as e drejtë të ndodhë.

Shumë herë disa komunistë të terrenit, por edhe nga ata të ushtrisë, mendojnë gabim, që, meqenëse raporti që mbahet do t'u vejë në bazë, do ta marrin dhe do të kenë kohë për ta lexuar e kështu nuk mbajnë fare shënimë në mbledhjet. Sipas tyre jo vetëm s'ka nevojë të merren shënimë, por as të vritet mendja e as t'u punojë koka për të gjitha ato çka thuhen në mbledhje. Një metodë e tillë pune nuk e nxit dhe nuk e pasuron intelektin, nuk e nxit mendimin krijues dhe nuk e lejon zhvillimin e iniciativës. Kjo mënyrë të punuari nuk jep gjykime të vlefshme dhe të pasura që më vonë të kthehen në veprime të partishme. Me këtë lloj praktike nuk mund të ngrihet niveli ideologjik e politik i shokëve.

Për këto arsy, si organizatat e Partisë në terren, edhe ato në ushtri duhet të thellohen më mirë e më

shumë në këto probleme e në shumë të tjera që nuk përfshihen në këtë material. Partia duhet të ketë, siç thotë populli: «Fjalë pak dhe punë shumë», pra, të ketë fjalë të pakta, por të sakta, punë shumë dhe të paqme. Llafologjia, raportet, udhëzimet e gjata e me fraza të përgjithshme, kudo, por veçanërisht në ushtri, janë pa bukë dhe si të tilla duhet të hidhen poshtë.

Arti ushtarak është një shkencë dhe si çdo shkencë tjetër ai është preciz. Precizioni gjendet në shtruarjen koncize të çështjeve që paraqiten pa lustër dhe sidomos pa i rrumbullakosur të metat që ndodhen rreth një problemi të caktuar. Ushtrisë duhet t'i mësojmë atë që ka është e nevojshme dhe e domosdoshme të dijë, t'i vëmë detyra, t'i japim urdhra të qartë, të zbatueshëm dhe të kontrollueshëm. Kështu duhet t'i mësojmë një-rëzit që t'u punojë koka dhe t'u punojë drejt, të kenë iniciativë dhe iniciativë frytdhënëse, të vetëveprojnë kudo e kurdoherë në bazë të mësimeve të Partisë dhe në mënyrë aktive, me një disiplinë të hekurt ushtarake, shkencore dhe proletare.

Këto vërejtje kisha lidhur me materialet dhe me diskutimet që u bënë. Në qoftë se shokët s'kanë përtë shtuar ndonjë gjë në lidhje me mendimet që shpreha, atëherë mund të mbarojmë me këtë çështje.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Për  
Ushtrinë Popullore» (Për-  
mbledhje reprash), vëll. II,  
Tiranë, 1984, f. 323*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Ushtrinë  
Popullore» (Përbledhje re-  
prash), vëll. II. Tiranë, 1984,  
f. 323*

# ZBËRTIIMI I MATERIALEVE TË KONGRESIT KËRKON PUNE KRIJUESE E THELLIM SHKENCOR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 dhjetor 1976

Për punimin e materialeve të Kongresit ju, të mbështetur edhe në mendimet e rretheve, keni ardhur në konkluzionin që të zhvillohen në çdo rrëth katër mbledhje të plenumeve të komiteteve të Partisë. Bile në materialin e paraqitur bëhet fjalë edhe për një plenum tjetër që duhet të bëhet më parë se këta të katër. Pra, deri në prill bëhen pesë mbledhje plenumi, me një fjalë, nga një mbledhje plenumi për çdo muaj.

Shtroj pyetjen: Zbërthimin dhe diskutimin rrëth materialeve të Kongresit do t'i bëjmë sa për t'i bërë, apo për të shpjeguar vijën e Kongresit, të cilën duhet ta lidhim me tërë veprimtarinë e shumanshme të Partisë? Pa dyshim që do të bëjmë këtë të dytën dhe jo

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punimin e materialeve të Kongresit të 7-të të PPSH.

një punë sa për të shkuar radhën. Eksperiencën e zhvillimit të tre apo katër plenumeve radhazi ne e kemi. po kemi, gjithashtu, edhe eksperiencën kur kemi bërë vetëm një mbledhje plenumi për një problem të tillë. Një plenum, natyrisht, duhet bërë medocmos. Por ka ndodhur që, edhe kur janë bërë disa plenume njëri pas tjetrit, ashtu edhe kur është bërë vetëm një, të mos vëmë re gjallërinë e duhur, gjë që do të thotë se nuk bëhet përherë një punë krijuese për problemin që shtrohet. Diskutimet, qoftë edhe kur është fjala për një problem të vetëm, në disa raste bëhen pak a shumë në një formë.

Një e metë tjetër është se në këto mbledhje të plenumit ndonjëherë nuk merren vendime, nuk hartohen që më parë projektdetyra, që pastaj të kthehen në detyra. Zakonisht diskutohet dhe miratohet vetëm raporti. Prandaj tani, përpara se të veprojmë, duhet të mendojmë mirë për këtë problem të madh, sepse mund të zhvillohen përsëri formalisht gjithë këto plume.

Në secilin prej tyre do të vejë një shok nga ne. Në plumin e parë, që nuk ka ndonjë problem të veçantë, kushdo që të vejë do të flasë në vija të përgjithshme. Më pas, kur të bëhet plumi për problemet e bujqësisë ose për çështjet ekonomike në tërësi, ai do të flasë më konkretisht. Po a jemi të bindur ne që për problemet ekonomike një plenum i vetëm do të na japë rezultatin që presim? Unë mendoj se nuk do të na japë atë që duhet. Por edhe po të mblidhen çdo muaj plume të komiteteve të Partisë të rrtheve, do të bëhet një qarkullim i dendur i anëtarëve të Komitetit Qendror,

se, natyrisht, nuk mund të vejë po ai shok disa herë në të njëjtin rreth. Njëri do të vejë të flasë në plenum, fjala vjen, për politikën e jashtme; më vonë, tjetri do të vejë të shtrojë problemet e ushtrisë, e kështu me radhë i treti, i katërti etj. Me një praktikë të tillë dyshoj se do të bëhen vetëm perifrazime e përsëritje për ato probleme që Kongresi i ka trajtuar shumë më mirë në raportet që janë botuar. Prandaj ta diskutojmë ca këtë çështje. Personalisht kam mendimin që në çdo rreth të bëjmë nga një mbledhje të plenumit për të caktuar metodën e punës që duhet ndjekur për punimin e materialeve të Kongresit. Kjo, metodologjia, ka shumë rëndësi për Partinë. Por për kë do të caktohet kjo metodologji? Natyrisht, në radhë të parë, për anëtarët e Partisë, pastaj edhe për masat e gjera të popullit.

Në raportet e Kongresit ka shumë probleme kapitale. Të marrim çështjet ekonomike e, më konkretisht, ato të bujqësisë, që është një degë me rëndësi kolosale për vendin tonë. Problemi shtrohet që të mendojmë e të punojmë se si t'i realizojmë deri në fund detyrat që shtroi Kongresi për këtë sektor. Ai ngriti për bujqësinë një sërë problemesh të rëndësishme, për zgjidhjen e të cilave duhen mobilizuar tërë Partia e tërë masat tona punonjëse. Parulla «Bujqësia — çështje e të gjithë popullit» të ngrejë në këmbë të madh e të vogël, por kjo nuk mund të bëhet menjëherë. Rëndësi ka, në radhë të parë, që çdo anëtar i të Partisë t'i ngulen në kokë detyrat që na vihen për të kryer në këtë sektor.

Sipas mendimit tim, punimi i materialeve të Kongresit do të ishte mirë të shkallëzohej në disa mbledhje.

Në se cilën prej tyre të diskutohen e të shoshiten të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një sektor të caktuar. Po kush do t'i bëjë këto mbledhje? Këto mendoj t'i organizojë komiteti i Partisë i çdo rrathi, duke aktivizuar në fillim grupe specialistësh sipas problemit. Kështu, fjala vjen, për bujqësinë të vërë në lëvizje agronomë, zooveterinerë, ekonomistë, pedagogë, administratorë të zotë ndërmarrjesh e kooperativash e të tjerë; për çështjet politike mund të aktivizojë gazetarë, kuadro të aparateve të Partisë, të bashkimeve profesionale e të pushtetit në rrath e të tjerë. Kështu mund të veprohet edhe për problemet e ushtrisë etj.

Po çfarë do të diskutohet e do të vendoset konkretisht në këto mbledhje? Të caktohet, fjala vjen, që brenda një afati, ta zëmë prej 6 ose 7 muajsh, të nijhen thellë dhe deri në fund çështjet që shtroi Kongresi. Gjatë kësaj kohe njërejt do të studiojnë raportet, por njëkohësisht do të kryejnë edhe detyrat që kanë. Atëherë, pra, rrathi nuk i mbledh menjëherë komunistët që ka në organizatat-bazë, por sipas profilit, në grupe me 100-150 veta. Në këto grupe komunistësh mund të mos flasë vetëm një, por të referojnë tre-katër veta të përgatitur. Atyre mund t'u bëhen edhe pyetje nga pjesëmarrësit. Ata, si specialistë që janë, do të jalin shpjegime me kompetencë. Por edhe pjesëmarrësit presupozohet që i kanë lexuar e i kanë studuar me kujdes, qysh më parë se të vijnë në mbledhje, raportet e Kongresit. Prandaj në mbledhje ata do të janë në gjendje të flasin e të diskutojnë për bujqësinë në fryshten e Kongresit e të bëjnë edhe pyetje. Kështu të veprohet edhe

në grupet e tjera. Në këtë mënyrë do të ngarkohen me detyra e do të aktivizohen të gjithë kuadrot më të përshtatshëm e më të specializuar, do të mobilizohet e tërë Partia. Por të bëhet kujdes që të fillohet me problemet më të ngutshme.

Me një fjalë, këto mbledhje duhen bërë në bazë të një planëzimi të studiuar shkencërisht. Kjo punë do të kryhet sipas planit që harton Komiteti Qendror i Partisë për zërthimin e vendimeve të Kongresit. Pas kësaj, pra, do të shkohet në organizatat-bazë, ku, pasi të diskutohet gjerë e gjatë, do të bëhen plane pune të veçanta për vënien në jetë të këtyre vendimeve. Në organizatë do të shihet konkretisht se ç'detyra dalin, në radhë të parë komunistët aty do t'i zërthejnë problemet nga ana politike. Natyrisht, të gjitha këto mund të mos bëhen dot në një ditë. Rëndësi ka që qysht në fillim të mos lejojmë që të bëhet diçka formale, por të kërkojmë që komunistët e punonjësit t'u futen thellë problemeve.

Ne, për shembull, do të flasim në Parti dhe në masat e popullit për zhvillimin e industrisë gjatë pësëvjeçarit të gjashtë. Po çfarë do t'u tregojmë atyre? Do t'u themi se do të ndërtojmë këto apo ato fabrika, apo do t'u flasim për problemet që lidhen me zhvillimin e Industrisë, domethënë me normat, me rendimentin, me koston etj.? Pastaj, si do ta bëjmë këtë punë, vetëm në mënyrë propagandistike dhe në vija të përgjithshme? Jo, atë do ta bëjmë konkretisht, me të dhëna e me shifra. Prandaj thashë që të mblidhen më parë specialistë nga më të aftot, si ekonomistë, inxhinierë,

punëtorë të dalluar e të tjerë dhe që kanë një eksperiencë të madhe. Me këta mund të krijohet edhe një grup pune, i cili, pasi ta ketë studiuar problemin si duhet, në bazë të materialeve të Kongresit, mund të përgatitë e të mbajë disa referate kyç, të cilat do të ndihmojnë për t'u thelluar jo vetëm në problemet kryesore, por edhe në ato anësore. Këto të fundit do të analizohen më hollësish në organizatat-bazë, ku çdo çështje do të detajohet sipas sektorit. Për shembull, në një uzinë të tjera probleme për të zgjidhur ka kovaçhana e të tjera reparti i tornove, e kështu me radhë.

Partia ka tash në çdo rreth një kontingjent të madh kuadrosh të aftë, të cilët i kanë të gjitha mundësitë që t'i trajtojnë me kompetencë problemet që u përkasin. Në këto mbledhje, përveç shokëve kryesorë të Partisë në rreth, mund të vejë edhe ndonjë anëtar i Komitetit Qendror. Anëtarët e komitetit të Partisë të rrethit, natyrisht, nuk do të lidhin duart pse do të vejë ndonjë i deleguar nga qendra. Në këto grupe mund të përfshihen, gjithashtu, edhe instruktorët e aparatit të komitetit të Partisë. Për shembull, në grupin që do të diskutojë problemet organizative, mund të bëjnë pjesë shokët që merren me jetën e Partisë. Po kështu edhe për sektorët e tjera. Ndërsa kur të flitet për problemet në përgjithësi, në këto mbledhje duhet të marrë pjesë medemos sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit.

Në raportin që do të mbahet në plenum e në diskutimet e shokëve nuk do të qe nevoja të trajtoheshin me radhë të gjitha problemet që do të zgjidhë rrethi në pesëvjeçarin e ardhshëm, se kjo do të bënte që të

përsëriteshin aty çështjet e thëna në Kongres. Ato do t'i trajtojnë konkretisht grupet e specialistëve. Kjo nuk do të thotë që plenumet të mbeten në gjëra të përgjithshme, meqenëse raporti do të flasë për të tëra çështjet; plenumi i rrethit duhet të trajtojë ato probleme të veçanta që e preokupojnë atë. Ne nuk kemi nevojë të na perifrazohen raportet e Kongresit, por të zbërthehen problemet që u shtruan atje. Pra, kjo çështje të mos vendoset pa u thelluar e pa u studiuar edhe një herë me kujdes.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ne mund ta diskutojmë akoma edhe një herë këtë çështje, shoku Enver. Duke shkuar drejtpërdrejt te komunistët dhe pastaj te masat, siç thoni ju, kjo përbën përfitimin kryesor. Kështu ne vemi me materiale të zbërthyera nga specialistë të veçantë, kurse, me rrugën që ramë dakord me shokët e rretheve, mund të bëhej punë formale, pse nga plenumi do të shkohej në organizatat-bazë, pa u trajtuar më parë problemet nga specialistët. Këtë defekt do ta kishim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çështjet që shtrohen në raportet e Kongresit janë jetike për të ardhmen e socializmit në vendin tonë. Me zgjidhjen e tyre të plotë do të vihen baza për disa vjet. Prandaj edhe po e theksojmë kaq shumë se materialet e Kongresit duhet të zbërthehen sa më thellë e sa më gjërë. Me një raport që mund të mbajë në mbledhjen e plenumit sekretari i komitetit të Partisë të rrethit për bujqësinë ose për sektorët e tjerë, nuk do të armatoseshin dot si duhet organizatat-bazë dhe komunistët. Kurse, me rrugën që po diskutojmë, puna do të jetë ndryshe, pse në këto

materiale do të flitet konkretisht pikërisht për ato probleme që u dhembin industrisë, bujqësisë apo sektorëve të tjyre në rreth, do të flitet, pra, për problemet kryç. Kështu shokët do të shkojnë të përgatitur në organizatë.

Organizatat-bazë mund të mblidhen 20 ditë pas mbledhjes që do të bëjnë grupet e specialistëve dhe të diskutojnë ato që u shtruan në mbledhjet me specialistët; në këto mbledhje përcaktohet, gjithashtu, edhe një plan pune, ta zëmë për një vit, si edhe njerëzit që do të ndjekin e do të kontrollojnë realizimin e detyrave.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Duke vepruar në këtë mënyrë, si na thoni ju, shoku Enver, do të bëhet një zbërthim më konkret i problemeve të ndryshme drejt-përdrejt me masën e Partisë. Kështu evitohen edhe mbledhjet e plenumeve të veçanta për çështje të ndryshme, siç kishim menduar ne. Duke e punuar materialin kështu, do t'i japim Partisë një ndihmë më të madhe, do të bëjmë më konkretisht zbërthimin e të gjitha problemeve brenda një kohe sa më të shkurtër dhe me pjesëmarrjen e gjerë të sa më shumë njerëzve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk ekskludohet që disa çështje të veçanta të planifikohen për t'u marrë në shqyrtim çdo vit nga plenumi i komitetit të Partisë të rrethit.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Kështu ne do ta kemi sqa-ruar Partinë për të gjitha problemet, pse këto do të janë diskutuar mirë më parë në mbledhjet fillestare e pastaj edhe në organizatat-bazë. Kështu Partia do t'u jetë futur mirë të gjitha çështjeve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dhe më e rëndësishmja është se puna do të bëhet jo globalisht, po konkretisht Organizata-bazë, për zbatimin e detyrate që shtroi Kongresi, ka edhe probleme të tjera për të shqyrtuar. Por herën e parë do të flitet për këtë ose për atë çështje, më vonë do të flitet me radhë edhe për çështjet e tjera. Organizatat-bazë jo vetëm që nuk do të pengohen nga kjo mënyrë punimi, por, përkundrazi, do të fuqizohen edhe më tepër që t'i shohin më qartë detyrat që do të kenë përparrë për të kryer.

**SHOKU PILO PERISTERI:** Kështu si thotë shoku Enver, rreh çekani ku duhet: Ja, ky është problemi! Specialistët do ta kenë gjetur çelësin që na duhet, prandaj kjo punë do t'i ndihmojë shumë organizatat-bazë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo varet edhe nga mënyra se si do t'i organizojnë komitetet e Partisë të rretheve mbledhjet me specialistët, si do t'i zgjedhin njerëzit, si do t'i përgatitin këta.

Në qoftë se do të aprovojmë këtë mënyrë pune që parashtrova, para se ta zbatojmë mund të konsultohemi edhe me shokët, po ama sa më shpejt, me qëllim që të mobilizohen të tërë komunistët e masat punonjëse për të kryer brenda një kohe sa më të shkurtër detyrat që dalin.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## KONTAKTI ME BAZËN E GJALLERON MË TEPËR UDHËHEQJEN

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**24 dhjetor 1976**

Për disa probleme që shqyrtohen në Byronë Politeke, për disa të tjera që dalin nga sfera e veprimtarisë së një komiteti partie rrethi dhe që shqetësojnë udhëheqjen, nuk mjafton vetëm vajtja në byronë e komitetit të Partisë të rrethit. Unë e shoh këtë çështje edhe nga një anë tjetër, si me thënë, nga ndjenja e njëfarë rehatie, e një dëshire të aparateve për t'u marrë vetëm me disa njerëz që i shohim vazhdimisht dhe me të cilët mund të takohemi lehtë. Kështu, dashur pa dashur, mjaftohemi vetëm duke u dhënë urdhra këtyre njerëzve, duke dëgjuar çfarë thonë këta dhe kënaqemi duke menduar se «e kemi në dorë situatën». Me fjalë të tjera, duke vepruar kështu, ne e kufizojmë punën tonë në një rreth të ngushtë drejtuesish, me të cilët kemi kontakte të vazhdueshme dhe dalim me zor jashtë kësaj kornize. Në këtë mënyrë pengohet kontakti i drejt-përdrejtë me bazën.

Mirëpo, për disa probleme që na preokupojnë, është e nevojshme të marrim jo vetëm mendimin e drejtuesve të Partisë në rrethe, por edhe të shokëve të bazës. Mos vallë edhe drejtuesit e Partisë në rrethe, deri në njëfarë shkalle, ndjekin po këtë rrugë në marrëdhëniet e tyre me bazën? Me këtë nuk dua të them që aparatet, të cilat i kemi krijuar për të marrë kontakte të vazhdueshme me bazën, të mos i dëgjojmë për probleme të ndryshme dhe të mos nxjerrim konkluzione nga të dhënat e tyre. Por mendoj se, para së gjithash, më shpesh e më mirë të merren kontakte me bazën. Kontakti me bazën, më duket mua, gjallëron më tepër udhëheqjen.

Ka probleme shumë të mëdha, si, për shembull, ato të kuadrit, që janë të vazhdueshme dhe nuk zgjidhen dot menjëherë. Unë do të pyesja, fjala vjen, shokun Hekuran Isai, si sekretar i Komitetit Qendror që merret me kuadrin, nëse ka vajtur ndonjëherë në shkollën e Partisë «Vladimir Iliç Lenin» që të shohë atje se si punohet për përgatitjen e kuadrove të Partisë. Është një gjë e mirë, bie fjala, të shikohet në organizatën-bazë të Partisë të një fshati puna për edukimin e komunistëve, por, krahas kësaj, duhet vajtur edhe atje ku mësojnë dhe edukohen mijëra kuadro të Partisë. Në këtë shkollë të shikojmë jo vetëm kuadrot që mësojnë, por edhe mësimdhënësit, që janë me dhjetëra pedagogë, të cilët përgatitin leksione të ndryshme për të edukuar masën e komunistëve. Megjithëse ne themi gjithnjë që kjo shkollë është fidanishtja ku përgatiten kuadrot e Partisë etj., etj., prapëseprapë puna që bëhet atje në këtë drejtim nuk është ajo që duhet të jetë. Më

falni që po i nGRE vazhdimisht këto çështje, por do tË isha i mendimit se, pËR tË zgjidhur drejt problemet që pËrmendëm, një rol tË madh luajnë kuadrot e Partisë, prandaj pËR tË parë si përgatiten ata duhet vajtur më shumë në Shkollën e Partisë.

Ju ka shkuar në mendje, shokë, tË veni e tË pyesni se çfarë bëhet në Shkollën e Partisë pËR punimin e materialeve tË Kongresit, si punohet, ç'mendohet jo vetëm tani pËR tani, por edhe pËR perspektivën etj.? Është bërë atje ndonjëfarë plani pËR këto probleme?

*Pasi shokët sekretarë shpjeguan se është biseduar me drejtuesit e Shkollës së Partisë dhe se atje ka njëfarë plani pËR punimin e materialeve tË Kongresit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ata, sigurisht, kanë një program pËR zhvillimin e lëndëve në shkollë. Por, duke menduar edhe pËR këtë problem që po diskutojmë, ndihmojnë Partinë, se atje ka nga specialistët tanë më të mirë në fushën teorike. Si tË tillë ata mund tË sugjerojnë ide dhe mendime interesante pËR mënyrën e trajtimit tË shumë çështjeve, si, bie fjala, pËR zhvillimin e luftës së klasave, pËR kuptimin e teorisë së «tri botëve» e të tjera. Nga sugjerimet e tyre ne mund tË nxjerrim tema e detyra konkrete pËR ato që thamë, si, pËR shembull, që në këtë artikull duhet tË trajtojmë këtë gjë, tË cilin do ta përgatitë ky apo ai shok, e të tjera. PËR këtë qëllim mund tË vemi edhe në katedrën e filozofisë në universitet e tË kërkojmë që edhe ata tË bëjnë zbërtimin e raportit tË Kongresit. Këtë zbërtim sigurisht që do ta orientojë dhe do ta udhëheqë Partia.

Ne duhet të shoqërojmë me një sërë artikujsh metodën e punës që duhet ndjekur për zbërthimin e materialeve të Kongresit. Duhet menduar mirë bashkë me shokët e aparatit që merren me këto probleme se çfarë shkrimesh do të botojmë. Këto, sipas mendimit tim, duhet të jenë kryesisht artikuj teorikë, të bazuar në materialet e Kongresit.

Partia jo vetëm do t'i udhëheqë këto punë, por ajo të lidhet më afër me bazën edhe për të mësuar një çikë më shumë prej saj. Nuk mund dhe nuk duhet t'i bëjmë punët duke caktuar për to vetëm një specialist, të aparatave apo të institucioneve, por të dëgjojmë edhe qindra specialistë e punonjës të tjerë që kemi në rrethe e në bazë. Nuk mund të themi *a priori* se «nuk punojnë një rrezit». Më përpara të shkojmë e t'i shohim këta njerëz se si punojnë. Nga puna e tyre të mësojmë dhe të bëjmë disa përgjithësimë. Nuk është e domosdoshme që për zbërthimin e materialeve të Kongresit të shkruajnë në shtyp vetëm shokë të udhëheqjes, por le të shkruajnë edhe ata që janë kompetentë për këtë ose atë problem në fusha të ndryshme, ku janë thelluar më shumë e janë specializuar. Pse të mbështetemi kurdoherë vetëm te disa kuadro, kur kemi nëpër shkolla, institucione e qendra pune tërë ata specialistë e drejtues të aftë? Ne duhet të shkojmë edhe vetë e të konsultohemi me këta njerëz, për të mësuar prej tyre dhe për t'i parë se si punojnë.

Ne kemi gjithë këto gazeta e revista. Mendoj se ato tashmë i kanë bërë planet e tyre të punës për zbërthimin e materialeve të Kongresit. Por këto plane duhet

t'i kontrollojmë për t'i ndihmuar ato ose, kur e kanë mirë këtë ose atë gjë, atëherë t'i inkurajojmë e t'i udhëzojmë për frymën e mënyrën e trajtimit të çeshtjeve. Sigurisht, të tëra këto punë nuk mund t'i bëjë një person, prandaj edhe thashë më përpara se duhet të kemi kujdes nga puna e myllur me instruktorët, e cila shpeshherë, gabimisht, na duket sikur është gjithçka. Puna me instruktorët është njëra anë dhe lypset që ata të përdoren si duhet. Përveç instruktorëve duhet të aktivizohen edhe forumet. Jo vetëm kaq, por duhet të shkohet edhe më tej, te njerëzit e punës në bazë. Këto punë duhet të bëhen jo me një rrëth të ngushtë njerëzish, por me kontakte të gjera, sa më të gjera.

Unë s'jam kundër që të merret kontakt me shokët e Bashkimeve Profesionale, siç u tha këtu. Kjo është një gjë shumë e mirë. Por, para kësaj, të merret kontakt me «fidanishten» ku përgatiten kuadrot e Partisë, me shkollat e kurset e Partisë.

Sot lexova në gazeten «Zëri i popullit» se Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës ka organizuar një kurs trijavor me kryepropagandistët e formave të arsimit në Parti të ndërmarrjeve ekonomike e të kooperativave bujqësore të rrethit, për zbërrthimin e materialeve të Kongresit të 7-të të Partisë. Kjo punë parapërgatitore nuk më duket e keqe. Atëherë, derisa është bërë një punë përgatitore e tillë, pse nuk na informojnë edhe ne për këtë eksperiencë, por na dërgojnë shpeshherë propozime shabllone, si ai që na erdhi këtu që, në vend të tri aktiveve që kishin bërë më parë, të bëhen pesë aktive lidhur me mënyrën e punimit të materialeve të

Kongresit! Ky nuk është aspak një mendim krijues! Duhet të kemi parasysh se edhe ajo që thamë ne nuk i zgjidh të tëra, veçse i vë më mirë në lëvizje masat.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Edhe kur vajtën njerëzit tanë në Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës, shokët atje nuk u thanë gjë fare!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po çfarë është kjo pунë? Kjo është një vetëkënaqësi e rutinë e aparateve, që duhet ta luftojmë. Këtë rutinë na e shkaktojnë disa njerëz, të cilët mund të jenë edhe shokë të mirë, të kualifikuar, por, meqenëse kanë adaptuar një metodë pune rutinë, e kanë të zorshme të dalin jashtë kuadrit të saj. Në qoftë se ne nuk punojmë me ta që ta braktisin këtë metodë, ose nuk shkojmë të marrim kontakte direkte që ta rregullojnë punën, si zor të realizohen ato që themi. Ja, kjo që shkruhet në gazeten e sotme është një eksperiencë e mirë.

Sot gazeta «Zëri i popullit» shkruante, gjithashtu, për mitingun e organizuar në Portugali nga Partia Komuniste Portugeze (e Rindërtuar) për ndër të Kongresit të 7-të të PPSH<sup>1</sup>. Gjithë bota po flet vazhdimisht për Kongresin tonë. A nuk mundet vallë shtypi ynë ta pas-qyrojë këtë jehonë e t'u thotë popullit dhe Partisë se çfarë flasin të tjerët, bota përparimtare, për Kongresin tonë? Kemi dëgjuar që radioja, herë pas here, flet për deklarata dhe për përshtypjet e miqve të huaj për Shqipërinë. Kjo ka ngjallur e ngjall interesim e kënaqësi në popull. Po për jehonën kaq të madhe dhe pozitive që

---

1. Shih: «Zëri i popullit», nr. 310 (8853), 24 dhjetor 1976.

është bërë e po bëhet në botë për Kongresin e Partisë sonë, a po mendon njeri? Ç'bëjnë shokët e sektorit të jashtëm të aparatit të Komitetit Qendror? A mendohet që të grumbullohen vlerësimet e mira e pozitive që bëhen në të katër anët, siç lexojmë në telegramet që marrim dhe në buletinet e lajmeve? Në qoftë se ata nuk i bëjnë këto punë, atëherë le të gjejmë njerëzit që i bëjnë. Është kështu apo jo? Pasqyrimi i gjithë asaj jehone në shtypin tonë, do të qe një forcë tjetër nxitëse për njerëzit tanë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Në përgjithësi shumë pak i botojnë në shtyp ato çka shkruan bota jashtë për vendin tonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pse të mos e trajtojmë në shtyp këtë çështje? Këtu u tha se për shkrimet e huaja lidhur me Kongresin është nxjerrë një material dhe u është dërguar komiteteve të Partisë për ta përdorur për propagandën. Shpeshherë vërehet prirja e informimit vetëm të kuadrove. Unë s'jam në kundërshtim që kuadrot duhen vënë në korent për shumë gjëra, po sa i çojnë ato te masa, në bazë? A keni dëgjuar ndonjëherë që të flitet se kështu ose ashtu po bëhet në filan vend për të punuar raportin e Kongresit të 7-të? Jo. Atëherë këtë material e mban ndonjë sekretar komiteti partie në sirtar. Pse, vetëm për t'i ditur sekretarët e komiteteve të Partisë i bëjmë këto punë? Jo, ne duam të ngjallim entuziazmin në tërë Partinë dhe në masat e popullit.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Edhe lajmet e shtypit tonë për botimin e raportit të Kongresit të 7-të në këtë

e në atë gjuhë u bëjnë përshtypje të madhe mësave.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne jemi një popull me histori të lashtë. Ngaqë jemi sulmuar e jemi pushtuar nga të huajt, edhe në gjak na ka hyrë dëshira për të kërkuar kurdoherë miq që të na mbrojnë nga lakmitë e botës së egër të imperializmit dhe të kolonializmit. Kur ndodhët ndonjëherë, megjithëse shumë rrallë, që të shkruhej diçka nga ndonjë dashamir i Shqipërisë, që dilte si një fishek i izoluar, gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë e përdornin atë shkrim për të ngritur opinionin dhe për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare. «*Eropa shkruajnë e thonë / Bëhet dyfek në Vlorë / Shqipëtarët luftojnë / Me një mbret 40 milionë» etj. Kjo këngë tregonte atë që populli shqiptar dhe lufta e tij ishin dëgjuar jashtë. Tani kohët kanë ndryshuar. Por përsëri ne jemi të interesuar dhe luftojmë që opinioni botëror të flasë mirë për ne dhe këto që thuhen t'ia bëjmë të njohura edhe popullit.*

**SHOKU HYSNI KAPO:** Dhe sa shumë që kemi për të thënë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vlerësime pozitive të opinionit përparimtar botëror për Partinë tonë dhe për politikën e saj të brendshme e të jashtme kemi sa të duash. Sigurisht, edhe reaksiuni me veglat e tij përpinqet të propagandojë sikur Shqipëria paska mbetur e izoluar nga bota! Shtypi ynë duhet t'i kundërvihet kësaj propaganda, duke botuar materiale të tillë si ai i sotmi për mitingun e organizuar në Portugali. Unë kam vënë re kur bisedojnë në shtëpinë time dhe thonë se duan ta

dëgjojnë emisionin e radios për të ditur se çfarë flasin të huajt për Shqipërinë.

Të gjitha këto punë janë të lidhura konkretisht me ndërtimin e socializmit. Të ndërtosh socializmin do të thotë jo vetëm t'i ngresh njerëzit politikisht e ideologjisht, por dhe të realizosh detyrat në fushën ekonomike e kulturore, që populli të ketë të hajë e të pijë, të vishet e të mbathet, të arsimohet e të bëhet i zoti për të prodhuar makina, për të ndërtuar hidrocentrale etj., etj. Për këtë të gjitha detyrat që shtron Kongresi i 7-të i Partisë ne do t'i zbërthejmë dhe do të orientojmë njerëzit tanë se si të punojnë për t'i vënë në jetë, duke realizuar dhe duke tejkaluar planet. Pasi të bëjmë këtë punë, detyrat do të shtrohen në organizatat-bazë, që do të mblidhen për të diskutuar më hollësisht, duke pasur përparrë planin e duke përcaktuar konkretisht se si do të plotësohet ai dita me ditë, çdo javë e çdo muaj.

Plenumet e komiteteve të Partisë në rrethe do të shikojnë si është bërë zbërthimi politiko-ideologjik i vendimeve të Partisë dhe si kanë udhëhequr organizatat-bazë për të realizuar planin brenda dy muajve. Të mos bëhen mbledhje fiktive, në tym, ose të rrihet me orë të tëra në një mbledhje që të kritikohet një shok për gabime apo faje që janë të qarta. Në këtë rast të mos vritet koha, por të procedohet shpejt: «Pse e bëre ti shok këtë gabim? Mos e bëj më!». Po qe e arsyeshme, mund të merret edhe ndonjë masë për atë që ka gabuar dhe pastaj të shtrohemi e të diskutojmë përsë nuk u realizua norma, plani. Këtu duhet të insistojmë. Të

vëmë përpara përgjegjësisë atë që nuk ka plotësuar detyrën dhe t'i kërkojmë llogari atij forumi që nuk e ka kontrolluar. Gjithë kjo punë bëhet për të realizuar konkretisht planet, prandaj të merremi më shumë me organizimin që kërkohet dhe ta shoqërojmë tërë këtë veprimtari me artikuj në shtyp. Të mos themi se këto çështje i kemi shtruar. Është e vërtetë që i kemi shtruar vazhdimisht, por këto janë të përhershme. Lufta e klasave, nevoja e forcimit të disiplinës, uniteti i Partisë me popullin, rrethimi imperialisto-revizonist i vendit dhe një sërë problemesh të tjera janë të tilla që agjitationin dhe propagandën duhet t'i shqetësojnë përherë.

Duke vajtur në rrëth ose në bazë, do të bisedohet për një numër më të madh problemesh, do të shkëmbohen më tepër mendime dhe do të hapen horizonte më të gjera edhe për vetë sekretarët. Më vonë mund të shkohet edhe në një mbledhje tjetër dhe kështu reflektohet një çikë më mirë për të metat e dobësitë që mund të jenë konstatuar. Gjatë shkëmbimit të mendimeve për këto probleme, mund të sugjerohet, fjala vjen, që, përveç asaj pune që është në plan, të ndërmerrët edhe ndonjë veprimtari tjetër.

Kuptimin e zbërrthimin e materialeve të Kongresit ne lypset t'i përgatitim në mënyrë të koordinuar, të organizuar dhe të shumanshme.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Në fakt që këtu, te shokët e aparatit të Komitetit Qendror dhe te ne, u krijua mendimi që duhen bërë disa plenume, se kështu e kemi

pasur praktikën. Në qoftë se u krijua mendimi këtu, të shokët e aparatit, që kjo është forma më e mirë e zbërthimit të materialeve të Kongresit, kjo është e gabuar. Në fakt ne na erdhi mendimi edhe nga baza, por nuk ngulëm këmbë për mendime krijuese.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Dhe ne pikërisht këto mendime deshëm.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Ndonjëherë ndikon edhe aparati në këtë drejtim, se instruktorët janë mësuar me disa gjëra të praktikës së vjetër dhe nuk mendojnë si të gjejnë forma të reja pune.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Prandaj thashë unë që instruktorët vërtet t'i konsiderojmë njërejt të mirë e që na ndihmojnë, por njëkohësisht duhet të luftojmë rutinën, mendimin burokratik dhe atë të «superioritetit» të tyre mbi eksperiencën e bazës. Këto prirje të punojnësve të aparateve janë shumë të rrezikshme dhe shumë të gabuara. Të shkosh në bazë me ide të fiksuar që këtu për një problem për të cilin dërgohesh që të marrësh mendimin e masës, kjo tregon për një punë krejt formale dhe fiktive. Një veprim i tillë do të thotë se unë shoku i qendrës e kam vendosur këtë punë që këtej, kurse ju shokët e bazës vetëm do të bëni ç'them unë. Të kuptohemi drejt, unë nuk them që puna për tërheqjen e mendimit të masës bëhet kudo formalisht, por e kam hallin që të luftohen disa tendenca të tilla që duken aty-këtu.

Ta japid edhe shokët që punojnë në aparat mendimin e tyre, unë nuk e përjashtoj këtë gjë. Por ata më

tepër konformohen me mendimin e cprorëve. Këtë konformizëm ne duhet ta luftojmë. Po si ta luftojmë? Duke vajtur në bazë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

# KUSHTETUTA E VENDIT TONE SOCIALIST ESIITË SHPREIIJE E VULLNETIT TË POPULLIT

*Fjala në mbledhjen e Kuvendit Popullor të RPSH*

27 dhjetor 1976

Shokë dhe shoqe deputetë,

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe komisioni i posaçëm i krijuar nga Kuvendi Popullor për hartimin e Projektkushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë më kanë ngarkuar t'ju paraqes në emër të tyre projektin përfundimtar të Ligjit të ri Themeltar të shtetit tonë socialist, që juve ju takon nderi dhe ju bie përgjegjësia e madhe ta diskutoni e ta miratoni.

Pas hartimit të projektit filletar që u shpall publikisht nga Kuvendi Popullor në janar të këtij viti, masat e gjera punonjëse, në qytet e në fshat, nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror, u njohën me dispozitat e tij dhe zhvilluan diskutime jashtëzakonisht të gjera, të gjalla, revolucionare, në forma nga më demokratiket për plotësimin,

saktësimin dhe përmirësimin e tij në drejtimet politike, ideologjike, juridike, organizative etj.

Njohja e masave me projektin e Kushtetutës dhe diskutimi i tij i zhvilluar në një mënyrë të efektshme ishin jo vetëm një kontribut i madh për hartimin e një kushtetute nga më demokratiket e nga më revolucionaret, por shërbyen njëkohësisht si një shkollë e madhe teoriko-politike e morale. Ky aktivitet i gjerë u ka dhënë e do t'u japë një shtytje të paparë prodhimit, mendimit përparimtar dhe veprimit revolucionar. Të gjitha këto do të hapin perspektiva të shkëlqyera për ndërtimin më me vrull të socializmit në Shqipëri.

Duke pasur parasysh numrin e madh të diskutuesve në tërë Shqipérinë dhe diskutimet e tyre, të thella e të dobishme, mund të thuhet me siguri se projekti që ju paraqitet për aprovim mban plotësisht vulën e mendimit të urtë e revolucionar popullor. Projektkushtetuta është vepër e madhe e Partisë dhe e popullit tonë, ajo është pasqyrë e shkëlqyer e realitetit tonë, tregon pjekurinë e madhe politike e ideologjike të Partisë e të popullit, si dhe vitalitetin, guximin, vendosmërinë dhe konsekucencën e tyre të palëkundshme për ta çuar përpara, për ta forcuar, për ta lulëzuar, për ta begatuar dhe për ta mbrojtur atdheun tonë socialist.

E tërë puna e gjithanshme që u zhvillua në diskutimin e madh popullor të Projektkushtetutës, në kuadrin e 35-vjetorit të themelimit të Partisë e të Kongresit të saj, u kurorëzua me sukses. Kongresi i 7-të i Partisë, me një entuziazëm të papërshtkuar, e vlerësoi lart njëzëri projektin e Kushtetutës së re socialiste.

Komisioni i posaçëm për hartimin e projektit të Kushtetutës, duke e çmuar drejt detyrën që iu ngarkua nga Kuvendi Popullor, pasi u njoh mirë me materialet e përgatitura nga Komiteti Qendror i Partisë, me plotësimet, saktësimet dhe përmirësimet e shumta të propozuara nga masat e gjera punonjëse, nga kuadro, institucionë, organizata dhe organe shtetërore e partie, si dhe me vlerësimin e lartë që i bëri projektit Kongresi i 7-të i Partisë, dhe pasi i sistemoi e i studioi me kujdes, i pasqyroi në projektin përfundimtar.

Ju, shokë dhe shoqe deputetë, jeni njohur me përbajtjen e dispozitave të projektit të Kushtetutës së re, sepse bashkë me popullin edhe vetë u aktivizuat në diskutime dhe në tërë procesin e hartimit të Projekt-kushtetutës.

Në raportin e Komitetit Qendror të Partisë, që iu paraqit Kongresit të 7-të, një kapitull i veçantë iu kushtua tërësisht Kushtetutës. Kongresi përcaktoi vijën e Partisë në fushën politike, ekonomike e organizative, për çështjet e politikës sonë të jashtme dhe qëndrimet tonë ndaj problemeve të lëvizjes punëtore e marksiste-leniniste ndërkombëtare. Vendimet historike të Kongresit janë udhërrëfyese për mbarë Partinë e popullin tonë. Ato kanë ngritur peshë masat punonjëse të vendit dhe kanë ngjallur kudo një frymë të lartë entuziazmi e mobilizimi në punë.

Në këtë sesion të Kuvendit Popullor do të ndalem në disa nga problemet thelbësore e parimore të Projektkushtetutës.

Projektkushtetuta e Republikës Popullore Socia-

liste të Shqipërisë pasqyron në mënyrë të sintetizuar realitetin tonë socialist dhe tendencën e zhvillimit të tij, vijën e Partisë, mësimet dhe përvojën revolucionare të saj; ajo përshkohet fund e krye nga ideologjia mark-siste-leniniste dhe nga parimet bazë të socializmit shkencor. Për këtë arsyе përbajtja e projektit jo vetëm është miratuar nga masat tona punonjëse, të cilat kanë gjetur të shprehur besnikërisht në të vijën e drejtë të Partisë sonë gjatë zhvillimit të pandalshëm të revolucionit socialist dhe të ndërtimit e të mbrojtjes së socializmit, por ka bërë një jehonë pozitive edhe në botë.

Kushtetuta e vendit tonë socialist është shprehje e vullnetit të popullit shqiptar dhe e askujt tjetër. Ajo është Ligji Themeltar, bazë mbi të cilin zhvillohet gjithë jeta e vendit. Kjo Kushtetutë, nga njëra anë, i përgjigjet një realiteti konkret, të arritur me gjak, me punë e me djersë dhe, nga ana tjetër, i hap Shqipërisë socialeste perspektiva të shkëlqyera dhe të sigurta nga çdo pikëpamje.

Qartësia është karakteristika e saj, e cila vihet re në çdo nen që trajton probleme të strukturës apo të superstrukturës, të organizimit apo të drejtat dhe de-tyrat e shtetasve shqiptarë. Njerëzit tanë, me çdo prej-ardhje shoqërore që të janë dhe me çdo nivel kulturor qofshin, i kuptojnë dhe i zbatojnë nenet e Kushtetutës si individë dhe si kolektiva në interesin e madh të shoqërisë socialeste, që ndërtohet nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila ndjek dhe zbaton me besnikëri të madhe e me konsekuençë teorinë mark-siste-leniniste në kushtet e vendit tonë.

Origjinaliteti i Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë qëndron në atë që ajo ndryshon nga kushtetutat e vendeve të tjera. Ky origjinalitet nuk e çan dhe nuk e dobëson unitetin e popullit, por e forcon, e shumëfishon vitalitetin e tij; ai nuk nxit degjenerimin moralo-politik, por, përkundrazi, forcon e kalit vjetët e shëndosha dhe të pastra të njeriut tonë, besnikërinë ndaj atdheut socialist, dashurinë për shokun, ndjenjën e drejtësisë etj. Kushtetuta ngre lart punën si mjet edukues dhe si krijuese e të mirave materiale për njeriun, i cili lufton dhe frymëzohet për ngritjen e mirëgenics individuale, familjare dhe të të gjithë shoqërisë, duke i marrë këto çështje të lidhura ngushtë në një unitet të fortë dhe të koncentruara lirisht në forma nga më demokratiket. Origjinaliteti i Kushtetutës sonë qëndron në faktin e rëndësishëm që në udhëheqje të vendit është Partia e Punës e Shqipërisë, pa të cilën nuk mund të kishte Shqipëri të lirë dhe shoqëri socialiste.

Eksperiencia historike ka vërtetuar se idetë gjeniale të klasikëve të marksizëm-leninizmit për rolin udhëheqës e të pandarë të Partisë së klasës punëtore, për shtetin e diktaturës së proletariatit dhe për luftën e klasave janë parime bazë për ndërtimin e shoqërisë sociale. Ato duhet të mbahen mirë parasysh, gjersatë zhduken plotësisht të gjitha shkaqet e brendshme e të jashtme, objektive e subjektive, për lindjen e revisionizmit e për restaurimin e kapitalizmit, pra, gjersatë ketë triumfuar komunizmi përfundimisht në shkallë botërore. Duke u udhëhequr nga këto mësime parimore,

në projekt është sanksionuar se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shtet i diktaturës së proletariatit, i cili shpreh dhe mbron interesat e të gjithë punonjësve, që zhvillon pandërprerë revolucionin, duke iu përbajtur luftës së klasave, dhe se Partia e Punës e Shqipërisë, pararojë e klasës punëtore, është forca e vëtme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë.

Duke i ngritur këto parime themelore marksiste-leniniste në norma kushtetuese, në një kohë kur revizionistët modernë i kanë shtrembëruar në mënyrë flagrante, ne u bëjmë një shërbim të madh jo vetëm atdheut tonë, klasës punëtore dhe popullit shqiptar, por tregojmë në praktikën tonë forcën krijuese e gjithnjë të re të marksizëm-leninizmit, mbrojmë parimet e patundura të diktaturës së proletariatit, idetë e pavdekshme të socializmit shkencor.

Në projektin e Kushtetutës së re është sanksionuar edhe ideja tjeter shumë e rëndësishme se në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë marksizëm-leninizmi, ideologjia e klasës punëtore dhe e Partisë së saj, është ideologji sunduese. Kjo normë kushtetuese, që shpreh një fitore të madhe historike të realizuar te ne, nga njëra anë, afirmon tezën me rëndësi parimore se socializmi mund të ndërtohet vetëm mbi bazën e kësaj ideologjie shkencore dhe, nga ana tjetër, i pret rrugën përhapjes në vendin tonë të ideologjive të huaja dhe gjithë teorive të revizionistëve modernë për «pluralizmin ideologjik», për «qarkullimin e lirë» të ideve e të kulturave reaksionare, që janë armë të kundërre-

volucionit politik e të agresionit ideologjik, pas të cilit vjen edhe agresioni i armatosur ushtarak.

Në kushtet e zhvillimit të sotëm botëror, kur imperializmi dhe socialimperializmi bëjnë të gjitha përpjekjet për të sunduar mbi popujt, kur ideologët në shërbim të tyre përhapin «teori» nga më monstruozet për nënshtrimin e kombeve, një rëndësi të dorës së parë merr mbrojtja e sovranitetit, e ruajtjes së pozitës së pavarur të shtetit në të gjitha fushat. Shumica e popujve të botës sot bëjnë përpjekje të mëdha dhe kundërshtojnë me forcë ligjet koloniale e sundimin neokolonialist, luftojnë të gjitha ato rregulla, praktika, zakone, marrëveshje të pabarabarta, të vjetra e të reja, të vendosura nga borgjezia për të ruajtur shfrytëzimin e popujve, dallimet e diskriminimet e urryera në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto ligje mundohen me të gjitha mënyrat t'i ruajnë e t'i përjetësojnë të dyja superfuqitë, që përpinqen të grabitin pasuritë e vendeve të tjera, të sigurojnë privilegje dhe të skllavërojnë popujt e ndryshëm. Popujt e shtetet demokratike që nuk pajtohen me këtë gjendje, që luftojnë për vendosjen e sovranitetit kombëtar, për forcimin e pavarësisë politike e ekonomike të tyre, për barazi e drejtësi në marrëdhëni të ndërkombëtare, gëzojnë solidaritetin e përkrahjen e plotë të popullit e të shtetit shqiptar.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, që, siç është shpallur edhe në projektin e Kushtetutës, i përmbahet me vendosmëri parimit të vetëvendosjes së popujve, ushtrimit të plotë të sovranitetit kombëtar, hedh poshtë çdo formë kufizimi të sovranitetit, në çdo fushë

qoftë. Duke sanksionuar këtë qëndrim që ka të bëjë drejtëpërdrejt me vijën e Partisë sonë, në projekt deklarohet: «Askush tjetër veç organeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Kushtetutë nuk mund ta ushtrojë sovranitetin e popullit dhe çdo atribut të tij në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në emër të saj». Me këtë dispozitë të ligjit jo vetëm u jepet përgjigje e vendosur teorive false borgjeze që e konsiderojnë sovranitetin «një koncept anakronik», «burim i të këqijave në botën aktuale» etj., por hidhet poshtë kategorikisht edhe «teoria» e revisionistëve sovjetikë për «sovranitetin e kufizuar» në dobi të «interesave supremë» të së ashtuquajturës bashkësi socialiste.

Cdo shtet që respekton vetveten dhe të tjerët, ka normat e tij, që e udhëheqin në relatat miqësore. Këto norma ndryshojnë sipas botëkuptimit të çdo shteti. Asnjeli nuk mund t'i imponojë tjetrit normat e tij. Një diçka që i pëlqen ose i përshtatet një regjimi, mund të mos i pëlqejë dhe as t'i përshtatet një tjetri. Opinionet dhe pikëpamjet e veta asnjë shtet nuk i lë në errësirë, pa i shfaqur edhe në formë kritike e polemike ndaj një shteti tjetër. Është e logjikshme të ketë edhe shtete me të vërtetë sovrane, si yni, që nuk kanë pranuar e nuk pranojnë t'i shtrohen «shkopit të dirigjentit» dhe asnjë shkopi tjetër.

Në qoftë se ka të tjerë që dëshirojnë ta pranojnë «shkopin e dirigjentit» ose «shkopin e madh», kjo është punë e tyre, por Kushtetuta dhe ideologjia jonë na lejojnë dhe na urdhërojnë t'i luftojmë presione të tillë, që cenojnë interesat e shtetit socialist dhe të popullit tonë.

Kushtetuta jonë sanksionon në mënyrë të qartë e të prerë se askush nuk mund t'i japë vetes të drejtën e ushtrimit të sovranitetit dhe të kërkojë «ndihmë» që të përligjet ndonjë ndërhyrje në Shqipëri nga ana e armiqve imperialistë, revisionistë apo reaksionarë të tjerë. Kështu u hiqet mundësia orvatjeve për maskimin e justifikimin e agresionit që duan të praktikojnë imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe socialimperializmi sovjetik, të cilët bëjnë politikë agresive. Një praktikë e tillë, që nuk mund ta harrojnë kurrë historia dhe popujt, është edhe pushtimi i Çekoslovakisë nga Bashkimi revisionist Sovjetik më 1968, janë edhe luftërat agresive e ndërhyrjet grabitqarc që imperializmi amerikan ka kryer në Azi, Afrikë, Amerikën Latine, Lindjen e Mesme etj.

Rëndësi të madhe për ruajtjen e forcimin e pavarësisë, të mbrojtjes së aldeut e të fitoreve të revolucionit ka edhe parimi i shprehur në projektin e Kushtetutës që territori i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është i patjetërsueshëm dhe kufijtë e saj janë të paprekshëm. Askujt nuk i njihet e drejta të nënshkruarë ose të pranojë në emër të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kapitullimin ose pushtimin e vendit. Çdo akt i tillë dënohet si tradhti ndaj atdheut. Kështu edhe nga pikëpamja kushtetuese nuk është i vlefshëm asnjë akt që do të përligjte kapitullimin e vendit para armikut.

Në dispozitat e projektit të Kushtetutës është afirmuar qëndrimi kategorik i Partisë dhe i popullit tonë për të mos lejuar vendosjen e bazave dhe të forcave

ushtarake të huaja në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ky parim ka rëndësi jetike për Shqipërinë, se shpreh qartë dhe pa asnje ekuvok vendosmërinë e popullit shqiptar dhe të drejtën e tij sovranë për mbrojtjen e vendit. Në të njëjtën kohë kjo normë kushtetuese shpreh edhe politikën e jashtme internacionale, parimore e miqësore të ndjekur nga Shqipëria socialiste, me qëllim që territori i saj të mos përdoret asnjëherë e në asnje rrëthanë si bazë për agresione kundër vendeve e popujve të tjerë.

Normat juridike kushtetuese që bëjnë fjalë për mbrojtjen e atdheut e të fitoreve të arritura, kanë ngriitur peshë zemrat e popullit patriot heroik shqiptar. «Edhe njëqind vjeç në qofshim, kur të lëshojë kushtrimin Partia, do të çohemi pa i ndie vitet, me shtatin drejt si pushka, e me armë në dorë do të mbrojmë vatanin», shkruanin me plot entuziazëm e atdhedashuri disa veteranë kur u njohtën me projektin e Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Për të ruajtur pavarësinë e atdheut në fushën ekonomike, për të mbrojtur të pacenuar rendin shoqëror ekonomik socialist dhe pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit, projekti i Kushtetutës afirmon se në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ndalohen dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe i institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe shtetet kapitaliste, borgjeze e revisioniste, si dhe marrja e kredive prej tyre.

Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik e lakenjtë e tyre «i qajnë hallin» Shqipërisë socialiste se

si do të rrojë dhe si do të zhvillohet ajo me forcat e veta pa marrë kredi nga kapitalistët e revisionistët.

Ne do të ecim përpëra me forcat tona. Këtë vendosmëri të Partisë e të popullit tonë e kanë vërtetuar koha dhe realiteti i pamohucshëm i vendit tonë, realizimet e mëdha në ekonomi, në arsim e në kulturë.

Ndihmat në formë kredie që merr një shtet nga jashtë janë të ndryshme, në një anë janë ndihmat e dhëna nga një shtet socialist vëlla, dhe, nga ana tjetër, kreditë e dhëna nga imperialistët, socialimperialistët dhe kapitalistët. Të parat janë ndihma vëllazërore, pa interes, pa presione politike, të palidhura me koniunkturat, kurse kreditë e imperializmit, socialimperializmit dhe kapitalizmit botëror, në çdo formë që të jepen, synojnë të cenojnë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popujve e të vendeve të ndryshme, duke i vënë nën presione politike të vazhdueshme.

Vendi ynë kurrë nuk ka pranuar dhe nuk do të pranojë kredi të tillë skllavëruese, që s'janë tjetër veçse forma të neokolonializmit.

Kushtetuta jonë e re nuk lë shteg përmendime ekuivoke dhe përminterpretime në dëm të lirisë, pavarësisë, sovranitetit dhe mbrojtjes së atdheut. Në të njëjtën kohë ajo nuk prek të drejtat e asnje shteti tjetër. Kushtetuta nuk lejon kurrikënd, shtet ose individ qoftë, që të përzihet në punët e brendshme të vendit tonë dhe, anasjelltas, nuk i lejon as shtetit tonë të diktaturës së proletariatit të ndërhyjë në punët e brendshme të ndonjë vendi tjetër.

Një shtet socialist si yni, që ka një Kushtetutë të

tillë nga më demokratiket, nuk ka si të mës jetë në marrëdhënie të mira dhe miqësore me popujt e botës.

Kushtetuta jonë nuk është kushtetutë që sjell izolimin e vendit tonë, siç pretendojnë disa, por në të kundërtën, ajo bie dashurinë, respektin e popujve, të demokratëve, të njerëzve dhe të shteteve përparimtare.

Projekti i Kushtetutës, nëpërmjet shumë dispozitive të tij, e ka bërë të vetin parimin marksist-lcninist se demokracia socialiste është e pandarë nga diktatura e proletariatit, se nëpërmjet zbatimit të plotë të demokracisë së gjerë për punonjësit mund të ruhet e të konsolidohet diktatura e proletariatit dhe se vetëm kjo diktaturë është në gjendje të sigurojë demokracinë e vërtetë për masat.

I gjithë pushteti shtetëror në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë buron nga populli punonjës dhe i përket atij. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë mund të ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese për qeverisjen e vendit jo vetëm nëpërmjet organeve përfaqësuese, por edhe drejtpërsëdrejti.

Gjithë ndërtimin e shtetit tonë socialist, që nga këshillat popullorë të instancave më të ulëta e gjer tek organi më i lartë i pushtetit shtetëror, që është Kuvendi Popullor, e përshkon thellësisht fryma e demokracisë socialiste. Organet përfaqësuese dhe organet e tjera të shtetit në ushtrimin e veprimtarisë së tyre mbështeten në iniciativën krijuarë të punonjësve të organizatave shoqërore dhe japin llogari përpara popullit.

Një shprehje e gjallë e konkrete e rolit udhëheqës

të klasës punëtore dhe e demokracisë socialiste në veprim është edhe e drejta e ushtrimit, nën udhëheqjen e Partisë, të kontrollit nga kjo klasë mbi veprimtarinë e organeve shtetërore, organizative, ekonomike e shoqërore dhe të punonjësve, që sanksionon projektin. Kontrolli punëtor është pjesë e pandarë e vijës së masave dhe përbën jo vetëm një parim bazë të veprimtarisë së Partisë e të shtetit, por shpreh edhe një tipar dallues karakteristik të realitetit tonë shoqëror.

Shumica e kushtetutave të vendeve kapitaliste, ku sundon e egër diktatura e borgjezisë, si dhe kushtetutat e vendeve ku sundojnë revizionistët, shquhen për frazeologjinë demokratike, por prapa fjalëve të bukura e premtiveve boshe për «lirinë», «barazinë», «drejtësinë» etj. fshihet dhuna e klasave shfrytëzuese dhe e klikave sunduese, që ushtrohet mbi punonjësit.

Për realizimin e të drejtave dhe të lirive demokratike luftojnë sot në të katër anët e botës masat e gjera punonjëse, të cilat, siç thoshte Lenini, duan të fitojnë jo premtimin e lirisë, jo lirinë në letër, por lirinë e vërtetë. Sa herë që masat kërkojnë zbatimin e normave kushtetuese të shpallura me qëllime mashtruese nga borgjezia, kjo orvatje e tyre cilësohet shpejt e shpejt si veprimitari që rrezikon rendin shtetëror e politik dhe goditet me zjarr e me hekur. Ky realitet argumenton tezën e drejtë marksiste-leniniste se atje ku nuk ka fituar akoma diktatura e proletariatit ose atje ku është hequr dorë prej saj, masat punonjëse nuk mund të gjëzojnë të drejta dhe liri të vërteta demokratike.

Në atdheun tonë socialist, nëpërmjet zbatimit të

demokracisë socialiste, shtetasve u janë siguruar me ligj të drejtat që ata i gjëzojnë realisht, sepse te ne nuk ekziston ndonjë hendek midis ligjit dhe realitetit. Të drejta të tilla janë, sidomos, barazia e shtetasve para ligjit, pavarësisht nga seksi, raca, kombësia, arsimi, pozita shoqërore e gjendja materiale; e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në të gjitha organet e pushtetit shtetëror; e drejta për punë dhe për pushim pas punës; e drejta për sigurimin e mjeteve të nevojshme materiale për jetesë në pleqëri, në rast sëmundjeje ose humbeje të aftësisë për punë; sigurimi falas i shërbimit të nevojshëm mjekësor, si dhe mjekimi në qendrat shëndetësore të vendit; e drejta për arsim; e drejta e bashkimit në organizata të ndryshme që veprojnë në fushën politike, ekonomike, kulturore, si dhe në çdo fushë tjeter të jetës së vendit; e drejta për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe propozime në organet kompetente për çështje personale, shoqërore dhe shtetërore e shumë të tjera që njihen nga Ligji ynë Themeltar dhe nga ligjet e tjera. Shqipëria është vendi që ka hequr i pari në botë të gjitha taksat.

Po kështu, projekti jo vetëm i shpall të drejtat e pakicave kombëtare, por ai, në të njëjtën kohë, sanksionon dënimin sipas ligjit të çdo cenimi të këtyre të drejtave.

Të drejtave themelore që shteti u garanton shtetasve tanë u korrespondojnë detyrat që janë, në të njëjtën kohë, edhe ndër për ta. Shtetasit kanë për detyrë respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve të tjera të vendit; ruajtjen dhe forcimin e rendit socialist dhe zbatimi

min e rrregullave të bashkëjetesës socialiste; ruajtjen e forcimin e pronës socialiste dhe qëndrimin e ndërgjegjshëm ndaj punës; mbrojtjen e atdheut socialist dhe, lidhur me këtë, detyrimin e përgjithshëm ushtarak e përgatitjen e vazhdueshme luftarake. Në Shqipëri i gjithë populli është ushtar dhe të gjithë kurdoherë e plotësish të gatshëm mbrojnë atdheun e tyre socialist, fitoret e mëdha të revolucionit tonë popullor.

Armiqtë e lirisë e të socializmit, duke kundërshtuar luftën e klasave, diktaturën e proletariatit dhe rolin udhëheqës të partisë së tij, me qëllim që të mbrojnë rendin kapitalist dhe të justifikojnë rivendosjen e rendit borgjez atje ku ai çshtë përbysur, «teorizojnë» për «socializmin demokratik», për «socializmin me ftyrë njeriu» dhe për kthimin prapa në demokracinë e humbur nga klasat shfrytëzuese e nga armiqtë e popullit.

Në vendin tonë, siç u vu në dukje, shtetasve u sigurohen të gjitha të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe nga ligjet e tjera, por u është mbyllur dhe do t'u mbyllët gjithmonë shtegu armiqve të rendit tonë shtetëror e shoqëror, që synojnë për të dëmtuar interesat e popullit, të atdheut e të socializmit. Te ne nuk ka pasur, nuk ka e nuk do të ketë liri veprimi për armiqtë. Duke mbrojtur këtë vijë të Partisë, projekti ndalon krijimin e çfarëdo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist, ndalon edhe veprimitarinë e propagandën fashiste, antidemokratike, fetare, luftënxitëse, antisocialiste, si dhe nxitjen e urrejtjes kombëtare e racore. Në këtë qëndrim Partia jonë çshtë nisur nga mësimi i Leninit që thoshte:

*«Bashkë me një zgjerim shumë të madh të demokratizmit, që bëhet për herë të parë demokratizëm për të varfrit... dhe jo demokratizëm për pasanikët, diktatura e proletariatit sjell me vete një varg kufizimesh të lirisë për shtypësit, për shfrytëzuesit dhe kapitalistët»<sup>1</sup>.*

Të drejtat e shtetasve janë të pandara nga plotësimi i detyrave të tyre dhe ato nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me rendin socialist. Të drejtat dhe detyrat e shtetasve janë në unitet dhe ndërtohen mbi bazën e pajtimit të interesave të individit me ato të shoqërisë socialiste, duke i dhënë përparësi kurdoherë interesit të përgjithshëm. Zhvillimi i shoqërisë socialiste shpie në afrimin gjithnjë e më të madh të interesave personalë e shoqërorë, sepse, siç shkruante Marks, shoqëria socialiste krijon kushte të tillë në të cilat zhvillimi i lirë i seccilit është kusht për zhvillimin e lirë të të gjithëve.

Edhe për sa i përket rendit ekonomik projekti i Kushtetutës pasqyron parimet themelore të politikës ekonomike të Partisë dhe ligjëson ato anë të sistemit të marrëdhënieve socialiste në prodhim që përbëjnë karakteristikat thelbësore të socializmit të vërtetë.

Projekti, juridikisht, i shpall mjetet e prodhimit si pronë shoqërore socialiste në formën e pronës shtetërore që i përket gjithë popullit, dhe të pronës kooperativiste në bëjnjësi që i përket grupit të punonjësve të fshatit.

Mbi bazën e pronës socialiste mbi mjetet e prodhii-

mit dhe nëpërmjet veprimtarisë së ndërgjegjshme të Partisë e të vetë masave punonjëse kryhet atrimi gjithnjë e më i madh midis fshatit e qytetit, punës mendore e fizike, realizohet zhdukja graduale e dallimeve të ndryshme që ekzistojnë akoma në shoqërinë tonë.

Për arsyen se prona socialiste mbi mjetet e prodhimit përbën bazën e paprekshme të rendit ekonomik socialist, projekti ligjëson si normë kushtetuese detyrimin e shtetit për ta mbrojtur këtë pronë.

Edhe prona vetjake që përbëhet prej të ardhurave nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme që shërbijnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore të personit e të familjarëve, njihet e mbrohet nga shteti ynë me të vetmin kufizim që ajo nuk mund të përdoret në dëm të interesit shoqëror.

Midis objekteve të tjera të pronës shtetërore është dekluaruar si e tillë edhe toka. Duke e shpallur tokën si pronë ekskluzive të shtetit, Projektkushtetuta synon të shprehë juridikisht atë realitet që në fakt është arritur prej kohësh në vendin tonë. Kuptohet se shpallja e tokës pronë shtetërore nuk i ndryshon aspak marrëdhëni që ekzistojnë sot dhe që rrjedhin nga dhënia e saj në përdorim shoqëror kooperativave bujqësore ose organizatave shoqërore.

Shokë dhe shoqe deputetë,

Përveç këtyre parimeve e normave që përmenda shkurtimisht, siç e dini, në Projektkushtetutë janë sanksionuar edhe shumë parime e norma të tjera të rën-

dësishme që kanë të bëjnë me ndërtimin e funksionimin e tërë jetës politike, shoqërore, ekonomike, kulturore etj., siç janë ato që rregullojnë rendin shoqëror ekonomik, marrëdhëniet e pronësisë e të shpërndarjes, zhvillimin e planifikuar të ekonomisë, marrëdhëniet midis kuadrove e masave, midis shtetit e shoqërisë, parimi i unitetit të pushtetit, i centralizmit demokratik, i ligjshmërisë socialiste etj.

Këto parime e norma, të sanksionuara në projektin e Kushtetutës, jepin tablonë e plotë të shoqërisë sonë socialiste që ecën përpara në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, të cilat janë vërtetuar plotësisht në praktikën tonë revolucionare. Kushtetuta e re do të jetë burimi kryesor dhe baza e legjisacionit tonë të ardhshëm. Miratimi i saj duhet të shënojë pikënisjen e një pune të re për përmirësimin e mëtejshëm të ligjeve kryesore të shtetit. Këtu hyjnë në radhë të parë kodet e ndryshme, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm, por që tanimë janë kapërcyer në disa drejtime, prandaj duhet të ripunohen për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të fazës së tanishme.

Shokë dhe shoqe deputetë,

Regjimi ynë socialist është regjimi i klasës punëtore, është diktatura e saj, që e ka bazën sociale në aleancën e pathyeshme të klasës punëtore dhe të fshatarësисë kooperativiste, është regjimi i demokracisë së vërtetë revolucionare. Në këtë regjim si yni populli ka marrë në duart e tij fatet e veta dhe qeveris vendin.

Këto ide të mëdha pasqyron, zhvillon dhe mbron Kushtetuta e re. Në këto ide dhe në zbatimin e tyre qëndron forcë e madhe e popullit tonë. Në themel të këtyre ideve dhe veprimeve të drejta e të vendosura qëndron ajo politikë parimore e shtetit shqiptar që zhvillohet në arenën ndërkontinentare, të cilën popujt dhe individët progresistë e kupojnë dhe e respektojnë. Politika jonë nderohet e respektohet, sepse ajo karakterizohet nga dashamirësia ndaj shteteve të tjera dhe nga dëshira për ekzistencën e marrëdhënieve të mira në bazë të parimeve të njohura të barazisë, të respektimit të sovranitetit shtetëror e të integritetit territorial, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe të dobisë reciproke. Ne ecim kundër korrentit imperialisto-revizionist. Korrenti ynë është revolucioni dhe shembja e rendit kapitalist, vendin e të cilit do ta zënë socializmi dhe komunizmi, shoqëria pa klasa. Kjo shoqëri është e ardhmja e njerëzimit që do të arrihet të ndërtohet me luftë klasore, me gjak e me sakrifica, por do të ndërtohet. Imperializmi dhe socialimperializmi janë në kalbëzim. Socializmi do të triumfojë, bota dhe njerëzimi do të shpëtojnë nga këto murtaja.

Miratimi i Kushtetutës së re është një ngjarje e madhe në historinë e popullit tonë, një hap me shumë rëndësi në luftën e tij për ndërtimin e shoqërisë sociale. E bazuar plotësisht në parimet marksiste-leniniste të zbatuara në mënyrë krijuese nga Partia jonë e lavidhme dhe duke sintetizuar në mënyrë shkencore përvojën tonë revolucionare, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë përbën një dokument me

rëndësi të madhe teorike e praktike, që do t'i shërbejë ndërtimit të plotë e me sukses të socializmit në vendin tonë.

Populli ynë heroik, që ndërton jetën e tij pa iu trembur syri nga rrëthimi imperialisto-revisionist, duke vënë në jetë detyrat e mëdha të Kongresit të 7-të të Partisë, do ta çojë edhe më përpara ndërtimin e socializmit, do ta forcojë më tej mbrojtjen e atdheut. Në Kushtetutën e tij populli do të gjejë një fryshtësim të ri për fitore edhe më të mëdha, për ta bërë Shqipërinë më të fortë e më të begatshme, për t'i sigruuar socializmin dhe atdheun nga çdo rrezik, ngado që të vijë.

Masat e gjera të popullit tonë e thanë sfjalën e tyre për Kushtetutën e re. Duke vënë në jetë me besnikëri mandatin e popullit, ju ftoj, shokë deputetë, që ta miratojmë njëzëri e me entuziazëm Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Kushtetutën që mishëron tiparet e vërteta të socializmit fitimtar, shpirtin liridashës e guximin e popullit tonë, vijën e urtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

Rroftë pushteti ynë i diktaturës së proletariatit!

# **DISA MENDIME RRETH «DEKALOGUT» BALLIST TË MAO CE DUNIT**

**Shënimë**

**28 dhjetor 1976**

Revisionistët kinezë, me grupin e Hua Kuo Fenit në krye, i cili mori fuqinë në Kinë nëpërmjet një puçi ushtarak, botuan këtë javë një dokument të Mao Ce Dunit, një fjalim prej dhjetë pikash («Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore»), që ai ka mbajtur në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, në prill të vitit 1956.

Ky dokument është shkruar para Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës, ku raportin kryesor e mbajti Liu Shao Çia. Raporti ka pasur përbajtje revisioniste. Ne që asistuam në kongres, u çuditëm se si u mbajt ky raport dhe të paktën si nuk u dënuai as më vonë tok me Liu Shao Çinë, që u likuidua. Në këtë raport të Kongresit të 8-të shtjelloheshin problemet sipas ideve të Mao Ce Dunit, prandaj, edhe pas Revolucionit Kulturor, ai u quajt i drejtë. Këtë e afirmojnë të dhjetë pikat e «dekalogut» ballist të Maos, të cilat formojnë strategjinë dhe botëkuptimin e tij jomarksist, eklektik.

Këto dhjetë pika të Maos u shkruan dhe u shtruan pas Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashki-

mit Sovjetik, ku revizionisti dhe renegati Hrushov sulmoi marksizëm-leninizmin dhe shpifi e hodhi baltë mbi Stalinin. Me këtë veprim Maoja mori iniciativën, e cila mund të ishte e bashkërenduar me hrušovianët. Dhe kështu ishte. Hrušovi e ka pasë vënë në dijeni Maon për idetë e tij revizioniste dhe për veprimet që do të ndërmerrte. Maoja ka qenë dakord me Hrušovin, gjë që e tha botërisht në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957, ku mburri Hrušovin, goditi Stalinin dhe aprovoi likuidimin nga Hrušovi të «grupit antiparti të Molotovit me shokë». Kështu Maoja e ndihmoi Hrušovin. Ai ishte dakord me vijën e Kongresit të 20-të, ishte kundër Stalinit. Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste të Kinës ishte i akorduar me hrušovianët, sepse të dy «kumbarëtkishin të njëjtat ide. Natyrisht, edhe Hrušovi i dha premtimet Maos, por nuk i mbajti, vetëm e gënjeu sa kaloi lumen.

Pikësynimi i Maos nuk ishte të ndihmonte Hrušovin, po veten e tij, që Kina të bëhej udhëheqësja kryesore e botës komuniste dhe Maoja të zëvendësonte Stalinin, për të cilin menduan se e futën në dhe. Maoja veproi me shpejtësi për hegemoni.

Nga ana e vet Hrušovi donte ta vinte Mao Ce Dunin në radhë dhe nën drejtimin e tij, mirëpo në këtë mes ndërhyri Partia e Punës e Shqipërisë, e cila mbrojti marksizëm-leninizmin dhe Partinë Komuniste të Kinës. Në Bukuresht u ndez zjarri i polemikës, që Partia e Punës e Shqipërisë e vazhdoi «me të shtëna mitralozi» në Mbledhjen e 81 partive në Moskë. Maoja ishte për shuarjen e këtij zjarri të madh, ishte kundër polemikës.

**Ai donte mbledhje, donte ujdi socialdemokrate, sepse edhe vetë ishte një socialdemokrat, një oportunist, një revizionist.** Por Maoja nuk e shuajti dot zjarrin, as polemikën dhe, duke parë se nuk e vendosi dot hegjemoninë e tij, ndërroi qëndrim. Maoja u vendos disi «më mirë» në pozita antisovjetike dhe këtu në dukje u poq me ne që luftonim me konsekuençë revizionizmin hrušovian. Por edhe në këtë kohë ai kishte shpresa afrimi me revizionistët hrušovianë. Nga ana e udhëheqësve kinezë u bënë orvatje për këtë, por ne i kundërshtuam.

Kur ra Hrushovi, Maos iu ngjallën shpresat. Ai dërgoi Çunë në Moskë, na propozoi edhe neve që të venim, por ne e refuzuam me vendosmëri. Kjo ishte një fiasko për Mao Ce Dunin. Atëherë ai, nga strategjia e luftës në të dy krahët, u kthye drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Takimet e shumta në Varshavë midis ambasadorëve kinezë dhe amerikanë përgatitën vajtjen e Kissingerit në Kinë dhe, pas këtij, edhe të Niksonit.

**Revolucioni Kulturor mbaroi si një bisht peshku.** Ky revolucion u ndal në mes të rrugës, ose, më mirë të themi, forcoi pozitën personale të Mao Ce Dunit. Elementët e majtë «u likuiduan me një të goditur» nga të djathët me Hua Kuo Fenin në krye. Kështu vija revizioniste e Maos triumfoi dhe tash doli në dritë «dekalogu» që u përshtatet të djathtëve. Në këtë «dekalog» nuk bëhet fjalë fare për revolucionin botëror, për diktaturën e proletariatit, për luftën e klasave dhe për ndihmën ndaj popujve që duan liri dhe luftojnë për t'u çliruar.

**Ky dokument është një pasqyrë e ideve revizioniste të Maos, i cili është për bashkekzistencë paqësore edhe**

me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse nuk përmenden fare. Këtij dokumenti po i hedh një sy shpejt, por ai duhet analizuar thellë.

Asgjë nuk duhet të na çuditë për sa u përket qëndrimeve antimarksiste, pragmatiste, liberale, puçiste e plot zigzage të Mao Ce Dunit, Çu En Lait, Ten Hsiao Pinit, Hua Kuo Fenit dhe të revizionistëve të tjerë kinezë. Këto ide të tyre janë të vjetra, pesëdhjetëvjeçare, të gërshetuara me idealizëm e misticizëm dhe të lyera me një bojë të kuqe, të cilën dielli i marksizëm-leninizmit ua heq.

Një nga qëllimet kryesore të këtij «dekalogu» të Maos është të vërë kufirin midis vetes dhe Stalinit, midis ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe ideo-logjisë që udhëheq ndërtimin e socializmit në Kinë. Me fjalë të tjera, Mao Ce Duni përballë teorisë marksiste vë idetë e tij, vë maocedunidenë, siç i quajnë tash kinezët këto të ashtuquajtura mendime «të njëlljojta me teorinë thelbësore të marksizëm-leninizmit», por që në realitet janë në kundërshtim me të.

Lenini e ka parashikuar veprimtarinë e antimarksistëve, cilëtdo qofshin këta, Maoja, maoistët e të tjerë, kur thotë, në veprën e tij «Fatet historike të doktrinës së Karl Marks-it» më 1913. se

*«Dialektika e historisë është e tillë, që fitojtja teorike e marksizmit i detyron armiqjtë e tij të vishen me pëlkun e marksistëve»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 18, f. 653.

Mao Ce Duni, siç e tregon ky «dekalog», në shumë çështje parimore ka qenë me kohë në kundërshtim me teorinë dhe me praktikën revolucionare të marksizëm-leninizmit. Siç del nga «dekalogu», që në kohën e «Marshimit të madh», që në Jenan, ai kishte pikëpamje antimarksiste për hegjemoninë e klasës punëtore dhe predikonte rolin drejtues të fshatarësisë në revolucion. Edhe aktualisht të ashtuquajturën botë të tretë Maoja e bën «qendrën dhe forcën drejtuese të revolucionit», duke mohuar kështu rolin drejtues të proletariatit ndërkombëtar. Pikëpamjet antimarksiste të Maos, që pasqyrohen edhe në këtë «dekalog» dhe që janë kristalizuar në kulmin e luftës çlirimtare kineze, jo vetëm e harrojnë luftën e klasave, por predikojnë haptazi shuarjen e saj.

Pra, këto teza reaksiونare dhe antirevolucionare të Maos fiksohen edhe në «dekalogun» e vitit 1956. Në veprat e tij të shtypura në 4 vëllime nuk gjen hapur teza të tilla flagrante antimarksiste dhe antileniniste. Siç po duket, Mao Ce Duni ka qenë një eklektik, një revisionist i maskuar, i cili e çori maskën kur ra në ujdi me revisionistët hrushovianë për të shkurorëzuar leninizmin dhe për të atakuar Stalinin. Mao Ce Duni, nën maskën e marksizëm-leninizmit, shpalosi teorinë e tij pseudomarksiste dhe kjo «teori» «do të udhëhiqte këtej e tutje proletariatin botëror dhe revolucionin». Këtu e ka maocedunideja burimin e saj mashtrues, megaloman dhe denigrues ndaj marksizëm-leninizmit.

MaoCEDUNIDEJA udhëhoqi edhe «Revolucionin e madh Kulturor Proletar» për t'iu kundërvënë Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, i cili, me fjalë të tje-

ra, për Maon ishte «kapërcyer», ishte «vjetruar» tok me teorinë e Marksit dhe të Leninit. Kohët kanë ndryshuar, kështu që, sipas tij, duhej një «teori e re për marksizmin» dhe kjo ishte maocedunideja. Kjo është teoria e revizionizmit modern, e cila, si edhe ajo hrushoviania, ruan maskën leniniste. Që të dyja këto variante të revizionizmit modern janë një dhe të pandara, por çështja qëndron në atë se kush do të dominojë, varianti revolucionist i Hrushovit, apo ai i Maos, pavarësisht se të dy dalin në një qafë, në atë të antimarksizmit. Në këtë rivalitet qëndron çështja se cili shtet i madh do të arrijë të dominojë mbi tjetrin, cili do të bëjë ligjin.

Që të dy në këtë rrugë kanë marrë si spunto denigrimin e veprës gjeniale të Stalinit. Hrushovianët shpifën deri në fund kundër Stalinit, kurse Maoja përfitoi nga ky denigrim që i bëhej Stalinit dhe përdori ato të dhëna që i duheshin pér të fshehur vijën e tij revolucioniste, pér ta ngritur në quell këtë si marksiste-leniniste dhe pér t'u maskuar më mirë që të fitonte terren mbi hrushovianët. Maoja tha se 30 pér qind e veprës së Stalinit është e gabuar dhe 70 pér qind është e mirë. Mjesh-tër i madh i zigareve! E peshoi veprën e Stalinit me atë precizion që mund të peshohen edhe domatet në fushë!!

Në pikën e parë të «dekalogut» të Mao Ce Dunit shtrohet teza antimarksiste e dhënies përparësi industriale së lehtë e bujqësisë dhe jo industrisë së rëndë. Këtë devijim kosiginist-revizonist Mao Ce Duni e argumenton me atë që investimet në industrinë e rëndë janë të mëdha dhe jorentabël, kurse industria e karamaleve

dhe e shoshoneve ka të ardhura, është më rentabël. Sa për bujqësinë, kjo prodhon ushqimet e popullit.

Teza antimarksiste e Maos nuk e çon përpëra, por e frenon zhvillimin e forcave prodhuese. Bujqësia dhe industria e lehtë nuk mund të zhvillohen me rilmet e duhura në rast se nuk zhvillohet industria minerare, në rast se nuk prodhohet çelik, në rast se nuk prodhohen naftë, traktorë, trena, automobila, anije, në qoftë se nuk ngrihet industria kimike etj., etj.

Zhvillimi i industrisë, sipas Maos, është një proces artizanal. Industria e lehtë, që pretendon të zhvillojë Maoja, nuk ngrihet vetëm me tulla, bicikleta, basma, termose e erashka që vërtet mund të sjellin disa të ardhura, por njerëzit, që t'i blejnë ato, duhet të kenë fuqi blerëse. Në vitin 1956 Kina, si vend me popullsi të madhe, ishte e prapambetur ekonomikisht dhe shumë artikuj të konsumit duhej të shiteshin nën çmimin e kostos. Atëherë rendimenti nuk ishte i madh.

Maoja në «dekalogun» e tij kritikon Stalinin dhe gjendjen ekonomike në Bashkimin Sovjetik. Por «dielli nuk mbulohet me shoshë». Realiteti tregon se në Bashkimin Sovjetik, brenda 24-25 vjetëve që nga Revolucioni e deri në Luftën e Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Leninit e pastaj të Stalinit, në sajë të një vije e politike të drejtë, u ngrit një industri e tillë e rëndë që jo vetëm i dha hov ekonomisë së brendshme të këtij vendi të parë socialist, por që lejoi t'i bëhej ballë sulmit të makinës së tmerrshme të Gjermanisë hitleriane. Kurse me politikën ekonomike të Maos, nga viti 1949 e deri në ditët tona, po mbushen afër 30 vjet dhe ku është Kina

me potencialin industrial? Shumë prapa! Dhe për këtë fajet i paska «katërshja»! Jo, fajin s'e ka «katërshja», por vija e Maos, siç e vërtetojnë pikëpamjet e tij të parashtruara në «dekalog».

Po si mund të bënte Kina e madhe socialiste pa industri të rëndë? Sigurisht, Maoja mendonte se do të ndihmohej nga Bashkimi Sovjetik për ndërtimin e industrisë së rëndë, ose do të kthente fletën nga kreditë amerikane. Kur pa se Bashkimi Sovjetik nuk iu «bind-dhe nuk ia dha ndihmën e kërkuar, Maoja filloi të derdhë çelik me sobat që ndërtoheshin në trotuaret e bulevardeve ose me minifurra për gizë. Kina mbeti pas, Kina mbeti pa teknologji moderne. Është e vërtetë se populli kinez nuk vuante më për bukë si më parë, por të arrish të pohosh, siç bëri Maoja, se fshatari kinez më 1956 rronte më mirë se kolkoziani sovjetik, në një kohë kur në të vërtetë ai ishte prapa, kjo do të thotë të denigrosh kolektivizimin e bujqësisë dhe ndërtimin e socialistit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe të Stalinit.

Mao Ce Duni thotë me përcnim: «Ç'kuptim ka të bisedosh për zhvillimin e industrisë së rëndë? Duhet t'u sigurohen punëtorëve mjetet e jetesës». Me fjalë të tjera, kjo është «teoria e gulashit» e Hrushovit. Dhe si përfundim Maoja në «dekalog» kërkon të thotë se ata s'kanë bërë gabime si paska bërë Bashkimi Sovjetik, ose më mirë (po këtë nuk e thotë me plot gojën) si Lenin dhe Stalini. Por që ta mbulojë këtë devijim, ai nuk mungon të thotë se «duhet që edhe industrinë e rëndë ta zhvillojmë, por më shumë vëmendje t'u kushtojmë buj-

qësisë dhe industrisë së lehtë». Kjo pikëpamje e tij që u zbatua në mënyrë pragmatiste dhe që Kinën e ka lënë prapa, ka bërë që kësaj t'i duhen dekada, deri në vitin 2000, që të arrijë disi të kapërcejë prapambetjen... me ndihmën dhe me kreditë e kapitalit amerikan që po i siguron strategjia e re. Nuk ka asnjë dyshim se Kina mund të mbështetet në forcat e veta, ajo ka një fuqi njerëzore të madhe, ka gjithashtu një fuqi ekonomike të konsiderueshme, por ka mbetur pas për shkak të vijës së saj të gabuar.

Në pikën e dytë të «dekalogut» shtrohet edhe çështja se ku duhet të ndërtohet industria, në bregdet apo në brendësi. Maoja thotë se «rreth 70 për qind e gjithë industrisë sonë, të lehtë dhe të rëndë, ishte ngritur në rajonet bregdetare dhe vetëm 30 për qind në rajonet e brendshme. Kjo ndarje e parregullt është rezultat i historisë». Kuptohet, kjo industri u ngrit nga të huajt, të cilët kishin koncesionet aty, thithnin lëndën e parë nga Kina e brendshme dhe në bregdet gjenin punëtorë skllevër. Kësaj mënyre zhvillimi Maoja i jep rëndësi. Ai thekson se edhe në të ardhmen duhet të vazhdohet të ndërtohet në bregdet dhe bën për këtë një llogari fantaziste se, me të ardhurat e një fabrike të industrisë së lehtë, «ne mund të fitojmë për të ndërtuar brenda katër vjetëve tri fabrika të tjera ose dy, ose një, osc të paktën gjysmën e njërsë». Kjo i përrngjet teorisë së revolucionistit Koço Tashko, i cili në Konferencën e Parë të Partisë në Labinot tha se ne «duhet të bëjmë një revolucion me shumë gjak, me pak gjak ose, mundësish, me aspak gjak».

Lidhur me këtë çështje Maoja nxjerr konkluzionin: «Të ndërtojmë industri edhe në thellësi, që ta kemi edhe pér kohë luftë».

Por nga do t'i vijë lufta? Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Japonia, apo nga Bashkimi Sovjetik? Siç duket, në të njëjtën kohë ai mendon se lufta nuk do t'i vijë nga asnë anë, sidomos jo nga deti, derisa në breg të tij Maoja rekomanon të ndërtohen fabrika.

Maoja, si duket, nuk mendon se në ç'mënyrë duhet ta shpopullojë ca Jugun dhe Juglindjen, pér të populluar Veriun dhe Perëndimin.

Në pikën e tretë të «dekalogut» Mao Ce Duni përcakton raportet në mes ndërtimeve ekonomike dhe atyre të mbrojtjes. Ai, kur thotë se duhet t'i ulim shpenzimet pér mbrojtjen, duket qartë se mbështetet në përcaktimet e gabuara. Mbrojtja kineze, sipas Maos, na qenka më e fuqishme se ajo e Bashkimit Sovjetik para Luftës së Dytë Botërore.

Hrushovi lëshoi tezën se Stalini gjoja e kishte lënë Bashkimin Sovjetik pa mbrojtje përballë hitlerianëve. Këtë shpifje adopton edhe Maoja, duke u mburrur se, me ata avionë dhe me ata topa që kishte (dhe me bombardë atomike që do t'ia jepte Hrushovi), mbrojtja e Kinës ishte e siguruar.

Faktet tregojnë se Kina mbeti prapa. Kjo ishte pasojë e nënveftësimit të industrisë së rëndë dhe e mbështetjes tek të tjerrët pér të forcuar aftësinë mbrojtëse me një strategji ushtarake të gabuar. Tash Kina ka filluar të ndërrojë mendje pér mbrojtjen, por, tok me këtë, ka ndryshuar edhe alcancat. Ajo është afruar me amerika-

nët dhe ka blerë prej tyre teknologji moderne luftarakë.

Po në këtë pikë të «dekalogut» Maoja shprchët qartë se është për një armatim të lehtë, për të paguar ushtarët kinezë (si një ushtri mercenare) dhe për të shkurtuar administratën, për të cilën asgjë nuk është bërë, në të kundërtën, ajo është shndërruar në një kancer për Kinën. Këtë ne e kemi konstatuar kur ishim atje në vitin 1956 dhe na e kanë thënë vetë: gjithë ish-ushtarakët e Çan Kai Shisë mbaheshin si nëpunës me rrogë.

Në pikën e katërt të «dekalogut» flitet për marrëdhëni midis shtetit, njësive të prodhimit dhe produhesve. Natyrisht këtë organizim dhe këtë ndarje organizative të Kinës as nuk e kemi mësuar kurrë dhe as nuk dimë si janë marrëdhëni mes shtetit, njësive të prodhimit dhe produhesve. Kina mund dhe duhet të ketë specifikën e saj, sepse ajo ka një territor të madh, me plot kombësi dhe jo me republikë, por me provinca. Ne kemi ditur që atje ka centralizëm demokratik, por që provincat tē mos kishin kompetenca në ndarjet brenda tyre dhe hozrashote në fabrika, këtë nuk mund ta imagjinonim. Maoja na thotë se në Bashkimin Sovjetik (kuptohet të kohës së Stalinit) ka pasur një centralizëm tē madh e burokratik dhe, sipas tij, republikat sovjetike i kishin duart tē lidhura. Sa është e vërtetë kjo nuk e dimë, por aq burokraci dhe centralizëm, në mos më shumë nga sa kishte në Bashkimin Sovjetik, kishte e ka sot edhe në Kinë. Por Kina është në vijën e denigrimit tē Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit dhe vepron

ashtu si Hrushovi. Maoja dëshiron të tregohet më organizator «marksist-leninist», por, me këto që po bën, mos vallë ai po ecën në rrugën e vetadministrimit titist?

Maoja po në këtë pikë e krahason ushtrinë me shtetin, domethënë një armë të shtetit ai e quan shtet dhe e vë atë edhe mbi partinë. Në fakt, në Kinë e vjetër dhe në këtë të renë ushtria ka luajtur një rol vendimtar. Ajo ka mbështetur një fraksion dhe ka likuiduar tjetrin.

Centralizmin demokratik dhe pavarësinë ekonomike nga qendra, Maoja e banalizon me një shembull qesharak dhe semplist që të habit se si ky «teoricien i madh» shpjegon një çështje kaq të rëndësishme politike, ideologjike dhe organizativo-ekonomike të socializmit me kaq desinvolturë<sup>1</sup>!?

Kur flet për fshatarësinë, dhe këtë Maoja e bën më 1956, kur kanë kaluar vetëm pak vjet prej çlirimt, ai nxjerr në pah dhe vë në dukje se sistemi i kolkozeve dhe i sovkozeve në Bashkimin Sovjetik është një falimentim, se fshatarët atje janë të shtypur nga taksat, se prodhimet u paguhen lirë e të tjera të këqija, kurse në Kinë gati sa nuk thotë që fshatarësia rron në bollëk e në lumturi, se prodhimi është i bollshëm, se çmimet janë të ulëta, se akumulimi shtetëror është i paktë. Analizë e çuditshme! Ne e kemi njojur vetë gjendjen si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në Kinë, sepse

---

1. Frëngjisht — qëndrim, mënyrë të vepruar me një lehtaesi e liri të tepruar.

kemi qenë në ato vite në të dy vendet, prandaj kjo që thotë Maoja nuk është reale.

Në këtë pikë të «dekalogut», analiza e Maos përmarrëdhëniet shtet-bujqësi, komuna-komunare, për ndarjen e të ardhurave, për problemin e investimeve, për çështjen e akumulimit dhe nivelin e jetesës të komunave fshatare dhe të qytetit nuk është aspak marksiste-leniniste, nuk është as një pasqyrë e qartë dhe objektive e gjendjes, por vetëm një demonstrim i «epërsisë» së rreme të bujqësisë kineze përballë asaj sovjetike. Hrushovi na doli një «teoricien i bujqësisë», i cili do ta nxirrte këtë «nga llumi ku e kishte futur Stalini». Edhe Maoja po imiton këtë kulak e matrapaz.

Këtë problem kaq të rëndësishëm Maoja e mbyll me fjalë që duan të tregojnë se në Kinë çdo gjë shkon mirë; industrinë e rëndë e vë në radhën e tretë, fabrikantët borgjezë i integron në socializëm; kështu predikon edhe për kulakët në fshat, e çdo gjë të rregullohet sipas teorisë së tij maoiste, që na qenka plotësisht e drejtë, pa gabime! Në të vërtetë këto ide të Maos janë në kundërshtim me ato të Leninit e të Stalinit.

Nuk ka ku vete më qartë megalomania e këtij «klasiku» revisionist dhe denigrimi që ai i bën veprës së Leninit dhe të Stalinit.

Në pikën e pestë të «dekalogut», ku flitet përmarrëdhëniet midis qendrës dhe bazës, Mao Ce Duni përcakton cilat duhet të jenë këto marrëdhënie. Natyrisht, kjo varet nga kompetencat që i ka dhënë qendra bazës në Kinë. Tërë kjo punë ka lidhje me territoret e mëdha e të gjera të këtij vendi. Këtu Mao Ce Duni shtron se

nuk duhet ndjekur shembulli i Bashkimit Sovjetik në përqendrimin e çdo çështjeje në duart e organeve qendrore, duke u ndrydhur iniciativën organeve lokale, por të bëhen përpjekje që këto të drejtojnë në mënyrë të pavarur. Me këtë Maoja do të thotë se republikat e federuara në Bashkimin Sovjetik nuk kishin asnje kompetencë. Ky është një blof, një gjenjeshtër, pse, siç e dimë, republikat sovjetike kanë pasur planet e zhvillimit të tyre ekonomik, planet industriale, ato bujqësore etj., natyrisht të lidhura ngushtë këto edhe me qendrën. Pra, të thuash se republikat në Bashkimin Sovjetik, siç mund të janë provincat në Kinë, nuk kanë pasur kompetenca të tyre, do të thotë të denigrosh socializmin që u ndërtua atje në kohën e Stalinit, do të thotë të përpinqesh të tregosh se organizimi, drejtimi, ideologjia dhe politika e Kinës qëndrojnë më lart nga ato të Bashkimit Sovjetik, se praktika leniniste e ndërtimit ekonomik të socializmit në Bashkimin Sovjetik, sipas Maos, nuk është e drejtë, pse, sipas tij, këtë praktikë leniniste e kishte shtrembëruar Stalini! Mirëpo ne dimë që Stalini ka zbatuar me besnikëri politikën ekonomike, organizative dhe ideologjike të Leninit. Që mund të janë bërë edhe atje gabime gjatë gjithë kësaj pune kolosale, kjo nuk përjashtohet. Vetë Mao Ce Duni thotë se edhe në Kinë janë bërë gabime, por, kur vjen rasti për të folur për Bashkimin Sovjetik, këto gabime ai i frysht shumë, bile i zmadhon në një shkallë të tillë saqë duket hapur se ai synon të denigrojë sistemin e drejtë të ndërtimit socialist të kohës së Stalinit.

Është absurde të pohosh se në Bashkimin Sovje-

tik në kohën e Stalinit nuk ka pasur iniciativa nga ana e organeve lokale. Mos vallë Mao Ce Duni me këtë po-him dëshiron të minimizojë dhe të dobësojë rolin e centralizmit demokratik e të justifikojë rrugën e vet-administrimit titist? Ne nuk i harrojmë konsideratat e Mao Ce Dunit për Titon. Të pranosh se ka gabuar Stalini në drejtëm të Titos, kjo do të thotë se Mao Ce Duni duhet të ketë aprovuar metodat e vetadministrimit të ekonomisë jugosllave, domethënë metodat e vetadministrimit revisionist titist. Këtë vetadministrim Maoja dëshiron ta zbatojë progresivisht edhe në Kinë. Ai nuk mungon të flasë edhe për specifikën. Është interesante ajo që thonë kinezët se duan të ndërtojnë një socializëm specifik. Në këtë çështje puqen me Titon, i cili ka kohë që dërdëllis për ndërtimin e «socializmit specifik». Këtu nuk është çështja vetëm e termit që përdorin kinezët, por edhe e brendisë dhe e futjes në këtë të përvojës ala titiste.

Në pikën e gjashtë Maoja flet për marrëdhëni midis kombësisë së hanëve dhe kombësive minoritare që jetojnë në Kinë. Në teori mund të flasësh sa të duash për barazinë midis kombeve, por, në fakt, në Kinë sundon kombësia e hanëve. Në marrëdhëni midis kombësive populli han ka mbajtur dhe ruan epërsinë, ai dominon dhe urdhëron kombësitë e tjera, pavarësisht nga formulat bajate dhe demagogjike që përdoren. Në kohën e Stalinit gjendja në marrëdhëni midis kombësive ruse dhe pakicave kombëtare nuk ka qenë siç pretendon Maoja. Gabime ka pasur, por jo ashtu siç pohon ai. Në Kinë nuk ekziston demokraci

e barazi midis kombësive. Atje ekziston, si në kohët e para, një diktaturë ushtarake. Ai fraksion i asaj kombësie që kishte ushtrinë me vete u impononte vullnetin e vet masave të popullit dhe partisë. Pra në krye, të partisë atje është ushtria, në krye të shtetit gjithashu është ushtria.

Në pikën e shtatë, lidhur me marrëdhëniet midis njerëzve me parti dhe atyre pa parti, Mao Ce Duni është plotësisht në vijën revizioniste, oportuniste. Partinë komuniste ai nuk e vë në krye, në udhëheqje; lë të kuptohet që kjo është në udhëheqje, por kërkon dhe afirmon që pushteti të ndahet me partitë e borgjezisë. Pra, Maoja është për pluralizmin e partive në drejtimin e shtetit proletar. Këto parti të ndryshme ai i quan të domosdoshme të ekzistojnë për shumë arsyë: për arsyë të kritikave që mund t'i bëhen Partisë Komuniste të Kinës, për arsyë se mund të mësohet shumë prej tyre për të zbuluar çdo gjë që organizohet dhe veprohet nën rrugoz etj. Ekzistencën e këtyre partive ai e konsideron si një faktor përcaktues ose më mirë të themi si një faktor të domosdoshëm për ndërtimin e socializmit në Kinë.

Me këtë Maoja bie në kundërshtim me Leninin, i cili, natyrisht, nuk ka lejuar që parti të tjera, veç asaj bolshevike, të drejtonin shtetin sovjetik. Pra të pranosh vënien e sistemit të shumë partive në udhëheqje, do të thotë të udhëhiqesh nga pikëpamje ideologjike antimarksiste. Në këtë kapitull Maoja përpinqet që t'i reduktojë këto parti në disa njerëz, në disa udhëheqës, të cilët -bëjnë nga një kritikë ose miratojnë vendimet e Partisë

Komuniste të Kinës». Këtu nuk është çështja e disa individëve demokratë përparimtarë, të cilët edhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, edhe Partia jonë e të gjitha partitë e tjera i kanë pranuar në front, i kanë mbajtur afër, janë këshilluar me ta kur ka qenë e nevojshme, por Mao Ce Duni ligjëson ekzistencën e partive borgjeze në drejtimin e shtetit proletar. Me këtë tezë të tij ai shpjegon gjoja se «partitë demokratike janë produkte të historisë» dhe se «çdo gjë që lind në histori, zhduket në histori». Për marksistë-leninistët është e qartë se çdo parti përfaqëson interesat e disa klasave e të shtresave të caktuara, prandaj ç'kuptim ka të ruash në socializëm partitë që përfaqësojnë interesat e borgjezisë? Kjo do të thotë të mos bësh luftën e klasave, të mos luftosh për rolin hegemon të proletariatit e të partisë së tij.

Këto parti të ashtuquajtura demokratike, deri tek ajo e Guomindanit, do të zhduken, sipas Maos, ashtu siç do të zhduket edhe partia komuniste. «Me zhdukjen e partisë komuniste dhe të diktaturës së proletariatit, ne do të jemi shumë të kënaqur», thotë ai.

Maoja nuk mungon të thotë që aktualisht ne nuk mund të bëjmë pa diktaturën e proletariatit dhe pa partinë e proletariatit. Ai e thekson këtë dhe flet që partia duhet të bëhet e fuqishme, bile për këtë ai citon edhe Leninin, por këtë e bën pasi ka hedhur helmin. Lenini ka thënë se nuk mund të bëjmë pa partinë e proletariatit dhe pa diktaturën e proletariatit, ka shpjeguar edhe përsë shërben kjo diktaturë. Më 1920 Lenini thoshte:

«Kush e dobëson qostë edhe pak disiplinën e hekurt të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»<sup>1</sup>.

Stalini gjithashtu thotë:

«Mjafton vetëm të tronditet partia jonë, të dobësohet ajo, që menjëherë të tronditet dhe të dobësohet diktatura e proletariatit»<sup>2</sup>.

Në pikën e tetë, ku bën fjalë për raportin midis revolucionit dhe kundërrevolucionit, Mao Ce Duni thotë se diktatura e proletariatit nevojitet për të shtypur kundërrevolucionin dhe kundërrevolucionarët, por për fat të keq ai i përkëdhel kundërrevolucionarët. Ai pohon se «kemi vrarë në fillim disa kundërrevolucionarë, por më nuk duhet të vrasim, nuk duhet të burgosim, ata nuk duhet t'i gjykojmë, por t'i bindim, t'i dërgojmë në fshat, ku të edukohen në punë» etj., etj. «Ne mund ta mbajmë në fuqi ligjin e dënimit me vdekje, — thotë Maoja, — por të mos e zbatojmë në praktikë! Ç'është kjo? Kjo nuk është luftë klasash. Një qëndrim i tillë nuk e zhduk kundërrevolucionin, nuk i zhduk klasat shfrytëzuese.

Por, lidhur me këtë, mes të tjera, Lenini na mëson që të shkohet

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 33.

2. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 7, f. 347.

«...deri në dëbimin total ose në internimin e shfrytëzuesve më të rrezikshëm dhe më kryenegjë, vendosja e një mbikëqyrjeje rigorozë mbi ta për të luftuar kundër orvatjeve të pashmangshme për rezistencë dhe për restaurimin e sklavërisë kapitaliste, vetëm masat e këtij lloji janë në gjendje të sigurojnë nënshtrimin e vërtetë të të gjithë klasës së shfrytëzuesve»<sup>1</sup>.

Nga tezat e «dakalogut» të Maos duhet të jenë shkurtuar shumë gjëra, sepse disa muaj pas Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës është fojur shprehimisht që pronarët e fabrikave duhet të marrin renta dhe të jenë zëvendësdrejtore të tyre. Kjo pikëpamje duket në gjithë këtë tezë të Mao Ce Dunit. Ai i mban reaksionarët kapitalistë në drejtimin e fabrikave që kanë pasur pronë të tyre, u jep të ardhura nga këto fabrika, që u janë shtetëzuar, por që pjesërisht konsiderohen të tyre, dhe harron se ato i kanë ngritur e i kanë zgjeruar duke shfrytëzuar gjakun dhe djersën e punëtorëve. Luftë klasash i thonë kësaj? Jo, nuk i thonë aspak luftë klasash. Këta ish-pronarë, sipas Mao Ce Dunit, duhet të shkrihen në shoqëri, të futen në shoqëri, të edukohen në shoqëri. (Domethënë të integrohen në socializëm. Për integrim të kapitalizmit në socializëm po flitet sot shumë nga «teoricienët» borgjezë e revolucionarët, si dhe nga titistët, eurokomunistët etj.) «Kjo do të jetë një gjë shumë e mirë, — pohon

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 31, f. 201.

Maoja, — për shumë arsyë, një nga të cilat është se ne (kinezët) do t'u japim kështu një shembull të mirë vendeve të tjera të botës». (Shembull «i bukur» se si nuk luftohen armiqtë e popullit!)

Krejt ndryshe mendon Lenini. Ai thotë:

*«Dhe lufta kundër kësaj vale spontane nuk mund të zhvillohet vetëm me propagandë dhe agjuracion, vetëm duke organizuar emulacionin, vetëm duke zgjedhur organizatorë, — lufta duhet zhvilluar dhe me detyrim!»<sup>1</sup>.*

Dhe prapë Lenini, lidhur me këtë problem, theksion:

*«... çdo mendim se kapitalistët do t'i nënshtronhen në mënyrë paqësore vullnetit të shumicës së të shfrytëzuarve, se mund të kalohet në mënyrë paqësore, reformiste në socializëm është jo vetëm marrëzia filistine më e madhe, por edhe një mashtrim i drejtpërdrejtë i punëtorëve»<sup>2</sup>.*

Pikëpamje tjetër e Maos është ajo se, sipas tij, po t'i zhdukim kapitalistët, ne do të humbasim edhe një burim informacioni, kështu që nuk do të dimë ç'ngjet në gjirin e tyre. Ç'përfundime «gjeniale» për të shuar luftën e klasave! Për të zbatuar edhe ne një «luftë klasash» të tillë, u përpoq të na mbushte mendjen Çu En

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 27, f. 295.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 201.

Lai, i cili na akuzonte se gjoja ne nuk bënim luftë klasash! Qëllimi ishte për të parë se deri ku e bënim ne këtë luftë, ishim me vijën e Mao Ce Dunit për shuarjen e luftës së klasave, apo me rrugën leniniste dhe staliniane për zhvillimin me ashpërsi të kësaj lufte.

Në Partinë Komuniste të Kinës Maoja ka kultivuar kultin e tij dhe nuk ka zbatuar mësimet e mëdha të marksizëm-leninizmit, as luftën e klasave, as disiplinën e hekurt proletare, as diktaturën e proletariatit. Partia Komuniste e Kinës është rritur dhe është brumosur me norma liberale, reformiste, mo dy e më shumë vija. Pra, tezat bazë të marksizëm-leninizmit janë fiktive për Maon dhe për Partinë Komuniste të Kinës.

Njerëz si Mao Ce Duni e akuzojnë Stalinin se gjoja paska bërë gabime në lidhje me luftën e klasave, kurse vetë afirmojnë se në socializëm lufta e klasave vjen duke u dobësuar. Bile Mao Ce Duni flet fare hapur që të mos bëjmë luftë klasash, të mos ekzekutojmë kriminelët, të mos pushkatojmë armiqët e rrezikshëm, të mos futim njeri në burg. Kurse Stalini një gjë të tillë nuk e ka bërë kurrë. Ai në praktikë e vazhdoi me ashpërsi, me vendosmëri e deri në fund luftën kundër armiqve të popullit. Për ta shfajësuar kundërrevolucionin, për ta mbrojtur atë, Mao Ce Duni jep deri në pesë-gjashtë arsyë dhe me to mundohet «të provojë» se rruga e tij na qenka e drejtë, marksiste-leniniste.

Maoja pretendon të zhdukë dhunën, dënimin me vdekje, gjykatat dhe prokuroritë, që të mos ndëshkohen kundërrevolucionarët. Ai predikon vetëm edukimin dhe propagandën. Ku është këtu lufta e klasave

nga ana e Maos? Ku ekziston diktatura e proletariatit në pikëpamjet dhe në praktikën e tij?

Në pikën e nëntë Maoja flet për marrëdhëniet midis së drejtës dhe së padrejtës. Ku synon ai që flet për këto marrëdhënie? Edhe këtu Maoja përpinqet të sulmojë Stalinin. Ai thotë se «Stalini pushkatonte njerëz për gabimin më të vogël». Kjo është një shpifje. Stalini nuk pushkatonte njerëz për gabime, përkundrazi, ata që gabonin ai luftonte t'i korrigjonte dhe për këtë të vërtetë janë dokumentet që flasin. Stalini orientonte që të futeshin në burg ose në kampe përqendrimi keqbë-rësit apo të pushkatoheshin kundërrevolucionarët, tradhtarët, spiunët dhe armiqtë e tjerë të popullit për krime veçanërisht të rrezikshme. Po të mos bëhej kjo nga ana e tij, nuk mund të ndërtohej socializmi në Bashkimin Sovjetik dhe ai nuk mund të ishte në rrugën leniniste. Mao Ce Duni është në kundërshtim me këtë vijë. Ai e përgjithëson çështjen dhe i trajton njëloj si ata që kanë bërë krime jo shumë të rrezikshme, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të pushkatohen, ashtu edhe kundërrevolucionarët. Kush thotë t'i pushkatojmë ata që s'kanë bërë krime të rënda? Askush. Përkundrazi, ne jemi për atë që të tillë njerëz t'i ndreqim dhe kështu kemi vepruar.

Pika e dhjetë dhe e fundit e «dekalogut» bën fjalë për marrëdhëniet mes Kinës dhe vendeve të tjera. Këto marrëdhënie, që ai i shpjegon dhe i ngrë në teza, nuk kanë shumë marksizëm brenda, përkundrazi, janë marrëdhënie oportuniste, revisioniste. Ato kanë për qëllim që në Kinë të mos zbatohet një vijë e drejtë revolucionare.

nare në ndihmë të proletariatit botëror dhe të revolucionit botëror, në ndihmë të partive komuniste marksiste-leniniste, që këto të luftojnë me sukses kundër borgjezisë, kundër kapitalizmit dhe revizionizmit modern. Në fakt, Maoja është një revisionist modern, si dhe revisionistët sovjetikë, titistë e të tjerë.

Lidhur me politikën e jashtme të Kinës, në tezat e famshme të Mao Ce Dunit thuhet: «Politika jonë është të mësojmë pikat e shëndosha të të gjitha kombeve dhe vendeve, të mësojmë gjithçka ka të mirë në fushën politike, ekonomike, shkencore dhe teknike, si dhe në letërsi e në art». Kjo është e gjithë politika e tij. Që të bëhen këto, sipas Mao Ce Dunit, duhet të vendoset bashkekzistenca paqësore (revisioniste) me të gjitha shtetet e botës. Për Maon nuk ka dallim mes këtyre shteteve. Mao Ce Duni, më vonë, duke injoruar rendin ekonomiko-shoqëror që cikiston në njërin apo në tjetrin vend, botën e ndau në tri dhe është për strategjinë e «tri botëve». Ai nuk është kundër asnjë «botë». Edhe në «botën e parë», ku Maoja fut imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik, ai nuk bën dallime. Tash është pro imperializmit amerikan, nesër mund të jetë kundër; sot është kundër socialimperializmit sovjetik, nesër mund të jetë pro tij. Pra, ai lëviz sipas rrethanave, ashtu si e do interesit revisionist i shtetit kinez, dhe nuk vepron në bazë të parimeve marksiste-leniniste, nuk mendon se duhet të luftohen fuqitë imperialiste dhe të mbështetet lufta nacionalçlirimtare e popujve.

Luftën nacionalçlirimtare të popujve Mao Ce Duni

nuk mund ta mbrojë me këtë vijë. Demagogji ai mund të bëjë dhe të deklarojë që «ne kinezët jemi me popujt e botës së tretë», por këto janë vetëm fjalë. Derisa formulon taktikën që përmenda më sipër, derisa është me imperializmin amerikan, me të cilin nuk dëshiron ta prishë, sepse duhet «të mësojë» nga ai, të marrë edhe kredi të hapëta ose të fshehta, Mao Ce Duni nuk mund të jetë me popujt e së ashtuquajturës botë e tretë, të cilët luftojnë kundër imperializmit amerikan, nuk mund t'i ndihmojë ata që të shpëtojnë nga zgjedha e këtij imperializmi. Me demagogji ai përpinqet të dalë në mbrojtje të shteteve që janë nën ndikimin e social-imperializmit sovjetik, por këtë e bën për t'i kaluar ato ose nën influencën e Kinës, ose nën influencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Duke ndjekur një strategji antimarksiste, Maoja pranoi Niksonin të vente në Kinë, pa u njojur zyrtarisht ky shtet nga SHBA; gjithashtu, ai pranoi që të heqë për vizitën e presidentit amerikan pengesën e çështjes së Tajvanit, të cilën e kishte ngritur si një mur çeliku për çdo vend që donte të lidhte marrëdhënie diplomatike me Kinën. Që atëherë ai e la në heshtje Tajvanin. Me këtë ai u thotë Shteteve të Bashkuara të Amerikës se mund të qëndrojnë në Tajvan, në Japoni, në ishujt Okinava, në Birmani e gjatkë, dhe mbi këtë strategji të Maos Kina e udhëheqësit e sotëm revolucionistë kinezë kanë mbështetur politikën e tyre të jashtme dhe mbrojtjen. Me siguri udhëheqja kineze duhet të ketë pranuar që amerikanët mund të qëndronin edhe në Vietnamin e Jugut dhe të pushohej lufta, që viet-

namezët të binin në miqësi me amerikanët. Për këtë arsyе duhet të kenë lindur kundërshtimet mes kinezëve dhe vietnamezëve, të cilët në një kohë deklaruan hapur që «Ne (vietnamezët) nuk lejojmë asnjë shtet tjetër të përzihet në punët tona të brendshme...».

Mao Ce Duni e akuzon Stalinin për aventurizëm të majtë, e akuzon se ka bërë presione të mëdha kundër Kinës dhe Partisë Komuniste të Kinës. Stalini duhet të mos ketë pasur besim tek udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës. Kur u çlirua Kina, Stalini ka shprehur dyshimin se mos udhëheqja kineze shkonte në rrugën titiste. Duke u hedhur një sy gjithë parimeve kryesore të vijës revizioniste të Mao Ce Dunit, për të gjitha ato që ngre kundër Stalinit, mund të themi me plot gojën se Stalini ka qenë me të vërtetë marksist-leninist i madh dhe ka parashikuar drejt se ku po shkonte Kina, ka parë me kohë cilat ishin pikëpamjet e Mao Ce Dunit, ka vlerësuar se ato në shumë drejtime ishin pikëpamje revizioniste titiste, si në politikën ndërkombëtare, edhe në politikën e brendshme, në luftën e klasave, në diktaturën e proletariatit, në bashkëzistencën paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore etj.

Duke botuar këtë «dekalog», Hua Kuo Feni me shokë duan të legalizojnë vijën e tyre revizioniste, të legalizojnë veprimtarinë e tyre kundërrrevolucionare, të legalizojnë ndërprerjen e Revolucionit Kulturor, sepse mendojnë se kështu do të peshkojnë më lehtë, megjithëse, siç e kam pasë shkruar më përpara, Revolucioni Kulturor në Kinë nuk ka qenë në baza revolucionare,

por në baza oportuniste. Ai ka qenë luftë e një grupei oportunist me Mao Ce Dunin në krye, kundër një grupei tjetër oportunist me Liu Shao Çinë, Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin, Pen Çenin e të tjerë në krye, që kishin uzurpuar pushtetin. Mao Ce Duni ishte vënë në rrezik nga grupei kundërshtar dhe personi i tij do të hidhej në shportën e historisë, siç hodhi Maoja Liu Shao Çinë. Maoja diti të përfitonte nga kulti që ishte ngritur në qiell për të, megjithëse për kultin ai akuzon të tjerët si mburravecë. Këta mburravecë, sipas Maos, janë Stalin me shokë. Pra, Mao Ce Duni përfitoi nga kulti i shfrenuar që ishte ushqyer gjatë gjithë jetës për personin e tij, ngriti ushtrinë në këmbë, u mbështet tek ajo e te rinia shkollore dhe shpërtheu të ashtuquajturin Revolucion Kulturor. Por edhe këtë revolucion ai e pengoi të zhvillohej deri në fund, për arsy se rrezikonte të gjithë kuadrot oportunistë që bënин pjesë në grupin e Liu Shao Çisë dhe të Çu En Lait, rrezikonte edhe vetë Mao Ce Dunin. Prandaj, pas një kohe, e ktheu në drejtim tjetër timonin, mbështeti të djathjtët dhe i dha fuqi Çu En Lait, i cili përpunoi dhe vuri në zbatim planet e tij.

Gjatë kësaj kohe elementë të rinj, që dolën në procesin e Revolucionit Kulturor, sidomos ata të «katersh», që tash quhen «tradhtarë» nga Hua Kuo Feni. e shikonin këtë greminë të tmerrshme ku po e çonin Kinën, dhe me mënyrën e me metodat e tyre, që, siç duket, nuk ishin shumë të studiuara e të pjekura, mundet edhe jo plotësisht të drejta, por megjithatë ishin pak a shumë revolucionare, u përpoqën t'i vinin një

kufi kësaj veprimtarie armiqësore, e cila e çonte Kinën në socialimperializëm. Me vdekjen e Maos, të djathtët arritën të marrin fuqinë. Ata përnjëherë, me një të rënë, siç e thonë, goditën elementët e së majtës dhe shtypën revolucionin. Pra, kundërrevolucionarët, që ishin futur në pushtet e në parti nga Mao Ce Duni dhe nga pasuesit e tij, e shtypën revolucionin në Kinë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shë-  
nime për Kinën», vëll II,  
f. 359*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënimë për  
Kinën», vëll II, f. 359*

# **REVIZIONISTËT KINEZE SULMOJNE PRAPA KRAHËVE PARTINE E PUNËS TË SHQIPËRISË**

**Shënime**

**8 janar 1977**

Partia Komuniste e Kinës ka hapur një polemikë të ndyrë prapa krahëve të Partisë sonë, pa i shtruar më parë mosmarrëvçeshjet dhe kontradiktat që ka më të. Ajo ka përgatitur një material standard, thërret në Pekin përsaqësuesit e të gjitha partive marksiste-leniniste që mundet dhe ua punon atë. Ky material, në përgjithësi, është përgatitur kundër vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe, në veçanti, kundër Kongresit të 7-të të saj.

Një veprim të tillë revizionist, trockist, as Hrushovi nuk e kishte bërë, as kundër nesh, por, me sa dimë, as kundër kinezëve. Renegati Hrushov na ka sulmuar, na ka atakuar e na ka kundërshtuar ne ose haptazi, ose me letër, kurse kinezët asnjëherë nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Ne, për çdo çështje me rëndësi parimore, ku kemi pasur divergjenca me ta, ose u kemi shkruar letra, ose

ua kemi bërë të njohura pikëpamjet tona me anë delegacionesh. Nga ana jonë qëndrimet kanë qenë korrekte si mes dy partive motra. Kur nuk kemi qenë dakord me ta, çdo gjë ua kemi thënë hapur, kemi mbrojtur mendimet tona dhe nuk kemi ndërruar mendim. Kinezët nuk u janë përgjigjur letrave tona dhe për një varg problemesh secila parti ka vepruar sipas pikëpmjes së vet.

Ata pretendojnë se «nuk donin të bënин polemikë me ne» për çka u kemi shtruar, prandaj nuk na janë përgjigjur. Mirëpo ata vetë vepronin sipas strategjisë së tyre dhe kjo ishte «e drejta» e tyre, por edhe ne vepronim sipas strategjisë dhe taktikës sonë. Por, siç po duket, ata strategjinë dhe taktikën tonë i kanë konsideruar si sulme kundër Partisë Komuniste të Kinës; atëherë edhe ne kemi të drejtë t'i konsiderojmë ato të tyret si sulme kundër Partisë së Punës të Shqipërisë.

Del qartë se Partia Komuniste e Kinës, e cila në mënyrë hipokrite pretendon se nuk duhet të ketë «parti mëmë» dhe «parti bijë», ka dashur që Partia e Punës e Shqipërisë të ndiqte qorazi vijën e saj dhe jo vetëm kaq, por të na impononte neve mendimet e veta. Them kështu sepse ajo as ka pranuar të bisedonte me ne përkëto divergjenca që njiheshin nga dy partitë tona. Po përse ndodhë kështu?

Së pari, ne mendojmë se Kina e ndiente veten «një shtet i madh», Partia e saj Komuniste «një parti e madhe» dhe Mao Ce Duni «një udhëheqës i pagabueshëm», prandaj ndjenja e «shtetit të madh», e «partisë së madhe» dhc e «udhëheqësit të madh» vepronin në bllok..

Së dyti, Kina, megjithëse është «për marrëdhënie dypalëshe dhe për bisedime të tilla», i trembet ballafaqimit të mendimeve me ne. Bashkëbisëdime dypalëshe Kina «pranon», por të tilla bisedime ajo i do për aq sa të informohet, se pastaj, atje ku gjen, u jep direktiva të tjerëve.

Së treti, Kina mendon se, meqë ajo na jep disa kredi, ne duhet t'u bindemi pikëpamjeve të saj.

Dëshiroj t'i thelloj pak më shumë mendimet tonë se për ç'arsye Mao Ce Duni dhe Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës nuk kanë dashur të bisedojnë me ne për problemet që u kemi shtruar dhe për të cilat kemi pasur divergjenca me ta. Ne mendojmë se çështja qëndron në pikëpamjet socialdemokrate dhe oportuniste që kanë ekzistuar te Mao Ce Duni. Për këtë problem atij nuk i bëhej vonë nëse ekzistonin mendime të kundërta. Por, përveç kësaj, ka ekzistuar edhe një arsyet tjetër: problemet në fjalë do të hapnin të tjera probleme në lidhje me vijën e përgjithshme të Partisë sonë, të partisë së tyre dhe të Partisë Komuniste (bolşevike) të Bashkimit Sovjetik.

Ata na bëjnë neve disa akuza pa baza, për shembull, se ne gjoja ishim me tezat e «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane, se ne gjoja atakuam kultin e Stalinit, por më vonë e fshimë këtë kritikë, se ne gjoja ishim vetëm për mundësinë e evitimit të luftës e të tjera thënie të tilla që nuk i vërtetojnë as veprimet e Partisë sonë, as dokumentet e saj të shkruara. Por, me këto akuza pa baza që bëjnë ata, vërtetohet diçka tjetër shumë kritike dhe me rëndësi të madhe për Kinën

e për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ne mendojmë se, pas vdekjes së Stalinit dhe gjatë peripecive hru- shoviane, derisa u arrit në Kongresin e 20-të, vërtetohet që Mao Ce Duni dhe Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ndjenë, si të thuash, njëfarë kë- naqësie në këtë drejtim që «tash e tutje ne (kinezët) do të veprojmë më lirisht në punët tona të brendshme dhe në arenën ndërkombëtare». Kjo është përshtypja jonë, të cilën e nxjerrim si nga bisedimet, ashtu edhe nga tezat e mëvonshme të Mao Ce Dunit, sipas të cilit, Stalini gjoja u impononte kinezëve dhe të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste pikëpamjet e Partisë Bol- shevike. Pra, sipas Maos, të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste të botës, në kohën e Stalinit, de- tyroheshin të mbështetnin Bashkimin Sovjetik dhe vijën e tij, ato ishin në shërbim të Partisë Bolshevikë dhe nuk e ndienin veten si parti të pavarura marksiste- leniniste. Këtë e pohoi vetë Mao Ce Duni në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957. Përveç kësaj, Mao Ce Duni në këtë mbledhje ngriti çështjen se «të gjithë ne partitë komuniste dhe punëtore të botës, domethënë kampi i socializmit, duhet të ketë një krye, dhe ky krye duhet të jetë Bashkimi Sovjetik». Këtë tezë Mao Ce Duni e paraqiti në Mbledhjen e Moskës dhe e mbrojt- ti, kurse Hrushovi bëri sikur nuk e dëshironte një gjë të tillë. Duhet të pohojmë se këtë tezë e mbrojtëm edhe ne, edhe të tjerët. Por shoku Mao Ce Dun, me gjithë autoritetin e tij të madh, tha edhe një gjë tjetër, se «Hrushovi është një marksist-leninist i shquar, udhë- heqës i madh i Bashkimit Sovjetik», se «me Hrushovin

**mund të bisedohet e mund të ecet përpara», kurse me Stalinin duhej të rrije gatitu, donte të thoshte ai.**

Po ashtu Mao Ce Duni, siç e kemi dëgjuar me veshët tanë, mbështeti me plot gojën Hrushovin, kur likuidoi të ashtuquajturin grup antiparti të Molotovit me shokë. Pra, të gjitha këto fakte tregojnë se Mao Ce Duni ka qenë plotësisht me vijën revizioniste dhe me veprimet puçiste, denigruese e komplotuese kundër Partisë Komuniste (bolshevike), kundër Stalinit, kundër Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë nuk ka qenë në këto pozita të Mao Ce Dunit, as të Partisë Komuniste të Kinës. Pas vdekjes së Stalinit, ne mendonim se dikush tjetër do të vinte në krye të partisë, dhe në parantezë mund të themi se mendonim për Molotovin. Pikërisht pas vdekjes së Stalinit ne hymë në konflikt me udhëheqjen e re të Bashkimit Sovjetik, me Malenkovin, me Bulganinin, me IIrushovin, me Mikojanin e të tjera. Këta, tre-katër muaj pas vdekjes së Stalinit, na sulmuam paturpësisht dhe ashpërsisht, duke na akuzuar si njerëz që nuk dinim të përdornim ato pak kredi që na kishin dhënë e të ndërtonim ato pak objekte industriale, të cilat në realitet ne i ndërtuam në kohën e duhur, sepse punonim që socializmi të ecte përpara në vendin tonë.

Ne morëm pjesë në mbledhjet e partive komuniste dhe punëtore në Moskë, por nuk shkuam atje me pikëpamjet e Mao Ce Dunit. Ne nuk folëm kundër Bashkimit Sovjetik deri në një kohë sa nuk ishin pjekur kushtet, por brenda vetes sonë kishim brenga të mëdha dhe dyshime ndaj udhëheqjes së tij. Ajo nuk tre-

gohej e vendosur, kishte konfuzion. Në nuhatnim, por nuk ishim në dijeni të kontradiktave që ekzistonin brendapërpendura saj, mes udhëheqësve, dhe sidomos për sa i përket vijës së Stalinit.

Mendimi ynë është se Mao Ce Duni ishte në dijeni të kësaj gjendjeje dhe se ai duhet të ketë qenë dakord me vijën dhe me veprimet e Hrushovit kundër Stalinit dhe vijës së Partisë Bolshevikke. **Gjithashtu, Mao Ce Duni duhet të ketë marrë nga Hrushovi premtimë për ndihmë ekonomike dhe për ndihmë politike në arenën ndërkombëtare, si dhe premtimë për ndihma ushtarake, ndërmjet të cilave edhe për sekretin e bombës atomike.** Hrushovi i ka bërë këto premtimë, mendojmë ne, dhe për një kohë çështjet duket se ecnin mirë, por ai ishte një mashtrues. Edhe Maoja, mendojmë ne, kishte qëllimet e tij. Maoja (këto natyrisht janë supozime), pas vdekjes së Stalinit, pavarësisht nga ato që thoshte se «Hrushovi është njeri i madh», e vinte veten mbi Hrushovin dhe mendonte se ai duhej ta kishte vendin pas Leninit si «kokë e madhe filozofi» dhe udhëheqës i një vendi me popullsinë më të madhe në botë. Megjithëse thoshte që «në krye të kampit duhet të jetë Bashkimi Sovjetik», ai në të vërtetë mendonte se duhej të ishin të paktën dy: Kina dhe Bashkimi Sovjetik, një *de jure*, po dy *de facto*, që të bënin ligjin në botë.

Ne bëmë Kongresin e 7-të dhe Partia e Punës e Shqipërisë i shprehu pikëpamjet e veta ashtu siç i mendonte, kurse udhëheqja kineze u thartua dhe bëri gabimin tragjik që sulmoi Kongresin tonë në mënyrë të

dënueshme, në kundërshtim me normat që ekzistojnë për marrëdhëni mes partive marksiste-leniniste. Sa ishin gjallë Maoja dhe Çuja, ne kemi pasur kontradikta të brendshme, por ata nuk pranuan t'i diskutonin, ose qëndruan në mendimet e tyre, dhe ne, duke mos pasur mundësi tjetër, qëndruam në tonat. Kjo nga ana e tyre ishte një taktkë oportuniste, por këtë gabim antimarksist që bënë tanë udhëheqësit kinezë, ata nuk e bënë atëherë, sepse, së pari, e dinin që pikëpamjet tona ishin të palëkundura, dhe, së dyti, sepse Partia e Punës e Shqipërisë, me vijën e drejtë të saj, i ka mbrojtur Partinë Komuniste të Kinës dhe Kinën në momentet më të vështira për to, si në Mbledhjen e Bukureshtit e në atë të 81 partive në Moskë, ashtu edhe më vonë gjatë Revolucionit Kulturor.

**Pse e bënë Hua Kuo Feni me shokë këtë gabim?** E bënë se politika e tyre pësoi disfatë dhe krijoj konfuzion të madh brenda dhe jashtë Kinës. Ne nuk mund të mbronim veprimet e tyre të brendshme, se kishim shumë arsyë të mos i mbështetnim, dhe sepse akoma nuk jemi të qartë për çka po ngjet në Kinë. Qëndrimet e Kinës në politikën e jashtme i dobësuan pozitat e saj. Me veprimet që bënë udhëheqësit e sotëm, Maoja u godit tërthorazi; kurse Teni, i cili ishte rehabilituar një herë dhe prapë u rrëzua, po del përsëri në skenë për të rimarrë postet e humbura.

Kohët e fundit doli edhe çështja e «katërsjes», e cila u demaskua në një platformë të ndyrë personale dhe jo në platformë politike e ideologjike. Revolucioni Kulturor tash vetëm sa përmendet, ai u errësua dhe në

fakt u likuidua. Nga të gjitha këto ngjarje marksistë-lininistëve të botës filluan t'u lindnin dyshime të mëdha ndaj Partisë Komuniste të Kinës. Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, që dinin të manovronin, vdiqën dhe Kina hyri në kaos. **Po përse? Sepse vija e saj nuk ka qenë një vijë e drejtë marksiste-lininiste.** Në parti sundonin dy ose më shumë vija, ekzistonin fraksione në luftë njëri me tjetrin etj.

Në këto situata u mblodh Kongresi i 7-të i Partisë sonë, në të cilin morën pjesë mbi 40 parti, duke dërguar delegacione dhe duke dërguar telegrame përkrahjeje. Kinezët, me siguri, këtë solidaritet internacionalist e konsideruan si një sfidë e disfatë për ta, sepse shumë gjëra shkonin kundër tezave të tyre. Qëndrimi ynë parimor bëri që të ngrihej autoriteti i Partisë së Punës të Shqipërisë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në botë. Prandaj, duke e gjuquar situatën të vësh-tirë për ta, udhëheqësit e tanishëm të Kinës filluan prapa krahëve sulmin armiqësor trockist kundër Partisë sonë. Ata thirrën në Pekin një nga një përfaqësues të partive komuniste marksiste-lininiste, duke filluar që nga ajo e Hillit të Australisë, e Zhyrkesë së Francës dhe deri tek ato të Amerikës Latine. Kurse neve, me një notë pa adresë, pa kokë dhe lakonike, na thanë se «në Kongresin e 7-të janë sulmuar vija dhe strategjia e Mao Ce Dunit!» Natyrisht, kinezëve ne iu përgjigjëm më gjatë se ç'na shkruanin ata dhe u kërkuam të na shpjegonin se ku e përse e paskemi sulmuar ne strategjinë e Mao Ce Dunit.

Në materialin standard në fjalë, revizionistët ki-

nezë shtrembërojnë të vërtetën që ekziston në material, në dokumentet tona, si në letrën që u kemi dërguar atyre për çështjet kufitare me Bashkimin Sovjetik, për propozimin e tyre për të vajtur në Moskë pas rrëzimit të Hrushovit, për vajtjen e Niksonit në Pekin, për takimin e Kosiginit me Çu En Lain etj. Kopjet e letraleve tona dërguar kinezëve ekzistojnë. Për fatin e tyre të keq «*Verba volant, scripta manent*». Këto letra demaskojnë shpifjet, mashtrimet, shtrembërimet dhe qëllimet e tyre, tregojnë pse ata i kanë bërë ato veprime armiqësore, antimarksiste dhe kundërrevolucionare. Me mashtrime nuk fshihen dot qëllimet e tyre. Mendimet dhe veprimet e Partisë sonë lidhur me problemet që përmenda më sipër, jo vetëm që ishin të drejta në atë kohë, por jeta vërtetoi se ato janë të drejta edhe sot, dhe ne mendojmë se do të janë të drejta edhe nësër. Faktet janë kryene, dhe ato vërtetojnë tezat tona marksiste-leniniste. Demagogjia që përdorin revisionistët kinezë, dhe bazat gjoja teorike leniniste mbëtë cilat ata mbështeten për këto veprime të tyre kundër Shqipërisë socialiste, janë të kota, nuk janë në gjendje të mbulojnë fytyrën e tyre prej revisionisti dhe opor tunisti. Kontradiktat tona me revisionistët kinezë janë parimore; më kot ata pretendojnë se analizat tona janë «të dobëta», «të pabazuara» dhe se vetëm ata i bëkan një analizë «objektive» situatës politike ndërkombëtare.

Çështja kryesore për kinezët është që të bindin njerëzit vesh më vesh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dobësuar ekonomikisht dhe ushtarakisht, se

borxhi i tyre i brendshëm dhe i jashtëm është shtuar shumë, se gjendja e tyre ka arritur deri atje sa vendet e tjera kapitaliste të investojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se këto nuk janë më të forta si më parë. Kjo është një analizë false, pa baza dhe paraqitet për të vërtetuar diçka që nuk mund të vërtetohet. Ata duan të vërtetojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjoja nuk janë më agresive; se ato, sipas kinezëve, përpiken të ruajnë vetëm ato çka kanë fituar; se ato duan të mbajnë statukuonë; prandaj për botën «armiku kryesor është revizionizmi sovjetik që do ekspanzion». Kjo është një nga tezat e kinezëve dhe nga më kryesoret. Ata na akuzojnë se ne gjoja nuk bëjmë një analizë marksiste-leniniste të gjendjes ndërkombe tëare dhe të kontradiktave mes dy supersuqive, dhe prandaj nuk ndjekim rrugën e kinezëve që t'u bëjmë thirrje «Evropës së Bashkuar», Tregut të Përbashkët Evropian dhe proletariatit botëror që të bashkohen të gjithë kundër sovjetikëve. Ata kanë nxjerrë si «konkluzion» të tyre se ne gjoja favorizojmë socialimperializmin sovjetik! Kjo jo vetëm që është një tezë revizioniste e veshur me pëtkun e antirevizionizmit, por është armiqësore dhe shpifëse ndaj nesh.

Imperializmi amerikan është agresor, luftëdashës e luftënxitës dhe përpara fakteve nuk qëndron dot një tezë e kundërt me këtë. Bazat e amerikanëve, kreditë e amerikanëve, shtimi i madh i armatimeve të tyre, klikat proamerikane që janë vendosur kudo, vërtetojnë se imperialistët amerikanë nuk duan vetëm statukuonë, por ata duan edhe ekspansionin, ndryshe nuk ka përsë

të ketë kontradikta kaq të thella mes tyre dhe Bashkimit Sovjetik, siç pretendojnë kinezët. «Bashkimi Sovjetik do luftë, — thonë kinezët, — kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo» dhe lënë të kuptohet që këtë tregon citati i Maos se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë bërë si një mi dhe gjithë bota thërret në rrugë: «Vriteni, vriteni miun!». Kjo gjithashtu tregon butësinë nga ana e kinezëve dhe tërthorazi bën thirrje të mos e godasim një shtet si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që tash qenka katandisur si një mi.

**Strategji marksiste është kjo e Maos?**

Strategja e Mao Ce Dunit «e mbështetur në analizën marksiste-leniniste» ka përçaktuar përfundimisht se «rivaliteti mes dy superfuqive qëndron në Evropë». Çudi! Pse nuk qëndron edhe në ndonjë pikë më të dobët të botës, ku Bashkimi Sovjetik kërkon ekspansion, si në Azi, në Afrikë, në Australi ose në Amerikën Latine?! Tradita e kolonizatorëve ka qenë ecja drejt pikave të dobëta. Edhe luftërat grabitqare imperialistët i shpërthejnë për hegemoni, për tregje të reja, për ndarje të reja të botës. A nuk është vallë rivaliteti kryesor ai midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik revisionist? Atëherë, sipas kinezëve, këto dy superfuqi, njëra nga të cilat do statukuonë dhe tjetra ekspansionin, do të arrijnë të shpërthejnë luftën në Evropë, si në kohën e Hitlerit, sepse ky donte ekspansion. Por, që ta arrinte Hitleri këtë, atij i duhej të mposhtte Francën, Anglinë dhe Bashkimin Sovjetik. Për këto arsyе ai e filloi luftën në Evropë dhe jo gjetkë. Stalini hyri në aleancë me Anglinë dhe me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbasi Gjermania e kishte sulmuar Bashkimin Sovjetik e jo më parë. Por kinezët, takтикën që Stalini qe i detyruar të përdorte në ato kushte, e marrin për argument, për të thënë: pse të mos mbështeten edhe ata te Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë luftë të ardhshme?

Të gjitha këto nuk vërtetojnë tezën e kinezëve në aleancat që predikojnë; ato vërtetojnë të kundërtën. Kur Gjermania e Vilhelmit të Dytë sulmoi Francën dhe Anglinë, Internacionalja e Dytë predikoi «mbrojtjen e atdheut» borgjez si nga ana e socialistëve gjermanë, edhe e atyre francezë, megjithëse lufta kishte nga të dyja palët karakter imperialist. Dihet se si u dënuia kjo nga Lenini dhe çfarë tha ai kundër luftërave imperialiste dhe për kthimin e tyre në luftë civile. Kinezët sot, kur prononcohen për mbrojtjen e «Evropës së Bashkuar», bëjnë ashtu siç bëri Internacionalja e Dytë. Ata nxitin luftën e ardhshme bërthamore që kërkojnë të shpërthejnë të dyja superfuqitë, dhe, megjithëse kjo luftë midis dy superfuqive nuk mund të jetë veçse imperialiste, u bëjnë thirrje «patriotike» popujve të Evropës Perëndimore, proletariatit të saj, që të lënë mënjanë «gjërat e vogla» me borgjezinë (dhe këto «gjëra të vogla» janë shtypja, uria, grevat, vrasjet, pa-punësia, mosprekja e pushtetit të borgjezisë) dhe të bashkohen me NATO-n, me «Evropën e Bashkuar», me Tregun e Përbashkët Evropian të borgjezisë së madhe të koncerneve dhe të luftojnë kundër Bashkimit Sovjetik, të bëhen mish për top për borgjezinë.

Më mirë se kaq nuk mund ta bënte propagandën Internacionalja e Dytë!

Po popujve të Bashkimit Sovjetik, atyrc të vendevë të tjera revizioniste që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës dhe në KNER, ç'u këshillon Kina të bëjnë? Asgjë! Me heshtjen e saj ajo u thottë: «Qëndroni. Luftoni e derdhni gjak për klikën gjakatare të Kremlinit!». Qëndrim leninist është ky?! Jo! Kjo vijë e Partisë Komuniste të Kinës është antiproletare, luftënxitëse.

Kinezët nuk janë për atë që të bëhet luftë në të dy krahët, kundër dy superfuqive imperialiste, për t'u prishur planet e tyre të luftës grabitqare; ata nuk duan të punohet në mënyrë që, po të pëlcasë lufta, të kthchet kjo në një luftë civile, në një luftë të drejtë. Ne ndjekim pikërisht këtë mësim leninist, prandaj kinezët na akuzojnë se gjoja ne paskemi iluzione për paqen dhe çojmë ujë në mullirin e sovjetikëve!!

Kinezët shpifin për ne se gjoja mbivlerësojmë bashkëpunimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik dhe nënveftësojmë kontradiktat midis tyre. Ata thonë, po ashtu, që «shqiptarët theksojnë se të dyja superfuqitë, sa njëra edhe tjetra, janë njëlloj të rrezikshme». E para nuk është e vërtetë, kurse e dyta është plotësisht e vërtetë. Ne jo vetëm që i njohim dhe i vlerësojmë drejt kontradiktat që kanë mes tyre të dyja superfuqitë, por luftojmë që ato të thelohen më tej. Në të gjitha dokumentet tona këto probleme përcaktohen si duhet.

Kinezët nuk zënë shumë në gojë faktin se dy superfuqitë janë në akord të plotë kundër socializmit,

**komunizmit dhe çlirimit të popujve.** Shpifjet e kinezëve e sofizmat e tyre nuk mund as të fshehin revizionimin e marksizëm-leninizmit nga ana e tyre dhe as të atakojnë vijën dhe qëndrimet e drejta të Partisë sonë. Kinezët deklarojnë haptazi se amerikanët u thonë atyre: «Kini mendjen, se Bashkimi Sovjetik do t'ju sulmojë!». Kjo do të thotë: «Ju, kinezë, mos kini frikë nga ne amerikanët, se aleanca juaj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është në rrugë të mirë». Dhe, në bazë të kësaj porosie, kinezët bëjnë një politikë «gjeniale»: «T'i themi Bashkimit Sovjetik të sulmojë Evropën, dhe tërthorazi të dobësojmë edhe Shtetet e Bashkuara, edhe aleatët e tyre, kështu ne fitojmë! Kinezërra!

Edhe një çështje tjeter me rëndësi: Kinezët, për të kamufluar nxitjen e luftës së ardhshme imperialiste dhe për të mbrojtur tezën e tyre të «Evropës së Bashkuar», përpinqen ta rrëzojnë mendimin e qartë të Leninit, që ne e kemi cituar në Kongresin e 7-të të Partisë sonë në lidhje me «Evropën e Bashkuar». Ata pretendojnë se shqiptarët, duke u mbështetur te Lenini për të hedhur poshtë tezën për «Evropën e Bashkuar», «qëllojnë në erë, për arsyen e Lenini e ka shprehur këtë kundërshtim për një federatë evropiane mes Rusisë, Austrisë, Anglisë që ishin imperialiste». Dhe shtojnë se «ne (kinezët) i referohemi bashkimit të vendeve të Evropës Perëndimore». Kjo, për kinezët, do të thotë se vendet kapitaliste të Evropës Perëndimore s'janë reaktionare! Mirëpo këto «shtete të bashkuara të Evropës» çdo ditë e thonë edhe vetë që, në qoftë se bashkohen, nuk mund të mos bëjnë një tërësi imperialiste. Dhe

cilat janë këto shtete? Janë pikërisht ato për të cilat kinezët thonë se «janë bërë aq të fuqishme, saqë investojnë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës!»

Në marrëdhëniet e Partisë Komuniste të Kinës me partitë komuniste marksiste-leniniste të botës, çdo gjë është e gënjeshtërt, demagogjike. Asnjë marrëdhënie të singertë nuk mbajnë kinezët me këto parti. Ata mbajnë marrëdhënie vetëm me lakenjtë e tyre, me ata që u binden parimeve të tyre antimarksiste. Partive komuniste marksiste-leniniste të botës ata u lënë të kuptojnë qartë se nuk ekziston ndihma internacionale, as internacionalizmi proletar. Pikërisht nga kjo, ide bazë antimarksiste rrjedhin të gjitha teoritë e tyre, për «takimet bilaterale» që «i duan» vetëm sa për t'u larë trutë partive të tjera që kundërshtojnë. Kinezët u shmangen mbledhjeve të shumë partive sepse, sipas tyre, këto, në vend që të forcojnë unitetin e lëvizjes marksiste-leniniste, e përcajnë këtë unitet dhe shtojnë mosmarrëveshjet. Absurde! Antimarksiste! Ata, me këtë vijë, janë kundër unitetit të lëvizjes ndërkombëtare të proletariatit.

Kinezët nuk thérresin dhe nuk dërgojnë delegacione në kongreset e partive komuniste marksiste-leniniste. Arsyet që nxjerrin edhe për këtë qëndrim të tyre, janë gjithashtu absurde! E vërteta është se, me të gjitha këto, ata duan të fshehin kalbëzimin e vijës së tyre, mungesën e leninizmit në të gjitha aspektet e punës së partisë së tyre, kështu që në këto mbledhje nuk duan të ketë parti të tjera që t'i gjykojnë. Mbledhjet dyshëske u shërbijnë atyre vetëm për të marrë informa-

**mata dhe drejtoria e Jashtme e Komitetit të tyre Qendror nuk është veçse një oficinë sigurimi.** Për kinezët çdo parti le të luftojë si di vetë, dhe këtë ide nuk mungojnë «ta ilustrojnë» me ndonjë citat «marksist», por s'mungojnë gjithashtu t'u thonë partive të tjera: «Punoni kështu si ju themi ne!».

Kinezët njohin çdo parti dhe grup që vetëquhet marksist-leninist, ose më mirë maoist. Kjo do të thotë të përçash partitë e vërteta marksiste-leniniste, të kri-josh pështjellim, fraksion, të dobësosh unitetin marksist-leninist internacionalist dhe shtabet e revolucionit.

«Mbështetja diplomatike, — thonë kinezët, — mbështet revolucionin». Kjo kështu duhet të jetë, por përkinezët nuk ka qenë dhe nuk është e tillë. Ne u kemi thënë atyre më përpara se «duhet të keni marrëdhënie diplomatike me shtetet e botës dhe të mos qëndroni të izoluar», por ata na e kanë kundërshtuar pikëpamjen tonë dhe na vinin përballë «çështjen e Tajvanit», si kusht që më parë duhej njohur Kina Popullore nga shtetet e ndryshme, pastaj këto të vendosnin marrëdhënie diplomatike. Ne luftuam për Kinën në OKB, derisa kjo u pranua, por udhëheqësit kinezë nuk e dëshironin këtë pranim, sepse Çu En Lai shprehu botërisht dëshirën që të formonte një tjetër OKB të tij. Ne ishim kundër kësaj ideje, por këto veprime që ata kanë bërë dje, nuk i thonë më sot. Ne u sugjeruam t'i prisnin marrëdhëniet diplomatike me qeverinë e Suhartos të Indonezisë, që e poshtëroi Kinën edhe si shtet, kurse ata nuk e bënë këtë. Po as diplomacia e tyre me Pino-çetin dhe me Frankon nuk arsyetohet! Atëherë, pse

nuk lidhin marrëdhënie edhe me Izraelin? Apo se ai është agresor? Po Pinojeti ç'është, kur shtyp e vret popullin, proletarët, komunistët dhe njerëzit përparimtarë e liridashës kilianë?

«Partia e Punës e Shqipërisë nuk është dakord me ne, kur përqendrojmë zjarrin kundër Bashkimit Sovjetik», thonë kinezët. Kjo është një shpifje. Ne jemi kundër qëndrimit të tyre, për arsyen se ata nuk koncentrojnë të njëjtin zjarr edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ne jemi për atë që jo vetëm kundër Bashkimit Sovjetik, por edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës të përqendrohet një zjarr po aq i fortë. Pse udhëheqësit kinezë nuk pohojnë kurrë me të madhe se Bashkimi Sovjetik mund të sulmojë edhe Kinën, siç pretendojnë për Evropën Perëndimore? Por kinezët thonë vetëm këtë: «Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Evropën». Pse e ndiejnë veten ata kaq të sigurt nga kufijtë e tyre të Lindjes? Ne kemi të drejtë ta bëjmë këtë pyetje dhe ta shtrojmë për diskutim këtë problem.

Partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine, kur përqendrojnë zjarrin kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, këtë e bëjnë edhe kundër klikës së gjeneralëve sundimtarë brenda vendeve të tyre, edhe kundër Bashkimit Sovjetik revizionist, kurse Kina jo! **Një armik kjo e vlerëson, dy i nënvlefëson!** Pra strategjia e Kinës nuk bazohet as në realitetin, as në parimet marksiste-leniniste.

Kultin e individit te cilido qoflë, ne e kemi dënuar, e dënojmë edhe tash. Ne ndjekim në këtë çështje pikë-

pamjen e Marksit, dhe për këtë arsy te në, në udhëheqje, ka unitet marksist-leninist, dashuri, sinqueritet, respekt marksist-leninist ndaj shokëve, duke u bazuar në punën e në besnikërinë e secilit ndaj parimeve të Partisë. *Idolatri*<sup>1</sup> te ne nuk ka, te ne mbi të gjitha flitet për Partinë, ndërsa për Enverin flitet aq sa e do interes i Partisë dhe i vendit, dhe kur nga baza e nga masat ndonjëherë taprohet, Komiteti Qendror, udhëheqja e Partisë dhe unë vetë personalisht, me sa mundem e sa më dëgjojnë në këtë drejtim, kemi marrë e do të marrim kurdoherë masa që të ecet drejt.

As që mund të zgjatem për shpifjet dhe akuzat që i bëhen Partisë sonë nga Partia Komuniste e Kinës se ne gjoja u bashkuam me vijën e bashkëkzistencës pa-qësore hrushoviane etj. E gjithë lufta e Partisë sonë, të gjitha dokumentet e shkrimet e saj vërtetojnë të kundërtën e akuzave kinezë, kurse vija e Partisë Komuniste të Kinës ka qenë e njëllojtë me atë të hrushovianëve. Përse bëri zigzage në vijë kjo parti e kinezëve? Ka edhe kjo arsyet e saj, që i kam shpjeguar në shkrime të tjera.

Për sa i përket teorisë së «tri botëve», ne në Kongres e kemi analizuar dhe e konsiderojmë, ashtu siç e kemi thënë, një ndarje fiktive, joklasore, jomarksiste. Teza e Maos dhe përpjekjet e shokëve kinezë për të analizuar këtë apelacion gjoja nga ana teorike, duke përmendur një analizë pa adresë të Leninit, nuk mund t'ia arrijnë qëllimit. Lenini ka bërë analiza të gjendjes

---

1. Nga frëngjishtja — adhurim i tepruar.

ndërkomëtare, pas Luftës së Parë Botërore edhe më vonë, por ai ka shkruar se ekzistojnë dy botë: «bota kapitaliste dhe bota jonë, socialiste». Kinezët thonë: «Meqenëse Bashkimi Sovjetik e disa vende ish-socialiste tradhtuan dhe u kthyen në vende kapitaliste, u zhduk sistemi socialist»! Jo, sistemi socialist nuk u zhduk, ai ekziston e shkon përpara në vendet e vërteta socialiste, që i qëndrojnë besnikë marksizëm-leninizmit, siç është Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Por edhe sikur asnjë shtet socialist të mos kishte ngelur, teza e Leninit qëndron e patundur. Edhe në këtë rast dy botë do të krijoheshin me luftë, me revolucion, pra do të ekzistonin.

Ne dhe të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste kemi bërë dhe bëjmë analiza të situatave ndërkomëtare në dritën e analizave të Leninit dhe të teorisë së tij. Si gjatë kohës së luftës dhe pas luftës ne e kemi studiuar thellë situatën ndërkomëtare. Në çdo kongres tonin kemi analizuar raportin e forcave në botë, sepse kjo është e demosdoshme të bëhet, ndryshe ecet në errësirë. Ajo parti ose ai shtet socialist apo josocialist që nuk bën analizën e situatave ndërkomëtare, qorolliset në greminë. Por ta – botën në disa botë, t'u ngjitet shifra arabe ose romake, të integrohen në njérën prej tyre dhe të kërkosh t'ua imponosh edhe të tjerëve këtë ndarje të imagjinuar, kjo është e parpranueshme. Si mund të identifikohet një vend socialist me «botën e tretë», domethënë me vende ku sundojnë klasat shfrytëzuese dhe shtypja e të vihet në një radhë me mbretërit dhe me shahët, siç pohojnë vetë kinezët,

kur ai mund të ndihmojë e të përkrahë popujt e këtyre vendeve edhe pa e futur veten brenda në këtë «botë», edhe pa e ndarë botën në tri? Pikëpamja jonë nuk është as e njëanshme osc e dyanshme, siç na akuzojnë kinezët, por ajo është leniniste dhe i përgjigjet realitetit. Ne, me analizën klasore të situatës dhe me qëndrimet e drejta klasore, ndihmojmë në radhë të parë popujt, proletariatin, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vërtetë të popujve dhe nuk ndihmojmë në mënyrë të vëçantë shtetet ku sundojnë mbretërit, shahët dhe klikat reaksionare. Ne ndihmojmë popujt dhe ato shtete demokratike që duan të çlrohen me të vërtetë nga zgjedha e superfuqive. Theksojmë se një detyrë e tillë nuk mund të realizohet si duhet dhe në rrugë klasore, në rast se nuk lustohen edhe shahët, edhe mbretërit, edhe koncernet ndërkombëtarë. Kinezët gabojnë duke e kuptuar kështu këtë lustë dhë mendojnë se e zgjidhën këtë problem klasor të koklavitur duke u shkrirë në këtë botë të imagjinuar, që s'ka as kokë, as këmbë, por që mund të konsiderohet një grupim shtetesh me regjime dhe me politika të ndryshme. Jo të gjitha këto shtete janë, ashtu siç pretendojnë kinezët, pro luftës çlirimtare, kundër «botës së dyti» ose «të parë», as pro luftës kundër imperializmit amerikan ose kundër socialimperializmit sovjetik.

Rryma e popujve të botës ecën drejt luftës për çlirim, për revolucion, për socializëm, por në këtë rrugë nuk mund të jenë klikat e atyre shteteve të «botës së tretë» të futura të gjitha në një thes, ku bën pjesë edhe Kina vetë, ashtu siç bën pjesë edhe Titoja në bo-

tën e «të paangazhuarve». Të dyja palët po mundohen kush e kush të shesë më shumë «bileta hyrjeje» në botën e tyre.

Pikëpamja jonë, në analizën që bëjmë, bazohet në ndarjen klasore që i bën botës Lenini. Kjo analizë nuk na pengon ne të luftojmë kundër të dyja superfuqive dhe të ndihmojmë të gjithë popujt e shtetet që kërkojnë çlirim dhe që kanë kontradikta me dy superfuqitë. Ne edhe ndonjë mbret apo princ mund ta ndihmojmë, por ta dojë situata dhe interesë i popullit të atij vendi, por të fshehësh parimet e regjimit socialist, të fshehësh natyrën klasore të tij, të fshehësh dhe të shtrembërosh marksizëm-leninizmin dhe normat ideologjike e politike të partisë së proletariatit, kjo është antimarksiste, është mashtrim dhe hipokrizi. Partia e Punës e Shqipërisë s'e ka bërë dhe s'do ta bëjë kurrë një gjë të tillë, sepse do të ishte një krim i pafalshëm ndaj popullit të saj, ndaj popujve të tjera, proletariatit ndërkommbëtar dhc revolucionit botëror.

Dëshiroj të theksoj se kinezët u përpouqën të përpunonin partitë komuniste marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine, si edhe përfaqësuesit e disa prej këtyre partive që vajtën në Kinë, për t'u impunuar këtyre vijën. pikëpamjet e strategjinë e tyre të gabuar, por nuk patën asnjë sukses. Shokët e këtyre partive i kundërshtuan të gjitha pikëpamjet e gabuara të kinezëve. Këto parti mbrojtën me vendosmëri vijën e tyre, mbrojtën mbledhjen e tështë partive të vendeve të Amerikës Latine, që u bë, si dhe deklaratën që nxori kjo mbledhje. Kinezët e konsideronin mbledhjen e tështë

partive si antikineze, deklaratën e saj antikineze dhe i kërcënuan se: «Po u botua kjo deklaratë, Partia Komuniste e Kinës do të presë marrëdhëniet me to». Përfaqësuesit e këtyre partive u indinjuan shumë. Ua hodhën poshtë pretendimet kinezëve dhe më në fund u thanë se: «Secili nga ata nuk merr urdhra veçse nga partia e vet dhe nga Komiteti Qendror i saj». Partinë tonë ato e kanë mbrojtur me zjarr dhe si parti komuniste e marksiste-leniniste na i dhanë me shkrim dokumentet shpifarake të Partisë Komuniste të Kinës. Mbi këto dokumente po e bazoj unë këtë shkrim paraprak e të shpejtë; çdo gjë do të plotësohet më vonë me të dhëna e me fakte të reja.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vëll. II, f. 397*

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 16*

**DUKE PASQYRUAR THIELLE REALITETIN,  
TË PERCAKTOJMË DETYRA DHE MASA  
KONKRETE**

**Shënime<sup>1</sup>**

**14 janar 1977**

Për caktimin e problemeve që do të shqyrtojmë në mbledhjet e Plenumit, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të nisemi nga orientimet e Kongresit të 7-të të Partisë.

Unë e lexova materialin që na është paraqitur me problemet që mendohet të studiohen gjatë këtij viti nga ne dhe, lidhur me të, dëshiroj të bëj disa vërejtje.

Në përgjithësi mendoj se gjatë vitit 1977 puna jonë duhet të përqendrohet në çështje të atilla që kanë të bëjnë me zbërthimin dhe kontrollin e disa problemeve kyç të planit të këtij viti dhe të mos merremi me perifrazimin e problemeve që kemi diskutuar e kemi

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka bërë pasi lexoi projektplanin e çështjeve që do t'i paraqiteshin për shqyrtim gjatë vitit 1977 Plenumit, Byrosë Politike dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

shtruar më parë, ashtu siç e theksuanë edhe në Kongresin e 7-të.

Diçka tjetër që dua të theksoj dhe që ka rëndësi për ne, është që vështirësive që do të hasim gjatë punës për realizimin e planit t'u dalim përpara. Por që ta bëjmë këtë, para se të marrim në shqyrtim një problem, duhet të njohim mirë situatën, sukseset dhe dobësitë, të zbulojmë shkakun e të metave e të gabimeve që vërehen dhe të marrim masa të shpejtë. Të menjëherëshme e të sakta për të plotësuar boshllëqet e krijuara nga mosrealizimet e planit. Për këtë të mos kemi iluzione. Të kuptuarit e rëndësisë së këtij problemi nga pikëpamja politike, organizimi i mirë i punës për zbatimin me rreptësi të detyrave të planit, kontrolli në kohën e duhur dhe jo kur e ka marrë ferra uratën, si dhe marrja e masave të menjëherëshme dhe në vend, ndikojnë drejtpërdrejt në suksesin e gjithë kësaj punc.

Qeveria nga ana e vet do të studiojë një varg problemesh, të cilave do t'u japë rrugëzgjidhje. Këto probleme do të kenë të njëjtin karakter me ato që do të studiojnë Komitetin Qendror dhe Byroja Politike. Por është e kuptueshme që Qeveria, me organet e saj të shumta, duhet të kontrollojë një varg të tërë çështjesh dhe të nxjerrë konkluzione të drejta për secilën projekte në veçanti, me qëllim që puna të ecë përpara.

Nuk përjashtohet as për Komitetin Qendror, as për Byronë Politike, as edhe për Qeverinë parashtrimi në planin e punës i disa problemeve orientuese, të cilat duhet të studiohen me kujdes dhe të zgjidhen qoftë gjatë vitit 1977, qoftë vitin e ardhshëm apo në vjet e

tjera të pesëvjeçarit të gjashtë. Rëndësi ka, më duket mua, që këto probleme të mos trajtohen në një mënyrë rutinë, por, duke pasqyruar thellë realitetin, të përcaktojmë detyra konkrete dhe të marrim vendime të drejta për zbatimin e tyre. Në rast të kundërt, në qoftë se në rendin e ditës të një mbledhjeje vihen disa probleme që u vijnë rastësisht në kokë njerëzve të aparateve, ose që caktohen në bazë të programeve standarde të mëparshme dhe nuk bëhet thellim në brendinë e trajtimit të këtyre problemeve, këto nuk do të studiohen si duhet, mbledhja do të marrë një ngjyrë propagande e agitacioni dhe njerëzit që do të vijnë aty nuk do të përfitojnë shumë nga një punë e tillë.

1. Mendimi im është që mbledhja e parë e Plenumit të Komitetit Qendror të jetë lidhur me plotësimin e planit të gjashtëmujorit të parë të këtij viti dhe me masat për të plotësuar planin vjetor. Kjo të bëhet nga fundi i qershorit, veç jo për tërë planin e për të gjitha degët e zhvillimit të ekonomisë, po për degët e industrisë së rëndë dhe në mënyrë të veçantë të shohim realizimet në fushën e naftës. Në këtë degë duhet të bëjmë kujdes të posaçëm dhe ta përqendrojmë kontrollin, sepse deri tash kemi humbur e vazhdojmë të humbasim fonde dhe kohë, gjë që na shkakton dëme. Po në këtë mënyrë, në të njëjtin raport të trajtojmë edhe disa çështje të industrisë së lehtë e ushqimore, si dhe problemi shumë të rëndësishëm të bujqësisë. Ne duhet të shohim se si do të paraqiten në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 1977 prodhimi i grurit, i misrit, i bimëve industriale, gjendja e mishit, e zarzava-

teve, e frutave dhe të parashikojmë masat përkatëse që duhen marrë për gjashtëmuajrin e ardhshëm. Kjo, pra, mendoj unë, duhet të jetë tema kryesore e Plenumit të qershorit. Po përse mendoj ta analizojmë këtë problem në fund të gjashtëmuajrit të parë? Që t'i dalim punës përpëra për çështjet themelore të ekonomisë sonë.

Raportin për dhënien llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe për detyrat e planit të vitit 1978, natyrisht, ta përgatitim, por ta marrim në shqyrtim aty nga muaji janar i vitit 1978. Mendimi im është se vetëm kështu do të mësojmë se ç'ngjet në sektorët e rëndësishëm të ekonomisë që në periudhën e gjashtëmuajrit të parë të këtij viti dhe të marrim pastaj në kohë masat e nevojshme për të kapërcyer ndonjë mosrealizim të planit. Problemin e parë që do të marrë në shqyrtim Plenumi i Komitetit Qendror unë e konsideroj një temë informimi, kontrolli e marrjeje vendimesh për të plotësuar në kohë mungesat e vërtetuar gjatë realizimit të planit.

**2. Problemi i dytë që duhet të analizohet në Plenumin e Komitetit Qendror, aty nga fundi i vitit, mendoj të jetë edukimi marksist-leninist i komunistëve dhe i kuadrove.** Duke pasur parasysh se dobësimi i punës për edukimin marksist-leninist të komunistëve ka pa soja negative, shqyrtimi i këtij problemi është i domosdoshëm për Partinë. Edukimi marksist-leninist përbën një nga kapitujt më të rëndësishëm të raportit të Kongresit të 7-të të Partisë, prandaj janë caktuar

detyra, të cilat duhet të zbatohen me përpikëri nga komunistët. Mendoj se kemi kohë për të bërë detajimin e temës, që këtë çështje ta ndjekë me kujdesin më të madh Partia, nga qendra deri në bazë, dhe në fund të vtitit të arrijmë në konkluzione të studiuara mirë pér zhvillimin e gjendjes. Pér këtë problem duhet të punohet të paktën një muaj nga ana e Sektorit të Agjizacionit dhe të Propagandës, nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe nga Shkolla e Partisë, pér ta përcaktuar e pér ta detajuar atë, dhe të shikohet jo vetëm si mësohet marksizëm-leninizmi, c'rezultate kemi, por të ndalemi edhe te format e punës që përdorim, nëse duhet bërë ose jo ndonjë ndryshim apo përmirësim i mëtejshëm ose si ka hyrë edukimi marksist-leninist në gjithë jetën kulturore të njerëzve tanë, pra, jo vetëm në arsim e kulturë, por edhe në sektorët e industrisë, të bujqësisë, të shkencave etj. Me këtë dua të them se format organizative të edukimit dhe të punës duhet të bazohen në parimet leniniste të materializuar, dhe pér këto probleme të mëdha jetike të bëhen përpjekje që të spikatin si duhet e kudo idetë e marksizëm-leninizmit.

Problemi që propozohet të merret në shqyrtim në qershori nga Plenumi i Komitetit Qendror «**Mbi përgatitjen, edukimin e gjithanshëm dhe përdorimin e kuadrit në përputhje me kërkasat e zhvillimit ekonomik e shoqëror aktual e në perspektivë», mund të merret në studim në një mbledhje të Byrosë Politike, se është i rëndësishëm, kurse problemi që ka të bëjë me bazën e zhvillimit të mëtejshëm të përqendrimit, speciali-**

zimit e kooperimit të industrisë mekanike në të gjithë degët e sektorët e ekonomisë, si dhe me shfrytëzimin racional të aftësive prodhuese e të lëndëve të para, më duket se nuk është e nevojshme të shihet as nga Byroja Politike, pse kjo ka marrë shumë vendime në këtë drejtim. Mendoj se i përket Këshillit të Ministrave që këtë çështje ta shqyrtojë jo një herë, por vazhdimisht, ta kontrollojë si zbatohet, të marrë masa të përshtatshme të veçanta, të vendosë një organizim të shëndoшë, një kontroll të rreptë dhe një bashkëpunim të fritshëm ndërmjet dikastereve e ndërmarrjeve që vendimet që janë në fuqi të zbatohen. Prandaj ky problem, si dhe disa të tjera që janë caktuar për t'i shqyrtuar Byroja Politike dhe që propozohen nga ana e Këshillit të Ministrave, mua më duket se nuk janë të gjitha për Byronë Politike.

Jam dakord që në tremujorin e parë të vendosim për t'u shqyrtuar nga Byroja Politike ato probleme që parashikohen në projektin e përgatitur, sepse nuk mund të lihen për më vonë, por gjatë këtyre tre muajve që do të punohet me problemet e tjera që do të vendosim të shqyrtohen në tremujorët e mëvonshëm, të bëhet një çikë më tepër kujdes dhe t'i ndajmë mirë problemet, mendoj unë, që ne dhe shokët të mund t'i shikojmë më qartë ato sipas sektorëve të ndryshëm që duhet të marrim në analizë. Gjatë kësaj kohe duhet të punohet për të nxjerrë se cilët sektorë dhe probleme duhet të marrim në shqyrtim gjatë vitit, në mënyrë që për ta të kemi më shumë mendime.

Kur shohim, për shembull, që për bujqësinë janë

caktuar dy ose tre probleme, ne kemi gjykuar se këto janë më të rëndësishmet e më urgjentet e këtij sektori, duke u bazuar në vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë, por, duke u përqendruar në to, mund të na vijnë edhe mendime të tjera për bujqësinë, që nuk janë parashikuar. Atëherë mund të japim variante më të shumta për të zgjedhur më të rëndësishmet. Kjo është njëra arsy. E dyta, për këto probleme në sektorë të ndryshëm duhet të matim përafërsisht edhe kohën për përgatitjen mirë të tyre dhe jo sa për të thënë që u përgatitëm, por të mendohet seriozisht që të punohet për t'i përgatitur ato në mënyrë shkencore, ekzakte. Së pari, të kontrollojmë, të marrim vendime dhe të bëjmë shësa të problemeve që nxjerr jeta, dhe, së dyti, të kontrollojmë në mënyrë që të mos marrim në shqyrtim probleme që pasqyrohen shumë qartë në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë ose që janë marrë më parë shumë afër në shqyrtim dhe që Ministria e Bujqësisë ose komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e kanë për detyrë t'i detajojnë, të bëjnë mbledhje me cilët duhet, t'i shtrojnë dhe t'i zbatojnë ato.

Pra, kështu si na paraqiten problemet që duhet të shqyrtohen nga Byroja Politike, më duket mua, nuk na jepen mendime se sa kohë nevojitet për çdo problem që të përgatitet dhe kur është momenti i përshtatshëm që ky të merret në studim. Përndryshe ndodh ashtu siç ka ngjarë edhe herë të tjera, që na e rregullojnë shokët e aparatit tematikën e problemeve, na e japin këtë në kohën e fundit dhe ne gjendemi në pozita të tillë që detyrohem i të pranojmë ato probleme që kanë menduar

ata ose për të cilat kanë organizuar njëfarë mënyre studimi, kurse, po të veprohet ashtu siç thashë më lart, ne mund të sugjerojmë edhe probleme të tjera dhe mënyra studimi më të mira për to.

Problemi që mendohet të shihet nga Byroja Politike në muajin janar, lidhur me përbërjen e organeve të zgjedhura të Partisë në rrethe e në bazë për vitin 1976, më duket se mund të qëndrojë. Por propozoj që të mos na jepen vetëm statistika dhe përqindje lidhur me këtë çështje, por të na bëhet një analizë marksiste-leniniste në prizmin e kërkesave të Kongresit të 7-të të Partisë. Aty ne të shohim jo vetëm përbërjen e organeve të zgjedhura, e cila mund të jetë shumë e mirë, por të na thuhet nëse këto organe dhe njerëzit që i përbëjnë ato i kryejnë si duhet detyrat apo jo, i zbatojnë drejt direktivat e Komitetit Qendror dhe të Partisë, këshillat dhe orientimet që ka dhënë Byroja Politike. Një analizë e tillë e problemit ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për punën e Partisë. Me këtë dua të them që, kur caktojmë një problem si ky, duhet të kemi parasysh të gjitha çka kemi thënë dhe kemi vendosur në Komitetin Qendror, në Byronë Politike dhe në Sekretariat lidhur me organet e zgjedhura të Partisë. Pra, të bëhet analiza në këtë drejtim, që materiali të mos ketë karakter thjesht informativ, por të dalë mirë çështja se si i kryejnë detyrat shokët që janë zgjedhur në udhëheqje, Byroja Politike, Sekretariati, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë dhe aparati i tij. Kjo ka rëndësi për ne dhe për organet e bazës deri te sekretarët e organizatave-bazë. Pra, analiza e punës

për zbatimin e orientimeve të Byrosë Politike lidhur me përbërjen e organeve të zgjedhura të Partisë duhet të përqendrohet në çështje të tilla e jo thjesht në statistika.

Për mbledhjen e muajit shkurt në pikën e parë ju propozoni të shqyrtojmë çështjen «Mbi masat e marra në fryshtë e vendimeve të Plenumit të 7-të të Komitetit Qendror të Partisë për të përmirësuar punën kërkimore-shkencore për studimin e vendburimeve të reja të naf-tës dhe të gazit». Unë mendoj ta marrë në shqyrtim Qeveria realizimin e planit, kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe marrjen e masave përkatëse për këtë problem, dhe në fund të gjashtëmujorit shokët e Qeve-rissë të jepin llogari në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë.

Problemi tjetër që parashikohet në projekt përmua-jin shkurt, studimi «Mbi përgatitjen, shpërndarjen dhe përdorimin e kuadrove», mund të shqyrtohet në Byronë Politike, po nuk jam shumë dakord që atë ta paraqitë vetëm komisioni i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë, pa bashkëpunuar në mënyrë të plotë me Komisionin e Planit të Shtetit dhe me një varg institucio-nesh të tjera arsimore, si dhe me dikasteret, sepse ky është një problem me rëndësi të madhe. Prandaj lidhur me këtë mendoj se ne duhet të njohim gjendjen reale të kuadrit në vitin 1977 në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të arsimit e të kulturës dhe pastaj ky studim duhet të përgatitet gjatë këtij viti, por kam mendimin se është shumë shpejt për t'u paraqitur në shkurt. Kjo nuk mund të bëhet, për arsyen se vendosja e kritereve

shkencore nuk mendoj të jetë diçka vetëm teorike, por edhe konkrete, pra të dimë sa njerëz do të na duhen të dalin nga shkollat e larta në çdo degë etj., të paktën për një periudhë 5 ose 6-vjeçare. Prandaj pyes se, po të kryhet një studim i imët, do të bëhet dot gati për t'u shqyrtuar në Byronë Politike në muajin shkurt?! Në qoftë se ky është përgatitur më parë, atëherë çështja është ndryshe. Të mbajmë parasysh faktin që në Byronë Politike duhet të studiohen probleme të cilat nuk mund të merren në analizë çdo vit, por që të kenë një efekt për disa vjet. Byroja Politike nuk do t'i kthehet përsëri këtij problemi, por më vonë ajo do të kontrollojë se si zbatohen vendimet e marra për të dhe kjo çështë tjetër çështje. Ajo mund t'i kthchet ndonjëherë vetëm sa për të korrigjuar ndonjë gabim që na e ka vërtetuar koha, por në parim edhe në praktikë vendimi i marrë duhet të zbatohet. Prandaj këtu duhet të ndalem i dhe të gjykojmë: Është me vend që ky problem të shqyrtohet kaq shpejt, në shkurt, në qoftë se veprohet kështu si e mendoj unë këtë studim?

Informacionin për përfundimin e studimit gjeologjik të Hidrocentralit të Fierzës pse ta marrim në shqyrtim në Byronë Politike, përderisa nuk ka asgjë të veçantë? Në Byronë Politike ne i kemi marrë të gjitha vendimet për këtë objekt, i kemi parë të gjitha studimet e paraqitura nga Qeveria, prandaj këtë problem mund ta marrë në shqyrtim Qeveria gjatë vitit, por jo ne.

Një problem që mendohet të shqyrtohet në muajin mars është raporti «Mbi veprimtarinë e Bashkimeve

Profesionale dhe detyrat që dalin për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë. Kështu siç është formuluar në projekt problemi është i përgjithshëm dhe do të na radhiten fraza dhe shembuj të shumtë. Unë mendoj se, qoftë për organizatën e Bashkimeve Profesionale, qoftë për organizatën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, pse një problem të tillë e kemi edhe për rininë, ne duhet të përqendrohemë në çështjet kryesore, të cilat nuk duhet të trajtohen në mënyra të përgjithshme, por të jenë të rëndësishme nga pikëpamja shoqërore, politike ose ideologjike dhe të mos analizohen më tepër se dy çështje në një raport. Këtyre dy çështjeve kyc, që kanë të bëjnë me këto organizata, t'u vemi deri në fund nga ana teorike, politike, organizative, nga ana e kuadrit, si dhe nga ana e bashkëpunimit të Partisë me organizatat e tjera të masave. Një raport i tillë më duket se mund të bëhet dhe ne mund ta marrim në studim.

Për sa i përket raportit «Mbi ritmet dhe kriteret e shtimit të radhëve të Partisë», që mendohet të shihet po në muajin mars, jam dakord. Gjithashtu jam dakord të shqyrtojmë parashtresën për mënyrën e bërjes së projektit dhe të preventivit përfundimtar për Hidrocentralin e Komanit, pse është një vepër e re që nuk e kemi marrë asnjëherë në shqyrtim në Byronë Politike.

Për listën e gjatë të problemeve që na propozohet të studiojmë në periudhën tjetër të vitit, kisha nevojë të reflektoja më shumë. Por konstatoj se mjaft probleme parashikohet të paraqiten nga Qeveria ose nga Kryesia e Këshillit të Ministrave. Këto, para se t'ia pa-

raqitin Byrosë Politike, duhet të bashkëpunojnë edhe me sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë, për arsyen se mund t'i shikojnë problemet në prizmin tekniko-ekonomik, kurse ne duhet t'i shikojmë edhe në prizmin politiko-ideologjik.

Aparati i Komitetit Qendror të Partisë dhe ai i Këshillit të Ministrave duhet të punojnë për ato probleme që do të na vijnë në Byronë Politike, pse çdo problem, para se të na paraqitet, duhet të jetë i plotë. Përveç kësaj, ka probleme që duhet t'i marrin në studim vetëm Qeveria e Kryesia dhe s'është e nevojshme t'i marrim ne. Ne mund të shohim anën ideopolitike ose organizative të disa problemeve dhe si e në ç'bazë t'i trajtojmë, prej tyre të nxjerrim pastaj detyra politiko-ideologjike. Por, që të marrim në studim probleme që u përkasin thjesht organeve shtetërore t'i kontrollojnë, të marrin masa dhe të japid ndihmën e duhur, më duket se nuk është e arsyeshme. Në vend të tyre ne duhet të shqyrtojmë probleme të tjera, të cilat nuk mund t'i gjejmë me imagjinatë, po duke studiuar me imtësi kapitujt e raporteve të Kongresit të 7-të, prej tyre të nxjerrim edhe temat, që t'u bëjmë pastaj një klasifikim, cilave duhet t'u japim prioritet dhe cilat anë të këtij apo të atij problemi duhet të marrim në shqyrtim. Kjo ka rëndësi të madhe, pse kështu largohemi nga një plan pune imagjinar ose rutinë.

Përveç kësaj, sekretarët e Komitetit Qendror, aparatet, komitetet e Partisë duhet të janë të lidhur edhe me dikasteret, me ministrat, me instruktorët, me njerëzit e bazës që punojnë për realizimin e detyrave,

prej të cilëve ndihmohen të nxjerrin mendime plotësuese, që të mund t'i përcaktojmë më drejt problemet dhe anët e tyre të veçanta që duhet të studiojmë. Në qoftë se duam të bëjmë një punë shkencore, dhe është e detyrueshme ta bëjmë këtë në Byronë Politike dhe në Sekretariatin e Komitetit Qendror, të njëjtën gjë duhet të bëjnë, gjithashtu, edhe Qeveria me Kryesinë e saj. Mendoj ta kemi mirë parasysh këtë çështje. Përpjekje bëhen në këtë drejtim, por kam përshtypjen se në thellësi nuk bëhet sa duhet.

Më falni se po i rikthehem prapë çështjes që propozohet të shqyrtohet në pikën e parë të rendit të ditës të mbledhjes së muajit janar të Byrosë Politike, studimt për përgjithësimin e përvojës së deritanishme të kooperativave të tipit të lartë. Këtë studim e kam lexuar që vitin e kaluar, por ai është shtyrë muaj pas muaji. Mendoj se ky material duhet azhurnuar dhe jo të na serviret siç është bërë më parë, pse ashtu siç ishte, në qoftë se nuk gabohem, jepte një informacion të përgjithshëm dhe pastaj përcaktonte parimet dhe perspektivat e kooperativave të tipit të lartë. Perspektivën e këtyre kooperativave ne e kemi caktuar vetë dhe s'është nevoja të na i përsëritin as Ministria e Bujqësisë, as punonjësi i aparatit të Komitetit Qendror, që ndjek problemet e bujqësisë. Çështja këtu qëndron më thellë, se nga informatat mësoj që të ardhurat e anëtarëve të kooperativave të tipit të lartë i kapërcejnë ato të punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore, se ka kooperativa të tilla që thonë se s'kanë më nevojë për kontributin e shtctit etj.

Mendoj se në këtë çështje është mbyllur gërshëra, në rast se anëtarët e kooperativave të tipit të lartë prodhojnë njësoj, në mos të themi edhe ca më mirë se punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore. Pra, sipas tyre, këto kooperativa kanë arritur në një shkallë me ndërmarrjet bujqësore. Tani vihet pyetja: Ti kthejmë në ndërmarrje bujqësore? Kooperativat me siguri do të thonë jo. Edhe unë kështu mendoj, sepse në këto kooperativa ndërgjegjja e anëtarëve nuk është ngritur në nivelin që kërkohet, pse edhe në ndërmarrjet bujqësore ndërgjegjja nuk është aq e ngritur dhe duhet të punohet thellë për këtë çështje në të dy sektorët. Prandaj mendoj të na bëhet një analizë për të parë qartë nëse ngritja e kooperativave të tipit të lartë në këtë nivel u arrit se i ndihmoi sa duhet ose më shumë nga sa duhet shteti, apo ka ardhur si rezultat i punës së tyre.

Ne e njohim mentalitetin e fshatarit, i cili, në rast se në pronën e tij të grupit do të sigurojë të ardhura më të mëdha, e plus këtyre ka edhe oborrin kooperativist, kur të piqen situatat, nuk do të dëshirojë që kooperativa e tipit të lartë të kthehet në pronë të përgjithshme të popullit. Këtë kalim ne nuk duhet ta bëjmë me dekret, por në baza leniniste. Pirro Dodbiba bënte prova në Kooperativën e Tipit të Lartë të Shjakut që SMT-ja t'i jepej asaj, po kjo ishte një orvatje revisioniste. Mund të ketë edhe mjete të tjera që ne, për të lehtësuar SMT-të, se mos rëndojmë kuadrot, ua shesim kooperativave të tipit të lartë. Stalini në një vend diku thotë se për sa u përket kooperativave, këto duhet t'i perfekcionojmë që të përdoren mirë levat

financiare e të kreditit, të përdoret, gjithashtu, mirë kontrolli me anën e rublës, shteti të mbikëqyrë çmimet, uljen e çmimit të kulturave, si edhe fitimin. Ne duhet të rritim rolin e fitimit dhe të rendimentit, thotë Stalini, dhe këto të ndihmojnë për realizimin e planit, për inkurajimin e kooperativave dhe për shtimin e prodhimit.

Këto dhe disa probleme të tjera, që nuk janë të shkëputura nga problemet thjesht ekonomike, duhet të na bëhen të qarta në këtë raport, por pa u futur në kooperativat e tjera të zakonshme apo të bashkuara. Diçka mund të thuhet për to lidhur me problemet që na shtrohen për kooperativat e tipit të lartë, se në çfarë niveli gjenden disa prej tyre e ndonjë gjë tjetër. Ka rëndësi të na qartësohet më mirë problemi i fondit të paprekshëm dhe përdorimi i tij në to. Unë jam dakord që ky problem të merret në shqyrtim.

Do të kthehem përsëri në listën e problemeve që do të shqyrtojmë në periudhën tjetër të vitit. Për të, siç thashë më parë, natyrisht, më duhet njëfarë kohe që ta studioj, por për disa probleme mund të bëj ndonjë vërejtje paraprakisht.

Raporti «Mbi stadin e arritur dhe masat që duhen marrë për ngushtimin e dallimeve ndërmjet qytetit dhe fshatit në fushën socialkulturore», në qoftë se do të merret në studim, mendoj të lihet për në fund të vitit, se nuk është një problem që e shqyrtojmë për të rimarrë ose për të shtuar masa të tjera të mëtejshme për ngushtimin e gëershërés mes qytetit dhe fshatit. Probleme të tillë ekonomike nuk mund të shihen as çdo muaj, as çdo vit. Qeveria mund të kontrollojë se si po zba-

tohet, se edhe kjo ka rëndësi. Ne mund ta marrim në shqyrtim raportin, por jo sipas radhës që vihet në listë, mendoj se është më mirë andej nga fundi i vitiit. Këtë mund ta shqyrtojmë ose në mënyrë të veçantë, ose brenda një problemi tjetër ekonomik, për të parë se si po zbatohet orientimi i Partisë. Lidhur me këtë dua të shtoj se ka shumë rëndësi që problemi të studiohet në mënyrë speciale nga ekonomistët. Ne duam që ato që kemi vendosur të zbatohen, se aktualisht nuk është urgjente të marrim vendime të tjera të mëtejshme, mbasi sot shtrohet çështja të bëjmë kursime, se mund të na dalin përpara vështirësi. Prandaj ta shtrën gojmë dorën në lekë dhe jo ta lirojmë. Duhet të bëhen disa studime më të thella në bazë të ekonomisë politike të socializmit.

Edhe problemet që dalin në fushën e demografisë lidhur me shtimin e popullatës e lëvizjen mekanike, me forcat e reja që krijohen për punë, me frontet që mund të hapen, si dhe me masat për ngritjen në një nivel më të lartë të veprimtarisë së organeve që merren me to, më duket se janë diskutuar shumë herë, prandaj mendoj se nuk është e domosdoshme t'i rimarrim përsëri në studim në Byronë Politike. Qeveria po, mund t'i rimarrë, por kjo, organet shtetërore dhe komitetet e Partisë në bazë duhet të kujdesen që të zbatohen vendimet ekzistuese, të ushtrojnë kontroll të rreptë ndaj organeve shtetërore, edhe Partia, gjithashtu, të kontrollojë punën e saj agjitative, politike dhe ideologjike për lëvizjen e njerëzve në raport me punët që dalin dhe atje ku dalin.

Çështja «Mbi gjendjen e minierave të kromit e të bakrit dhe zhvillimin e tyre gjatë pesëvjeçarit të gjashë e në perspektivë», më duket gjithashtu e panevojshme t'i paraqitet Byrosë Politike, pse nuk do të na thuhej ndonjë gjë e re. Qeveria po, duhet t'i kontrollojë këta sektorë, kurse neve, kur të marrim në shqyrtim problemin e minierave ose kur të analizojmë në fund të vitit planin, atëherë të na flitet edhe për këta dy sektorë. Që t'i shqyrtojmë tanë këta në mënyrë të vëçantë, më duket se nuk ia vlen.

Çështja «Mbi masat që duhen marrë për rritjen e rolit të organeve përfaqësuese të pushtetit» mendoj se s'është shumë e nevojshme të merret në shqyrtim nga Byroja Politike, për arsyen Presidiumi i Kuvendit Popullor gati çdo muaj thërret rregullisht në raport nga një komitet ekzekutiv rrëthi dhe me këtë rast jep udhëzime. Nga ana tjetër, ne bëmë gjithë atë Kongres<sup>1</sup>, komitetet e Partisë, komitetet e ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe Qeverisë u janë shtruar detyra shumë herë se si duhet të punojë pushtet. Prandaj kam mendimin se edhe kjo është një temë që mund të mos kalojë nga Byroja Politike.

Edhe rapporti «Mbi zbatimin e orientimeve të Partisë për grumbullimin, shitjen dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtoriale» po ashtu më duket se nuk është për në Byronë Politike, por për Kryesinë e Këshillit të Ministrave. Kjo duhet të kontrollojë zbatimin e orientimeve të Partisë për grumbullimin, shitjen

---

1. Kongresi i 7-të i PPSH.

dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorele, po të jetë nevoja edhe çdo muaj.

Po kështu, nuk e quaj të nevojshme të merret në shqyrtim nga Byroja Politike raporti «Mbi punën e Partisë për të përmirësuar më tej rezultatet e kërkimeve gjeologjike», pasi kemi të bëjmë me çështje tekniko-shtetërore. Edhe këtë, po të dojë, le ta marrë në studim Qeveria. Probleme të tilla janë të teknikëve, sidomos të Ministrisë së Industrisë e të Minierave. Të njëjtën vërejtje kisha edhe për informacionin «Mbi masat që janë marrë për të përdorur si lëndë djegëse qymyrin në vend të naftës dhe të mazutit». Mendoj se nuk është nevoja të na vijë në Byronë Politike as kjo çështje.

Duke lexuar materialin me problemet, të cilat është menduar të na paraqiten në Byronë Politike, konstatoj, edhe një herë e përsëris, se këto probleme nuk janë nxjerrë si duhet nga raportet e Kongresit të 7-të të Partisë ose nga përvoja e vitit të kaluar. Këtu nuk shoh asnjë çështje, ta zëmë, për ndërtimin. Ndërtimi ka shumë probleme dhe, kur them ndërtimi, nuk parashikoj të na vijë ndonjë raport, fjala vjen, për Ballshin ose për Fierzën, por në Byronë Politike të këqyrim nëse Ministria e Ndërtimit dhe organet e saj vartëse i kanë kuptuar mirë gabimet e tyre dhe i kanë analizuar ato. A janë marrë masat e përshtatshme me kushtet e krijuara që të mos na përsëriten më të njëjtat gabime dhe çfarë masash janë marrë? Në këtë sektor, sipas mendimit tim, duhej të merreshin një varg masash, bile edhe në thellësi. Nuk mund të na ecin mirë

ndërtimet, nuk mund të kontrollohet leku atje, nuk mund të ndërtohen me kohë dhe me çmimet që janë caktuar veprat e mëdha, në rast se ne nuk do të shohim e nuk do të zgjidhim mirë anën organizativo-teknike të vetë Ministrisë së Ndërtimit dhe të organeve të saj vartëse, si dhe normativat e projekteve dhe të materialeve. Këtë duhet ta organizojë Këshilli i Ministrave, por ai të bashkëpunojë edhe me organet e Partisë, si me aparatin e Komitetit Qendror, ashtu edhe me komitetet e Partisë në rrethe, për ta parë në kompleks këtë problem.

Nuk shoh, gjithashtu, në projektpalan një çështje tjetër, atë të shkollave dhe në veçanti të universitetit dhc të instituteve të tjera të larta, jo vetëm në drejtim të përparimit në mësime, por edhe të qëndrimeve politiko-ideologjike të studentëve dhe të kuadrove që dalin prej tyre, të problemeve shoqërore që ata mund të kenë, të drejtimit e të interesimit të veçantë të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe të Komitetit të Partisë të kryeqytetit e të rretheve që kanë shkolla të larta e filiale, pse këtu kemi pasur të meta. Të mos harrojmë se Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, siç e dimë, ka pasë bërë gabime të rënda, po kështu edhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës. Duhet t'i kontrollojmë ne shkollat dhe në veçanti ato të lartat? Më duket se këtë duhet ta bëjmë medoemos. Por në projektpalan nuk shoh ndonjë gjë në këtë drejtim.

Mund të ketë dhe ka shumë probleme të tjera të rëndësishme, të cilat mund t'i analizojmë këtu në Byronë Politike. Këto, siç e theksova më lart, nuk mund

t'i gjejmë me imagjinatë, por duke u përqendruar në problemet që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë.

Për sa u përket çështjeve që propozohet të marrë në shqyrtim Sekretariati i Komitetit Qendror në janar, lidhur me pikën e parë «Mbi konkluzionet e kontrollit punëtor të organizuar nga Komiteti Qendror i Partisë për prodhimin dhe përdorimin e qymyreve», nuk e kuptoj cili është ky grup kontrolli punëtor që është marrë me kontrollin e prodhimit e të përdorimit të qymyreve. Mua më duket se nuk na përket neve ta analizojmë një çështje të tillë, këtë mund ta studiojë Kryesia e Këshillit të Ministrave, pse përdorimin e qymyreve në parim e kemi shqyrtuar, kemi marrë, gjithashtu, edhe vendime, e kemi shtruar shumë herë këtë çështje në Byronë Politike. Të mos harrojmë, gjithashtu, se atë e theksuam me forcë edhe në Kongres. Atëherë përsë duhet ta analizojë prapë Sekretariati? Prandaj organet qeveritare, organet përkatëse shtetërore dhe organet e bazës duhet ta kontrollojnë dhe të kujdesen që të zbatohen vendimet që janë marrë nga Kongresi, nga Komiteti Qendror, nga Byroja Politike dhe nga Qeveria. Kjo, më duket mua, është një pikë që është futur në projektplan sa për të thënë, sepse mund të kemi në dorë raportin e ndonjë komisioni ose të ndonjë kontrolli punëtor.

Çështja e parë që parashikohet të shqyrtohet në Sekretariat në muajin shkurt «Mbi punën me të përjashtuarit nga Partia», mund të merret, po këtë çështje ne e kemi shtruar edhe herë tjetër, pastaj, po të thirrësim të na raportojnë rrëthet e Sarandës dhe të

Kukësit që paraqiten dobët në këtë çështje, ato me siguri «do të na tregojnë përralla». Mendoj se interesimi i Partisë për këtë çështje, në qoftë se do ta marrim në studim, duhet të përqendrohet në eksperiencën e mirë, të shohim ku punohet në këtë drejtim dhe eksperiencën e përparuar t'ua rekomandojmë pastaj edhe atyre rretheve ku kjo punë s'bëhet si duhet. Prandaj mendoj se është më e efektshme të thërresim në Sekretariat dy rrethe të tjera, ku punohet mirë me të përjashtuarit nga Partia, dhe eksperiencën e tyre ta përgjithësojmë. Kjo nuk është një çështje aq e thjeshtë. Pastaj të mos mendojmë se Partia nuk interesohet për elementët që janë përjashtuar nga radhët e saj, se këta janë në punë, bëjnë pjesë në organizatat e masave, gjë që do të thotë se shoqëria i ka nën kujdes. Pra, ne mund ta shqyrtojmë këtë si problem, po ky nuk është një problem special, sikundër mendon ndokush, sikur Partia nuk interesohet për të përjashtuarit. Partia interesohet për ta si për gjithë të tjerët, bile i mban afër nëpërmjet punëve që u jep. Me këta njerëz puna duhet të zhvillohet njëloj si me gjithë punonjësit e tjerë, që bëjnë pjesë në Frontin Demokratik dhe në organizatat e tjera të masave. Si problem, pra, ky mund të shikohet në Sekretariat, por që ne të përcaktojmë një punë speciale që duhet të bëjë Partia me këta njerëz, nuk e di, në qoftë se eksperiencia na jep të dhëna, edhe mund të përcaktojmë.

Edhe raportin «Mbi zbatimin e vendimit të Byrosë Politike për unifikimin e hetuesisë dhe masat për përmirësimin e punës në këtë sektor», që mendohet të me-

rret në shqyrtim nga Sekretariati në muajin shkurt, më duket se nuk është e nevojshme ta shohim ne, këtë mund ta marrë në studim Qeveria.

Përsëri në mars na jepet për shqyrtim një problem që nuk i përket Sekretariatit, po Kryesisë së Këshillit të Ministrave ose Qeverisë, siç është raporti «Mbi masat e marra për administrimin e mirë të drithërave të bukës në depo, pakësimin e firove dhe mënyrën e gatimit për të përmirësuar cilësinë dhe për të rritur rrezen e prodhimit të bukës». Kam mendimin se duhet të hiqen të tilla probleme nga rendet e ditës të mbledhjeve të Sekretariatit. Kurse çështja që ka të bëjë me luftën kundër grindjeve dhe mërive që cenojnë unitetin e popullit, jam dakord të mbetet në listë.

Në përgjithësi mendoj se temat që janë parashikuar të merren në studim në Sekretariat gjatë këtyre muajve të parë nuk janë të përshtatshme. Për sa u përket temave që janë radhitur për periudhën tjetër të viti, ajo për masat që janë marrë nga komitetet dhe nga organizatat-bazë të Partisë për të nxjerrë nga prapambetja kooperativat bujqësore që marrin më pak se 10 lekë për ditë-punë dhe që kanë kredi të pashlyera në bankë, më duket se gjithashtu nuk është për Sekretariatin e Komitetit Qendror.

Tema «Mbi eksperiencën e deritanishme të punës së komiteteve të Partisë të rajoneve të Tiranës dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre udhëheqëse» duhet formuluar më mirë, sepse kështu siç është paraqitur ka karakter të përgjithshëm dhe, po u la një titull i përgjithshëm, edhe

brendia e materialit që do të na vijë, do të jetë e përgjithshme, gjë që s'na shërben për gjëkafshë. Por më shumë në Tiranë ne duhet të kërkojmë disa probleme kyç, që nuk po na ecin.

Në përgjithësi problemet që janë caktuar për t'u analizuar në Sekretariatin e Komitetit Qendror të Partisë gjatë periudhës tjeter të vitit, mendoj se është e nevojshme të merren në studim, por duhet të punohet mirë për to. Gjithashtu mund të mendohet edhe për disa probleme të tjera që mund të shqyrtohen.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# **CILAT JANË KONTRADIKTAT PARIMORE QË KEMI ME KINEZET**

**Shënimë**

**14 janar 1977**

Udhëzova shokun Ramiz të formulojë një material të shkurtër e konciz, ku të vihet në dukje se cilat janë kontradiktat parimore që kemi ne me udhëheqësit kinezë. Ky material t'u dërgohet komiteteve të Partisë të rretheve dhe sekretarët e parë të udhëzohen që, kur të flasin për zërthimin e materialeve të Kongresit të 7-të, për problemet ndërkombëtare dhe përlëvizjen marksiste-leniniste, çështjet që do të preken në këtë material të inkuadrohen në çështjet përkatëse.

Cilat janë çështjet për të cilat duhet t'u jepen rretheve shpjegime suplementare dhe që janë edhe në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë:

1. Për teorinë e «tri botëve». Nuk mund të jetë dakord Partia jonë me këtë ndarje fiktive, joreale, pa baza, joklasore dhe jorevolucionare. Partia e Punës e Shqipërisë është për ndarjen që kanë formuluar Marksit dhe Lenini. Formulimi i kinezëve për «tri botët», siç e trumbetojnë dhe e mbrojnë ata, si «forcë lëvizëse revolu-

lucionare e kohës», ku futin edhe veten dhe disa vende socialiste, është një koncept revisionist, një grumbullim shtetesh pa personalitet. Për disa është gjoja një front antiimperialist kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe antisocialimperialist, kundër Bashkimit Sovjetik, për disa të tjerë, pra, është kundër hegemonizmit të disave dhe aspak kundër borgjezisë dhe reaksionit vendës që shtypin dhe skllavërojnë masat, që e kanë shitur vendin te njëri ose tek tjetri imperialist dhe pretendojnë se janë të lirë dhe sovranë.

Ky grupim, kjo ndarje, kjo teori dhe këto veprime të kësaj «bote» zhdukin luftën e klasave në planin kombëtar e ndërkombëtar dhe ndihmojnë imperializmin, socialimperializmin e të gjithë ata që hiqen si marksistë-lininistë. Partia jonë është kundër kësaj.

2. Pikëpamjet e kinezëve për Tregun e Përbashkët Evropian dhe për «Evropën e Bashkuar», për bashkësinë socialiste dhe KNER-in, janë reaksionare, kundërrevolucionare. Edhe ato për NATO-n, nga një anë, dhe për Traktatin e Varshavës, nga ana tjetër, të tilla janë, sepse të dy këto pakte janë agresive. Të dy këto formacione ushtarake, organizma shtetërorë dhe ekonomikë janë në dobi të interesave kapitalistë të të dyjalëve, janë në dëm të lirisë së popujve, të proletariatit, të revolucionit. Ata që thonë se duhet mbrojtur njëri ose tjetri nga këta organizma për të thelluar kontradiktat midis tyre, gënjejnë, shuajnë luftën kundër dy superfuqive, shuajnë luftën e klasave në platformën kombëtare dhe ndërkombëtare; ata janë për një luftë të tretë botërore dhe e nxitin atë, në vend që të ndjekin

parimin leninist për sabotimin e kësaj lufte dhe, në pamundësi për t'ia arritur kësaj, ta kthejnë atë në një luftë civile. Mbrojtja e NATO-s ose e Traktatit të Varshavës është një parullë antimarksiste. Partia jonë është kundër saj dhe lufton për ta demaskuar.

3. Diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave ne e zbatojmë sipas tçave të marksizëm-leninizmit. Kjo diktaturë shtyp armiqtë e klasës. Kontradiktat antagoniste dhe joantagoniste Partia jonë i ka shikuar dhe i shikon drejt. Kundërrevolucionarët, spiunët e tradhtarët e atdheut ajo i dënon sipas fajeve e deri edhe me vdekje.

Partia jonë mendon se pikëpamjet dhe veprimet e saj janë të drejta dhe revolucionare. Të tjerat që bien në kundërshtim me normat marksiste-leniniste, ne i quajmë oportuniste dhe moszbatim të diktaturës së proletariatit e të luftës së klasave.

4. Çështja e luftës në të dy krahët është zhvilluar qartë. Kush e ka mizën nën kësulë, mund të thotë se Partia e Punës e Shqipërisë na sulmon tërthorazi.

5. Për kinezët mund të themi se pretendojnë sikur ne i kemi sulmuar në Kongresin e 7-të të Partisë sonë dhe për këtë na bënë një notë verbale, ku na akuzojnë dhe thonë se nuk do të bëjnë polemikë me ne. Ne iu përgjigjëm se jeni ju kinezët që sulmoni Kongresin tonë të 7-të, pa na thënë konkretisht se në ç'drejtim ju atakojmë, prandaj na e sqaroni këtë dhe atëherë do t'ju japim përgjigje. Kinezët deklarojnë se s'duan të bëjnë polemikë me ne, po ata shkelin çdo normë në marrëdhëni midis partive dhe na sulmojnë prapa krahëve,

duke bërë presione, shantazhe dhe shpifje kundër nesh. Kjo është një metodë trockiste.

6. Partia jonë ka qenë dhe është për hegjemoninë e klasës punëtore, ajo kurrë nuk ka lejuar dhe nuk lejon pluralizmin e partive borgjeze në vend dhe nuk e ka ndarë e nuk do ta ndajë kurrë pushtetin me kurrikënd.

7. Në Partinë tonë nuk lejohet të zhvillohen dhe të bashkëjetojnë dy vija. Te ne ka vetëm një vijë marksi-te-leniniste.

8. Te ne janë likuiduar klasat shfrytëzuese. Mbeturinat e tyre luftohen dhe shtypen nga diktatura e proletariatit dhe lufta e klasave në vendin tonë zhvillohet si brenda Partisë, ashtu edhe jashtë saj.

Këto çështje ne duhet të mos i bëjmë akoma fushatë, por t'ia themi Partisë, që ajo të jetë e armatosur, të mos gjendet asnjëherë në befasi, të zbatojë si duhet vijën e Kongresit të 7-të dhe t'i kuptojë taktikat.

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 35*

## **PSE KËTO VARIACIONE NË STRATEGJINË KINEZE?**

**Shënime**

**16 janar 1977**

Po hedh disa mendime në këto shënime lidhur me disa nga kritikat e pathemelta dhe trockiste që bën Partia Komuniste e Kinës në takime me shokë të disa partive komuniste marksiste-leniniste të botës kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, prapa krahëve të saj. Këta, kinezët i thérresin në Pekin ose në ambasadat e tyre në vende të ndryshme të botës dhe u trajtojnë probleme të politikës ndërkombëtare e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare sipas strategjisë dhe taktikës së tyre. Në disa nga këto probleme ata janë në kundërshtim flagrant me strategjinë dhe me vijën e Partisë sonë.

**Por sot unë do të trajtoj çështjen që shtrojnë udhëheqësit kinezë se gjoja qenka pikëpamje antikineze kur ne themi se nuk duhet mbështetur në një imperializëm për të luftuar një imperializëm tjeter.**

Revisionistët kinezë pretendojnë se çdo parti tjeter marksiste-leniniste duhet të ndjekë me besnikëri

variantet e ndryshme të strategjisë së tyre. Në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës strategjia e saj synonte që të grumbulloheshin të gjitha forcat që mund të grumbulloheshin, dhe, me Bashkimin Sovjetik në krye, të drejtosheshin në luftë të ashpër dhe të pandërrerë kundër imperializmit amerikan.

Më vonë, në Kongresin e 9-të të Partisë Komuniste të Kinës, strategjia e saj ndryshoi. Sipas kësaj strategjie duhej të luftohej me të gjitha forcat dhe në të njëjtën kohë edhe kundër imperializmit amerikan, edhe kundër socialimperializmit sovjetik, si armiq nga më të tèrbuarit të popujve. Në këtë kongres u tha, gjithashtu, se duhet të luftojmë në mënyrë të tillë që t'i futim në varr si imperializmin amerikan, ashtu edhe socialimperializmin sovjetik.

Në Kongresin e 10-të kjo strategji ndryshoi përsëri, dhe nga lufta në të dy krahët u kalua në luftën në një krah. Socialimperializmi sovjetik u konsiderua armiku më i madh i njerëzimit, kurse imperializmi amerikan zbriti në radhë të dytë. Pra, siç shohim, në çdo kongres na del nga një strategji, kurse strategjia e Partisë sonë nuk lëviz, vija jonë është: armiqtë kryesorë të popujve, të socializmit dhe të komunizmit janë dy, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik me gjithë aleatët e tyre, borgjezinë e madhe reaksionare.

Pra, konkluzioni ynë se nuk mund të mbështetemi në një imperializëm për të luftuar një imperializëm tjetër, është pascjë e strategjisë së palëkundur të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë palëkundshmëri dhe qëndrueshmëri në rrugën marksiste-leniniste të Partisë

sonë kinezët e quajnë strategji antikineze! Po pse e quajnë vallë strategji antikineze? Kjo ka një të vërtetë: kinezët mbështeten tek imperializmi amerikan kundër socialimperializmit sovjetik.

Mbështetja e kinezëve tek imperializmi amerikan nuk është diçka fiktive, mendoj unë. Që me takimin e Çu En Lait e më vonë të Maos me Kisingerin, me Niksonin, me Shlesingerin e me një mori grupesh të specializuara të senatit, të financierëve të mëdhenj e të industrisë së rëndë amerikane, vërtetohet se kjo mbështetje është realë.

Natyrisht, të dyja palët, kur filluan bisedimet, i bënë lëshime njëra-tjetrës. Imperializmi amerikan ka për qëllim që Kinën ta ketë nga ana e tij, që kjo të mos shkojë nga ana e Bashkimit Sovjetik. Kina, natyrisht, ka edhe ajo qëllimet e veta: dëshiron të bëhet një superfuqi dhe të balancojë dy superfuqitë e tjera. Mirëpo për këtë asaj i duhet kohë, i duhen mjete, i duhen armë moderne, dhe Partia Komuniste e Kinës, siç po duket, ka gjetur rrugën e mbështetjes tek imperializmi amerikan.

Ka marrë vallë Kina ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Fakte nuk kemi, por ne mendojmë se ka marrë. Këtë ne e bazojmë në ato që shkruajnë gazetat amerikane, në fjalimet e presidentit Ford, në aluzionet e Kisingerit dhe në mbështetjen zyrtare që i bëri Kinës Kisingeri në një fjalim, ku tha që, në rast se Kina do të sulmohet nga ndonjë fuqi tjetër, atëherë balanca në marrëdhëniet ndërkombëtare ka përsuar një ndryshim të madh, që do të ketë rrjedhime

me rëndësi. Këto fjalë tha afërsisht Kisingeri. Sidoqoftë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i akorduan Kinës 10 avionë «Boing», pa pasur akoma marrëdhënie diplomatike me të, vetëm duke pasur një zyrë amerikane në Kinë, dhe Kina, nga ana e vet, një të tillë në Uashington. Përmes këtyre zyrave të ndërlidhjes, domethënë nën këtë ombrellë, shkëmbëshin e shkëmbehen delegacione të panumërtë, të deklaruara dhe të padeklaruara. Por nuk është vetëm çështja e «Boingeve», sepse, fundi i fundit, acroplani mund të konsiderohet si një plaçkë tregu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia shesin gjithë botës. Sipas fjalimeve të Fordit përpara senatit, duket se Kina do të ketë blerë edhe ordinatore nga Amerika. Këta ordinatore, komplikse aparaturash të rëndësishme, përveç të tjerave, shërbejnë për të kontrolluar radarë të fuqishëm dhe drejtimet e raketave në avion. Për këtë ka pasur një zhurmë dhe është bërë një polemikë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por, në fakt, marrim vesh se, pas blerjes së këtij ordinatori ose të këtyre ordinatoreve, Kina filloi të intensifikojë nxjerrjen e naftës, pse të tilla apatura janë shumë të perfeksionuara dhe shërbejnë si për industrinë civile, ashtu dhe për atë të luftës.

Natyrisht, ka ekzistuar edhe frika se me këtë veprim mos prishej ekuilibri dhc për këtë arsy, siç kemi lexuar në shtyp, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ofruan edhe Bashkimit Sovjetik të tillë ordinatore. Kinëzët mund të kenë marrë nga amerikanët edhe patentë të tjera të rëndësishme ushtarake dhe besoj se do të marrin edhe në të ardhmen. Prandaj them se mbështet-

tja e kinezëve te Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk është një mbështetje fiktive, por reale.

Po pse ia japid Kinës Shtetet e Bashkuara të Amerikës këto? Sigurisht ato kanë qëllimet e tyre strategjike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë që Kina të armatoset, por të armatoset për sulm kundër Bashkimit Sovjetik dhe jo kundër tyre. Kjo do të thotë se armatimet që ato do t'i japid Kinës do të dinë t'i matin. Armatimet, patentat ose modelet e armatimeve që do t'i japid Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do t'i shërbijnë Kinës edhe për t'u mbrojtur nga një sulm eventual sovjetik. Kështu amerikanët nuk e përjashtojnë një përlleshje midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, bila ata e dëshirojnë një gjë të tillë; prandaj e ndihmojnë Kinën me armatime dhe nxitin egërsinë e imperializmit sovjetik.

Çështja tjetër që synojnë amerikanët është që, në rast se Kina armatoset dhe vë përballë socialimperializmit sovjetik një fuqi relativisht të fortë, atëherë Bashkimit Sovjetik, mendojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do t'i duhet të tërheqë forca nga Evropa që t'i sjellë në kufijtë e gjatë me Kinën. Nga ana tjetër, duke vepruar në këtë mënyrë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të nxitin, siç kanë nxitur edhe në vendet e tjera, mënyrën e tyre të jetesës dhe të të menduarit në gjirin e popullit kinez, sepse një ndihmë e tillë substanciale e amerikanëve, natyrisht, do të fitojë simpati në udhëheqjen kincze, por edhe në ushtrinë kinezë do të ngjallet një miqësi e vjetër. Edhe në popull nuk do të mbetet pa depërtuar mënyra amerikane

e jetesës dhe e të menduarit. Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjetën te Kina një treg të madh për evadimin e mallrave të tyre dhe për thithjen e lëndëve të para kineze, por duhet thënë se në këto mallra që ato do të eksportojnë, figurojnë në radhë të parë armatimet, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu si dhe Bashkimi Sovjetik, janë bërë shlelet më të mëdha që furnizojnë të tjerët me armë.

Amerikanët e njojin mirë mentalitetin e popullit kinez dhe të udhëheqësve kinezë. Në ndërgjegjen e popullit kinez pikëpamjet konfuciane, 2 000 vjet para erës së re, kanë zënë rrënje, kurse periudha e ndërtimit të socializmit (ashtu siç ndërtohet ky socializëm në Kinë) është një periudhë kohe shumë e shkurtër. Pikëpamje konfuciane ekzistojnë jo vetëm në popull, por edhe në udhëheqjen kinez, sepse ne shohim, dhe faktet e trajtonë qartë këtë, që në udhëheqjen kinez ekzistojnë një varg fraksionesh; shohim se kombinohen, organizohen e çorganizohen komplotë të ndryshme për rrëzimin e njörir dhe të tjetrit; kombinohen vrasje e shumë veprime të tjera që, për fat të keq, i përngjasin edhe mentalitetit të vjetër kinez, i cili nuk është spastruar nga mbeturinat. Deri në njëfarë shkalle këto mbeturina vazhdohet të ushqehen edhe tash, kur Kina është shpalloj republikë popullore.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i studiojnë me hollësi të gjitha këto çështje. Interesat e imperializmit amerikan kanë qenë jashtëzakonisht të mëdhenj në zonën e Paqësorit, në Japoni, Kore, Kinë, Vietnam. Indi e gjetkë. Prandaj kinologët amerikanë kanë punuar,

dhe në mënyrë sistematike kanë analizuar çdo situatë, pra kanë studiuar prirjet politike, opinionet politike në popull e në udhëheqje, dhe problemet i kanë trajtuar në mënyrë që këto të zgjidhen ose të fillojnë të zgjidhen në interes të amerikanëve.

Pra, Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste të Kinës, me raportin që mbajti atje Çu En Lai, e ktheu strategjinë e Kinës drejt mbështetjes te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe jo në mënyrë fiktive, por në mënyrë reale, konkrete. Kina ka interes të madh që brenda një periudhe kohe të forcohet, dhe këtë kohë Çu En Lai e përcaktoi në Kongresin e 10-të, duke dekluar që Kina në vitin 2000 duhet të arrijë të bëhet një «fuqi e madhe socialiste». Natyrisht, kjo «fuqi e madhe socialiste», sipas pikëpamjeve të grupit të Çu En Lait, do të bëhej edhe me forcat e veta, të Kinës, por dhe me ndihmën e një superfuqie, dhe kjo superfuqi, sipas pikëpamjeve dhe prirjeve të Mao Ce Dunit e të Çu En Lait, ishte imperializmi amerikan. Këta të dy mund të zgjidhnin edhe Bashkimin Sovjetik, por ky nuk kishte rëndësi për ta, sepse aleanca me Bashkimin Sovjetik Mao Ce Dunit dha Çu En Lait nuk u dha ato që shpresonin. Kështu që kthesa u bë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo kthesë u përcaktua në këtë drejtim edhe për arsyen ushtarake, që kinezët nuk e thonë, por e mendojnë, dhe këtu qëndron falsiteti i propagandës që shpjegon strategjinë e tyre: që Bashkimi Sovjetik është, në radhë të parë, një forcë e fuqishme tokësore. Sulmi që mund të ketë njëfarë efekti kundër Kinës, do të jetë në radhë të parë sulmi

që kësaj do t'i vijë nga kufijtë me Bashkimin Sovjetik, i cili ka një armatim të madh konvencional, por është i armatosur fort edhe me armë moderne, me bomba atomike, për të mos folur për flotën luftarake detare, e cila është zmadhuar e është forcuar, saqë u ka futur frikën edhe imperializmit amerikan dhe aleatëve të tyre anglezë, japonezë etj. Strategjia e revisionistëve sovjetikë është sundimi i botës, sundimi i deteve dhe shtypja e popujve.

Kina, pra, tash ka gjykuar se një sulm eventual mund t'i vijë më parë nga Bashkimi Sovjetik sesa nga imperializmi amerikan. Ky i fundit e kuption dhe e ka kuptuar vazhdimisht këtë situatë, pse në dy luftërat e para botërore, duke qenë i mbrojtur nga oqeanet, nga flota, nga armët që posedonte dhe nga fuqia e tij ekonomike, ka ndërsyer të tjerët të luftonin me njëri-tjetrin, të vriteshin, të shkatërrohen, dhe vetë të përfitonte më së fundi nga gjaku i huaj i derdhur. Pra, imperializmi amerikan gjithmonë ka nxitur të tjerët të luftonin që vetë të fitonte. Kështu bën edhe sot me Kinën; e ndihmon këtë që të forcohet dhe të luftojë kundër Bashkimit Sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund ta ndihmojnë Kinën edhe gjatë luftës, por, prapëseprapë, gjaku i popujve kinezë dhe sovjetikë do të derdhet, lufta mund të kthehet në një luftë botërore, siç u kthyen edhe dy luftërat e tjera të mëparshme, dhe, në aksham, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të ndërhyjnë, pasi të tjerët të kenë pësuar humbje shumë të mëdha dhe të kenë arritur fitore si ajo e Pirros.

Kina nga ana e saj ndjek strategjinë që të përfishtojë nga imperializmi amerikan, të mos i shpallë luftë Bashkimit Sovjetik, por të bëjë një politikë të atillë që të konsiderohet si arbitri botëror për të zgjidhur problemet. Për këtë gjë pikëpamja kineze bazohet në idenë e shtetit të madh, në madhësinë e kontinentit kinez dhe në popullsinë e madhe kineze. Natyrisht, kjo politikë bazohet edhe në forcën ekonomike dhe ushtarake që Kina mendon të krijojë gjatë kësaj periudhe; prandaj nuk është çudi që edhe Hua Kuo Feni, në qoftë se qëndron në fuqi, ose personi që do ta zëvendësojë më pas, të rekomandojë një politikë «urtë e butë» me të dyja superfuqitë. Domethënë Kina të mos i ketë më të acaruara marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, t'i ketë të mira ato edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, t'i përmirësojë pastaj më tej me Bashkimin Sovjetik, kështu që të marrë ndihma edhe këtej, edhe andej, për ta zhvilluar më në qetësi fuqinë e saj ekonomike dhe ushtarake. Është fakt që Kina aktualisht gjendet në një kaos politik, ekonomik dhe organizativ, i cili medocmos duhet rregulluar, ndryshe ajo do të jetë kurdoherë e dobët dhe në mëshirën e fuqive të mëdha.

**Kinës i duhet të forcojë ekonominë, sepse ekonomia kineze aktualisht nuk duket të jetë e fortë. Ajo ka pasuri të mëdha mineralc, por këto pasuri duhet të nxirren, të zhvillohen e të përpunohen. Edhe për sa u përket armatimeve Kina është e dobët, ajo ka me të vërtetë një numër bombash atomike, por, sikundër thonë specialistët amerikanë dhe ata të Evropës Perëndimore, Kinës do t'i duhen afro 20 vjet që të mund**

të arrijë armatimet ekzistuese të Bashkimit Sovjetik.

Prandaj, në këto situata, ka mundësi që ne të asistojmë në një kthesë të re të politikës së Partisë Komuniste të Kinës, dua të them në një strategji të re, të ndryshme nga të mëparshmet — nga strategjia e dikurshme: luftë, me Bashkimin Sovjetik në krye, kundër imperializmit amerikan; nga strategjia: luftë në të njëjtën kohë kundër imperializmit amerikan e social-imperializmit sovjetik, pastaj nga strategjia: të bashkuar edhe me imperializmin amerikan luftë kundër Bashkimit Sovjetik. Ka mundësi që kinezët të arrijnë në një strategji të re: paqe në të dy krahët, miqësi me Bashkimin Sovjetik, miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Siç po duket, një strategji të tillë kërkon të ndjekë dhe mund të arrijë Kina.

Natyrisht, ne kurrë nuk kemi për ta ndjekur Kinën në këtë rrugë, edhe sikur të mbetemi vetëm; por mendojmë se këto variacione të strategjisë kineze nuk do t'ia ngrenë asaj prestigjin në botë. Popujt dhe njerëzit përparimtarë në botë do të kuptojnë se Partia e Punës e Shqipërisë, parti e vogël, ka një politikë konsekuente të drejtë, të qëndrueshme, marksiste-leniniste, dhe se marksizëm-leninizmi është një teori e pagabueshme.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
-Shënimë për Kinën-,  
vëll. II, f. 413*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, -Shënimë për  
Kinën-, vëll. II, f. 413*

## **PËR PROBLEMET QË DO TË DISKUTOJMË, TË BËHEN STUDIME TË THELLA**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**17 janar 1977**

Pardje ju dërgova një material me disa vërejtje për projektplanin e çështjeve që është menduar t'i paraqiten Plenumit, Byrosë Politike dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë gjatë vitit 1977, meqenëse atje kishte disa gjëra që nuk kishin dalë mirë. Sigurisht, problemet janë po ato, por mendoj se është e nevojshme të bëhen disa rregullime.

Ajo që më shqetëson lidhur me këtë është se për problemet që do të marrim në shqyrtim gjatë këtij viti duhet të reflektohet më thellë. Më bënë përshtypje disa tema që propozohen në projekt, si, për shembull, studimi për përgjithësimin e përvojës së deritanishme të kooperativave të tipit të lartë dhe për perspektivën e zhvillimit të tyre. Kjo temë ka kohë që po qëndron në zyrat e shokëve që ndjekin këto probleme dhe ata e kishin lehtë për ta nderur në projektplan.

Përveç vërejtjeve që kam bërë për këtë temë, mendoj se ka probleme të tjera që janë shumë më të rëndësishme për kooperativat, si dhe për sektorë të tjerë të ekonomisë sonë. Në qoftë se të ardhurat e anëtarëve në disa kooperativa të tipit të lartë ose të zakonshme kanë arritur në një shkallë të tillë sa të kapërcejnë të ardhurat e punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore, atëherë kjo çështje duhet të na bëjë të reflektojmë. Mirëpo, nga raporti që është përgatitur për këtë problem, konstatojmë se nuk po mendohet thellë. Po të ndodhë kështu, anëtarët e këtyre kooperativave më vonë do të ngurrojnë që ekonomia e tyre të kthehet në ndërmarrje bujqësore (në kuptimin që prona e kooperativës të bëhet pronë e gjithë popullit), sepse në këto raste fillojnë të veprojnë interesat personalë dhe të grupit mbi ata të të gjithë shoqërisë. Prandaj jo pa qëllim e kam përmendur në material se ç'shkruan Stalini për këto probleme. Kanë rëndësi të madhe ato që thotë Stalini.

Mua më vijnë të dhëna se, duke pasur parasysh të ardhurat që marrin, disa shokë në kooperativat e tipit të lartë thonë që nuk kanë nevojë për ndihmë nga shteti, meqenëse kooperativat e tyre i përballojnë vetë investimet që u nevojiten. Një gjë e tillë, në sipërfaqe, duket si diçka e mirë, se gjoja kështu ato ndihmojnë shtetin. Por, në brendi, ky mendim, në radhë të parë, tregon se ka paqartësi politike dhe, së dyti, mund të ketë edhe përdorime jo të drejta të ndihmave materiale që shteti jep për këto kooperativa. Gjithashtu mendoj se këtu duhet të ketë edhe motive personale të nisura nga prona e grupit.

Ata që udhëhiqen nga të tilla pikëpamje mendojnë se kooperativa ka fonde të atilla që mund t'i investojë në sektorë të caktuar dhe nuk është e nevojshme, sipas tyre, t'u ndërhyjë shteti në këto punë. Dometënë, pjesëmarrjen e shtetit në ndihmë të këtyre kooperativave këta shokë nuk e kuptojnë si duhet. Po kështu ata nuk mendojnë as për anën ekonomike. Me mjetet financiare që kanë e që mund t'i investojnë, atyre do t'u duhet, për shembull, që drenazhimin ta bëjnë për dhjetë vjet, duke menduar se, krahas kësaj, me atë punë që bëjnë, sigurojnë edhe të ardhura të mira për ditë-punë. Ata parashikojnë që, edhe kur ta mbarojnë këtë punë pas dhjetë vjetëve, fjala vjen, përsëri mund të krijojnë vetë fonde të tjera. Mirëpo shteti socialist nuk mendon kështu. Ai është i interesuar që investimet, qoftë për drenazhimin, që solla si shembull, qoftë në drejtime të tjera, të përdoren në një kohë sa më të shkurtër për të marrë rendimente sa më të larta.

Duke u nisur nga këto shfaqje të pjesshme, dua të shpjegoj se problemet duhen parë më gjërë e më thellë, jo vetëm për sot, por sidomos për perspektivën. Kështu, në disa kooperativa të tipit të lartë vëmë re se ka edhe pikëpamje të tjera jo të shëndosha, veçanërisht lidhur me fondin e paprekshëm dhe me përdorimin e tij. Fondet e paprekshme janë përsëri të kooperativës. Ato do të investohen për tokën e për të gjithë zërat që asaj i nevojiten të zhvillojë, ta zëmë, për të mbjellë vreshta, dru frutorë etj. Të gjitha këto para, pra shpenzimet për këto investime, do t'i kthehen përsëri koo-

perativës. Atëherë, kështu duhet t'i kuptojmë e t'i analizojmë dhe jo t'i shohim në sipërsaqe. Këtu e kisha fjalën kur thashë se duhet menduar një çikë më thellë për këto probleme.

Mendoj, gjithashtu, se duhet rritur më shumë kujdesi për investimet që kryhen në kooperativa. Në qoftë se kooperativa mbjell vreshta dhe i trajton mirë ato, pas katër vjetësh ajo do të marrë rrush, nga i cili, duke e shitur, do t'i rritë më shumë të ardhurat e saj. Po kështu në qoftë se do të mbjellë blloqe me gështenja dhe këto t'i ruajë mirë që të sigurojë prodhime, ta zëmë, pas pesëmbëdhjetë vjetësh, përsëri të ardhurat do t'i rriten. Por në qoftë se gështenjat i mbjellin buzë rrugëve të fshatit, siç bëjnë shpesh, atëherë qysh vitin e dytë paratë mund të venë dëm: gropat vërtet do të jenë hapur, po gështenja ndoshta nuk do të ketë, se mund t'i kenë dëmtuar. Kështu, siç më kanë trenguar, në një rast, nga pakujdesia, ka ndodhur që të gjithë fidanët e gështenjave që qenë mbjellë i kishinngrënë dhitë.

Çdo vit, në kooperativat bujqësore krijohen të ardhura të konsiderueshme. Një pjesë e tyre, natyrish, ndahet për pagimin e ditëve të punës, një pjesë tjetër për investime etj. Si rezultat i masave të marra dhe i punës që bëhet, fondet e pagave të anëtarëve shtohen vazhdimisht. Pra, fshatari kooperativist po grumbullon të holla. Këto para ne duhet t'i mbulojmë me mallra. Kjo që po them, pavarësisht se mund të jetë e njojur, pse është thënë e është përsëritur herë pas here, duhet të shikohet me seriozitetin më të madh, sepse çdo pa-

kujdesi në këtë çështje është me pasoja të rënda. Duke ndjekur një politikë të drejtë, ne as kemi lejuar, as nuk lejojmë rrezikun e inflacionit. Kjo ndodh për arsyen: së pari, të forcës së Partisë, të punës dhe të vijës së saj dhe, së dyti, për arsyen të patriotizmit të fshatarësisë sonë, që ka besim në shtetin e vet. Pra, ky është një problem i rëndësishëm. Kartmonedha ekzistuese duhet të mbulohet me mallra qarkullimi dhe të mos rrijë në xhepin e fshatarit.

Konstatojmë se në disa kooperativa bujqësore dëgjohen zëra që thonë: «Më parë ne merrnim 13 lekë, pastaj 14 lekë, tani marrim nga 15 lekë për ditë-punë. Mirëpo tani punojmë më shumë dhe marrim rendimente më të larta. Atëherë, do të mbetemi përsëri me nga 15 lekë për ditë-punë?». Kuptohet, këto fjalë ata ia thonë Partisë, prandaj ato duhen vlerësuar. Partia të mendojë seriozisht për këtë gjë. Nesër fshatari, shokë, do të marrë edhe më shumë.

Për këto ne duhet të reflektojmë duke pasur mirë parasysh ato që thotë Stalini lidhur me çmimet e prodhimeve bujqësore. Deri tash shteti ynë ka bërë gjithë ato investime për rritjen e prodhimeve bujqësore. Fshatarit i paguajmë për krasitjen e ullinjve, për bërjen e brezareve; kemi ulur çmimin e plehut kimik etj. Edhe shpenzimet për shërbimet e SMT-së ose i kemi ulur, ose i kemi mbajtur në të njëjtin nivel. Shteti ka përballuar, gjithashtu, të gjitha shpenzimet për bonifikimin e fushave dhe u paguan kooperativave një pjesë të shpenzimeve për hapjen e tokave të reja. Pra, krahas punës së kooperativistëve, janë edhe gjithë kë-

to shpenzime të shtetit që kanë bërë të mundur të rriten rendimentet në kooperativat bujqësore. Megjithatë çmimin e drithit e kemi lënë atje ku ka qenë, njëloj si në kohën kur merreshin rendimente më të ulëta. Domethënë, edhe tash, kur ka kooperativa që marrin gjashtëfishin e prodhimit në drithëra, në sajë të shërbimeve e të të gjitha mundësive të tjera që ka krijuar pushteti populor, natyrisht edhe të punës së fshatarit, çmimi i drithrave është po ai që ka qenë vite më parë. Kjo duhet t'u bëhet e qartë kooperativistëve.

Këto janë probleme financiare dhe ekonomike që kanë të bëjnë me planin në tërsi. Nuk do të anulojmë çka kemi vendosur të bëhet në ndihmë të kooperativave. Nuk do të ngremë çmimet e plehrave etj., etj. Jo, këtë nuk do ta bëjmë, por mendoj se është koha ta studiojmë problemin e ta zgjidhim në atë mënyrë që të mos frenohet rritja e prodhimit. Kooperativistëve t'u thuhet, për shembull, se atyre do t'u jepet edhe diçka më shumë, kurse pjesa tjetër e të ardhurave do të përdoret për të zhvilluar ekonominë. Pra, t'ia bëjmë të qartë problemin fshatarësisë. Asaj i nevojiten produkte industriale, ushqimore dhe shumë gjëra të tjera, por edhe shtetit i duhet të ndërtojë fabrika, dhe përkëtë do të detyrohem i të shesim një sasi misri jashtë, fjala vjen, që të sigurojmë valutën që do të na nevojitet për t'i blerë këto fabrika etj., etj. Po të bëhen sqarime të tilla, atëherë kooperativistët me siguri do ta kuptojnë drejt dhe do ta aprovojnë këtë rrugë që ndjek Partia. Ne duhet të punojmë që ata ta kuptojnë mirë këtë gjë,

se shteti deri tani ka marrë gjithë ato masa, i ka bërë gjithë ato favore fshatarësisë etj., etj. Po ku i ka gjetur ai mundësitë financiare? Vërtet fshatarësia ka punuar shumë e ka prodhuar më tepër, por edhe shteti e ka organizuar dhe e ka kullandrisur ekonominë socialiste në mënyrë të tillë që ka nxjerrë prej saj të ardhura, ka krijuar fonde monetare dhe mjete të tjera që kanë dhënë mundësi për t'i bërë fshatarësisë gjithë këto favore që përmendëm dhe që të gjithë i shohim me sy. Dhe te ne kjo është një ligjësi, prandaj fshatarësia kooperativiste, me punën e saj dhe me ndihmën e madhe që po i jep shteti, çdo ditë shkon më përpara.

Po t'i shpjegohen kështu këto çështje fshatarësisë, nuk do të zënë vend ato koncepte që thamë lidhur me investimet. Përkundrazi, shteti do t'i thotë tani kooperativistit: «Po punove dhe po prodhove më shumë, nuk do të marrësh 13 lekë, po 17 lekë, dhe, sa më shumë të prodhosh, aq më shumë do të marrësh. Por edhe shteti duhet të sigurojë më shumë fonde. Pse? Sepse në këtë mënyrë ai do të jetë në gjendje të krijojë mundësinë që kooperativistët t'i harxhojnë lekët e jo t'i mbajnë në xhep, sepse leku në xhep nuk ka asnje vlerë. Prandaj mendojmë t'i marrim këto masa, se duam të sigurojmë, veç të tjerash, edhe mallrat që do të blejë fshatari». Sigurisht, këto nuk janë kaq të thjeshta. Për problemet që do të diskutojmë të bëhen studime të thella.

Lidhur me këtë Qeveria nuk duhet të shikojë vetëm nëse u realizua apo jo plani, por të interesohet një çikë edhe për çështje të tilla, sepse këto nuk janë vetëm

për bujqësinë e për fshatarët, por edhe për qytetarët. Edhe këta kanë të holla në arkat e kursimit, bile më shumë se fshatarët. Kjo tregon që, si fshatarët, edhe qytetarët nuk kanë nevoja të ngutshme për të harxhuar rezervat monetare që kanë grumbulluar në arkat e kursimit. Ata presin të dalë diçka e re që nuk ndodhet në shtëpitë e tyre, sepse sendet e nevojshme tashmë secili pak a shumë i ka siguruar. Domethënë, qytetari edhe fshatari, aktualisht, më 1977, nuk është më ai i vitit 1948, 1949 apo i vitit 1950. Situata ka ndryshuar krejtësisht. Këtë ta kemi mirë parasysh.

Bisedova një ditë me shokun Adil [Çarçani] edhe për çështjen e kontrollit të preventivave, të normave të planifikimit të materialeve të Ministrisë së Ndërtimit etj. Ai më tha se paraprakisht 20 për qind e të gjitha këtyre janë të tepërtë. Ne duam që kësaj pune t'i shkohet deri në fund, por duket se ata po e studiojnë këtë problem. Mirë që po e studiojnë ata, po ne çfarë do të bëjmë? Do të rrimë me duar lidhur? Ç'bëjnë këtu te ne në aparat shokët që merren me ndërtimet? E kontrollojnë ata këtë gjendje apo nuk e kontrollojnë? Ky është një nga problemet më të rëndësishme, për të cilin, siç e dini ju, unë kam bërë edhe vërejtje. Por në planin e punës që po diskutojmë është harruar sektori i ndërtimit, i cili është një «lubi» që na përpin pjesën më të madhe të buxhetit shtetëror. Ç'po bisedojmë këtu së bashku çdo ditë? Është e vërtctë që kostoja në ndërtime ka ardhur duke u ulur, por shokët janë, gjithashtu, në dijeni edhe për ato ngjarje të padëshiruara që na kanë ndodhur në këtë sektor.

Nga informacionet që më vijnë del që gurin për ndërtimet e Tiranës e kanë marrë në malin e Dajtit. Punimet atje u ndaluan, me qëllim që të mos prishet pamja e bukur e Dajtit. Ky është një vendim i drejtë. Po atëherë, pse të shkohet nga Tirana deri në Krujë për të marrë gurë për ndërtime e jo në ndonjë vend tjetër që është më afër? Se karrierën e gjetën të gatshme, pa sa për transportin, për shpenzimet hekurudhore dhe për automjetet, aq u bën disave. Të tilla gjëra nuk duhen lejuar. Prandaj të ushtrohet kontroll i fortë e i vazhduese shëm në të gjitha drejtimet dhe jo thjesht të na sillen informata këtu lart.

Porosita që të ngrihen komisione me financierë e me ekonomistë, të cilët t'i studiojnë këto çështje. Vitet kalojnë dhe një situatë e tillë nuk mund të zgjidhet duke thënë se akumulimi në kooperativat është i vogël, se në fakt ky është i madh. Bile, akumulimi do të vijë duke u rritur pas 4, 5 apo 10 vjetëve. Atëherë del problemi se ç'do të bëjmë me gjithë këtë akumulim. Thuhet se «do të investojmë», po ku dhe si, sepse kërkohen materiale, njerëz, vend, fidanishte, si dhe shumë gjëra të tjera. Të gjitha këto probleme duhet të përbëjnë objektin e një studimi e të një llogarie sa më të përasfërt nga çdo ministri, veçanërisht nga Ministria e Financave e Komisioni i Planit të Shtetit.

Në projektplanin e çështjeve që do të shqyrtohen gjatë vitit është vënë edhe administrimi e përdorimi i lekut. Por, në qoftë se ata që do të përgatitin materialin kanë ndër mend të na paraqitin gjëra që i dimë, kjo nuk ka vlerë për ne. Prandaj mendoj që të gjitha këto

studime duhen bërë para se problemi të analizohet në Byronë Politike. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të gjykojmë drejt dhe të shohim, për shembull, se a duhet t'i ulim çmimet e grumbullimit të prodhimeve apo jo. Kooperativisti nuk do të mbjellë, fjala vjen, patate, pse çmimi i saj mund të jetë i ulët. Atëherë në vend t'ia ulim, ne mund ta ngremë diçka çmimin e patates dhe nxitim kështu rritjen e prodhimit të saj ose të zarzavateve të tjera, që të na shtohen. Tregut kështu do t'i shtohen zarzavatet, edhe buka do të konsumohet më pak, pra do të kurschet drithi.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Kështu krijojmë edhe mundësi për të eksportuar më shumë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, ashtu është, në këtë mënyrë rriten edhe mundësitë e eksportit. Prandaj kjo çështje, që solla si shembull si dhe të tjera si kjo, duhen menduar një çikë më thellë, se, në materialin që thashë, na janë vënë problemet varg njëri pas tjeterit, por jo si duhet. Kjo gjë ka ndodhur edhe herë të tjera me projektplanin e çështjeve, i rregullojmë disi këto në tremujorin e parë dhe pastaj në muajt e tjerë na thuhet: «Ja, këto probleme janë!». Po si u përgatiten këto? A janë vallë të kohës apo jo? Si u bë studimi për to? Sa ekipe u organizuan për problemet në fjalë? Për të gjitha këto çështje nuk tregohet gjithmonë preokupacioni i duhur.

Pra, mua më duket se duhet vepruar më mirë para se problemet të na paraqiten për t'i shqyrtauar dhe jo me ç'të na kujtohet. Duhet vrarë mendja se ç'do të vë-

më në projektplan. Kështu siç është përgatitur ai, ka gjëra që duhen ndrequr.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Një çështje që e kemi studuar dhe e kemi paraqitur edhe në Byronë Politike, është niveli i jetesës. Por ne kemi parë vetëm një aspekt të këtij problemi, atë që fshati ka një nivel jetese më të ulët se qyteti. Duke u nisur nga kjo, kemi marrë gjithë ato masa që ju thatë më lart, me qëllim që të inkurajojmë fshatarësinë në punë e të ngrihet niveli i jetesës së saj. Mirëpo harruam anën tjetër, atë që sot po na ngrini ju. Prandaj duhet, siç thoni ju, që ta shikojmë në kompleks problemin, se mirë i bëmë këto, po ç'do të sjellë kjo? Ose, e dyta, ju përmendët atë që ka thënë Stalini për çmimet. Mua më kujtohet që ju e keni ngritur edhe tre vjet përpara këtë çështje, që duhet bërë një studim, në përgjithësi, për politikën e çmimeve. Mirëpo armiqjtë Abdyl Këllezi e Kiço Ngjela nuk donin t'i hynin kësaj çështjeje, me siguri për rrjedhimet e këqija që mund të sillte moszgjidhja e këtij problemi, se ata donin të krijonin situata të vështira në vend.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ky problem nuk zgjidhet në atë mënyrë siç mendojnë shokët e Qeverisë. Ky nuk është një problem thjesht organizativ, se çmimet i cakton Qeveria, komiteti ekzekutiv etj. Nuk është kjo politika e çmimeve.

Në përgjithësi ne e kemi ndihmuar mjaft fshatarësinë. Po të mos ishin dhënë tërë këto ndihma, nuk do të ishin arritur rezultatet që kemi. Mirëpo tashti që është krijuar një situatë e favorshme në prodhimin e grurit

e në disa bimë të tjera, rendimentin e tyre duhet ta stabilizojmë. Rritjen e rendimenteve ta kuptojmë mirë. Kjo ka ardhur nga vija e drejtë politike e Partisë, nga masat e përgjithshme që kanë marrë Partia e pushleti dhe, natyrisht, edhe nga puna e vetë fshatarësisë 'koperativiste, sepse ajo ka luajtur dhe luan rol vendimtar. Prandaj ngritja e rendimenteve ka ardhur nga gjithë këta faktorë.

Problemi duhet parë medoemos në të gjitha aspektet. Ishte kjo arsyjeja që propozova të punohen në atë formë materialet e Kongresit: të raportohet, të zbërthehen problemet e mëdha kyç që përokupojnë Partinë, dhe për to të flasin njerëzit më kompetentë, të cilët duhet të udhëzohen mirë nga Partia se ku të godasin.

Pavarësisht se vendosem një mënyrë të tillë punimi të materialeve të Kongresit, përgatitja e deritanishme për zbërthimin e problemeve që trajtohen në raportet e tij mendoj se akoma nuk është në nivelin e duhur, pse ata që po merren me këtë punë, nuk po u futen mirë çështjeve. Po të jenë shokët e Partisë në kontakt të ngushtë me bazën dhe me njerëzit, atyre do t'u dalë një mori çështjesh e problemesh. Kjo kërkon që të arrihet në konkluzione, të cilat duhet t'i shqyrtojë komiteti i Partisë dhe t'ua thotë specialistëve që t'i zbërthejnë e t'i konkretizojnë ato me zotësinë e përgatitjen e tyre politiko-organizative e teknike. Çështje të tilla, si cilësia, sasia, punimet e ndryshme, kontrolllet që bën shteti, fondet që ka, investimet që duhet të bëjë etj., duhet t'i kuptojnë mirë punëtori e fshatari. Mendoj që forma se si do të bëhet kjo është gjetur

mirë. Ne themi që këto çështje duhet t'i studiojmë me specialistët dhe kjo është e drejtë. Por të kemi para-sysh se një sërë studimesh të tillë janë bërë edhe nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, nga Akade-mia e Shkencave, si dhe nga vetë komitetet e Partisë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kur vijnë për kon-sulta, na i paraqitin edhe neve materialet për të dhënë mendime.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Neve na vijnë ma-te-riale edhe kur bëhen sesione shkencore.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë kur bëhen sesione shkencore, por edhe kur nuk bëhen të tillë, materiale na vijnë këtu. Këto duhen përdorur më mirë. Më vjen mua një material, për shembull, për luftën e klasave, hajde ta studiojmë e të marrim masa për ta vënë atë në shërbim të punës së Partisë. Deri tani si zor të jetë bërë një gjë e tillë në mënyrë të vazhdueshme. Pra nuk është punuar ashtu si duhet për të studiuar pro-bлемet e për t'i zgjidhur ato. E kam fjalën që duhet të bëhen edhe në bazë studime të tillë, sepse atje situatat janë më të ndërlikuara dhe pikërisht janë baza, pro-dhimi që do të vërtetojnë drejtësinë ose jo të një ven-dimi që është marrë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga bisëda e incizuar, që gjendet në AQP*

## **TE ARDHURAT E KOOPERATIVISTEVE SHTOHEN DUKE RRITUR PRODHIMIN**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**28 janar 1977**

**SHOKU PROKOP MURRA:** Isha në Batër të Martaneshit, në Bulqizë dhe për pak kohë në Peshkopi. Ndërmarrja Gjeologjike që punon në zonën e Matit dhe të Peshkopisë është shumë e përhapur. Perspektiva në jug të Bulqizës, atje ku ajo lidhet me Batrën, është e mirë. Kjo do të thotë se po zgjerohet horizonti i njoftues së zonës ku shtrihet minerali.

Unë pashtë disa sonda që shpojnë me diametër të vogël, por që për shkak të mungesës së tubave që duhen për shpim, i kanë lënë dy-tre vjet pa i përdorur. Kështu që zbulimet në thellësi, në zonën e Batrës dhe të Bulqizës, kanë ngecur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ka mundësi që këta tuba të jenë në depot e Portit apo të bazës grosiste të Durrësit. Të kam dhënë një material ty, Hysni, të cilin shokët e Këshillit të Ministrave do ta marrin në ana-

lizë në mbledhjen e Qeverisë. Nga sa pashë, në këtë material theksohet se në Portin e Durrësit kanë ardhur me dhjetëra mijë tonë tuba e asnjeri nuk interesohet për tërheqjen e tyre sipas destinacionit në vendet ku do të përdoren.

Sigurisht që porositë prej këtej nga ministritë janë bërë. Materialet që kanë ardhur, pra edhe tubat, janë të nevojshme, por lënia në depot e Portit të Durrësit e të bazës grosiste, mosinteresimi për tërheqjen dhe futjen e tyre në përdorim atje ku lypsen, në një kohë kur kemi aq shumë nevojë për to, do të thotë shqip të dëmtosh rëndë ekonominë, në mos edhe më keq akoma. Me krijimin e ndërmarrjeve ndërministror<sup>1</sup>, që u bënë si mbretëri më vete, nuk është çudi që edhe tubat për ato sonda të jenë në depot e bazës grosiste apo të Portit të Durrësit. Jo vctëm këto, por edhe shumë makineri e pajisje të tjera që kërkohen mund të jenë në Durrës. Ata që i presin, nuk shkojnë të interesohen për to në Durrës, po kërkojnë që Ministria e Tregtisë t'ua çojë perin deri në vrimën e gjilpërës, si i thonë fjalës, sepse e tillë ka qenë metoda e punës që është zbatuar deri ca kohë përpara në këto ndërmarrje. Bile, mund të ketë ndodhur edhe që të ketë shkuar ndonjë tjetër e të ketë marrë edhe nga ato materiale që nuk i përkisnin atij. Kur s'ka rregull në të tilla ndërmarrje, patjetër që edhe kështu mund të ndodhë.

---

1. Është fjalë për drejtoritë e përgjithshme të kromit, të bakrit etj., që u krijuan nga Koço Theodhos i Abdyl Këllezi, por që më vonë u suprimuan.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kooperativat bujqësore, si në Dibër edhe në Mat, kanë njëfarë rritjeje të prodhimeve dhe të të ardhurave. Por, me thënë të drejtën, në kooperativa më duket se është akoma e dobët gjendja financiare dhe kontrolli me anë të lekut, sidomos në rrethin e Matit, ku disa kooperativa nuk duhet të marrin më paradhënie nga banka, se të ardhurat e tyre vjetore nuk e mbulonin dot atë sasi lekësh që ua kishin shpërndarë anëtarëve gjatë vitit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shteti duhet të ushtrojë kontroll për përdorimin e fondeve e për shpërndarjen e lekut dhe të ndalojë kryerjen e veprimeve të paligjshme. I hipën në kokë një drejtuesi që t'u japë anëtarëve të kooperativës 20 lekë për ditë-punë dhe këta t'i paguajë shteti, pavarësisht se nuk i shlyhen dot me prodhimet e kooperativës! Jo, nuk duhet të lejojmë raste si këto për të cilat po flasim, kur paratë i marrin nga shteti dhe nuk realizojnë të ardhurat apo i bëjnë ato rrush e kumbulla, si i thonë fjalës, për të mos thënë se i vjedhin, se s'ka si shpjegohet ndryshe. Derisa nuk është produhar grurë, do të thotë që nuk është punuar, mirëpo pagën ama, megjithëkëtë, kooperativistët e kanë marrë. Nga kush e kanë marrë? Nga shteti. Kështu është realiteti. Këto kooperativa nuk kanë dhe në fakt nuk duhet të kenë fond rezervë, se po të kishin, duhej ta përdornin për pagimin e borxheve që i detyrohen shtetit. Pra, nga këto shkelje të ligjeve e të rregullave del që shteti mban me rrogë edhe anëtarët e kooperativave që nuk realizojnë të ardhurat. Si është e mundur të ndodhë kjo kështu? Nuk e kuptoja, çfarë bën

banka? Si ka mundësi të ndodhin të tilla gjëra dhe ajo të mos veprojë? Pastaj a bëhet llogari se ç'deformime, ç'dëme pëson ndërgjegjja e njërzëve nga këto veprime?! Shkeljet e parimeve socialiste kanë reperkusione të mëdha. Nuk është aspak e rregullt që kooperativa të hajë paratë e shtetit për vite të tëra dhe të mos mobilizohet të prodhojë. Jo, shokë, këto janë veprime të dënueshme! Nuk mund të lejohen gjëra të tilla jashtëzakonisht të rënda në administrimin e pasurisë shtetërore. Dhe flasim pastaj për kontrollin me anë të lekut!

**SHOKU PROKOP MURRA:** Shokët, atje ku isha, më thanë që u kishin vajtur të dërguar edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës. Por që të venë ata atje e të mos shohin këtë situatë, ose ta shohin e të mos bëjnë zë, kjo është e pakuptueshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E po atyre nuk u dhimbisen lekët që harxhohen pa të drejtë, se kreditinë kooperativës nuk ia japid punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme apo të Bankës Bujqësore që venë atje, por ia jep shteti. Janë të shtetit ato para e nuk janë të atyre që t'u dhimbisen.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Banka duhet të kontrollojë realizimin e planit në çdo tremujor. Po që se nuk realizohet plani nga kooperativa, banka duhet ta paralajmërojë dhe të mos i japë kredi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, ashtu është. Në këtë rast banka nuk duhet t'i japë kredi kooperativës dhe s'ka asnje detyrim. Kooperativa të realizojë detyrat që t'i përgjigjet banka. Nuk duhet të veprohet ndryshe me fondet e shtetit. Vetëm në qoftë se koope-

rativa derdh në bankë lekë nga të ardhurat, banka do t'i japë paradhënie e kredi. Kështu duhet të ndodhë dhe jo e kundërtë, se, përndryshe, kooperativistët nuk nxiten të punojnë. Veçse kjo çështje duhet parë me kujdes, sepse kooperativa mund të mos ketë prodhime në çdo tremujor e, për pasojë, banka nuk ka si ta ndjekë realizimin e planit në këto periudha. Por, ama, kur vjen puna te gruri apo te ndonjë prodhim tjetër dhe konstatohet se ky nuk është i mbarë, atëherë shteti, me anë të organeve financiare e bankare, u tërheq vëmendjen kooperativave se duhet ta bëjnë më mirë punën që të sigurojnë të ardhurat për të shlyer fondet që u ka dhënë shteti si paradhënie. Nëse plani nuk është realizuar, atëherë shteti për grurin që grumbullon nuk i paguan asnjë lek më tepër kooperativës. Ndërsa, kur kooperativa merr më shumë të ardhura, pra kur grumbullohen më shumë fonde monetare nga prodhimet që merr kooperativa, edhe i paguan bankës ato që i ka marrë si kredi apo për paradhënie, edhe mban një pjesë për fondin e paprekshëm, edhe u ndan anëtarëve të ardhurat sipas ditë-punëve që kanë bërë.

Pra, siç thashë edhe më parë, duhet të bëhet medemos kontrolli i lekut, pse për këtë çështje është marrë edhe një vendim nga Komiteti Qendror. Banka, si institucion shtetëror, nuk duhet të mjaftohet vetëm me atë që të përgatitë pakot me para për t'i thënë koooperativës: «Urdhëro, më hidh një firmë këtu, që unë të jem në rregull, pastaj ti bëj ç'të duash me to», por të thotë: «Unë, si shtet, do të të jap ty këto fonde dhe, kur ti të kesh bërë punën, do të vij të të kontrolloj nëse

punimet për mbjelljen e pemëve dhe për ndërtimin e vetulloreve për ullinjtë, për të cilat shteti ka dhënë paratë, i ke kryer si duhet apo jo».

Ndihma financiare që jep shteti për fuqizimin e kooperativave duhet kontrolluar medoemos se si përdoret. Dhe ky kontroll të bëhet jo vetëm nga banka, nga shteti dhe nga organizata e Partisë e fshatit, por edhe nga kontrolli punëtor e fshatar, i cili të vejë të shohë nëse kooperativa i ka kryer punët për të cilat janë dhënë ato fonde apo jo. Vetëm pasi të jetë bërë ky kontroll, banka t'i japë para të tjera kooperativës, ndryshe asnë pagesë nuk duhet lejuar.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Këto që thoni ju, shoku Enver, janë të drejta, por duhet t'ua themi dhe t'ua bëjmë të qarta kooperativistëve që në fillim të vilit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sigurisht që duhet t'ua themi. Do t'u themi atyre që ju, shokë kooperativistë, duhet të punoni që të hani; do të punoni me ditë-punë dhe banka do t'ju paguajë me ditë-punë. Shteti do t'ju japë kredi në të holla, një paradhënie, por ju duhet t'i realizoni detyrat dhe, kur të inkasoni të ardhurat tuaja nga prodhimet e realizuara, qoftë në tre muaj ose qoftë në gjashtë muaj, banka do t'i mbajë të hollat që ju ka dhënë. Pas gjashtë muajve, në qoftë se nuk e keni realizuar planin si duhet, pra nuk keni siguruar të ardhura, kur të bëhen llogaritë, nuk do të merrni asnë lek më tepër. Punoni, prodhoni dhe siguroni të ardhura që të nxirri para, ndryshe ku do t'i gjejmë? Si mund të sigurohen të holla pa punuar e pa realizuar prodhimin?

Pra, siç vutë ju në dukje, në praktikë ka shtrembe-rime të tilla. Ç'bëjnë organet financiare, bankare etj. për eliminimin e tyre? Çfarë bëjnë seksionet e financës në rrethe dhe vetë degët e financës pranë kooperativave? Unë këtë nuk e kuptoj dot, shokë. Praktika që është vërtetuar në këto raste nuk është aspak socialiste. Shteti vërtet ndihmon kooperativat bujqësore me kreditë që jep, por kjo duhet të nxitë kooperativistët të punojnë sa më shumë, sepse do të shpërblehen nga puna që bëjnë në kooperativë dhe jo nga shteti. Kjo që ndodh po më çudit dhe unë me të drejtë shtroj pyetjen: Ç'bëhet kështu?

Kooperativave ne u japim kredi nga banka edhe për të bërë investime, dhe nëse ato nuk i përdorin këto investime, për të cilat kanë marrë kredi, kjo do të thotë se po e dëmtojnë rëndë kooperativën. Veprime të tilla janë antishtetërore, antisocialiste, që çojnë në dobësimin jo vetëm të kooperativave, por dhe të shtetit socialist. Prandaj duhet të merren sa më parë masa të rrepta që këto shtremberime të eliminohen e të vihen gjërat drejt në vend. Për mendimin tim, këtë problem duhet ta shtroni në Qeveri, por unë mendoj që mund ta shtrojmë edhe nesër në mbledhjen e Byrosë Politike. Ne nuk mund të lejojmë të veprohet jashtë vijës së Partisë e kundër ligjeve të shtetit, duke i shkelur ato; nuk mund t'i bëjmë lëshime kurrikujt. Ne vijën e Partisë e kemi të drejtë dhe ajo është e qartë për të gjithë. Fshatari, si tërë punonjësit e tjerë, duhet të punojë, të japë prodhime: aq sa do të japë, aq edhe do të marrë. Egalitarizmin nuk e ka lejuar Partia. Te ne

sipas punës është edhe shpërblimi, rrugë tjetër nuk lejohet. Në qoftë se kooperativisti merr 13 lekë në ditë dhe nuk punon që të nxjerrë as 5 lekë prodhime për ditë-punë, atëherë duhet të merren masa për ta ndrengur sa më parë këtë gjendje. Në këto çështje nuk duhen bërë lëshime. Gjithashtu nuk duhet të shkojmë nga pikëpamja se, meqë këto kooperativa i kanë shumë borxhe e kredi të pashlyera shtetit, hajde t'ua falim tashti. Ç'do me thënë kjo?

Unë nuk flas për ata që i kryejnë detyrat dhe që zbatojnë mirë ligjet e rregullat e vendosura për kooperativat bujqësore dhe ligjet e shtetit. Flas për rastet kur nuk punohet mirë dhe bëhen lëshime të palejueshme, siç ka ndodhur në kooperativat që u përmendën këtu.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kooperativistët, shoku Enver, mund të mos e kenë ditur mirë që kanë dalë keq, sepse paratë ata i kanë marrë më përpara.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E kanë ditur, shoku Prokop, bile edhe anëtarët e Partisë, që punojnë në këto kooperativa, e kanë ditur fare mirë gjendjen e realizimeve të kooperativës dhe të borxheve që kanë ndaj shtetit. Por çështja është se ka nga ata komunistë që nuk janë të formuar si duhet dhe kërkojnë të përfitojnë në rrugë jo të drejtë në kurriz të shtetit. Kjo vjen ngaqë ata kanë akoma të rrënjosur në ndërgjegjen e tyre ndjenjën e pronës private e të rehatisë personale. Të tillë komunistë nuk janë bindur plotësisht se tokës, siç thotë populli, duhet t'i nxjerrim vaj. Komiteti i Partisë i rrethit nuk bën hiç mirë që tororitet me këto

organizata. Me sa duket nuk ushtrohet mirë kontroll në punët e kooperativave, sa prodhojnë e si i realizojnë planet. Kontrolli, sidomos ai i Partisë, është i domosdoshëm, që të shihet si zbatohen orientimet e direktivat e saj. Nga ana tjetër, duhet parë mirë se në prodhimet e kooperativës vihet dorë nga persona të pandërgjegjshëm, ashtu siç ka edhe nga ata që livadhisin apo që e marrin rrogën pa bërë punën.

Po nivelin e jetesës si e kanë familjet në këto kooperativa?

*SHOKU PROKOP MURRA:* Për të jetuar, jetojnë mirë, se kanë ndonjë pjesëtar të familjes në punë shtetërorc.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pra, megjithëse të ardhurat nga kooperativa janë të vogla, të ardhurat e përgjithshme, si familje, në fakt janë të mira.

Një çështje tjetër që duhet parë me vëmendje është ajo e caktimit të përqindjes që jepet si paradhënie, në bazë të planit të prodhimit. Puna qëndron këtu: Në qoftë se shteti nuk është i sigurt që kooperativa do ta realizojë planin, atëherë t'i japë kooperativës një përqindje të caktuar të të ardhurave të pritshme që mund të arrijë deri në 50 për qind të vlerës së ditës së punës. Kjo do të thotë se banka duhet t'i qëndrojë afér kooperativës, për arsy se të ardhurat asaj nuk mund t'i llogariten me saktësi qysh më parë. Ato janë ende në letër. Në qoftë se kooperativistët punojnë, ata do të marrin më shumë. Në qoftë se nuk punojnë, nuk do të marrin. Shteti ndihmon në këto raste çdo muaj, por vetëm për gjërat më të nevojshme të jetesës. Për sa

u përket nevojave të tjera, anëtari duhet t'i përballojë një pjesë me të ardhurat e oborrit kooperativist dhe të tjerat me paratë që merr në fund të vitit. Këtu kërkohet edhe një ndjekje dinamike e problemit. Në qoftë se shteti ka parë që për një vit ose për dy vjet kooperativa ka realizuar prodhimet e të ardhurat, atëherë i jep paradhënie në masën 70 për qind të vlerës së ditës së punës. Në qoftë se kooperativa është fuqizuar e është stabilizuar dhe ka edhe fond qarkullues, edhe fond të paprekshëm, fond për investime etj., atëherë shteti në këtë rast ka siguri dhe i jep paradhënie deri në masën 80 për qind të vlerës së ditës së punës, por me kusht që në fund të vitit kooperativa t'ia kthejë këtë borxh, ndryshe ai vë dorë mbi fondet e saj. Këtë ta dijë mirë kooperativa.

Nga të gjitha sa thamë del se Partia dhe shteti duhet të bëjnë një kontroll të vazhdueshëm për këto probleme. Në qoftë se komiteti i Partisë, fjala vjen, ka në rrëthin e vet katër kooperativa që nuk kanë as fond rezervë, as fond qarkullues, që edhe nga shteti 70 për qindshin e kanë marrë dhe tash, si i thonë fjalës, dalin në diell, atëherë duhet të shikojë me se i kanë blerë anëtarët radiot, televizorët, artikujt e tjerë, se për këta duhen para. Pra ku i kanë gjetur paratë, derisa nuk realizuan të ardhurat si kooperativë? Kjo do të thotë se kooperativa u ndan anëtarëve paratë që merr nga shteti. Një gjë e tillë nuk duhet të llojohet.

Për sa i takon rezervës së prodhimeve bujqësore që duhet të mbahet, për të cilën u fol këtu, të bëjmë kujdes që ajo të mos preket sipas qejfit. Por, siç na tre-

goi Prokopi, na del se po preken edhe paratë e popullit sipas qejfit e jo më rezervat. Kjo është çështja e parë që kisha për rezervat.

E dyta është çështja që kjo rezervë duhet të sigurohet, të mirëmbahet. E ngrë këtë se nuk bëhet kudo kujdes për ruajtjen e mirëmbajtjen e prodhimit. Kemi informata jo vetëm për atë që thatë ju, për në Dibër, shoku Prokop, por edhe në të dalë të Ksamilit e në Çukë kishin parë misër të zhveshur të hedhur e të lënë në ujë e në baltë dhe pa rojë fare. Prandaj thashë që kjo rezervë që mbajnë kooperativat duhet të ruhet me shumë kujdes.

E treta, kur është fjala për misër kalli, për ruajtjen e mbajtjen mirë të tij nga kooperativa, duhet të ndërtohen koçekë, sepse në qoftë se do të mbahet në-për shtëpitë e anëtarëve, atëherë, javash-javash, një mëngjes, në vend, ta zëmë, të 10 mijë kuintalëve që janë rezervuar në fillim, do të gjesh 5 mijë. Është flori ky, është bukë, prandaj për ruajtjen e mirëmbajtjen e tij duhet të ushtrojmë kontroll të fortë nga të katër anët. Këto që përmenda më sipër, po të mos bëhet kujdes, këtu të çojnë. Për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rezervave duhet menduar më thelli.

Për sa i përket çështjes që kooperativat të mbajnë rezerva deri në pesë muaj, nuk ka ndonjë gjë të keq, kjo mendoj se nuk na hap ndonjë problem, sepse rezerva është e matur. Pra, dihet sasia e saj derisa të vijë prodhimi i ri.

Çështja tjetër që shtrohet është që kjo sasi rezervë do të ishte mirë t'i dorëzohet shtetit që ta adminis-

trojë ai. Por, po u bë kjo, kooperativës duhet t'i japësh paratë për të, dhe këto para, pastaj, duhet medoemos të mbulohen me mallra të tjera, nga ato që ka nevojë fshati.

Dihet se fondet në kooperativa shtohen, sepse, sa kohë që kooperativa shet prodhimet, këto para janë të sajat, domethënë këto bëjnë fondin e paprekshëm të kooperativës. Vihet pyetja: Përse lihet ky fond? Ai lihet për investime, ndryshe nuk ka kuptim, veçse ta tërheqë shteti. Mirëpo në bankë ky fond është në emrin e kooperativës, domethënë u përket kooperativistëve. Pra kooperativa e ka këtë fond që të bëjë investime, pse ajo duhet edhe të investojë dhe fushë investimi ka sa të duash në bujqësi. Veç investimeve që bën kooperativa, investime në bujqësi bën edhe shteti dhe, si pasojë e këtyre investimeve, paraja do të vejë të grumbullohet tek individët, tek anëtarët e kooperativave. Atëherë, nga ana e shtetit kjo para, që të thithet, medocmos duhet të mbulohet me mall. Ndërsa, në qoftë se këtë para e mban banka në formë fondesh, ne kemi avantazhin që atë para mund ta qarkullojmë. Me këtë shtesë fondesh mund të çelen përnjëherë fronte të reja pune, të cilat, në mos sivjet, pas katër-pesë vjetëve do të çojnë në shtimin e prodhimit, pra dhe të grumbullimit të parave prapëseprapë në duart e kooperativistëve. Kështu që këtij problemi ne duhet t'i dalim përpara.

Tashthi për prodhimet e kooperativave ne paguajmë një sasi fondesh. Kjo është gjë e mirë. Por edhe këtu ka një kufi. Ka kufi sepse, fundi i fundit, po nuk

e bleu shteti misrin, përse e prodrojnë kooperativat? Kur këto kanë misër në depo dhe kanë nevojë për para, atëherë atë do t'ia shesin shtetit, i cili duhet t'ia blejë. Edhe ky, pra, është një problem tjetër që duhet menduar e zgjidhur. Këtu del edhe problemi i grumbullimit të parave që kanë kooperativistët. Kjo dikton që këto para të mbulohen me mallra, sepse kështu ne nuk lejojmë lindjen e inflacionit. Duke hedhur sa më shumë mallra në treg, tërhiqet leku. Kjo ka rëndësi, ndërsa problemet e tjera marrin zgjidhje sipas kushteve e sipas rregullave në fuqi.

*Lufta kundër shpërdorimeve* është një problem i rëndësishëm, por jo më pak të rëndësishme janë edhe problemet e tjera për të cilat biseduam, sidomos ai i tërheqjes së parasë. Pra, kryesore është se sa mallra shiten dhe në fund të vitit bëhet bilanci se sa parandodhen në popull.

*SHOKU HEKURAN ISAI:* Në mjaft kooperativa të rrethit të Pogradecit nuk është realizuar prodhimi i qumështit. Po kështu, edhe në disa nga kooperativat e Librazhdit. Për këtë çështje ne biseduam edhe me shokët e bazës dhe mendimi është se, duke u vënë shumë rëndësi drithërave, lihet pas dore blegtoria.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po pse i pengon kujdesi për drithërat zhvillimin e blegtorisë dhe realizimin e planit të qumështit? Përkundrazi, unë mendoj se zhvillimi i drithërave duhet ta nxitë më tej zhvillimin e blegtorisë. Prodhimi i drithërave të jep, veç kokrrave, edhe kashtë, silazh e mbeturina të tjera. Pastaj shërbimet në blegtori paguhen më mirë sesa në bujqësi.

Aq më tepër, kooperativa e Starovës, për të cilën u fol këtu, ka edhe ujitjen të siguruar. Aty edhe panxhari mbillet e ujitet, po kështu misri bëhet sa një bojë njeriu e më i lartë dhe prej tij sigurohet gjithë ai silazh, por edhe jonxhë ka në Pogradec. Atëherë, në kushte të tilla, kooperativa, sidomos ajo e Starovës, pse të mos e realizojë prodhimin e qumështit?

*SHOKU HYSNI KAPO:* Pse nuk realizohet? Sepse. që të merret rendimenti i parashikuar, duhet jo vetëm të punohet toka që kemi caktuar për blegtorinë, por edhe t'u bëhen të gjitha shërbimet agroteknike, si çdo bimë tjetër, edhe foragjereve.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa herë është folur për çështjen e foragjereve, more shokë, qoftë për leguminozet, qoftë për graminozet! Ç'bëhet në këtë drejtim? Mua prapë më duket se nuk bëhet ajo që kemi thënë. Po kullotat kështu do t'i lëmë, në këtë mënyrë, pa i përmirësuar e pa u bërë shërbimet për të cilat kanë nevojë? Këto janë thënë edhe në Kongres, janë trajtuar edhe në sesione shkencore të bujqësisë. Puna tash është se ç'po bëhet në fakt, se bagëtitë duan të hanë. Ne e kemi caktuar drejt planin, por zbatimi i tij duhet kontrolluar, sepse mund të ndodhë që gjithë këto sipërsfaqe tokash në bazë, në vend që të mbillen me foragjere, të mbillen me bimë të tjera.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

# NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË TIPIT TË LARTE KËRKOHEN NJË PUNE MË E THELLE SIKENCORE, DREJTIM DIHE KONTROLL MË I MIRE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 shkurt 1977

Raporti që na paraqitet, më duket mua, është më i thelluar se një raport që kam parë vitin e kaluar, hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe nga Instituti i Studimeve Ekonomike.

Për problemin që po diskutojmë, dhe veçanërisht për të ardhurat dhe akumulimin në kooperativat e tipit të lartë, kam biseduar gjatë me shokët sekretarë të Komitetit Qendror, si dhe me shokë të Qeverisë në lidhje me rishikimin e çmimeve të blerjes së disa prodhimeve bujqësore, rendimentet e të cilave, në sajë të masave që janë marrë nga ana e pushtetit popullor në ndihmë të bujqësisë dhe të mobilizimit të fshatarësisë,

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme në kooperativat bujqësore të tipit të lartë.

janë ngritur në masë të kënaqshme. Edhe kostoja e tyre ka ardhur vazhdimesht duke u ulur, kurse çmimet, sipas mendimit tëm dhe sipas informatave që na janë dhënë, kanë mbetur në vend, ashtu sikundër kanë qenë caktuar shumë vjet përpara. Kjo më ka shqetësuar vazhdimesht, për arsy se në fshat, përveç fondeve të akumulimit që mbahen për investime, një pjesë e të cilave në kooperativat e tipit të lartë, si dhe në disa kooperativa të zakonshme, nuk arrijnë të përdoren, janë vënë në dispozicion të fshatarësisë shuma të mëdha të hollash që rrinë jashtë qarkullimit ekonomik.

Sidoqoftë, konstatojmë, dhe këtë na e konfirmon edhe raporti, se gjatë pesëvjeçarit të pestë, po kështu edhe vitin e kaluar, të ardhurat e kooperativave të tipit të lartë dhe të disa kooperativave të tjera të zakonshme kanë qenë më të larta se ato të ndërmarrjeve bujqësore në zonat fushore të krahasueshme. Kjo është shqetësues, përveç të tjerash, edhe nga një pikëpamje, sepse flet për një prapambetje të disa ndërmarrjeve bujqësore, të cilat, megjithëse disponojnë të gjitha mjetet dhe fonde, nuk janë kurdoherë në ballë të ekonomive bujqësore. Mendoj se një situatë e tillë krijohet nga dobësi të theksuara drejtimi dhe organizimi në këto ndërmarrje bujqësore, si dhe nga ana e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe nga Ministria e Bujqësisë. Këto ndërmarrje bujqësore të prapambetura, më duket, kanë vetëm formën si reparte pararojë të bujqësisë sonë socialiste, se, në fakt, mjaft kooperativa të tipit të lartë po ecin më përpara. Ecjen përpara të këtyre kooperativave, natyrisht, ne duhet

ta inkurajojmë edhe në të ardhmen, por në asnjë mënyrë të mos lejojmë që ndërmarrjet bujqësore të qëndrojnë prapa tyre.

Raporti na jep disa shifra orientuese për investimet shtetërore në kooperativat e tipit të lartë. Dhënia e fondeve këtyre kooperativave ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për furnizimin e tyre me mjete prodhimi, si plehra, materiale ndërtimi, farëra të zgjedhura dhe kafshë të trasha e të racës etj. Të gjitha këto kanë ngritur mirëqenien e kooperativistëve dhe kanë rritur mundësinë e prodhimtarisë më të lartë në kooperativat e këtij tipi.

Por të mos harrojmë se në vitin 1971 u dha një orientim, sipas të cilit paga e kooperativistëve nuk duhet të jetë më e lartë se ajo e punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore. Ishte, pra, e nevojshme që disa caqe, në të cilat po arrinin këto kooperativa, t'i rishikonim. Dhe tash është koha që të rishikojmë problemin e rëndësishëm që lidhet me pagat e kooperativistëve, të cilat jo vetëm janë më të larta se të punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore, por atyre u shtohen edhe të ardhurat e prodhimeve të oborrit. Ky disproporcjon bie në kundërshtim me vendimin që kemi marrë dhe me orientimet e përgjithshme.

Sipas të dhënave që kemi, duhet të mendojmë se ngritura e pagave në kooperativat e tipit të lartë nuk vjen vetëm nga rritja e prodhimit, por edhe nga disa dobësi që vihen re në to lidhur me normimin e punës, me kontrollin e pamjaftueshëm dhe me lëshimet që bëhen në cilësinë e punimeve. Të mos harrojmë, nga

ana tjetër, se kjo rritje, sidomos në kooperativat që s'janë të tipit të lartë, ka edhe një burim tjetër, që shfaqet në tendencën e ndarjes së më shumë të hollave për ditë-punë dhe në mbajtjen më pak në fondin e akumulimit.

Kur u mor vendimi për krijimin e kooperativave të tipit të lartë, natyrisht, u tha se shteti do t'i ndihmojë këto me investime, por, gjithashtu, u tha se edhe kooperativat duhet të krijojnë vetë fonde akumulimi dhe kurdoherë më të mëdha, për arsy se si pjesëmarrja e shtetit me investime të pakthycshmë, ashtu edhe puna e vetë kooperativistëve do të krijonin mundësi për shtimin e fondevë të akumulimit dhe të investimeve për prodhime të bollshme bujqësore e blegtorale. Për këto arsy u vu theksi që ndarja për ditë-punë që u bëhet kooperativistëve, nuk duhej ta kalonte pagën e punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore, pse do të na krijoleshin pastaj vështirësi.

Cilat janë këto vështirësi?

E para, duke u shtuar kooperativistëve të ardhurat për forca pune më shumë nga punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore, do të pakësoheshin fondet për investime në kooperativat e tipit të lartë.

E dyta, kështu shpresohet që fondi i investimeve do të jepet më shumë nga shteti, domethënë që shteti të investojë sa më shumë, kurse kooperativat të shkojnë duke investuar sa më pak dhe të ndajnë për anëtarët paga më të larta, bile më kanë raportuar se ka kooperativa që ua paguan shteti ditët e punës. Kjo të çon në rrugën e kundërt që kemi vendosur, pse investimet

shtetërore në kooperativat e tipit të lartë kanë një kufi. Është vendosur të investohet veçanërisht në këto koo-  
perativa, në mënyrë që të shtohet më shpejt prodhimi,  
dhe pastaj ky investim të vijë duke u pakësuar, për  
arsye se shteti duhet të bëjë investime edhe në koope-  
rativat e tjera, sidomos në ato maloret e gjysmëmalo-  
ret. Prandaj, në qoftë se nuk do të tregohet kujdes në  
këtë çështje, do të kemi pasoja të rënda, shfaqje in-  
flacioniste, për arsyse se ne nxjerrim të holla, të cilat  
i përballojmë me materiale investimesh në këto koo-  
perativa, dhe pastaj nuk kemi mundësi t'i mbulojmë  
ato me mallra. Nga kjo fshatarit po i shtohen paratë  
në xhep, pra mund të krijohet rrezik për një zhvleftë-  
sim të moncdhës sonë.

Përveç kësaj, duke marrë parasysh ngushtimin akoma më shumë të diferencave të të ardhurave midis punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativistëve, mund të na shkaktohet kthimi në të kundërt i dallimeve në shpërblimin e punës ndërmjet sektorit shtetëror dhc atij kooperativist të bujqësisë. Prandaj Partisë dhe Qeverisë u vihet detyrë urgjente t'i rishikojnë dhe t'i përmirësojnë levat ekonomike, siç janë tatimi, çmimi, tarifat etj., të cilat na i mëson edhe Stalini, në marrëdhëniet e shtetit me kooperativat. Kjo do të thotë që nëpërmjet këtyre levave të bëjmë që  
të realizohen detyrat e planit, të inkurajohet në rrugë  
të drejtë fshatarësia kooperativiste dhe të mbahet në  
përpjesëtime të drejta shpërndarja e të ardhurave në  
ekonomitë bujqësore. Janë këto mendime që më shtynë  
të ngrija çështjen se duhet rishikuar në tërcësi sistemi

I çmimeve të blerjes së produkteve bujqësore nga ana e shtetit, duke vënë theksin sidomos mbi një shpërndarje më të mirë brenda sektorit të bujqësisë.

Në këtë mënyrë, është shteti ynë ai që me politikën e tij të drejtë, me përsosjen e sistemit të çmimeve, drejton zhvillimin e harmonishëm të të gjilha prodhimeve bujqësore e blegtorale, duke u dhënë prioritet drithërave të bukës, dhe jo disa drejtues të ekonomive bujqësore, të cilët, me manovrimet që bëjnë, disa herë, duke treguar një kujdes më të madh ose më të vogël për disa produke bujqësore e blegtorale, i trajtojnë çështjet nga pozitat e interesave të ngushtë, të njëanshëm dhe tregtarë.

Gjithashtu mendoj se tatimi i diferencuar për kooperativat, që na propozohet në raport, do të jetë një masë e përshtatshme, pse do të rregullojë më mirë nivelin e pagave të larta, sasinë ose normën e akumulimit të brendshëm nga kooperativat, për të zhvilluar prodhimin me forcat e veta dhe për të caktuar më mirë sasinë e ndihmës së mundshme të shtetit për këto kooperativa të tipit të lartë, si dhe për kooperativat e tjera.

Duhet të reagojmë me kohë ndaj fenomeneve e sinqaleve që na shfaqen qysh kur ato janë në embrionin e tyre, për të shëndoshur e për të forcuar prirjet positive dhe për të mënjanuar me kohë ndonjë pasojë negative. Për këtë të kemi kurdoherë parasysh se politika ekonomike e Partisë me anë të çmimeve dhe investimeve ndikon e duhet të ndikojë në mënyrë të drejt-përdrejtë për të nxitur interesimin e kooperativave e të

kooperativistëve që ata të shtojnë prodhimin, të realizojnë planin e shtetit dhe që te kooperativistët të formohet një edukatë e shëndoshë në interes të grupit e të të gjithë shoqërisë socialiste. Prandaj çështja e përdorimit të drejtë të ligjit të vlerës në dobi të interesit të shoqërisë socialiste dhe të edukimit revolucionar të kooperativistëve ka një rëndësi të madhe, që në asnje mënyrë nuk duhet neglizhuar. Duhet pasur gjithashtu parasysh që çështjet të mos lihen përvite të tëra pa u nxjerrë konkluzionet e përshtatshme nga zhvillimi i ekonomisë.

Dihet se Partia dhe shteti ynë në ndërtimin e çmimeve të prodhimeve mbajnë parasysh një sërë normash e parimesh politike, ekonomike e shoqërore, në përpunhje me mësimet e marksizëm-lernizmit. Një nivel i caktuar çmimesh ndërtohet duke u bazuar në një nivel të caktuar të zhvillimit të prodhimit dhe të kushteve të tjera shoqërore-ekonomike. Me përmirësimin pozitiv të këtyre kushteve kërkohet të përsosen edhe çmimet, përndryshe ato, nga një faktor pozitiv, mund të bëhen frenuese e të sjellin pasoja të padëshiruara.

Në përgjithësi investimet në kooperativat bujqësore duhet të shtohen. Pse? Për arsyen e shtë e domosdoshme që bujqësia jonë të intensifikohet dhe prodhimet të vijnë duke u rritur. Logjikisht edhe investimet e vetë kooperativave dhe ndihma që shteti i jep bujqësisë kanë ardhur duke u shtuar. Kjo ka bërë që pagat për ditë-punë të kooperativistëve të përmirësohen, të rriten, dhe ato do të vazhdojnë të rriten, por duhet të kemi parasysh që të mos ngrihen jashtë nor-

mave që thashë më lart. Të kemi gjithashtu parasysh edhe nevojën për investime, për zhvillimin e prodhimit, për zhvillimin e mjeteve të prodhimit, përsosjen e agro-teknikës e të gjithë faktorët e tjerë që shërbejnë për zhvillimin e kooperativave bujqësore në rrugë të drejtë.

Në bisedimet që pata me shokët sekretarë të Komitetit Qendror, duke u bazuar në disa të dhëna të pjesëshme, vura në dukje se shumë investime që mund t'u bëhen, janë lënë pa u bërë. U përmenda gjithashtu se fondet e investimeve, të krijuara nga kooperativat që s'janë të tipit të lartë, por edhe fondet që atyre u ka caktuar Qeveria, nuk po realizohen kurdoherë mirë. Këtë e vërtetojnë edhe faktet që më sjellin shokët e aparatit të Komitetit Qendror, që merren me ekonominë. Kështu, për shembull, kooperativa «Agimi» në rrëthin e Fierit, megjithëse ka harxhuar një pjesë fondesh për investime gjatë vitit 1976, ka gjendje parash të papërdorura, të caktuara për investime, aq sa ajo kryen investime gjatë vitit. Kjo gjendje vjetore e fondeve për investime të kooperativës është rreth 4 herë më e madhe se ajo e fondeve që ka caktuar shteti për këtë kooperativë. Ose ka të tjera kooperativa në zonat kodrinore e malore, të cilave, për vitin 1976, u janë akorduar miliona lekë për ndërtimin e veprave të vogla ujitime, për hapjen dhe sistemimin e tokave, për mbjelljen e pemëve të reja, për blerjen e kafshëve etj., por ato kanë përdorur vetëm 70 për qind të këtyre ndihmave. Pse ngjet kjo? Thonë për mungesë materiali. Por unë mendoj se nuk është kjo e tëra. Mungesa materialesh ka në disa drejtime, por kjo vjen më shumë

nga një vetëkënaqësi dhe neglizhencë, nga një moskuptim i drejtë i pronës së përbashkët, e cila duhet zhviluar më tej, pse kjo është kryesorja dhe te kjo duhet drejtuar një kujdes më i madh, sepse ka kooperativistë që vazhdojnë të interesoohen më shumë për atë copë të vogël të oborrit dhe për ato 10 kokë bagëti apo për lopën që mbajnë.

Këtej rrjedh edhe një gjë, shokë, se krijohet ndjenja e vetëkënaqësisë, hapet dera e dëshirave të ngushta të kooperativistëve e të kooperativës, pse, duke marrë anëtarë një pagë pak a shumë të garantuar dhe në një nivel relativisht të mirë, kooperativa ka përshtypjen se është «e pasur» dhe disa drejtues kooperativash të tipit të lartë arrijnë të thonë: «Ç'na duhet të marrë pjesë shteti te ne», sikur shteti të ishte i huaj për ta. Prandaj, këtu, shokë, duhet të thellohemi një çikë më shumë, se këta drejtues, kooperativistët dhe organizatat e Partisë në radhë të parë, nuk e kanë kuptuar mirë dhe si duhet se kooperativa, duke qenë pronë e grupit, është njëkohësisht një sektor i rëndësishëm i ekonomisë socialiste. Ajo duhet të ndjekë me konsekuençë vijën e Partisë, që ndërtimi i socializmit në fshat të ecë paralel me ndërtimin e socializmit në qytet dhe të krijojë mundësinë e rritjes dhe të zhvillimit të gjerë të prodhimit, në mënyrë që së toku të ecin përpara, të përsoset ndërtimi i socializmit.

Në këtë drejtim edhe udhëheqja e Partisë dhe Qeveria duhet ta shikojnë me sy tjetër çështjen e planifikimit në baza sa më shkencore në kooperativat e tipit të lartë dhe në të tjerat, ashtu sikurse planifikohet për

ndërmarrjet bujqësore, dhe të mos lejohet asnjë shfaqje spontaneiteti në drejtimin dhe zhvillimin e kooperativave të tipit të lartë. Mendoj se drejtimi i këtyre kooperativave nuk duhet lënë vetëm në dorë të udhëheqjes së tyre, por të kujdesen shumë më tepër edhe komitetet ekzekutive, edhe Banka Bujqësore, që interesohen pak për këto çështje. Kur gjendja ka arritur deri në atë shkallë sa sipërfaqja e tokës arë në kooperativat e tipit të lartë është e njëllojtë si sasi me atë të ndërmarrjeve bujqësore, atëherë duhet të mendojmë seriozisht për planifikimin e llojeve të bimëve në baza shkencore, por të mendojmë gjithashtu për një planifikim shkencor edhe të mjeteve të prodhimit, edhe të investimeve. Kur themi që të planifikojmë investimet, me këtë të mos kuptojmë vetëm caktimin e fondeve në lekë, por këtyre fondeve t'u përgjigjet me prioritet edhe baza materiale, me forcat e vetë kooperativave dhe me furnizim nga shteti, sikundër veprohet në ndërmarrjet bujqësore, dhe, në radhë të parë, në ato drejtime që përcaktojnë satin e prodhimit dhe përmirësimin e kushteve shoqërore-ekonomike të fshatit tonë socialist. Lënia pas dore e kësaj çështjeje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e komiteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve na ka shkaktuar dëme. Prandaj edhe në kooperativat bujqësore ndërtimin e objekteve ta bëjmë me projekte dhe me preventiva, sikundër po vendosim tash në të gjithë sektorët e ekonomisë sonë socialiste.

Është e nevojshme të kuptohet nga Partia se mi-rëgenia e kooperativistëve duhet të ecë përpara në har-

moni me mirëqenien e gjithë popullit, pavarësisht se kooperativat bujqësore janë pronë grapi. Duhet të mendohet, gjithashtu, që në to të shtohet më shumë prodhimi. Për këtë mendoj se është e domosdoshme të investohet dhe të investohet sidomos për tokën, për ujitjen, për blegtorianë, për pemëtarinë dhe, natyrisht, në të gjitha ato drejtime që çojnë në ngritjen në një shkallë më të lartë të rendimenteve të drithërave, të bimëve industriale etj.

Duhet kuptuar edhe nga fshatarësia se socializmin ne do ta ndërtojmë me forcat tona dhe, kur themi me forcat tona, kemi parasysh jo vetëm forcat e shtetit, por edhe forcat e vëtë kooperativistëve. Është mirë gjithashtu që të kuptohet nga fshatarësia se zhvillimi i bujqësisë socialiste nuk bëhet vetëm nëpërmjet shtimit të prodhimit të drithërave. Ky është i domosdoshëm, është kryesori, por, nga ana tjetër, fshatarësia nuk u ka dhënë akoma rëndësinë e duhur blegtorisë dhe bimëve industriale, që nga pambuku dhe deri tek orizi, pa folur pastaj për pemëtarinë. Kështu, po të shohim rendimentet nga këta sektorë dhe të ardhurat prej tyre, del se ato janë akoma shumë të ulëta, prandaj na vihet detyrë të marrim masa serioze politike, ekonomike, organizative dhe financiare që të rriten jo vetëm rendimentet e drithërave, por edhe të të gjitha bimëve të tjera.

Siq na raportojnë, prodhimi i qumështit vitin e kaluar gati kudo ka rënë. Po pse ka rënë? «Sepse i është vënë rëndësi prodhimit të drithërave», thonë. Shumë mirë që i është vënë rëndësi prodhimit të dri-

thërave, po kjo nuk do të thotë aspak që të harrohen prodhimet blegtoriale, bimët industriale ose frutat, sepse nuk kemi mundësi që ato t'i zëvendësojmë duke i sjeillë nga jashtë, siç kemi vepruar deri tash për disa prej tyre.

Ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë, sipas të cilave prodhimi bujqësor këtë pesëvjeçar do të rritet 38-41 për qind, ndërsa forcat e punës në fshat rrëth 30 për qind. Kjo të na bëjë të mendojmë që përpjekjet të jenë shumë të mëdha për rritjen e efektivitetit të shpenzimeve materiale, si dhe të rendimentit e të efektivitetit të punës së njerëzve, sepse akumulimi ynë i brendshëm, natyrisht, e ka përballuar gjendjen deri tash, por nevojat do të shtohen si për mjete prodhimi edhe për mallra konsumi. Kredi nga jashtë nuk marrim, kriza ekonomike që ka pllakosur gjithë botën gjithash tu nuk duhet harruar, çmimet e importeve tona do të jenë të larta, prandaj na vihet përpara detyra të rritim efektivitetin dhe akumulimin që thashë më lart.

Lufta dhe përpjekjet për rritjen e akumulimit socialist synojnë mbajtjen e ritmeve të larta të zhvilimit, forcimin e mëtejshëm të stabilitetit tonë ekonomik kundër çdo rreziku e shfaqjeje sado të vogël me prirje inflacioniste, zënien në punë sa më të dobishme shoqërore të të gjitha forcave të reja të punës, që shtohen vazhdimisht, ngritjen në mënyrë graduale, por të sigurt, të mirëqenies së popullit dhe forcimin e afëtësisë mbrojtëse të vendit.

Nga sigurohen burimet e akumulimit? Atë datin,

në radhë të parë, nga dy degët kryesore të ekonomisë, industria dhe bujqësia. Prandaj shpenzimet në prodhimin bujqësor nuk duhen konsideruar një problem thjesht ekonomik i pathelluar mirë, i pastudluar mirë e i pakontrolluar mirë, por një problem politik, me rëndësi të madhe shoqërore, nga zgjidhja e drejtë e të cilit varet ecja përpara e shoqërisë sonë socialiste. Ky nuk ka të bëjë aspak me ekonomizmin, siç flasin revisionistët, duke vënë në bazën e prodhimit fitimin. Në këtë drejtim mendoj se ekonomistët dhe drejtuesit tanë duhet t'u futen më thellë këtyre problemeve, t'i studiojnë me imtësi. Atje ku kostoja është e lartë, të bëhen përpjekje që të ulet, sepse ajo është në një nivel të tillë ngaqë rendimentet e disa bimëve bujqësore janë ende shumë të ulëta dhe ngaqë planet e prodhimit të tyre nuk realizohen. Prandaj këtu lypset të përqendrohet edhe vëmendja e Partisë dhe e gjithë punonjësve e drejtuesve të bujqësisë. Atje ku rendimentet janë të larta dhe kostoja është ulur, lind nevoja që edhe çmimet e blerjes së produkteve bujqësore e blegtoreale nga ana e shtetit të kenë një ulje.

Partia nga njerëzit e saj që punojnë në pushtet, duhet të kërkojë medoemos një drejtim me baza më shkencore në ekonomi, mbajtjen e llogarive të qarta, pse shumë herë tregohet pakujdesi në këtë drejtim dhe shpenzohen shuma të konsiderueshme, që nuk kanë efektin e duhur në prodhim. Një drejtim joshkencor e lë zhvillimin e ekonomisë, qoftë atë kooperativiste, qoftë në industri dhe në degët e tjera, në një situatë të vështrimë, në mështësi, dhe e kthen atë nga një drejtim

i thelluar e me baza shkencore, ashtu siç e kërkojnë detyrat e mëdha që kemi përpara, në një drejtim të sipërfaqshëm. Në drejtim është e nevojshme të forcohet më shumë edhe ana e kontrollit. Prandaj mendoj se Partia duhet të reflektojë thellë në këto çështje, pse kuadrove aktualisht nuk u mungon ngritja politike e shkencore dhe as janë të rinj në drejtimin e ekonomisë.

Për këto arsyet e gjitha këtyre problemeve ne duhet t'u përvishemi si duhet, pse, siç e thashë në fillim, kur pashë se më 1976 gjendja e monedhës në qarkullim ishte shumë më e madhe nga ajo e fundit të vitit 1975, u shqetësova. Nga kjo del se në duart e populatës mbeten miliona lekë. Kjo flet për një mirëqenie, pse këto para janë dhënë, sepse janë prodhuar më shumë mallra, por duhet të pranojmë gjithashtu se prodhimi i tyre dhe shpërndarja nuk janë kurdoherë në lartësinë e duhur.

Të gjithë e dimë se ekzistojnë stoqe mallrash, të cilat nuk shiten, se janë prodhuar keq. Shikojmë gjithashtu se ekziston një shpërndarje jo e mirë e mallrave industriale. Atje ku fuqia blerëse është më e madhe, nuk gjen të tilla, kurse atje ku fuqia blerëse është më e vogël, gjen mallra të pashitura, që qëndrojnë në dyqane, dhe asnjë kontroll i shëndoshë nuk po zhvillohet për të bërë një shpërndarje më të drejtë të tyre. Është e domosdoshme të mendohet thellë për shpërndarjen dhe shitjen e këtyre mallrave. Pastaj, për të plotësuar nevojat e popullit dhe për të thithur paratë nga qarkullimi, nuk mjaftojnë vetëm mallrat industria-

le, por duhen edhe mallra të tjera, sidomos më shumë artikuj bujqësorë e blegtoralë, domethënë më shumë zarzavate, fruta, qumësht, gjalpë, mish, vezë etj., që akoma nuk janë në sasi të mjaftueshme. Këto mallra nuk janë të mjaftueshme, siç e thashë më parë, se nënvleftësohen nga fshatarësia. Kështu krijohet një sasi lekësh në xhepin e fshatarëve dhe një sasi, gjithashtu, e madhe edhe në xhepin e qytetarëve. Dhe të gjithë, si në fshat edhe në qytet, kërkojnë mallra. Kooperativistët kërkojnë kryesisht materiale ndërtimi, por edhe mallra të tjera, kurse qytetarët, po të ketë në treg më shumë mallra, sidomos ushqimore, i harxhojnë të hollat shpejt e shpejt. Paratë, që tash i mbajnë në xhep ose në arkat e kursimit, në rast se do t'i harxhojnë duke blerë mallra, do të përpilen t'i zëvendësojnë me shtimin e prodhimit. Ja, kështu ecin përpara edhe prodhimi, edhe mirëqenia e popullit. Po të mendohet më mirë, përveç këtyre që thashë, ka edhe shumë mënyra të tjera për të térhequr shteti të hollat nga ana e punonjësve.

Kooperativat bujqësore, qoftë ato të tipit të lartë, qoftë të zakonshmet, zhvillohen në rrugë të drejtë, politikisht dhe ekonomikisht, pavarësisht se në to duhet të ekzistojnë një kontroll financiar shumë më i shëndoshë, një organizim dhe një drejtim ekonomik akoma më i përsosur, pavarësisht se Partia dhe pushteti kanë shumë për të bërë, për të zhvilluar në to ekonominë e shumaneshme kooperativiste.

Në kooperativat e tipit të lartë pjesëmarrja e shtetit duhet të jetë e diferencuar. Në radhë të parë, koo-

perativat duhet të bazohen në forcat e veta, domethënë akumulimi për investime nga ana e tyre të shkojë duke u rritur, kurse ndihma shtetërore për to të jetë një plus. Është e nevojshme të bëhet e qartë se ndihma shtetërore u jepet atyre jo për të garantuar të ardhurat e kooperativistëve, por për zhvillimin dhe shtimin e mëtejshëm të prodhimit në kooperativa, gjë që do të thotë mirëqenie jo vetëm e kooperativistëve, por edhe e klasës punëtore dhe e të gjithë punonjësve të vendit.

Prandaj në kooperativat e tipit të lartë, pavarësisht se janë pronë grupi, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre, kërkohet që investimet shtetërore të planifikohen me kujdes nga ana e organeve përkatëse në bazë e në qendër, ashtu si edhe në ndërmarrjet shtetërore. Këtë ne e kemi thënë, po nuk po zbatohet si duhet. Investimet nuk bëhen kurdoherë të planifikuara mirë e me kujdes, me llogari dhe me preventiva, dhe nuk zbatohen në mënyrë rreptësisht të kontrolluar.

Ka kohë që i kemi vënë rëndësi ndërtimit të serrave. Ato janë të nevojshme dhe bile mund të ndërtojmë të tjera në të ardhmen, por t'u paguajmë kooperativistëve çmime aq të larta për prodhimin e domateve ose të zarzavateve të hershme, është e padrejtë dhe e gabuar. Një veprim i tillë edukon te fshatarët ndjenjën e ekonomizmit, i nxit ata të marrin sa më shumë të holla nga një sipërfaqe toke e vogël dhe me këtë të kënaqen, pse, natyrisht, çmimet janë të larta, dhe i bën të lënë pas dore prodhimet e tjera të rëndësishme, bile edhe grurin. Kështu ngjiste më parë, siç e dimë, në kooperativë bujqësore të Divjakës, në rrethin e Lushnjës, si

edhe në disa kooperativa të tjera. Prandaj t'u kushtohet kujdes i madh investimeve, këto të bëhen me vend, të kenë interes të madh, por jo që të pasurohet fshatari jashtë masës e vijës politike të Partisë. Çështja e akumulimit nga amortizimi i serrave, që u ngrit këtu, mendoj se nuk duhet të na shqetësojë. Akumulimet, si në rastin që thoni për serrat, janë kurdoherë të shtetit, ndërsa kur serrat do të amortizohen plotësisht, do të mbeten pronë e kooperativës, siç mbeten stallat, lopët e racës etj., bille deri në atë kohë kooperativat e tipit të lartë mund të jenë kthyer në ndërmarrje bujqësore.

Unë kisha edhe një vërejtje tjetër për vënien në dispozicion të kooperativave bujqësore të një numri makinerish e pajisjesh. Siç e thotë edhe raporti, ato që u jepen sot kooperativave, e kapërcejnë shumë kuptimin e mjeteve dhe të veglave të thjeshta. Unë kam vërejtje për impiantin e tharjes së misrit me kapacitet deri në 400 kuintalë për 24 orë, ose për serrat me avull së bashku me kaldajat, që kushtojnë me miliona lekë, të cilat, natyrisht, duhet të amortizohen me radhë. Kisha mendimin se me këtë sy duheshin parë edhe makinat shirëse të tipit «Tomorica» me elektromotorë. Mundet që për të shpejtar shirjet në një kooperativë të ketë 5 dhe 6 nga këto. Kjo çështje duhet të shikohet konkretisht. Po ashtu lypset të shikohet edhe problemi i baxhove. Sigurisht, makina dhe impiante si ai i tharjes së misrit duhet të prodhojmë, dhe jo 10 apo 20 copë, sepse këto i kërkon bujqësia moderne, dhe, po të mës prodhohen, zhvillimi i saj do të pengohej, veçse mëkanizma të tillë të mëdhenj duhet të mbahen nga shteti.

dhe jo t'u shiten kooperativave. Lidhur me këto çështje është e domosdoshme që Qeveria të vendosë një nomenklaturë se çfarë mund t'u shiten kooperativave bujqësore. Makineritë e natyrës që thashë, duhet të futen, si edhe të tjerat, në SMT-të, të janë këto që t'i drejtojnë. Prandaj të gjitha arsyimet e shokëve, propozimet që bënë si dhe këto që them unë, Qeveria t'i studiojë një për një, pastaj të vendoset.

Duke vepruar kështu, Partia jonë zbaton me konsekuencë mësimet e Stalinit, i cili, duke parashtruar argumentet përsë nuk i duhen shitur veglat kryesore të prodhimit pronës së grupit, theksonte se në këtë mënyrë prona e grupit do të bëhej pronare e veglave kryesore të prodhimit, domethënë ajo do të vihej në një pozitë të jashtëzakonshme, të cilën nuk e gjëzon asnje ndërmarrje e vendit, sepse, siç dihet, thoshte Stalini, ndër nc edhe ndërmarrjet e shtetëzuara nuk janë pronare të veglave të prodhimit. Përveç kësaj, kjo do të zgjeronte sferën e qarkullimit të mallrave dhe do të pengonte ripërtëritjen me ritmet e nevojshme të bazës materiale e teknike etj. Por këto mësime u shkelën me këmbë nga revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre. Kjo gjë, siç po e shohim çdo ditë, së bashku edhe me shkaqë të tjera, po e çon bujqësinë revizioniste poshtë e më poshtë.

Eshtë mirë që morëm në studim këtu në Byronë Politike disa probleme të kooperativave të tipit të lartë, por studimi që na paraqitet kërkon akoma punë për t'u thelluar. Ai duhet thelluar nga Ministria e Bujqësisë dhe, tok me të, të thellohet edhe puna për zgjidhjen e problemeve të kooperativave, qofshin të tipit të lartë

ose jo. Ky, natyrisht, është një problem shumë kompleks, për të cilin duhet të ndihmojnë dhe të marrin pjesë aktivisht Ministria e Financave e Banka Bujqësore që tani u shkëput nga Banka e Shtetit dhe iu dhanë kompetenca të rëndësishme veprimi në fushën e bujoësisë, natyrisht nën varësinë e Ministrisë së Financave. Banka Bujqësore duhet të lidhet më mirë edhe me Ministrinë e Bujqësisë. Detyra e probleme kanë në fushën e bujqësisë edhe Ministria e Ndërtimit dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave, pse edhe këto, tok me Komisionin e Planit të Shtetit si dhe me Institutin e Studimeve Ekonomike, kanë për të thënë fjalën e tyre për këto probleme që shtrojmë.

T'i vëmë rëndësi të madhe bujqësisë. Këtë e kemi theksuar edhe herë të tjera, e theksuam me forcë edhe në Kongresin e 7-të të Partisë. Aktualisht bujqësia ka rëndësi të madhe, të jashtëzakonshme, si ekonomike edhe politike. Të dyja këto aspekte duhen parë së toku dhe për këtë të bëjmë të ndërgjegjshme organizatat e Partisë në fshat, pse, pa i vënë rëndësi bujqësisë, do të ndeshim në vështirësi të mëdha, që do të kenë rrjetdhime politike në situatën tonë të brendshme dhe ndikimi i rrithimit armiqësor mbi vendin tonë do të ndihet më shumë. Të mos kemi iluzione dhe të mos notojmë në eufori për këtë problem kaq të rëndësishëm. Entuziazmin ta ngremë në një shkallë të lartë, por të ngremë, natyrisht, një entuziazëm që të sigurojë rezultata konkrete, që të vijë si rrjedhim i punës së palodhur, i një kontrolli sistematik, i dinamizmit dhe i ndihmës reale në drejtim.

Këtu nuk është vendi për t'u zgjatur në disa çështje të përgjithshme e shumë të rëndësishme që duhet të zbatojë dhe të zhvillojë Ministria e Bujqësisë, por punimet shkencore, konkluzionet shkencore që bëjnë një mori specialistësh në degë të ndryshme dhe zbatimin e këtyre konkluzioneve Ministria e Bujqësisë duhet t'i ketë shumë parasysh. Dhe nuk mjafton vetëm t'i ketë parasysh, por të krijojë grupe të veçanta, me specialistë të degëve të ndryshme në krye, ku të ketë edhe kooperativistë, dhe të caktojë plane me afate të kontrollueshme për zbatimin e këtyre studimeve.

Të marrim, për shembull, çështjen e kullotave e të foragjereve, nga të cilat varet sasia e mishit, e qu-mështit, e gjalpit, e lëkurëve, që presim të realizohet sipas planeve që kemi aprovuar. Ky nuk është një problem i vogël, mirëpo shohim se nuk po na zgjidhet si duhet. Kurdoherë flitet se këto sipërfaqe të mëdha tokash që janë rezervuar për kullotat dhe për rritjen e bimëve foragjere, nuk po shfrytëzohen si duhet. Me sa di unë, këshillat e specialistëve për të sjellë nga jashtë lloje të ndryshme farërash foragjeresh, qofshin këto leguminoze, qofshin graminace, të cilat nevojiten si për ushqimin racional të bagëtisë, ashtu edhe për pasurimin e tokës me elementet e domosdoshme që shërbejnë për rritjen e rendimentit të bimëve të arave, nuk po zbatohen në mënyrë të veçantë, të gjerë dhe shkencore dhe nuk shikoj të kontrollohet me rrëptësi kjo detyrë kaq e rëndësishme. Të gjithë kërkojnë kultuta, por edhe në rastet kur prodhimet bujqësore, sidomos prodhimi i drithërave, shtohen, një pjesë e mirë e

lëndës që mbetet pasi merren kokrrat, prapëseprapë nuk përdoret si duhet për ushqimin e bagëtive.

Po nuk është vetëm çështja e kullotave dhe e foragjereve. Del edhe ajo e hibrideve, e atyre hibrideve që ne kërkojmë t'i zëvendësojmë me kategorinë e dytë, sepse mbasandaj ulet rendimenti. Edhe për to nuk ka një interesim të veçantë, pse në Ministrinë e Bujqësisë kjo çështje delikate e speciale i qe lënë Ndërmarrjes së Farërave, e cila në këtë drejtim nuk ka treguar atë kujdes që kerkohet, por ia përplas Institutit të Kërkimeve Bujqësore të Lushnjës. Ky ia kthen Ndërmarrjes së Farërave përsëri dhe, më në fund, për një sasi hibridi që numërohet me kokrra, nuk gjenden dot as rrugë tregtare ose rrugë të tjera.

Ka pastaj edhe disa probleme që specialistët i kanë shtruar në mbledhje të gjera, për zgjidhjen e të cilave ata kanë dhënë një eksperiencë shumë të vyer. Unë kam pasë biseduar për to me Pirro Dodbibën më parë, por ky mjaftohej të më thoshte «si urdhëron, si urdhëron, do të marr masa», por se ç'masa mori e ç'rezultate nxori, këtë tash e dimë. Për këtë çështje kam biseduar shkurtimi shqip me shoqen Themije dhe konstatoj se po bëhen konsulta me specialistë. Unë jam në korent të këtij problemi, se intercsohem. Vë re se ekipi drejtues i Ministrisë së Bujqësisë po i shikon këto probleme, por tash ka rëndësi që ai të marrë masa dhe t'i zgjidhë një e nga një. Për shembull, Instituti I Lartë Bujqësor qahet se po i merren kuadrot më të mirë që u japid mësim studentëve. Pedagogë të tij po dërgohen për qarkullim në bazë, gjë që duhet bërë,

por këta i zëvendësojnë në institut me kuadro që kanë shumë pak eksperiencë, në një kohë kur në bazë kemi kuadro të tjerë me shumë eksperiencë. Është e drejtë vallë kjo praktikë? Mendoj se nuk është aspak e drejtë. Sigurisht, qarkullimi të mos pengohet as për këta lloj kuadrosh, por për nevojat e shkollës duhet të zgjidhen në bazë kuadro nga më të mirët. Si këto probleme ka dhe shumë të tjera që Ministria e Bujqësisë nuk duhet t'i lërë pas dore aspak, sepse kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë sonë socialiste, me shtimin e prodhimit, me konsolidimin e bujqësisë, në përgjithësi, dhe të kooperativave bujqësore, në veçanti. Prandaj, për gjithë këto probleme, të mos kënaqemi vetëm me parashtrimin e tyre teorik. Rëndësi ka që ky parashtrim teorik të vihet në jetë, në praktikë dhe, që të zbatohet kjo gjë, problemet duhet të planifikohen. Por për këtë nevojiten edhe fonde materiale, të cilat i janë caktuar bujqësisë, vetëm se këtu kërkohen punë më e thelluar shkencore, drejtim e kontroll më i mirë për zbatimin e detyrave të mëdha, por plotësisht të realizueshme, që Kongresi i 7-të i Partisë ka shtruar përpara bujqësisë sonë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Ra-  
porte e fjalime 1976-1977»,  
f. 151*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fja-  
lime 1976-1977», f. 151*

## **DUKE USHTRUAR DREJT KOMPETENCAT E DHËNA NGA PARTIA, ZBATOHET VIJA E SAJ**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 shkurt 1977**

Lidhur me çështjen që diskutojmë kam një vërejtje. Nga materiali që na është paraqitur, me gjithë atë eksperiencë të mirë që kemi, shikoj të flitet vetëm pér çështje ekonomike dhe, me përjashtim të organeve të Partisë në ushtri, pér të cilat thuhet se janë marrë edhe me probleme politike e ideologjike, aty del se organet e tjera të Partisë në terren janë marrë pothuajse vetëm me probleme ekonomike. Pra, bie në sy prirja që kanë organet e Partisë të terrenit pér të mos u marrë shumë me çështjet politike, dhe kjo ndodh jo se i harrojnë këto çështje, por mendojnë se vetëm pér ushtrinë ka probleme të tilla.

Direktiva e Partisë që organizata-bazë drejton, du-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit «Mbi përbërjen e organeve të zgjedhura të Partisë pér vitin 1976».

het kuptuar drejt. Por, gjithashtu, duhet kuptuar drejt që këtë direktivë Partia e shtron si për organizatatabazë, edhe për organet e pushtetit, në kuptimin që Partia u ka dhënë këtyre organeve kompetenca dhe ato, gjatë veprimtarisë së tyre, ushtrojnë kontrollin e të drejtat që u janë besuar. Prandaj të mos ndodhë që për çdo gjë organi shtetëror, fjala vjen drejtoria e ndërmarrjes, të presë ç'do të thotë organizata-bazë. Pse të veprojë kështu ajo për zbatimin e një parimi, kur Partia i ka dhënë kompetenca? Kjo duhet pasur mirë parasysh e jo të arrihet deri aty sa komiteti i Partisë i rrethit të analizojë brenda një muaji 29 probleme të bujqësisë! Po me problemet e tjera që ka rrethi, kush do të merret? Mos vallë me problemet politike, ideologjike, të arsimit e të kulturës duhet të merret vetëm komiteti ekzekutiv? Partia në bazë duhet orientuar mirë që t'i kuptojë drejt e t'i ketë të qarta këto gjëra.

Problemet e bujqësisë, për shembull, Komiteti i Partisë i Rrethit të Lushnjës, do t'i marrë në analizë, se Lushnja është rreth bujqësor, por atje ka dhe probleme politike e ideologjike, të cilat duhet të analizohen. Ka probleme ekonomike të bujqësisë, të cilat i takojnë t'i ndjekë komiteti ekzekutiv, dhe ky nga ana e vet duhet t'i konstatojë e t'i analizojë, por ka edhe probleme të politikës ekonomike bujqësore të cilat duhet të analizohen medoemos nga forumet e Partisë. Forumet në këtë drejtim të thellohen për të ndërtuar tematikat e punës e të analizave që bëjnë, anëtarët e tyre të aftësohen dhe të dinë se si t'i vënë në lëvizje

komitetet ekzekutive dhe seksionet që të zbatojnë orientimet e Partisë dhe të Qeverisë për bujqësinë. Këtë duhet ta keni mirë parasysh, se po nuk u kuptuan të gjitha këto probleme politike e ideologjike aktuale që kemi, përvèç problemeve ekonomike e bujqësore që shtrojmë vazhdimisht, punët nuk do të ecin mirë.

Këtu u shtruan shumë probleme politike dhe ideologjike, të cilat për komitetet e Partisë përbëjnë një sërë temash politiko-ideologjike që duhet të shtrohen dhe të punohen në gjithë organizatat-bazë të Partisë në rrethe, gjithashtu, mbi këtë bazë edhe organet e pushtetit të zbatojnë detyrat e veta nga ana teknike, shkencore, ndërsa komitetet e Partisë, si forume udhëheqëse në rreth, të kontrollojnë zbatimin e tyre e të fuqizojnë punën për zgjidhjen e atyre problemeve që u duken më të rëndësishme.

Nganjëherë ndodh që edhe organizatat e masave, këto leva të Partisë, nuk lejohen të ushtronin si duhet kompetencat e të zbatojnë funksionet e tyre, se u thonë që, para se të ushtroni këtë kompetencë, duhet të bisedoni me shokë të Partisë. «Po dale, — duhet të përgjigjet, për shembull, organizata e bashkimeve profesionale, e gruas apo e rinisë, — e kam vetë të drejtën ta bëj këtë gjë, kam kompetencat e mia që m'i ka dhënë Partia dhe, duke i ushtruar drejt ato, unë nuk bëj ndonjë shkelje, por, zbatoj vijën e Partisë».

Këtu u tha se ka lëvizje të shpeshta të shokëve të zgjedhur. Po pse nuk rizgjidhen prapë shokë që kanë qenë zgjedhur? Kështu siç veprohet, që në organet e

zgjedhura të Partisë hyjnë dhe dalin vazhdimesht shumë të rinj, nuk është mirë. Nuk është e domosdoshme që pas dy vjetëve nga plenumi të largohen e të mos rizgjidhen një numër i konsiderueshëm shokësh ish-anëtarë të tij. Duhet një kombinim më i mirë i shokëve të vjetër e me eksperiencë me shokë të rinj, parë në njëanshmëri.

Në materialin që na është paraqitur pashë se në një mbledhje byroje të komitetit të Partisë të një rrethi kanë ndërhyrë 40 herë sekretari i parë dhe 58 herë kryetari i komitetit ekzekutiv. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon «unin» e sekretarit, i cili mendon se «unë jam sekretar këtu, prandaj kот që flisni ju të tjerët!»

*Për pikën tjetër të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje, lidhur me miratimin e planit të çështjeve që do t'i paraqiteshin Plenuminit të KQ të PPSH për vitin 1977 dhe Byrosë Politike e Sekretariatit të KQ të PPSH për tremujorin e parë të vitit 1977, shoku Enver Hoxha tha:*

Unë propozova që të bënim dy mbledhje plenumi për të analizuar realizimin e planit ekonomik dhe që t'i dalim përpara situatës<sup>1</sup>. Planin do ta marrim në analizë edhe në Byro, por kur ta analizojmë atë edhe si gjashtëmujor, edhe si vjetor, në Plenum, ku janë edhe shokët që lidhen me prodhimin, më duket se çështjes kështu do t'i jepet më shumë rëndësi. Edhe në Byro ne mund ta marrim në analizë realizimin e planit si gjastëmujor, por në këtë rast konkluzionet shokëve të Plenu-

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 205.

mit do t'u venë nëpërmjet instruktorëve të aparatit të Komitetit Qendror dhe jo drejtpërdrejt.

Në muajin janar të vitit 1978 ne duhet ta marrim patjetër në analizë realizimin e planit, se atëherë rezultatet i kemi më të plota. Propozimin që realizimin e planit ta analizojmë edhe si gjashtëmuajor, e bëra që ne të analizojmë një herë paraprakisht realizimin e tij, se e vërteta është që në qershori nuk i kemi rezultatet e plota, por ama në përgjithësi treguesit i kemi.

Mbledhja e dytë e plenumit, që do ta bëjmë në janarin e ardhshëm, konsiderohet si e vitit tjetër, domethënë e vitit 1978. Si thoni ju? Atëherë të gjithë jemi dakord.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **KINEMATOGRAFIA E TELEVIZIONI U BËJNË NJË SHËRBIM TË MADH PARTISË, POPULLIT, INTERNACIONALIZMIT PROLETAR**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**5 shkurt 1977**

Lidhur me çështjen e kinematografisë dhe të televizonit, në qoftë se shokët kanë pyetje, le t'i bëjnë, pastaj shokët që merren drejtpërdrejt me këto probleme, do t'u përgjigjen, dhe, po të kenë për të shtuar ndonjë gjë për raportin, të na e thonë pas përgjigjeve të pyetjeve. Keni marrë dijeni ju, shokë, që jeni jashtë dikasterit, për raportin që është paraqitur?

Edhe këtu, gjatë kësaj mbledhjeje, ne do të bëjmë njëfarë «filmi», veçse pa aparate filmimi, por me shkëmbim mendimesh. Kështu, edhe kjo mbledhje është edukative, siç është edhe filmi.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për gjendjen dhe detyrat për një zhvillim të mëtejshëm të kinematografisë sonë, si dhe për masat e marra dhe disa probleme që dalin për prodhimin e filmave televizivë.

Jam i sigurt se puna e Partisë në kinostudio, natyrish edhe në televizion, është përmirësuar, por desha tē di si punojnë organizatat e Partisë pér të forcuar unitetin në radhët e tyre e të kolektivit, pér të dendësuar shkëmbimin e mendimeve lidhur me luftën pér pastrimin e ndonjë mbeturine që ekziston e shfaqet nga njëherë. Në një mënyrë apo në një tjetër, mbeturinat shfaqen te çdo njeri, prandaj Partia na mëson t'i luftojmë. Pra, dua tē di nëse ka kompaktësi, unitet, bashkëbisedime të frytshme midis shokëve e krijuesve të kinematografisë dhe të televizionit. Besoj se shokët do tē na i sqarojnë këto gjëra, këtu kemi edhe sekretarët e organizatave të Partisë të këtyre institucioneve, që mund tē na flasin.

Kur rronte Stalini, kam parë në Moskë filma sovjetikë me ngjyra. Unë tani kam parasysh vetëm vizionet e tyre, megjithatë jam i mendimit se filmat tanë sot janë më të bukur, jo vetëm nga përbajtja, nga ngjyrat dhe nga teknika e realizimit, por edhe nga pikëpamja e këndit të shikimit të gjërave dhe e filmimit të tyre lidhur me kombinimin e natyrës së bukur, të njerëzve, të shtëpive. Kinematografia jonë po i paraqet mirë bukuritë e natyrës sonë, mrekullitë e rivierës sonë, ku jetojnë njerëz të shëndetshëm, sepse klima e Jonit është e mirë, vaji i ullirit i bën shumë mirë shëndetit të njeriut, limonat e portokallet po ashtu. Ja, ju<sup>1</sup> andej nga

---

1. I drejtohet shokut Anastas Kondo, në atë kohë zëvendësministër i Arsimit dhe i Kulturës, kryetar i Komitetit të Kulturës dhe të Arteve.

Vunoj të tërë të shëndetshëm, të rrumbullakët jeni. Edhe për të xhiruar filma bregdeti ynë është vend i mrekullueshëm. Kjo duket, për shembull, edhe në filmin «Udhëtim në pranverë», në të cilin pasqyrohet puna e madhe që kemi bërë ne për agrumet në bregdetin e Jonit e për qytetin e bukur të Ksamilit. Ky film është shfaqur nga ambasadat tona jashtë vendit dhe të huajt që e kanë parë e kanë pëlqyer shumë.

Harmonia artistike e elementeve të natyrës së bukur dhe e njerëzve me ngjarjet që trajtohen është në një nivel të mirë në filmat tanë, prandaj kam përshtypjen se, si një fushë e re e veprimtarisë sonë artistike, kinematografia te ne ka ecur përpara.

Hymë në diskutime të tillë dhe nuk i qëndruam strikt procedurës së rendit të ditës, domethënë të mbaronim njëherë pyetjet, të jepeshin përgjigjet e pastaj të diskutonim, por edhe që ta zbatosh pikë për pikë këtë procedurë, mund të mos jetë e domosdoshme, rëndësi ka të bëjmë mirë punën.

*Pas diskutimeve të disa shokëve të pranishëm në këtë mbledhje, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Dëshiroj me këtë rast të përgëzoj shokët e kino-studios «Shqipëria e re» dhe ata të televizionit përgjithë ato suksese të lavdërueshme që kanë arritur në punën e tyre krijuese. Kjo është një dëshmi tjetër e vijës së drejtë të Partisë. E cila vazhdimisht ka mbajtur pranë, si gjithë punonjësit e tjerë të artit e të kulturës, edhe ata të kinematografisë e të televizionit, ka pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes edukimin e tyre nga ana politike, ideologjike dhe teknike. Punonjë-

sve tanë të kinematografisë dhe të televizionit nuk u kanë munguar pajisjet dhe mjetet materiale të domosdoshme, për të mos thënë shumë të perfektionuara. Të gjitha këto kanë bërë që ata të krijojnë filma të bukur që e kënaqin popullin, të jasin gjithashtu edhe emisione të mira televizive që kanë ngjallur gjithnjë e më shumë interesimin e masave punonjëse të vendit tonë, duke e bërë jetën e tyre kulturore më të këndshme e më të zhvilluar.

Këtu na janë paraqitur dy raporte: njëri për kinematografinë, tjetri për televizionin. Është e drejtë dhe mirë u bë që na u dhanë të dy raportet njëkohësisht, sepse televizioni dhe kinematografia, si nga ana teknike, ashtu edhe në të gjitha drejtimet e tjera, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Ndërtimi i socializmit u ka hapur artistëve tanë të kinematografisë, regjisoreve, operatorëve, aktorëve, kompozitorëve, krijuesve e teknikëve, sikurse edhe punonjësve të televizionit, fusha të gjera për të punuar, për të zgjedhur tematikën dhe për të krijuar e për të kompozuar. Është e vërtetë se ata kanë nevojë edhe për më tepër mjete, prandaj Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të marrë disa masa plotësuase për t'i pajisur kinematografinë dhe televizionin tonë me disa mjete teknike të veçanta dhe aparatura speciale, që duhen për të shumëfishuar prodhimin e filmave, të dokumentarëve etj. dhe për t'i bërë këta më të mirë e më të bukur.

Të dy këta sektorë, kinematografia e televizioni, kërkojnë edhe aktorë të afirmuar. Të tillë ne kemi

plot. Aktorët tanë interpretojnë tash në trupat e teatrove e të estradave tona dhe jo keq, bile, sipas mendimit tim, ata interpretojnë mirë. Flas këtu në përgjithësi dhe nuk kam parasysh aktorët tanë shumë të talentuar, të cilët mund të krahasohen me aktorë nga më të mëdhenjtë të vendeve të përparuara në teatër, në kinematografi etj.

Natyrisht, duhet parë me kujdes edhe angazhimi i disa aktorëve në prodhimin e filmave, qoftë të kinostudios, qoftë të televizionit. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ta vlerësojë si duhet televizionin, sepse veprimtaria e tij po vjen gjithnjë duke u zgjeruar dhe ky është bërë, e dita-ditës po bëhet më shumë, një mjet i dashur dhe i afërt për masat. Prandaj programi i televizionit merr aktualisht një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, por të kihet kujdes që as kinemaja të mos e humbasë vlerën e saj.

Ju, shokë të kinematografisë dhe të televizionit, i keni hyrë, mendoj unë, një rruge të drejtë, që, përveç aktorëve të talentuar, merrni në masë edhe aktorë amatorë. Dhe jo vetëm kaq, por ju aktivizoni në punën tuaj krijuese edhe masa të gjera të popullit: studentë, ushtarë, gra punëtore, fshatare, familjarë, nxënës e fëmijë, të cilët të entuziazmojnë si për interpretimin, ashtu edhe për ndërgjegjen e lartë që i karakterizon në kryerjen me seriozitet të punës që u caktohet. Nga radhët e gjithë këtyre ju mund të nxirrni edhe aktorë amatorë, që, më vonë, duke i dërguar në shkollat e institucionet tona artistike, mund t'i përgatitni dhe t'i aktivizoni për të prodhuar edhe më shumë filma artis-

tikë e dokumentarë me përbajtje shumë të mirë.

Unë kam parë mjaft filma nga tuajt, si «Përballimi», «Lulëkuqet mbi mure», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Dimri i fundit», «Rrugë të bardha», «Zonja nga qyteti», «Tinguj lufte» etj., etj. Të gjithë këta filma, po ju flas sinqerisht, më kanë pëlqyer shumë nga përbajtja ideopolitike, nga trajtimi artistik i subjekteve dhe nga përsosmëria teknike. Ata të lënë mbresa të mëdha dhe bëjnë efekt të jashtëzakonshëm jo vetëm në masat e gjera të popullit tonë, por edhe në ato maša jashtë Shqipërisë, që kanë rast të shohin filmat tanë. Në proletariatin, bile edhe në borgjezinë e vogël të vendeve kapitaliste, ka njëfarë neveritjeje kundër asaj jete boshe që ekziston realisht e që shfaqet rëndom në filmat e tyre, dhe kur këta njerëz shohin ndonjë film nga tanët, ky u tregon një jetë tjetër, me optimizëm e me gëzim. «Kështu duhet të jetëjeta, — thotë shikuesi i huaj, — se nga propaganda e filmove tanë m'u prishën fëmijët, m'u prish shtëpia». Pra, filmat tanë kanë një frymë tjetër, në kundërshtim me sistemin politik, ekonomik e shoqëror që është në fuqi në vendet kapitaliste dhe revizioniste.

Ashtu siç ju ka porositur Partia, ju i keni vënë rëndësi të madhe, në radhë të parë, përbajtjes politike dhe ideologjike të filmove, sepse çdo krijim artistik del i mirë kur nisesh nga një kënd i drejtë shikimi jo vetëm nga ana artistike, por sidomos nga ana politiko-ideologjike. Dhe kjo arrihet vetëm kur të gjithë, skenaristë, regjisori, aktorë, kompozitorë, anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve e të tjera që

kontribuojnë në këta sektorë, punojnë dhe diskutojnë së bashku më parë skenarin, përmbajtjen e çdo filmi që do të xhirohet, në mënyrë që kjo të përshkohet, prej kreut deri në fund, nga normat dhe tiparet e moralit tonë komunist.

Gjatë xhirimit të një filmi duhet pasur kurdohërë parasysh që veten ta vini në rolin e spektatorit, të provoni ndjenjat e tij. Ky, kur sheh një film, qoftë në televizorin që ka në shtëpi, qoftë në sallën e kinemasë, shikon t'i kalojë përpala syve një episod, një ngjarje ngajeta, prandaj ka rëndësi përmbajtja e këtij episodi apo ngjarjeje, ka rëndësi trajtimi i saj dhe morali që vetë spektatori duhet të nxjerrë prej saj. Ekrani duhet ta çojë spektatorin në një realitet, dua të them me këtë që spektatori të mos mbetet pasiv, por ta rrëmbecjë bota reale që trajton filmi, me heronjtë pozitivë realë, me mendimet dhe me luftën përrarritjen e një të ardhmeje më të mirë e më të përparuar. Me fjalë të tjera, spektatori nga të dy ekranet, nga i kinemasë dhe i televizorit, duhet të nxjerrë konkluzione të drejta, që të nxitin diskutimin me mendimet e tij personale, të cilat shumë herë mund të jenë në kontradiktë jo-antagoniste me moralin e lartë komunist të ngjarjes që paraqitet në ekran. Këto konkluzione duhet të nxitin gjithashtu diskutime me njerëzit edhe jashtë kinemasë.

Në kinema ose përpala televizorit, kur sheh një shfaqje, njeriu, në realitet, për aq kohë sa zgjat filmi, është disi, si të thuash, i izoluar, sepse vëmendja e tij është e përqendruar vetëm në një vend, por tema e

zgjedhur, fryma e drejtë politike që materializohet në film dhe në lojën, në mimikën, në fjalët e artistëve, ose vendi ku zhvillohet ngjarja dhe shoqëria e inkundruar në të, si dhe muzika që e shoqëron, të gjitha këto, në qoftë se krijojnë një ambient real, e bëjnë spektatorin ta harrojë pikërisht atë vetmi fizike, atë «izolim» që krijon tek ai qëndrimi për një kohë në kinema ose përpëra televizorit. Në qoftë se realizohen të gjitha këto që thashë, atëherë mund të themi se filmi ia ka arritur qëllimit.

Pikërisht të tillë filma na duhen ne, që ta bëjnë spektatorin të jetojë me jetën e përditshme të popullit, me realizimet e tij, që të shohë në ekran jetën dhe mendimet e veta. Ja, pra, pse ne i vëmë rëndësi të madhe temës së zgjedhur, e cila është e domosdoshme të përpunohet mirë. Po nga kush? Nga të gjithë ata kineastë dhe nga gjithë personeli që merr pjesë në përgatitjen e një filmi. Ky personel duhet të dijë ç'të nxjerrë dhe ç'të marrë nga romani ose nga novela, duhet të dijë e të ketë parasysh që brenda asaj kohe të shkurtër që i lejon metrazhi, të mos lërë vend as për elementë fantastikë, as për të dhëna fantazmagorike, as për ndodhi jashtë realitetit, as për luks të dënueshëm.

Dua të tregoj diçka për punën e luksit të tepruar që vihet re në ndonjë shfaqje. Vajtëm njëherë në teatrin «Balshoju» në Moskë, ku jepej një shfaqje që bënte fjalë për përparimet e kolkozit. Në këtë shfaqje erdhë dhe Stalini. Ai e ndoqi shfaqjen deri në fund. Pas dy ditësh ajo u ndalua. Pjesa u hodh poshtë, për arsyen se

kolkozin e tregonte luksoz, pra nuk jepte realitetin.

Në qoftë se nuk tregohet kujdes në drejtimet që përmenda më lart, filmat e çojnë spektatorin në një botë të panjohur dhe irreale, gjë që e çorodit atë në mendime, në ide, e huton, e bën të ëndërrojë për gjëra të një bote tjetër ose të një bote të bastarduar, fiktive, me një jetë të zbrazët, pa moral dhe pa etikë të përshtatshme. Ja pse duhet të përpinqemi ne që të gjithë artistët tanë të kinematografisë të jenë të ngritur politikisht, të jenë njerëz me kulturë të gjerë dhe çdo ditë të punojnë që të përsosen edhe teknikisht. Kur them teknikisht, kam parasysh që të trajtojnë me pjekuri artistike problemin e filmit dhe të interpretojnë me mjeshtëri, të bëhen specialistë në fushat ku debuton secili.

Korrentet e ndryshme të kinematografisë borgjeze, sipas kohëve dhe ideve të regjisoreve e të artistëve, shihnin më shumë, dhe aktualisht shohin, kryesisht interesin finansiar dhe forcimin te spektatorët të koncepteve idealiste, tekat e këqija të borgjezisë për ndrydhjen e vullnetit të masave dhe për të shuar luftën e njerëzve të shtypur, të poshtëruar e të varfëruar. Për t'i mbuluar këto mjerime kineastët borgjezë, që s'mendojnë kurrë për zhvillimin dhe përparimin e kulturës njerëzore, por veç për të fryrë xhepat e tyre, me një propagandë të shfrenuar e me reklama të bujshme, i nxitin masat të shkojnë në kinema për t'i hutuar dhe atje të harrojnë mjerimet e urinë e përditshme. Dhe ç'u japid në vend të tyre? Një ushqim shpirtëror të fantaksur e të bastarduar me anë të filmave. Ata një

orë ose dy, gjatë projektimit të filmit, e çojnë njeriun në një botë fantastike, boshe, në një botë me King-Kongë, me vrasje e me krimë. Lajtmotivi i këtyre filmave është degjenerimi moral, që në shumë prej tyre, në mos tek të gjithë, mbulohet me kultin e artistit ose të artistes së bukur.

Ndryshe janë filmat tanë. Ata paraqesin jetën e kulturuar socialiste, jetën e klasës punëtore, që me djersën e me punën e saj rron e respektuar nga të gjithë; ata tregojnë fshatarët tanë në punë e në jetë, i tregojnë ashtu siç janë, siç po ngrihen, brenda një ambienti të kulturuar; tregojnë punonjësit tanë të inteligjencies popullore që janë shkrirë me punëtorët e fshatarët, nga radhët e të cilëve kanë dalë dhe që dijet e aftësitetë i kanë vënë në shërbim të tyre.

Jemi shumë të kënaqur që, në përgjithësi, ne kemi shpëtuar nga filmat e huaj me përmbajtje të dobët ideopolitike. Ne nuk jemi ksenofobë, por nga jashtë duhet të sjellim filma përparimtarë, të cilët, sado pak që janë, t'i zgjedhim me kujdes që t'u shërbejnë kërkuesave të popullit tonë e të mbushim boshllëqet që kemi akoma për filma.

Duke e lidhur mendimin tim me atë që thashë më parë, nuk duhet të lejojmë në filmat tanë që bukuria e artistit të arrijë të ngrihet në kult. Ne nuk e mohojmë të bukurën, veçse për ne bukuria qëndron në radhë të parë në interpretimin e artistit në mënyrë sa më të përsosur, sa më natyrale, sa më afër njeriut që takohet realisht në jetë, në punë, në përpjekje, të shkrirë me mendimet dhe me aspiratat e tij.

Për ne jashtë këtij realiteti të pasqyruar edhe në ekranet tona, nuk ka bukuri. Po nuk pati këto karakteristika, po nuk u panë në sytë e tij ajo bukuri dhe freski mendimi, ajo pastërti e jetës së njerëzve tanë. artisti, sado i bukur që të jetë fizikisht, nuk vlen.

Interpretimi i përsosur i aktorit, sigurisht, lidhet me një edukatë artistike, e cila duhet të jetë e vazhdueshme dhe jo e cekët. Që kultura e artistëve tanë të jetë e gjerë, unë, përveç vçprave të letërsisë sonë të realizmit socialist, u rekomandoj atyre të lexojnë edhe libra të tjera të letërsisë përparimi të botërore për të parë se si autorë të njojur, shkrimtarë të shquar të kësaj letërsie, kanë përshkruar jetën e mjeruar të proletariatit, vuajtjet e luftërat e tij, tiparet e njerëzve që punojnë.

Mendoj se regjisori dhe aktori ynë nuk duhet të kufizohen vetëm në ato karakteristika të përshkruara nga autori i skenarit ose i romanit, që do të shërbejë si subjekt për filmin, sepse këto karakteristika mund të jenë të cekëta, autori mund të mos jetë themeluar në mendimet e personazhit të romanit, mund të mos ketë pasur horizonte të gjera mendimi, mund të mos i ketë njojur si duhet dhe sa duhet njerëzit e popullit, mund të mos ketë marrë një «banjo» populli, prandaj ideja kryesore e veprës që vihet në ekran, mund të qëndrojë, po personazhi duhet të përpunohet prej regjisitorit e aktorit. Ne kemi në vendin tonë njerëz të mrekullueshëm, tiparet dhe cilësitë e të cilëve artistët tanë të kinematografisë duhet të ngulmojnë që t'i njojin dhe, pra, vç kulturës libreske që marrin, ata

duhet të futen thellë në mendimet e personazhit që do të paraqitet në ekran, të bëhen një me të. Këta, me siguri, në rast se bëjnë studime të tilla, në qoftë se krijimet e shkrimtarëve tanë i vërejnë me sy kritik, do të arrijnë që të nxjerrin një personazh të përsosur, real.

Shoqja ime Nexhmije, nga biseda që ka pasur me artistin e madh Sandër Prosi, më ka treguar se në filmin «Në fillim të verës», ku ai ka luajtur rolin e një fshatari lab që vjen të punojë në një ndërmarrje italiane, për t'u siguruar nëse i përshtatej me të vërtetë ky rol që do të luante dhe nëse do të ishte bindës përpala publikut, Prosi, shumë i preokupuar për lojën e vet, shkon menjëherë dhë e provon këtë në jetë, në realitet, para se ta provonte rolin e tij përpala kamerave. Me ato rrobat e tij prej fshatari ai shkon në një nga hotel-restaurantet më të mira të Vlorës dhe ulet në një tryezë. Aty vjen kamerierja dhë e pyet: «Or xhaxho, çfarë do ti këtu?». Ai i kërkon një kafe ekspres.

Kamerierja hap sytë dhe i thotë: «Si the!?».

«Një ekspress, moj shoqe», i përgjigjet ai.

«Mirë, një ekspress për xhaxhon».

U sigurua kështu Sandër Prosi se kamerierja qytetare e kishte marrë për fshatar. Pasi piu ekspressin, ai shkoi në një nga rrugët kryesore ku kishte shumë lëvizje, se xhirohej një skenë e filmit, dhe apostasat shtynte herë njërin e herë tjetrin dhe përgjonte ç'do t'i thoshin. «E, or ti, ku je këtu, në fshat? Mos shty, or xhaxho!», i flisin ata që ai shtynte. Edhe këtu artisti Sandër Prosi e kuptoi se i përshtatej rolit të fshatarit.

Këtë preokupacion ne duhet t'ua kultivojmë punonjësve tanë të kinematografisë, sidomos aktorëve, të cilët përfaqësojnë në ekran personazhe nga më të ndryshmet të jetës sonë socialiste, sepse sa më afër masave të gjera të popullit të jetojnë ata, aq më të bukur e realë do të jenë filmat tanë.

Për shembull, në filmin «Beni ecën vetë» është për tu lavdëruar interpretimi aq i natyrshëm e real i Pandi Raidhit. Me të vërtetë këtu nuk mund të dallohet roli nga realiteti. Ky artist, megjithëse lindur në qytet, duke e njojur nga afër jetën e fshatit dhe psikologjinë e fshatarit, e përfaqëson shumë bukur e realisht kooperativistin tonë me atë zemër të pastër, me ato mendime të qarta, me atë durim, me atë dëshirë e zjarr për punën dhe për fshatin. Edhe Beni në fshat luan në një mënyrë të natyrshme me shokët, mësohet, del në jetën e gjallë, i punon mendja, i punojnë edhe krahët e këmbët, krijon një shoqëri të shëndoshë, gjë që do t'i shërbejë shumë, kur ai të kthehet në qytet.

Ose të lë mbresa të mëdha filmi «Lulëkuqet mbi mure», një film me të vërtetë real, tek i cili interpretimi i djemve të vegjël e i mësuesit patriot, si dhe i gjithë të tjerëve, të merr e të fut në një jetë reale që ka ekzistuar, një jetë me vuajtje nën robërinë e dredhitë e pushtucit, dhe të duket sikur je me të vërtetë përparrë një bote plot vuajtje e mjerime, por ku të vegjëlit ushqehen me ndjenjën e zjarrtë të at-dheshurisë e të urrejtjes për armikun, kaliten të rezistojnë e të luftojnë edhe ata kundër pushtuesve.

Të kujtohet koha e luftës ilegale që kemi bërë në qytete, kur sheh pikërisht filmin «Illegalët». Komunistët me të vërtetë ndiejnë një satisfaksion kur shikojnë heroin kryesor, sekretarin e Partisë, këtë personazh real të goditur dhe jo të idealizuar, por ashtu siç kanë qenë e siç janë në jetë komunistët, të thjeshtë, të vendosur, të qartë për luftën që bëjnë dhe të gatshëm për sakrifica.

Po ashtu në filmin «Tinguj lufte» të lënë mbresa heroizmi i mësuesit, rezistenca e tij, puna që bën ai për edukimin e djalit të varfër shërbëtor të ardhur nga fshati, i cili del në mal partizan i vogël, duke marrë violinën me vete. Ky i ndodhet pranë mësuesit të plagosur për vdekje, i cili i thotë: «Bjeri violinës e ndiq rrugën time».

Unë besoj se tash kinostudioja dhe artistët tanë janë në gjendje të krijojnë të tillë filma për të gjitha fushat dhe në shkallë të gjerë. Ne duhet të përgatitim edhe më shumë filma jo vetëm në numër, por sidomos me një nivel akoma më të lartë idecoartistik. Por kur vëmë kërkesa përpara kinematografisë, të kemi kujdes të mos i trajtojmë problemet në mënyrë mekanike dhe të vazhdojmë të kërkojmë plotësimin e atyre detyrave të mëdha që në fakt kanë filluar të zgjidhen drejt prej saj, sepse në këtë mënyrë mund t'i çorientojmë punonjësit e kinematografisë që janë vënë në rrugë të mbarë. Këtu, siç e shikoni, unë jam në kundërshtim me idenë e xhirimit të filmave epope, si për shembull për Luftën e Tiranës. Mua më duket se nuk duhet të ndjekim rrugët e vjetra të Sesil

Bloount Dë Milit, luftërat e Trojës apo luftërat e arenave romake etj., etj., sepse, përveç të tjerave, filma të tillë, sikurse u tha këtu, duan dy-tre vjet të realizohen. Ne kemi forma të tjera që na përshtaten për përgatitjen e filmave dhe kemi hyrë në këtë rrugë. Gjithashtu, detyrat e pasqyrimit të epikës së luftës, të ndërtimit socialist dhe të rolit hegemon të klasës punëtore nuk duhet menduar se do të zgjidhen vetëm në disa filma të veçantë. Me një film për luftën në shkallë epopeje, s'mund të themi se u zgjidh kjo çështje. Jo. Temat e mëdha, si ajo e Luftës Nacionalçlirimtare, e jetës socialiste, e ndërtimit të industrisë sonë, e zhvillimit të socializmit në fshat etj., do të realizohen nëpërmjet krijimtarisë së shumanshme të kinematografisë sonë, nëpërmjet shumë filmave, prandaj edhe në të ardhmen ne duhet të kërkojmë që në filmat tanë të trajtohen subjekte të ndryshme të veçanta dhe në to të dalë si duhet edhe roli udhëheqës i Partisë, roli hegemon i klasës punëtore në Luftën Nacionalçlirimtare apo në kohën e tanishme etj., etj. Unë kam bindjen se të tilla tema ju do t'i gjeni në çdo hap që do të hidhni në punën tuaj. Ju do të keni kërkesa për filma të tillë dhe mendoj se për këtë çështje regjisoret e aktorët dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, të gjithë në një bashkëpunim të ngushtë, do të kenë mundësi të zgjedhin tema të kësaj natyre nga letërsia artistike, që po zhvillohet me vrull në vendin tonë socialist. Mendoj se tash nuk jemi më si në kohët e para, kur vuanim edhe për skenarë, dhe këtë e nxirrnim si një arsyé për mos-realizimin e filmave, kur pengesë ishin edhe munge-

sat materiale ose të kuadrove artistë. Për sa u përket këtyre të fundit, e sidomos numrit dhe ngritjes ideo-profesionale të tyre, s'mund të krahasohemi me vitet e para, pse, përveç artistëve të shquar të teatrit e të kinematografisë, që janë afirmuar me rolet e tyre të një niveli të lartë, ne kemi tash edhe një numër të madh artistësh amatorë, të cilët këndojnë, kërcejnë e interpretojnë për mrekulli, kanë një pasion të zjarrtë për t'i shërbyer socializmit, kanë një kurajë e një dëshirë të madhe për të dalë në skenat tona dhe me një ndjenjë devocioni të veçantë për artin bëjnë përpjekje të kënaqin popullin, që është aq i apasionuar pas artit tonë të bukur të realizmit socialist. Trajtimi i artistëve, qofshin profesionistë, amatorë a të vegjël në moshë, që përmendën shokët, duhet shikuar me një sy tjetër dhe jo ashtu siç është bërë, pse qëndrimi i mbajtur, siç u tha këtu, nuk duhet të lejohet. Skenarë për filmat tanë le të kërkohen në romanet e shkrimtarëve të shquar e të afirmuar të vendit tonë, por unë them të mos harrojmë edhe novelat e këtyre shkrimtarëve, gjithashtu, edhe të shkrimtarëve të rinj, se ndër to mund të gjejmë subjekte të përshtatshme që, po të përpunohen, do të na japin filma të bukur.

Kurdoherë duhet qëndruar në atë që thashë më parë: zotësia e skenaristit, e regjisoret ose e aktorit është që ata ta zhvillojnë më tej novelën, ta pasurojnë atë edhe me mendimet e interpretimin e vërtetë që ua kanë mësuar eksperiencia e skenës ose «banjat» në popull. Në këto drejtime ne kemi fusha të gjera ku

të punojmë e të mbështetemi. Kemi njerëz të mrekullueshëm në masat e popullit, nga të cilët punonjësit e kinematografisë e të televizionit mund të zgjedhin aktorë joprofesionistë, që, po të ndihmohen dhe t'i futen me kujdes studimit të personazhit, mund të luajnë lirisht nëpër filma.

Një kërkesë me rëndësi për cilësinë e filmit është interpretimi i rolit fare lirshëm, pa u ndrydhur, jo në ato forma që menjëherë të jepin përshtypjen se artisti flet me zor, bën disa gjeste të alambikuara, të rekomanduara. Artistja e madhe Violeta Manushi interpreton krejt lirisht. Për shembull, në filmin «Zonja nga qyteti» ajo të bind që është me të vërtetë një grua qytetare, e cila ka shkuar në fshat nga e keqja, prandaj spektatori tek ajo shikon fare mirë karakteristikat e një gruaje qytetare me shumë mbeturina, por që pak nga pak, nën ndikimin e njerëzve të punës në fshat, të edukuar nga Partia, mëson dhe merr anët e mira që kajeta e fshatit. Në këto drejtime kinematografia jonë ka arritur suksese të mëdha.

E lidhur me të gjitha këto është edhe teknika, që luan një rol të madh. Këtu e kam fjalën, në radhë të parë, për teknikën e thjeshtë, për aparaturat. Natyrisht, aq sa na lejojnë mundësitetë, ne duhet të bëjmë përpjekje t'u shtojmë studiove tona disa mjete dhe aparatura të nevojshme që i bëjnë fotografimin dhe paraqitjen e figurës më të bukur, më të përsosur e më tërheqëse. Punonjësit e kinematografisë dhe të televizionit tonë duhet të bëjnë përpjekje që t'i arrijnë këto gjëra, por, gjithashtu, atyre që merren dhe që punojnë me

këtë teknikë u rekomandoj të mësojnë akoma dhe vazhdimisht, sepse, në qoftë se nuk gabohem, teknika e kinematografisë ose e televizionit nuk është diçka e thjeshtë, ajo lidhet me probleme parimore të fizikës, të elektronikës, të kimisë e të shkencave të tjera, pra nuk ka të bëjë vetëm me përdorimin në mënyrë automatike të aparaturave, por, në radhë të parë, me të kuptuarit thellë, me përvetësimin teorik të teknikës së tyre, sepse pikërisht si rezultat i kësaj realizohet si duhet ideja kryesore e filmit, paraqitet si duhet loja e artistëve. pasqyrohen bukur, në mënyrë mahnitëse, ashtu siç janë, natyra e vendit tonë, bjeshkët tona, kalatë e luttës, vendet ku jeton e punon populli ynë trim e heroik, fushat e gjera pjellore, të cilat nga vende dikur me ferra e moçalishtë, janë bërë sot kopshte të lulëzuara, fshatrat tona të bukura e qytetet krejt të reja që ka ndërtuar populli, nën udhëheqjen e Partisë, gjatë kësaj periudhe kaq të shkurtër që nga Çlirimi i vendit e deri sot. Pra edhe aparaturat, së bashku me zotësinë e atyre që i përdorin ato, luajnë një rol të rëndësishëm. Figura e pastër dhe e bukur që realizohet nëpërmjet tyre, bën që të rritet te njerëzit tanë dashuria e madhe për atdheun, të nxitet populli ta mbrojë veprën e tij të pavdekshme, socializmin, ta mbrojë atë duke e bërë mish e gjak të vtin ideologjinë e Partisë, marksizëm-leninizmin.

Artistët e të gjithë punonjësit e kinematografisë dhe të televizionit, të këtyre degëve të rëndësishme të frontit të kulturës e të propagandës sonë, duhet të përvetësojnë thellë mendimin teorik marksist-léninist të

Partisë sonë, të cilin e shohim të pasqyruar si duhet në ekran. Me të gjitha proceset artistike, nga loja e aktorit e deri te teknika, ata, duke treguar realitetin e vërtetë të Shqipërisë së re socialiste, u hapin njerëzve tanë perspektiva të reja. Të gjitha shoqet dhe shokët e këtij fronti të rëndësishëm të ndërtimit tonë socialist duhet të mbështeten fort në vijën e drejtë të Partisë, e cila është e pagabueshme, sepse bazohet në mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Është forca krijuese, është mendimi i drejtë i Partisë së Punës të Shqipërisë që, duke u mbështetur në këto ide të klasikëve tanë dhe në eksperiencën e madhe të popullit e të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. E bëjnë të përparojë Shqipërinë dhe zbuluojnë njeriun tonë të ri. Kinematografia dhe televizioni i bëjnë një shërbim të madh Partisë dhe popullit, por një shërbim të madh i bën kinematografian jonë edhe internacionalizmit proletar, sepse, siç e thashë më parë, nga informatat që kam, jashtë, dhe në konkurset e filmave që janë organizuar në vende të ndryshme, filmat tanë korrin suksese dhe kërkohen, ata kanë filluar të njihen, të pëlqehen e të popullarizohen. Njerëzit përparimtarë të vendeve të tjera shikojnë se nga filmat tanë ka se ç'të mësojë populli i tyre, rinja e tyre.

Së fundi dëshiroj të shtoj që të prodrojmë edhe më shumë filma për moshat e reja, e sidomos për fëmijët, që janë e ardhmja e vendit tonë. Në përpjesëtime të drcjta të prodrojmë filma edhe për të gjitha masat e popullit, në të tëra drejtimet.

Ju uroj suksese, shokë, dhe jam i bindur se direktivat e Partisë e të Kongresit të 7-të të saj ju do t'i plotësoni me sukses.

*Botuar për herë të parë, me  
disa shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1976-1977», f. 173*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## **KUR NJIHEN KONKRETISHT PROBLEMET, NXIRREN KONKLUZIONE TË DREJTA**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**5 shkurt 1977**

Si mendoni të procedojmë për këtë çështje me kaq rëndësi? Unë them të flasin njëherë shokët që kemi thirrur, për të parë si është situata. Ja, për shembull, të na flasë një çikë shoqja sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit. Si i keni punët me grurin? Vjet ju nuk i realizuat si duhet të gjitha detyrat e planit në sektorin e bujqësisë. Keni bërë autokritikë si sekretarë dhe komitet partie?

A mund të na thuash se cilat janë masat tekniko-organizative që keni menduar të merrni këtë vit? Si do ta zbatoni shkencën në bujqësi dhe, lidhur me këtë, çfarë pune konkrete bëjnë komiteti ekzekutiv me seksionin e bujqësisë, çfarë masash kanë përcaktuar ata

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për gjendjen e grurit dhe masat për mbjelljet e pranverës.

dhe çfarë bën Partia nga ana e saj për mbarëvajtjen e bujqësisë? Sqarimet ne i duam të jenë konkrete, sepse këtu pothuajse të tërë jemi qytetarë dhe nuk i dimë me hollësi të gjitha çështjet e bujqësisë. Disa nga shokët drejtues të rretheve na japid shpjegime të përgjithshme e me fraza stereotipe, ndërsa ne kërkojmë t'i dimë me saktësi gjërat. Për shembull, ju keni agronomë të cilët i njohin shkencat bujqësore. Atëherë mund të na thoni sa grupe pune keni formuar me këta specialistë, si konsultoheni e çfarë mbledhjesh bëni me ta, si i organizoni që të shtrojnë mendimet e tyre, të bëjnë vërejtje, sugjerime etj.? I mblidhni dhe bisedoni ju me këta specialistë përparrë se të filloni mbjelljet? A e praktikoni këtë metodë pune për të gjitha rastet e tjera? Ti vetë ke asistuar ndonjëherë në mbledhjet me specialistët në seksionin e bujqësisë të komitetit ekzekutiv, për probleme të bujqësisë?

Po specialistët kanë mendime të studiuara e të rracha në grupe pune, janë mbledhur ndonjëherë në seksionin e bujqësisë për të diskutuar çështje të rëndësishme, si, për shembull, përdorimi i plehrave në lloje të ndryshme bimësh, sasia që duhet hedhur për çdo hektar etj.? Pse ullinjve të Mallakastrës nuk u hidhni pleh në masën e caktuar? Me sa duket, nga ana juaj këto probleme nuk janë studiuar si duhet, nuk janë caktuar sasitë e nevojshme të plehut për çdo rrënje ulliri dhe nuk janë zbatuar rregullat e caktuara agro-teknike, në një kohë kur ne po flasim me të madhe për aplikimin e shkencës në bujqësi. Ne tani për tani nuk e kemi gjithë sasinë e superfosfatit, për shembull, që u

duhet bimëve, po për plehrat e tjera e për të gjitha shërbimet që u duhen bërë bimëve sipas kërkesave të agro-teknikës, si po veprohet? Duke i hedhur më pak pleh pambukut, ta zëmë, dhe duke ia shtuar grurit ose ndonjë bime tjetër, si do të plotësohen nevojat për pambuk, për zarzavatë e për produkte të tjera që n'a duhen?

Nga këto pyetje dhe nga përgjigjet tuaja, ne duam të nxjerrim disa konkluzione që mendojmë se kanë rëndësi të madhe për bujqësinë tonë. Shumë gjëra që na thuhen këtu dhe që ne i kemi dëgjuar të na përsëriten që nga ministria e deri në bazë, të tilla si «Kemi këshilla shkencorë, ata mblidhen e funksionojnë rregullisht, specialistët pycten e zëri i tyre dëgjohet etj., etj., nuk na thonë diçka konkrete, por vetëm përsëritin udhëzimet që kanë dhënë Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria se si duhet të veprohet për këto probleme. Çështja qëndron në atë që sa mblidhen konkretisht këta këshilla shkencorë, si diskutojnë në periudha të ndryshme, qoftë kur bëhet plani, qoftë në kohë fushate e për të gjitha punët. Ju thatë që s'ka pleh me shumicë, mirë, aq sa kemi, po specialistët kanë caktuar proporcione për sasinë e plehut që do të përdoret për çdo lloj bime? Kanë caktuar ata, fjala vjen, që grurit do t'i hedhin kaq, misrit aq etj.? Këto proporcione caktohen sepse aq pleh kemi. Mirëpo, në qoftë se do t'i hidhet grurit tërë sasia e plehut që është parashikuar edhe për bimë të tjera, atëherë ç'bëhet? Mund të thuhet që ja, morëm më shumë grurë. Po prodhimet e tjera? Specialistët kanë mendime, kanë propozime e sugjerime se

si duhem bërë këto punë, por si do të merren mendimet e tyre nëse nuk funksionojnë mirë e në rregull këshillat shkencorë? Sipas informatave që kemi, këta këshilla jo vetëm në Fier, ndonëse mundet që aty të njihen diçka më mirë derisa dëgjohen, por në shumë vende, nga qendra e rrethit deri në kooperativa, ndonëse mund të mblidhen, nuk bëjnë ndonjë punë të thellë, prandaj nuk japid rezultatet e duhura. Sot në gazetë kishte një artikull që fiste për këshillat shkencorë të historisë dhe të gjuhës në rrethin e Librazhdit. Në qoftë se nuk gabohem, në atë rreth punojnë mbi 160 arsimtarë me shkollë të lartë të profileve të gjuhës dhe të historisë, të cilët nuk kanë as plan të punës shkencore, as studime nuk kanë bërë e as iniciativa nuk kanë marrë. Megjithatë, atje thonë që këshillat shkencorë të bujqësisë janë mbledhur më në rregull. Po të ishte këtu shoku i Librazhdit do të na thoshtë se në rrethin tonë kemi kaq këshilla shkencorë që punojnë kështu e ashtu, pa na treguar ndonjë gjë konkrete. Prandaj ne këtu duam t'i njohim konkretisht problemet, sepse kështu mund të nxirren konkluzione të drejta.

Ja, për shembull, ju shokë të komiteteve të Partisë të Lushnjës e të Lezhës, që ju kemi këtu, ju kanë lajmëruar që ka rrezik përrhapjen e tuberkulozit dhe të brucelozës në lopë ose që ekziston një sëmundje në derrat, ose diçka tjeter? Ju kanë ardhur udhëzime shkencore dhe mbi bazën e tyre të mblidhni specialistët për t'u thënë që të kenë kujdes në përdorimin e nitrat amonit e të uresë? E keni shtruar problemin pse ngordhin lepujt nëpër fusha e si do të bëjmë, do ta zhdukim

lepurin? Shkencëtarët dhe specialistët duhet t'i diskutojnë çështje të tillë. A ju lajmëron Ministria e Bujqësisë për këto gjëra dhe a mblidhen specialistët të bëjnë konsulta për to? Për shembull, si u përcoll nga rrethi i Fierit deri në bazë udhëzimi i ministrisë për përdorimin e uresë në masën e duhur?

Po për pemët frutore si do të veproni? Për to është bërë pak punë. Kësaj i thonë mbill dhe mos korr. Ky është problem për gjithë vendin. Na thoni se këtë vit keni organizuar brigada të veçanta për pemët frutore. Neve na u zbardhën flokët që nga koha që po flasim për këto brigada. Qysh atëherë kanë kaluar dhjetëra vjet, prandaj si mund të thuhet se po bëhen këtë vit? Mos thuhet kjo sa për të kaluar radhën? Si do të ecë puna kështu? Kooperativistët paguhen për shërbimet që bëjnë, po sa fruta marrin? Po prodhimet e ullinjve që kemi mbjellë para dhjetë vjetëve, ku janë, sa kilogramë për rrënje jatin këta ullinj?

Nuk është puna për të ndier përgjegjësi për mosrealizimet, por duhet zgjidhur problemi, duhen plotësuar detyrat, ndryshe nuk mund të përballojmë situat. Këtë ta kuptojnë mirë organet dhe organizatat-bazë të Partisë që të mos vihemë përpara vështirësish dhe nesër të themi: «U bë si u bë». Punëve t'u dalim përpara.

*Në përgjigje të këtyre pyetjeve, sekretarja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit trajtoi me frymë autokritike disa çështje të bujqësisë në rreth dhe foli për masat që po merreshin për të realizuar detyrat vjetore. Pastaj shoku Enver Hoxha tha:*

Kush dëshiron të na flasë tani nga shokët sekretarë të rrtheve? Ti shoku Peti<sup>1</sup> mund të na thuash diçka, unë kam kohë që nuk ta kam dëgjuar zërin dhe me gjithë mend më ka marrë malli. Na thuaj një çikë si i keni lopët, sepse na shqetëson shumë ajo që na thanë se në Lezhë e në Shkodër është shfaqur tuberkulozi në lopë. Planin e dorëzimit të mishit sikur nuk e keni realizuar. Po numrin e viçave, si. dhe peshën për çdo viç, i realizuat? Atë tepricë baze ushqimore me të cilën do të rritnit edhe 300 viça të tjerë, por që nuk ju erdhën, pse nuk ia dhatë kooperativës së Balldrenit? Ku vajti kjo sasi ushqimi?

A i keni marrë të gjitha masat që kashta e grurit dhe e misrit të përdoret mirë? Tani që zbatohet rregulli që paga është e lidhur me prodhimin, mos është pak përqindja e tejkalimit të planit për ndërmarrjet bujqësore? Mos duhet ta ngremë edhe një çikë më tepër, që të lidhen akoma më shumë me prodhimin punëtorët e këtyre ndërmarrjeve? Unë kam mendimin se mund t'ua ngremë ca.

E keni mirë grurin sivjet? Çfarë bëhet për kanalet e dyta dhe të treta në fushën e rrëthit tuaj? Po shteti ç'po bën për kënetën e Kakariqit? Po për drenazhimin e kanaleve kryesore? I keni biseduar me shokët e Ministrisë së Bujqësisë këto çështje? Puna është se kur do të zbatohen projektet për sistemimin e tokave. Kjo na intereson neve më shumë, sepse ato parcelat në

---

1. Peti Shamblli, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrëthit të Lezhës.

rrethin tuaj, të cilat duhen sistemuar, janë të mëdha. Projektet ju i bëni me ndërmarrjet që keni në rreth. Atëherë ca më mirë, i kontrolloni këto ndërmarrje për projektet që bëjnë? Tani kërkohet që të gjitha projektit të zbatohen dhe të realizohen detyrat e caktuara.

Keni ndonjë gjë tjetër, shokë, veç këtyre që na janë thënë në materialin që na është paraqitur? Ju të Ministrisë së Bujqësisë na e keni dhënë këtë informacion, prandaj na thoni po të keni ndonjë gjë të re.

*Pasi shokë të pranishëm në mbledhje bënë shpjetimet përkatëse për pyetjet e mësipërme dhe shtruan disa probleme lidhur me punët e ditës në bujqësi, shoku Enver Hoxha tha:*

Lidhur me problemen që u ngrit këtu për të bërë disa porosi për materiale jashtë vendit, them se ato nuk realizohen dot. Tani në këtë periudhë të vitit nuk mund të bëjmë porosi dhe këtë ta kemi të qartë: U firmos kontrata, mbaroi çdo gjë; gjërat që nuk u porositën mbetën për vitin tjetër.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbalit i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## SI T'I BËJME MË REVOLUCIONARE MBLEDHIJET E PARTISE

*Nga biseda me shokun Qirjako Mihali<sup>1</sup>*

7 shkurt 1977

Sic e the edhe ti, shoku Qirjako, punimi i materialeve të Kongresit të 7-të të Partisë në një mënyrë të re, është një gjë e mirë, por të kemi parasysh se menjëherë nuk arrihet përsosmëria. Këtë formë të re për edukimin e komunistëve duhet ta konsiderojmë si një metodë pune që del nga kuadri i rutinës së zakonshme. Ka rëndësi të kuptohet që me metodën e vjetër të punës së plenumeve, me disa diskutime, ose me dërgimin e ndonjë instruktori nuk bëhet në nivelin e kërkuar mobilizimi i gjerë i komunistëve për shtruarjen, kuptimin dhe diskutimin e problemeve të mëdha që u trajtuan në Kongresin e 7-të. Komunistët venë, diskutojnë dhe marrin vendime në organizatën-bazë, pastaj veprojnë, por çështja është që shpjegimi i një direktive të rëndë-

---

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

sishme të Partisë, siç janë këto të Kongresit të 7-të, të mos bëhet në forma të thjeshta e të rëndomta.

Shumë herë në organizatën-bazë problemet nuk merren në diskutim në formë revolucionare, për to nuk bëhen debate, por vihet sa për ta shtruar çështjen, pastaj njerëzit shohin orën që të largohen, se «e kryen detyrën». Prandaj është e drejtë forma që menduan, sipas së cilës më parë duheshin zgjedhur e grumbulluar komunistët sipas specifikës, ashtu siç i keni zgjedhur dhe ju për të përgatitur materialet, dështojnë vështirësia e referuar. Pas kësaj, atyre u kërkohet t'u përgjigjen pyetjeve që do të ngrenë komunistët, të cilët do të asistojnë në debat. Këto çështje specifike, siç mund të jetë problemi i diktaturës së proletariatit, kanë në vëtvete një sërë problemesh të tjera. Edhe problemi aq i gjerë i bujqësisë ka, gjithashtu, një sërë problemesh e kështu me radhë të gjithë sektorët e tjcrë.

Unë kisha shfaqur mendimin që për problemet kryesore të mos ketë vetëm një referat, po mund të ketë edhe dy, edhe tri. Për shembull, për industrinë të mos ketë një referat, se është e zorshme të shpjegojet vetëm më një temë gjithë vija e Partisë për këtë sektor kaq të gjerë. Prandaj shokëve, në lidhje me këtë metodë, u rekomandova të përgatitin nga dy-tri referate për çdo çështje kryesore, të cilat të mbahen qoftë edhe gjatë një dite, të bëhen pastaj pyetjet dhe të nesërmënen të fillohet me diskutime. Dhe gjatë gjithë kësaj pune duhet të mbahen në shënim si problemet që do të ngrihen nga diskutantët, ashtu edhe pyetjet që do të bëhen dhe si ngrihen ato.

Duhet të mbahet parasysh që referuesi nuk mund të jetë enciklopedik. Për shembull, ai që do të ngarkohet të flasë në një organizatë për çështjet e kapitullit të parë, për Kushtetutën e Republikës ose për diktaturën e proletariatit, mund të mos ketë njohuri teorike në gjithë gjërësinë e problemit. Por, në qoftë se ne do ta ndanim në dy ose në tri pjesë këtë kapitull, atëherë, kur të bëhen pyetje, ai që është kompetent apo speciaлист në këtë ose atë anë të problemit, ngarkohet të japë shpjegime të qarta, duke punuar që t'ia ngulë çështjen me durim në kokë atij që bën pyetjen. Për një problem tjetër ngrihet një i dytë, që është, gjithashtu, specialist po për të e kështu me radhë. Kur të vijë puna të flitet, për shembull, për çështjet e këshillave popullorë, për rëndësinë e tyre dhe të aparatit shtetëror, atëherë ai që është specialist për këto çështje dhe që di jo vetëm teorinë, por edhe si veprohet e punohet në praktikë, flet me kompetencë dhe ilustron temën me shembuj nga jeta, ose një tjetër mund të trajtojë luftën kundër armikut të klasës. Duke qenë specialist për këtë problem, ai është në gjendje të flasë jo vctëm teorikisht, por të japë edhe shembuj konkretë. Referuesi i parë në përgjithësi mund të jetë në gjendje të flasë për problemin e këshillave popullorë nga ana teorike, se është një kuadër i ngritur. Ky referues mund të jetë, fjala vjen, një funksionar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili çdo muaj vete në bazë dhë i ndihmon e i kontrollon këshillat popullorë, përpinqet të shohë funksionimin e tyre, q'gabime e ç'të meta vërt-

tetohen etj. Ai pra mund të jetë më në gjendje t'u japë shpjegime komunistëve për këtë çështje.

Në qoftë se ne nuk do të veprojmë kështu, nuk do të kemi një pasqyrë të qartë për problemin. Për shembull, ai që është ngarkuar të flasë për industrinë, pa e parë problemin në të gjitha aspektet, nuk do të mund të na japë dot një tablo të perspektivës ku do të arrijë industria jonë. Dalim te çështja që të mos kufizohemi vetëm në anën teorike të çështjes, në disa vija të përgjithshme. Pastaj pas referimit mund të dalin pyetje të veçanta që as referuesi, sado me horizont të jetë, mund të mos i dijë, prandaj ai i grumbullon me kujdes pyetjet që i drejtojnë dhe në bashkëpunim e konsultim me sekretarin e organizatës së Partisë, pasi sistemojnë pyetjet, zgjedhin punonjësit më të mirë të ndërmarrjes që janë specialistë për çështje të veçanta, të cilëve u japid pyetjet sipas kategorive që janë ngritur, ta zëmë disa për çështjen e normave, të tjerat për assortimentet, cilësinë etj., etj., dhe i ngarkojnë të flasin e të japid shpjegime. Kështu ne e plotësojmë shpjegimin që nuk mundemi të bëjmë dot vetëm me referatin. Pra, mbledhim përnjëherë tre-katër specialistë të ndarë sipas kategorisë së pyetjeve, që edhe teorinë e njojin, dhe këta flasin konkretisht për këtë ose atë çështje, pse e dinë si zbatohen këto në praktikë. Domethënë mund të procedohet edhe në këtë mënyrë.

Ne duhet t'i mësojmë Partinë dhe komunistët që të bëjnë pyetje. Pyetja është një formë pune sqaruese, së cilës duhet t'i jepet rrugë nga i deleguari, nga se-

kretari i organizatës-bazë ose nga anëtari i komitetit të Partisë që vete të punojë në bazë një direktivë. Ajo shpreh preokupimin e madh të komunistit, i cili mund të mos ketë të qartë një ose shumë probleme, ose mund ta ketë gjysmë të qartë ose mund ta ketë shumë të qartë problemin, por do, si të thuash, që të shikojë çfarë thotë udhëheqja e Partisë për këtë osa atë problem. Të gjitha pyetjet që bëhen e kanë këtë aspekt.

Pyetjeve ne në asnjë mënyrë nuk duhet t'u shmangem, ndryshe nuk e kemi kryer si duhet detyrën ndaj Partisë, nuk kemi nxitur mendimin krijues të komunisteve dhe ky mendim krijues zhvillohet nëpërmjet një debati. Vetë pyetjet e përgjigjet janë debate, jo kurdoherë në vijën që ka menduar dhe është përgatitur referuesi përpara se të vejë të bisedojë me shokët.

Pyetje-përgjigjet janë debate joantagoniste, po shumë herë pyetjet shprchin edhe moskuptime ose kuptime të shtrembëruara të problemeve. Në këto raste detyra e punëtorit të Partisë që vete në një organizatë-bazë për të shtruar një direktivë, është, së pari, që ta shtrojë këtë direktivë qartë dhe drejt. Dhe shtrimi qartë e drejt i direktivës bëhet duke u larguar nga forma e rëndomtë e të folurit.

Si shkak i mungesës së pyetjeve është edhe intelektualizmi. Intelektualët, përpara se të pyesin, mendjnë: S'është nevoja të pyes unë për këtë, se e di që, po të pyes, mund të më dalë bakri, se mund të ketë njerëz më të zotë nga unë që të thonë: «More, po ky që na hiqet sikur di, nuk ditka gjë fare, se shiko

ç'pyetje bën», kurse pyetja e tij mund të jetë shumë me vend. Pastaj nuk është e thënë që një intelektual t'i dijë të gjitha, prandaj pyetja që mund të bëhet nga ana e tij, çshtë diçka e natyrshme. Është e vërtetë, që intelektuali e ka këtë dobësi, por arsyesa përse nuk bëhet pyetje qëndron, mendoj unë, të shokët e Partisë që vonë në bazë, pse ka prej tyre që nuk shkojnë të përgatitur siç duhet për atë që do të flasin, nuk e zotërojnë si duhet problemin. Në këto kushte ata kanë druajtje dhe frikë të qëndrojnë përballë të papriturave, prandaj, po të jetë e mundur, duan të mos ketë pyetje, ose të ketë disa pyetje të përgjithshme, të cilave instruktori ose referuesi t'u përgjigjet më lehtë, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe pastaj të përpinqet që pyetjet të mbyllen.

Një prirje e tillë duhet luftuar. Pse ç'ngjet? Të gjitha pyetjet që bëhen, në përgjithësi, në qoftë se ndërmjet tyre ka nga ato të cilat dalin nga normat që ka parashikuar në kokën e vet instruktori, konsiderohen pyetje të dyshimta dhe thuhet: «Pse e bëri ky këtë pyetje?». Dhe vjen raporton lart, në komitet. Bile na kanë raportuar edhe këtu, në Komitetin Qendror, që ja, filani bëri një pyetje me tendencë. Këto mendime e veprime i kufizojnë pyetjet, edhe kur këto janë në rrugë partie.

Të marrim si shembull një fakt: Derisa Partisë i bëhet e ditur çështja e marrëdhënieve me Kinën, komunistët do të drejojnë edhe pyetje në organizatë. Detyra e të deleguarit është që t'u përgjigjet kötyre pyetjeve, duke shpjeguar se ç'mendon Partia jonë për çështjet që kërkojnë sqarim. Pyetjet në këto raste janë të natyr-

shme, shumë të natyrshme, pse të tëra këto pyetje që bën një njeri ziejnë në kokën e tij si komunist dhe ne duhet t'i inkurajojmë pyetjet e t'u japim përgjigje.

Ne duhet t'i mësojmë komunistët që të mos kenë frikë për të bërë pyetje. Frika nga pyetjet vjen, më duket mua, për arsyet se njerëzit që venë të punojnë materialet e ndryshme të Partisë nuk përgatiten thellësisht si duhet, po punojnë në mënyrë të sipërfaqshme, përgatiten në atë mënyrë që të mos gjejnë kundërshtime nga dëgjuesit, domethënë të mos u bëhen pyetje kontradiktore. Të tillë shokë partie përpinqen të evitojnë debatet në fryshtë revolucionare. Ne themi se duhet të ekzistojë frysma revolucionare në Parti, po kjo fryshtë revolucionare duhet të zhvillohet.

Tjetri ka të drejtë të bëjë edhe ndonjë vërejtje ose kritikë në organizatë pér një çështje të caktuar, pér një udhëzim të dhënë, po kjo nuk do të thotë se është armik. Në rast se ai e bën pyetjen, se nuk e kupton si duhet çështjen, atëherë i ngarkuari nga Partia që ka shkuar në mbledhje, i bën thirrje një specialisti të ngrihet dhe të flasë drejt e qartë pér këtë problem. Ai që ngre një çështje, kur nuk e ka të qartë një situatë, ose kur sheh se nuk është zbatuar drejt një direktivë e Partisë ose një vendim i Qeverisë, ka të drejtë të pyesë, të japë mendim dhe kjo nuk do të thotë aspak se është kundër vijës së Partisë. Qeveria merr vendime, po çfarë bëhet me to në praktikë? Sigurisht, ju e dini se nuk ka ndonjë vendim që, kur t'i shiten një qytetari, fjala vjen, gjashë filxhanë, ai të detyrohet të marrë bashkë me ta edhe një kanë nga

ato që kanë mbetur stok pa shitur. Në qoftë se blerësi nuk merr kanën, shitësi s'ia jep filxhanët. Pra, në këtë rast s'kemi të bëjmë me një direktivë. Atëherë ai që vete të flasë përpara masës për çështje të tregtisë dhe të mirëqenies së popullit etj., ngrihet e kritikon që kjo formë tregtie nuk është aspak e drejtë. Si t'i përgjigjesh këtij njeriu që flet kështu? T'i thuhet që ti nuk je njeri i mirë? Jo, atij duhet t'i jepet përgjigje.

Përgatitja e njerëzve që venë të flasin në masën e komunistëve dhe të punonjësve për çështje të ndryshme, duhet të bëhet më e thellë dhe një punë e mirë në këtë drejtim të bëjë që të nxiten pyetjet.

Nxitja e pyetjeve, po ta shikosh me syrin marksist-leninist, ka shumë të mira: nëpërmjet tyre Partia shikon si reagon masa e komunistëve dhe e punonjësve, sa i kuptojnë ata problemet, sa i kuptojnë direktivat e Partisë, cilët janë njerëzit që i kuptojnë me të vërtetë drejt e mirë dhe këtyre ajo u vë syrin jo kurdoherë me synimin për t'i ngritur në vende udhëheqëse, por për t'i pasur si propagandistë të shquar të vijës së saj. Nëpërmjet pyetjeve Partia shikon, gjithashtu, edhe pikëpamjet e ndryshme të njerëzve. Mbi këto pikëpamje që dalin nga pyetjet dhe nga diskutimet duhet të reflektohet, nëse kanë karakter militant, karakter revolucionar apo bëhen nga disa njerëz me qëllime jo të mira. Edhe këtë anë duhet ta shikojë me kujdes Partia. Pastaj Partia ka caktuar rregulla që, edhe sikur pyetjet të bëhen me qëllime jo të mira, detyra e saj është që njerëzit t'i ndihmojë të ndreqen. Po ndreqja e njerëzve si bëhet? Me të shpjeguar, me sqarime, duke ua

argumentuar që pikëpamja e tyre nuk është e drejtë, se këtë ata e kanë gabim dhe këlë ua rrëzon me argumente të shumta. Pra, nga kjo metodë pune ne nxjerrrim shumë të mira për Partinë.

Në këtë drejtim, më duket mua, e kemi ca dobët punën dhe këndej lind edhe kulti i udhëheqjes, lind gjithashtu, prepotenca, sepse kur një person vete përpara komunistëve dhe shtron çështjet në mënyrë të rëndomtë e me një fryshtë të tillë që nuk i pranon me qejf pyetjet, mendimet e kundërta dhe debatet, do të thotë që ai përpinqet të mbajë të myllura te njerëzit mendime jo të qarta, të cilat ata mund edhe të mos i thonë në mbledhje, po i shfaqin pastaj jashtë saj. Ne nuk mund t'i themi tjetrit të myllë gojën për këtë ose për atë çështje. Ne mund t'i themi komunistit që çështjet organizative për një problem të caktuar, që janë sekrete, nuk duhet t'i bëjë muhabete pazari, për të tjerat ai do të diskutojë me shokët e tij, sidomos kur vihet në një situatë që duhet të flasë me ndonjë për këtë ose për atë problem dhe ka të drejtë të bisedo-jë. Fundi i fundit një punonjës, ndonëse i paorganizuar në Parti ose komunist në një organizatë tjeter, ka të drejtë të ngrëjë një problem, se shokët mund të ngrenë probleme edhe jashtë organizatës-bazë të Partisë, kur zë fill një problem dhe fillon një diskutim. Në organizatë jepen orientimet e drejta për zgjidhje të problemit, shpjegohet vija, shpjegohen kontradiktat që dalin në jetë, por këto tjetri i sheh në jetë duke luftuar, mi-répo komunisti bie në kontakt edhe me punëtorët, me kooperativistët, me shokë të tjerë dhe flet me ta për

një problem që ka nevojë të zgjidhet më mirë. Dua të them me këtë se Partia nuk i ndalon këto diskutime e situata që krijohen në punë e sipër apo në jetë gjatë zbatimit të një vendimi apo të një direktive.

Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë një punë më të gjerë, se vihet re që, kur bëhen mbledhje, aktive, konferenca etj., të gjithë ata që kanë probleme dhe dëshirojnë të flasin, nxjerrin nga xhepi diskutimet që kanë përgatitur në shtëpi dhe as që u bëjnë më të voglin ndryshim, edhe po të jenë shtruar në mbledhje mendime në kundërshtim me ato që kanë ndër mend të diskutojnë.

Kjo rrjedh edhe për arsyen se te disa ka shfaqje të një konformizmi burokratik për çështjet që ngrihen në një raport, ku pjesëmarrësi në mbledhje e imagjinon përse bëhet, se e di temën që do të trajtohet dhe përgatit një diskutim të rëndomtë, që nuk prek probleme shqetësuese për udhëheqjen. Diskutimi i tij nuk pëson kështu asnje ndryshim, edhe pasi këndohet raporti, edhe kur fillojnë të bëhen pyetje e diskutime; autori nuk e lëviz diskutimin që kishte në xhep edhe kur është e domosdoshme të mbahet ndonjë shënim për të dhënë përgjigje e sqarim, apo të mbajë qëndrim për çështjet e reja që dalin. Dua të them me këtë se ne nuk kemi krijuar si duhet tek të gjithë atë *présence d'esprit*<sup>1</sup> që të rrojnë me zhvillimin e vrullshëm të luftës së Partisë për realizimin e detyrave dhe të mos mjaftohet tjetri vetëm me paraqitjen e asaj që ka konkluduar

. 1. Frëngjisht — vëmendje, kujdes.

para se të vijë në mbledhje, por të konfrontohet me gjithë mendimet e diskutimet e shokëve.

Natyrisht, diskutimet duhen përgatitur përpara, por në mbledhje nuk është e thënë, që, kur nevojitet, ato të mos pësojnë ndryshime. Ky fenomen na ngjet si në jetën civile, edhe në jetën ushtarake. Ndodh që në ushtri njëri shtron disa çështje të rëndësishme për diskutim dhe nuk prek fare anën politike të tyre, ose çështjet e Partisë në repart lihen mënjanë, se diskutimin e ka përgatitur nga ana ushtarake; ose qëllon që në një mbledhje të gjerë të kuadrove të ushtrisë të diskutojë vetëm një komisar, kurse gjithë të tjerët flasin vetëm për çështje ushtarake. Po Partia që është në krye të ushtrisë vallë si punon? Po puna politike në repartet ushtarake është në rend të ditës, apo jo? Ata që diskutojnë pse nuk i trajtojnë çështjet edhe në këtë aspekt?

Pra çështjet që ngrite ti, shoku Qirjako, për format e edukimit, qëndrojnë. Për të vendosur për to, ne duhet ta rrahim mirë problemin. Pika që kemi caktuar për ta marrë në shqyrtim në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, edukimi marksist-leninist i kuadrove, duhet parë me kujdes. Komunistët nuk janë njerëz që nuk punojnë, që nuk duan të studiojnë, bile ata e ndiejnë shumë nevojën e studimit, por është fakt se, me gjithë këto mbledhje të njëpasnjëshme që bëhen, ka nga ata që nuk u mbetet kohë të marrin frymë, prandaj ne duhet të mendojmë për kohën që ka në dispozicion komunisti. Për këtë çështje duhet bërë llogari me kalem në dorë. Ne nuk themi që komunisti të flejë 9 orë në ditë. Jo, në asnje mënyrë, por atij i duhet minimumi të

punojë 8 orë atje ku është caktuar. Atëherë të llogaritim se nga gjithë koha tjetër sa orë mund të disponojë një shok komunist ose i paorganizuar në Parti për punët e tjera me të cilat e ngarkojmë. Kjo llogari, nuk bëhet, prandaj nuk i mbetet tjetrit kohë për pushim, nuk i mbetet një ditë e diel të rrijë me familjen, po i bëhet vazhdimisht thirrje të shkojë në fshat.

Njerëzit do të shkojnë edhe në fshat, por kjo me karar, që tjetri të ketë kohë edhe të studiojë një problem, të ketë kohë edhe për edukim. Veç kësaj, ai ka nevojë për njëfarë edukimi edhe në forma të tjera. Po pse i kërkon ai këto forma të tjera? Sepse e shikon që në organizatat-bazë ose në plenumet apo në aktivet, ka raste që problemet nuk shqyrtohen thellë. Kur këtu probleme që na preokupojnë shtrohen thellë në organizatën-bazë, njerëzit diskutojnë atje me zjarr.

Në këtë mënyrë ne bëjmë edukim, që shpeshherë kemi vënë në plan ta realizojmë me ndonjë referat të përgjithshëm, me ujë, kurse në luftë e sipër, në organizatën-bazë, në aktiv, në mbledhjen e Frontit apo të bashkimeve profesionale çfarë bëjmë? Atje rrahim me radhë probleme nga më të ndryshmet, si nga ana teorike, edhe nga ana praktike. Po referuesi çfarë u thotë dëgjuesve në referatin që mban në formën e edukimit? Shpeshherë, të njëjtat gjëra. Prandaj t'i shikojmë më mirë këto çështje.

Forma e edukimit duhet të ndihmojë organizatën-bazë të Partisë, aktivet e Partisë, mbledhjet e ndryshme që këto të zhvillohen në një nivel të lartë revolucionar, teorik dhe praktik. Forma e edukimit të

Partisë mendoj të jetë më e rrallë dhe të bëhet për një problem të rëndësishëm përgjithësues që të na ndihmojë, të na ushqejë, të na brumosë. Kur komunisti, pas punës dhe luftës që bën tërë ditën atje ku është caktuar, vjen në formë dhe sheh se atje zhvillohet një referat i rëndomtë me çështje të përgjithshme që i ka dëgjuar shumë herë, një punë e tillë nuk vlen shumë dhe këtë ne nuk duhet ta lejojmë.

Partia jonë ka në radhët e veta anëtarë të vjetër, ka edhe shokë me një stazh mesatar, ashtu sikundër ka shokë të rinj që punojnë, por që të gjitha çështjet teorike nuk i kanë akoma plotësisht të qarta. Edukimi më i madh teorik i tyre bëhet, në radhë të parë, në organizatat-bazë, pastaj në formën e edukimit. Këtë, në qoftë se do ta mbajmë, dhe duhet medoemos ta mbajmë, të punojmë që të ngrihet në një nivel të lartë.

Dëshiroj të kthehem edhe një herë te pyetjet. Evidencimi i tyre, siç keni menduar të bëni (dhe këto pyetje të punoni që akoma të shtohen edhe për çështjet politike dhe ideologjike sidomos) duhet të ketë një shtrirje më të gjerë. U shpjegoni shokëve komunistë që të mos druhën të bëjnë pyetje, edhe atyre të cilëve u drejtohen pyetje, gjithashtu, u thoni që të mos i marrin këto si me qëllime jo të mira, post'i konsiderojnë si një interesim të anëtarëve të Partisë, që preokupohen dhe dëshirojnë të sqarohen për këtë ose atë problem, pavarësisht se midis atyre që drejtojnë pyetje mund të ketë edhe njerëz me lakra në kokë. Megjithatë është detyrë partie që të gjithë të sqarohen.

Drejt keni menduar që këto pyetje t'i studioni me

kujdes dhe nuk do të bënit keq, duke i studiuar, t'i klasifikoni dhe, natyrisht, jo pa u menduar e duke u nxituar, por në bazë të një programi të gjerë, të nxirrni disa tema të përgatitura nga shokë specialistë, të cilët të venë t'i shtrojnë me komunistët. Në organizatat-bazë, ku janë ngritur këto probleme, mund të bëhet një mbledhje e gjerë, ku t'u thuhet që ju keni ngritur një numër pyetjesh dhe sot unë kam ardhur vetëm për të konkluduar nga ana teoriko-praktike për pyetjet tuaja, pavarësisht se për to u dhanë shpjegime ditën që u bënë. Kështu sot dëshiroj t'ju bëj një temë teorike për këto çështje.

Të jeni të bindur se masa e komunistëve, duke bërë këtë temë, ku përpunohen mirë idetë që nuk kanë qonë të qarta dhe kanë preokupuar ata që kanë bërë pyetje, do ta presë me kënaqësi një formë pune të tillë. Dhe pyetja pastaj nxit pyetjen, por në këtë rast referuesi u jep shpjegim atyre që ngritën problemet dhe hap horizonte pune dhe mendimi me dijenitë e tij.

Mua më duket se mund të bëhet një punë e tillë, por kini kurdoherë parasysh atë që ju thashë, çështjen e kohës për komunistët dhe për punonjësit. Mos lakmoni t'i ngarkoni shumë njerëzit, koha e secilit duhet llogaritur me kujdes. Prandaj, me dy-tre shokë partie mund të bëhet një kontroll apo anketë duke shkuar për të biseduar me njerëz të veçantë se ç'mendim ka njëri apo tjetri për mbledhjet. Ata që do të pyeten të flasin konkretisht në sa mbledhje merr pjesë secili, cila bëhet mirë, cila nuk bëhet mirë, cilat mbledhje mendon

ai që janë të tepërta, sa kohë vë secili në dispozicion për cilëndo nga këto mbledhje të ndryshme, pastaj kohën tjetër si e përdor. Të bëhen kështu, me një fjalë pyetje të tillë, që secili të thotë lirisht mendimin e vet dhe gjithë ky material të përbëjë një raportim për byronë e komitetit të Partisë të rrëthit, së cilës t'i thuhet se nga anketa që bëmë na rezulton se mbledhjet e kësaj natyre janë të tepërta, mbledhjet e kësaj kategorie janë të gjata, se koha e punëtorit dhe e punonjësit përdoret në këtë mënyrë, kurse atij i duhet minimumi kaq kohë të flejë, kaq të hajë, kaq të rrijë me familjen, kaq të lexojë në shtëpi dhe që të përgatitet për mbledhjet i mbetet vetëm kaq kohë në dispozicion. Atëherë, duke diskutuar për këtë problem, ju mund të arrini në një konkluzion, pastaj vendosni, mblidhni sekretarët e organizatave-bazë, diskutoni me ta.

Pas kësaj thërritni shokët e bashkimeve profesionale, më pas shoqet e organizatës së gruas e kështu me radhë ata të rinisë etj. Mund të ketë probleme që të gjitha këto organizata të mblidhen edhe bashkërisht, pse ka çështje që mund të mos shtrohen të tëra në organizatën-bazë. Kjo mund ta ketë të qartë një direktivë, por shikon se në praktikë nuk zbatohet, atëherë sekretari thërret përgjegjësit e organizatave të bashkimeve profesionale, të gruas apo të rinisë, që ka në fabrikë apo në ndërmarrje, dhe u thotë të diskutojmë, se mendojmë që ju duhet të bëni një mbledhje të përbashkët, ose ju të rinisë do të bëni një mbledhje të veçantë, pse shikohet që ka të rinj të fabrikës që mungojnë në punë, gjë që në moshat e tjera nuk vihet re, atëherë ti

shoku i rinisë duhet të bësh një mbledhje atje për këtë problem.

Me një fjalë, zbërthejmë me këtë punë një situatë, e cila na është pleksur si lëmshi në këmbë dhe nuk dimë të dalim prej saj, kurse ne duhet të dalim nga një situatë e tillë, pse këtë na e kërkon Partia, atëherë të gjejmë edhe mënyrën më racionale për të dalë prej saj. Dhe mënyra më racionale nuk bëhet duke vepruar nga zyra, por duke pyetur drejtpërdrejt edhe shokël e bazës, që vuajnë nga pasojat e kësaj metode dhe stili pune.

Si përbledhje, mund të themi se metoda që po përdorim për punimin e të tilla problemeve të mëdha të shumanshme, do të zhvillojë e do të ngrejë më lart frymën revolucionare të Partisë. Ne nuk do të heqim dorë nga plenumet, nga aktivet dhe mbledhjet e zakonshme të organizatave-bazë. Të gjitha këto do t'i bëjmë vazhdimisht dhe në bazë të normave të Statutit, por çështja qëndron në këtë që për shumë probleme kapitale ne mund e duhet të mobilizojmë një sërë kuadrosh që Partia tash i ka me mijëra dhe janë referues të aftë, elementë aktivë revolucionarë, të zotë për rrahjen e këtyre problemeve dhe të venë në të tëra organizatat t'i punojnë.

Kjo mënyrë pune ka edhe këtë të mirë që revolucionarizon punën e instruktorëve, pse ne, këtu në udhë-heqje, vuajmë për këtë çështje. Instruktorët janë të shtrënguar t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve që bëhen në Parti, por njëkohësisht janë të detyruar t'u japidhshpjegim të gjitha problemeve që shtron Partia, por

për të gjitha këto nuk janë në gjendje. Mirëpo në rast se mobilizojmë një numër të madh kuadrosh, atëherë puna ndryshon, ndryshon krejt situata, shtruarja e problemit nuk bëhet më në një formë të vjetruar, që s'të jep rezultat, problemi i nxit diskutimet, nxit pyetjet dhe referuesi, në këto raste, si i përgatitur që është, do të jetë në gjendje të japë shpjegime, Partia i kërkon atij t'u përgjigjet pyetjeve dhe jo të imponohet me autoritetin e tij.

Për shembull, një pedagog, kur u shpjegon nxënësve në klasë një çështje teorike, një fenomen fizik o reaksiون kimik, kemi parasysh se ai ka një numër individësh përpara, nxënësit, mbi të cilët ka një autoritet dhe u flet. Natyrisht ata përfitojnë nga shpjegimet e tij, bëjnë dhe pyetje, por që të dalin këta më shumë nga pozitat e tyre si nxënës përpara mësuesit ose profesorit të tyre, këtë nuk e bëjnë, nuk ia bëjnë pedagogut ndonjë pyetje një çikë me thumb, mbasi kanë frikë nga nota. Kurse gjithë këta njerëz, komunistë ose jo, që janë specialistë e dalin përpara Partisë për të shpjeguar një problem për të cilin janë kompetentë, nuk kanë përpara nxënës që qëndrojnë si të druajtur, vetë ata nuk kanë shkuar në mbledhje që t'u vënë ndonjë notë të kalueshme ose jo të kalueshme njerëzve, po kanë vajtur t'u shpjegojnë problemin, t'u përgjigjen pyetjeve që kanë bërë, të sqarojnë Partinë. Prandaj të tilla mbledhje kanë efekt dhe unë mendoj se ne duhet të vazhdojmë t'i bëjmë.

Çështja tjetër që duhet zgjidhur, mendoj dhe pro-

pozoj unë, që edhe ti e ngrite, është që komiteti i Partisë të hapë një ankjetë me shokët e bazës për të parë ngarkesën e tyre, sa kohë u mbetet anëtarëve të Partisë jashtë kohës së punës për të zhvilluar veprimtari shoqërore, për punë partie, pa harruar çështjen që ata si komunistë do të bëjnë edhe sakrifica, po jo të abuzohet me shokët e Partisë, sidomos me sekretarët e organizatave-bazë. Këta vazhdimisht punojnë dhe do të punojnë për punët e organizatës-bazë të Partisë, po duhet mbajtur parasysh se ata njëkohësisht janë edhe punëtorë, janë edhe kooperativistë, brigadierë, përgjegjës sektori etj., prandaj nuk mund të lënë punën orë e çast pse i thërret instruktori në aparatin e komitetit të Partisë. Jo, instruktori mund dhe do t'i thërrcesë edhe ata, por për punët më të rëndësishme, kurse për çështjet e tjera instruktori të shkojë vetë më shumë në bazë dhc atje ta gjejë sekretarin ku punon. Në ato raste kur nuk vete dot vëtë, të thërrresë anëtarë të tjerë të byrosë dhe jo vetëm sekretarin, pse kështu do të marrin përgjegjësi përpara organizatës-bazë ose përpara byrosë së organizatës-bazë të Partisë edhe këta dhe do të vijnë t'i raportojnë pastaj sekretarit ku janë me problemin. Prandaj këto gjëra, më duket mua, duhet të rregullohen në mënyrë racionale, pse kështu do të na ecin punët më mirë.

Mirë, shoku Qirjako, ta lëmë me kaq sot dhe do të të lutem që, kurdoherë që të kesh probleme për tò na raportuar, oja të takohemi dhe bashkërisht të shkëmbjmë mendime, se edhe unë kam shumë nevojë për

ndihmën e organizatës së Partisë, sidomos të rrrethit të Tiranës.

*Botuar për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, në librin:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përbledhje vepresh),  
vëll. 3, f. 344*

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim që  
gjenden në AQP*

## **PRIRJA PËR TA REALIZUAR PLANIN VETËM NË GLOBAL ËSHTË E DËMSHME**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**10 shkurt 1977**

Problemi i realizimit të planeve në cilësi dhe në assortiment është shumë preokupant. Planet nuk po realizohen si duhet në zëra dhe në cilësi, por vetëm si global në lekë dhe në disa degë të ekonomisë. Ky problem ngrihet vazhdimiisht në shtyp, në propagandën tonë, në leksione, por në praktikë nuk po gjen zgjidhjen e duhur. Kjo është një e keqe serioze që, po nuk u luftua, mund të dëmtojë ekonominë.

Prezikshtmëria e këtij fenomeni nuk kuptohet si duhet nga shumë drejtues të ekonomisë sonë, pse, po të kuptohej, do të merreshin masa të rrepta efektive në organizim, në normim, në planifikim, në kontroll si dhe masa të përshtatshme financiare të domosdoshme për një ekonomi të planifikuar dhe të centralizuar. Është e vërtetë që masa të tillë janë marrë e merren por në të

shumtën e rasteve ato merren të shkëputura nga njëratjetra, pa mbajtur parasysh që njëra të shkojë në ndihmë e në funksion të tjetrës, dhe për më tepër ka raste që ato merren spontanisht. Mirëpo spontaneiteti në marrjen e masave lind çrregullime, disbalancime, shthur disiplinën shkencore dhe teknologjinë e prodhimit, ngjall ndjenjën e fitimit për të marrë nga shoqëria më shumë nga sa jep, ushqen te drejtuesit dhe te punonjësit indiferentizmin ndaj kërkeseve të planit. Drejtuesit e ndërmarrjeve përpinqen t'i mbulojnë këto dobësi e të meta duke arritur realizimin e planit vetëm si global në lekë. Këtë arritje ata e përdorin për të thënë se ndërmarrja e tyre doli «faqe bardhë» me realizimin e planit, por, në realitet, ajo ka dalë «faqe zëzë», pse populli nuk gjen atë që i duhet, në treg ka mungesa, stogët e mallrave shtohen, mallrat që rrinë në depo prishen e dëmtohen, se nuk i blen kush, në një kohë kur lënda e parë është konsumuar dhe fondi i pagave është tejkaluar. Kjo ka rrezik ta çojë ekonominë në një rrugë pa krye, në rast se nuk do të merren masa serioze.

Po kush duhet t'i marrë këto masa dhe për çfarë masash është fjala? Natyrisht, këto do t'i marrin organet e pushtetit dhe të Partisë, nga qendra deri në bazë. Në radhë të parë kërkohet që punonjësit t'i edukojmë teorikisht dhe praktikisht për të kuptuar se ç'është planifikimi te ne, si bëhet ky planifikim dhe si të zbatohet plani në të gjithë treguesit. Por që ky të zbatohet kështu, është e nevojshme që punonjësit në të gjitha hallkat të njohin politikën ekonomike. Kjo nuk do të thotë që të tërë të jonë ekonomistë, por duhet

ditur se, pa njohur mirë politikën e asaj që prodhohet, prodhimit nuk do t'i bëhet hyzmeti si duhet, do të negligohet ai dhe plani nuk do të realizohet. Prandaj është e domosdoshme që punëtorët dhe drejtuesit të njohin mirë ligjet ekonomike të socializmit, teknologjinë dhe kërkesat e prodhimit dhe për këtë t'u kërkojmë të mësojnë, por edhe t'i kontrollojmë si mësojnë, si i zbatojnë njohuritë në praktikë dhe çfarë prodhimi nxjerrin. Në këtë mënyrë do të realizohen ashtu siç kërkohet zbatimi dhe kontrolli i normave, i cilësisë, i assortimentit, zbatimi i ligjeve, i urdhërcsave dhe i rregulloreve, në bazë të të cilave organizohet e drejtohet prodhimi. Po u veprua kështu, punët do të na ecin, po i neglizhuam dhe po i zbatuam shkel e shko ose këq, atëherë punët nuk do të na venë mirë dhe planet nuk do të realizohen.

Prirja e dënueshme e disa drejtuesve të ndërmarrjeve «për të dalë faqe bardhë» përpara udhëheqjes shtetërore dhe të Partisë në rreth pa e realizuar planin në të gjitha drejtimet, duhet luftuar rreptësisht, pse është e dëmshme dhe jo vetëm në shkallë lokale, por edhe më gjerë, sepse mosrealizimi i planit nga një ndërmarrje ndikon edhe në të gjitha ndërmarrjet që kanë lidhje ose që kooperojnë me të. Në këto raste, kur plani nuk realizohet në shumë zëra, në shumë degë dhe në shumë sektorë, drejtuesit nxitojnë të gjejnë arsyet e shfajësimit, çka flet për mungesë të ndjenjës së përgjegjësisë për detyrat.

Por koha kërkon që të gjithë, drejtues e punonjës, organet shtetërore dhe ato të Partisë, në të gjitha ins-

tancat, të bëhen të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe, personale dhe kolektive, që kanë për realizimin e detyrave në ekonomi, në organizim, në drejtësim dhe në kontroll. Të gjithë kanë kompetenca në sferën e punës së tyre, por këto t'i zbatojnë drejt, jo në formë shabllone, rutinë dhe burokratike. Në qoftë se s'punohet dhe nuk mendohet kudo e nga të gjithë me ndjenjë përgjegjësie, atëherë dobësohet disiplina, nuk ushtrohet kontrolli dhe nuk gjendet kush e ka meritën ose kush e ka fajin për mosrealizimin, «faji bëhet qyrk dhe nuk e vesh njeri». Kompetencat dhe zbatimi drejt i tyre shërbejnë dhe ndihmojnë për realizimin e detyrave në të gjitha hallkat. Kompetencat janë të ndërlidhura nga baza në qendër, prandaj që të gjithë e kanë për detyrë t'i zbatojnë ato. Baza duhet t'i kërkojë llogari udhëheqjes, por edhe udhëheqja duhet t'i kërkojë llogari bazës. Ndryshtë punët nuk do të ecin mirë, nuk do të ketë as centralizëm e demokraci, as disiplinë proletare, as disiplinë teknike dhe financiare.

Kam përshtypjen se kontrollit finanziar në ndërmarrje nuk i jepet rëndësia e duhur, as nga drejtuesit e saj dhe as nga nëpunësit specialistë të ngarkuar me llogarinë. Kjo ndodh sepse ana financiare nuk konsiderohet si një pjesë nga më të rëndësishmet e planit, si një vëzhgues, studiues dhe kontrollues i administrimit të pasurisë së ndërmarrjes, i progresit ose i mbetjes së saj prapa. Në ndërmarrjet tona degët dhe punonjësit e financës nuk kontrollojnë shumë gjëra, ka prej tyre që kufizohen vetëm me regjistrimin e hyrjeve dhe të daljeve në mënyrë formale për të qenë në rregull def-

terët, por defterët janë në rregull vetëm atëherë kur mjetet monetare, treguesit financiarë, si në hyrje edhe në dalje, pasqyrojnë realitetin e realizimit të planit të prodhimit jo vetëm në global, por edhe në assortiment e cilësi.

Ulja e kostos është një tregues, ka një vlerë reale, por kur kjo bëhet qëllim në vetvete dhe për hir të saj prodhohen mallra të panevojshme, me cilësi të dobët e me defekte, që konsumatori nuk i blen e mbeten stoque, një veprim i tillë është antiekonomik. Kjo nuk është ulje kostoje dhe kështu gënjejmë veten.

Për këto probleme drejtuesit e ndërmarrjes duhet të mbështeten e të përdorin më mirë degën e financës, sepse mendoj se ata nuk konsultohen me financierët, domethënë nuk e përdorin llogarinë si një levë të rëndësishme. Kjo vjen se as ata, as financierët nuk i kuptojnë si duhet përbajtjen e ligjit të vlerës, kërkesën dhe ofertën, nuk kanë kurdoherë parasysh perspektivën e evadimit të mallrave, të rikuperimit të fondeve, tatimet, amortizimet etj. Fakt është se bilancet e plota bëhen në fund të vitit, kurse ato të gjashtëmu-jorit as i shikon njeri, pale të studiohen e të bëhen objekt diskutimi për marrjen e masave për të ndrequr gjendjen. Në këtë mënyrë ndërmarrjet, ministritë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve nuk e kanë si duhet në dorë situatën.

Të gjithë e dimë se plani është ligj, prandaj për realizimin e tij duhet qëndruar si përpara ligjit, domethënë duhet zbatuar. Por si specifikohet ky plan, specifikohet drejt, në mënyrë reale, apo jo? Vihet në

planin e prodhimit dhe të shpërndarjes ajo që u duhet ekonomisë dhe popullit? Nuk mund të mos mendojmë, dhe këtë na e tregon eksperienca, se jo çdo gjë parashikohet si duhet. Përgjegjësia për planin nuk qëndron vetëm te realizimi, por qysh në planifikim. Metoda e planifikimit tonë është e drejtë dhe, po të zbatohet mirë kjo metodë, do të kemi më pak gabime dhe telashe.

Por metoda e planifikimit nuk zbatohet kurdoherë drejt. Shpesh organet planifikuese dhe drejtuese të bazës gjatë planifikimit shohin vetëm interesin e ngushtë të ndërmarrjes dhe të rrethit, planifikojnë me rezerva, që të jenë brenda, planifikojnë pak assortimente, kërkojnë normativa të larta të materialeve, më shumë fuqi punëtore dhe fonde të tepërt pagash. Ata planifikojnë gjoja duke pasur parasysh vitin e mëparshëm, por viti i kaluar u shërbën disa herë më shumë për t'u dalë përpara të papriturave për veten e tyre dhe jo për të zhvilluar e për të fuqizuar ekonominë popullore në përgjithësi. Kështu, «meqë plani është ligj», ata vazhdojnë të prodhojnë keq, pa marrë parasysh se me mallrat e tyre mbushen depot, se shtohet edhe paraja që është në qarkullim. Ata nuk mund ta ndryshojnë planin, se «plani është ligj», nuk mund të ndryshojnë linjën, se «duhet të ndërtohet një linjë e re», nuk mund të prodhojnë mallrat e nevojshme dhe me cilësi, se «duhet material importi» etj. Kështu, pragnë justifikime, që dëgjohen qysh në planifikim dhe pastaj shtohen gjatë kohës së zbatimit për t'u shfajësuar për mosrealizimin si duhet të planit.

Organet shtetërore, duke filluar nga ministritë, është e domosdoshme të kontrollojnë më mirë punët në rrethe e në ndërmarrje. Gjithashtu, është e nevojshtme të kombinohen mirë puna e Partisë me atë shtetëoren, edukimi politiko-moral me atë teknik e profesional. Se bëhen mbledhje të shumta, shpjegohet kjo e ajo, por sqarimet dhe instruktazhi që bëhen në to nuk kanë shumë efikasitet, pse nuk ka sa duhet koordinim.

Ne kemi përgatitur shumë kuadro për të gjitha fushat dhe profilet. Kjo është një armatë e madhe njerëzish të formuar, me dije, të ngritur politikisht, të cilën duhet ta mobilizojmë totalisht. Këta njerëz mendojnë, krijojnë e prodrojnë, janë bij dhe bija të popullit, që me përpjekjet e tyre dhe të edukuar e të udhëhequr nga Partia po bëjnë kudo mrekulli. Çështja është që gjithë këta njerëz, jo se nuk punojnë mirë, por të nxiten që të punojnë edhe më mirë, të organizojnë kudo siç duhet punën dhe drejtimin e ekonomisë. Dhe për këtë tash janë të gjitha mundësitë, të gjitha avantazhet, prandaj është detyrë e të gjithëve që t'i shfrytëzojmë më mirë këto mundësi dhe avantazhe.

*Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **PLANI FINANCIAR TE BEHET KRAHAS ME PLANIN E PRODHIMIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**12 shkurt 1977**

*Në këtë takim u bisedua për zhvillimin e mbledhjes së plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.*

**SHOKU PROKOP MURRA:** Në sektorin e bujqësisë shokët e Vlorës e kanë tejkaluar planin e drithërave. Më bëri përshtypje, shoku Enver, se planet financiare nuk shoqërojnë planet e prodhimit. Kjo, dashur pa dashur, ka bërë që ata të bien në vetëkënaqësi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E ke fjalën këtu për kooperativat? Nëse plani finansiar nuk përpushton me planin e prodhimit, atëherë çfarë bëjnë llogaritarët atje? Kjo praktikë duhet parë me kujdes.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kooperativa, kur ka bërë planin finansiar, nuk i ka llogaritur prodhimet, fjalë vjen, me çmimin e mesatares së vitit të kaluar, por me çmim më të ulët.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dhe i tërë pambuku, për shembull, qenka llogaritur i kategorisë së tretë?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Po. Kurse në fakt pambuku mund të dalë i kategorisë së dytë, pra, kooperativa merr më tepër lekë. Kjo është fiktive, se me këtë plani financiar realizohet edhe pa u realizuar plani i prodhimit.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Domethënë në këtë rast kooperativa në pambuk del me plan financiar të realizuar, se nga 9 milionë lekë që parashikonte, mori 10 milionë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Kështu bënë edhe në Krujë me domaten: e kishin llogaritur mesataren me 2,5 lekë kilogramin, në fakt e shitën me 4 lekë, kështu që u ngritën të ardhurat, megjithëse plani i prodhimit nuk u realizua. Pra del ajo që thotë shoku Prokop për Vlorën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Banka Bujqësore dhe seksionet e bujqësisë e të financës në komitetet ekzekutive të rretheve, më duket mua, janë duke punuar keq në këtë drejtim. E kemi theksuar edhe në Byronë Politike që, në rast se kooperativat nuk do të vënë në rregull buxhetin e tyre financiar, në rast se nuk do ta shohin atë të lidhur ngushtë e në përputhje me planin e prodhimit bujqësor, me të ardhurat për ditë-punë e me të ardhurat e tjera, atëherë nuk do të kenë gjë në vijë. Në qoftë se këto nuk ndiqen me kujdes, kooperativa bujqësore do të kthchej në një han me dy porta, do të ecej pa llogari e kontroll dhe mund të abuzohet me kreditë e shtetit, me paret e kooperativistit etj.

Shtroj pyetjen: çfarë po bëjnë punonjësit e financave që shërbejnë në rrethe? Ç'rëndësi kanë problemet e tjera me të cilat merren ata, në qoftë se nuk vihet, si të thuash, fare në hesap, ana financiare e të gjitha punëve në kooperativat bujqësore të rrethit? Në bujqësi është përqendruar tërë ajo pasuri e popullit. Anët financiare të një fabrike letre ose të një fabrike tullash, fjala vjen, kanë rëndësinë e tyre dhe duhen ndjekur. Por problemet financiare në kooperativat bujqësore janë akoma më të mëdha e më të mprchta, ndaj nuk duhen neglizhuar. Sa transmetohen dhe sa vihen në jetë ato vendime e orientime që kemi nxjerrë për rolin e punën e financave e të financirëve në të gjitha hallkat e dcri në kooperativat bujqësore?

Ne kemi shtruar që plani finansiar të hartohej krahas me planin e prodhimit. Dhe këtu nuk ka asnjë asasye që të bëhen lëshime. Nuk është aspak e rregullt që, kur bëhen planet, të ardhurat nga pambuku, ose nga orizi të llogariten me çmimet minimale, siç ndodh në ato rrethe që përmendët ju. Kjo është në kundërshtim direkt me përparimin e kooperativës. Si mund të lejojnë drejtuesit e Partisë e të pushtetit në rrethe që, në kooperativa, kur bëhet plani i prodhimit dhe plani finansiar, të bëjnë llogari të tillë për të qenë brenda e për të dalë me tejkalime fiktive të të ardhurave? Kjo është një shkelje flagrante: Marrin realizimin e vitit të kaluar dhe mbi këtë llogarin me çmimet që u leverdisin, sa do të tejkalojet plani finansiar!?

Ne tani po planifikojmë në bazë të mesatares së përparuar. Prandaj kooperativa duhet të luftojë që ta

marrë pambukun të kategorisë së parë e të dytë, kurse financieri e llogarit të kategorisë së tretë. Si mund të lejohet kjo gjë?! Kur flasim për planin e prodhimit, kemi parasysh edhe mjetet e prodhimit, që nga plehu dhe deri te parmenda; kemi parasysh edhe punimet që do t'i bëhen secilës bimë etj. Dhe përderisa kemi vendosur që plani i prodhimit dhe ai financiar të bëhen në një kohë, të tëra këto duhet të llogariten një për një në planet financiare. Pa financierin e kooperativës, për këto gjëra të mos hidhet asnjë çap përpëra! Të mos bëjë asnjë çap as kryetari i kooperativës apo sekretari i Partisë! Në qoftë se është vendosur kështu, kështu edhe të zbatohet. Në qoftë se dikush i jep urdhër financierit që të prishë planin financiar, ky nuk duhet të pranojë, por të thotë: «Atëherë të thërrsim asamblenë, ndryshe unë nuk lejoj, sikur edhe komiteti i Partisë apo komiteti ekzekutiv i rrëthit të vijë. Po përsë nuk lejoj? Për interesin e kooperativës». Vendimet që kemi marrë për anët financiare duhet të zbatohen me gjithë rigorozitetin e duhur nga tërë udhëheqja e kooperativës, duke filluar nga kryetari, dhe për këtë ekonomistët të ngulin këmbë.

Problemet financiare është e domosdoshme të ndiqen e të zbatohen me rreptësi të madhe gjatë vitit. Në qoftë se financieri i kooperativës ka dyshim se po bëhen veprime të parregullta, shkelje e shtrembërimë në këtë apo atë sektor, atëherë ai të vejë t'i shohë gjërat në vend, në brigadë, në sektor, në arë. Pas kësaj të vëré në dijeni kryetarin, duke i thënë: «Shiko, shoku kryetar, unë s'paguaj paratë, sepse pashë që

atje në ara nuk është hedhur pleh, ose, për shembull, në planin finansiar është llogaritur që kësaj bime t'i hidhet kaq pleh dhe kjo nuk është zbatuar». Jo vetëm kaq, por të kërkojë që të merren masa, sepse nuk ka shkuar plehu në vend sipas vendimit. Financieri duhet të lëvizë dhc, kur shikon se punët nuk kryhen ashtu si duhet, të mos japë asnijë lek! Në qoftë se financa nuk e bën një gjë të tillë, në kushtet kur ne kemi një ekonomi bujqësore të bashkuar, me dhjetëra fshatra dhe me qindra familje, atëherë kooperativa dhe gjithë rendi ynë kooperativist nuk do të na ecin mbarë, ashtu si e do Partia, por do të ecin sipas dëshirës së disave. Mirëpo kësaj dëshire i duhet prerë bari nën këmbë. Në çdo punë duhet vënë mbi gjithçka interesit i përgjithshëm.

Zbatimi i orientimeve dhe i vendimeve në jetë nuk bëhet pa luftë e pa kokëçarje. Jo. Nuk duhet të lidhen duart kur punët në kooperativë bëhen sipas qejfit të njërit apo tjetrit dhe punohet pa kontroll. Ç'kemi thënë ne herë pas here? Paratë në disa raste nuk shpërndahen ashtu si duhet dhe me kontroll të rreptë të ditëve të punës. Në një letër lexova se një fshatar 75 vjeç ka bërë 400 ditë-punë në vit! Si i lejojnë drejtuesit gjëra të tilla? E si i ka bërë ai këto 400 ditë-punë, është sforuar, apo duke ndenjur majë qerres që ia ngarkojnë dhe ia shkarkojnë të tjerët? Në ndonjë rast tjetër ka ndodhur që të futin në moshë pune edhe kallamanët, sikur po punojnë dhe ata, duke marrë nga një kalistir, dhe u japid edhe atyre nga një rrogë. Duhen parë me imtësi dhe duhen shtruar me forcë këto gjëra.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Seksionet e financave në rrëthe merren shumë pak me problemet e kooperativave.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ky është një dembelizëm i madh. Seksionet e financave merren me disa gjëra dhe punë rutinë, merren me tullat, me çimenton, me komunalen, që i kanë te pragu i derës, dhe nuk merren fare me kooperativat bujqësore në fshat, bile e konsiderojnë si një gjë të vështirë fshatin. Po a mund ta lejojmë ne një gjë të tillë?

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Është një sektor i madh dhe me rëndësi.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Në ndërmarrjet e qytetit duhet ushtruar kontroll, por edhe në kooperativat bujqësore, që kanë jo pak probleme financiare, duhet akoma më shumë kontroll.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jo vetëm në kooperativat bujqësore, por edhe në ndërmarrjet ekonomikë shtetërore seksionet e financës nuk e bëjnë si duhet kontrollin. A vete ndonjëherë inspektori i financës të shohë se si shkon në ndërmarrje ana financiare e prodhimit? Një punonjës i financës që nuk lëviz, që pret t'i vijnë bilancet në zyrë, nuk mund të jetë financier.

Ndërmarrja bujqësore ka plan prodhimi, ka edhe plan financiar. Financa e ndërmarrjes bujqësore varet nga seksioni i financës. Prandaj punonjësit e këtij sektori duhet të venë të shikojnë atje, të mos presin kur të vijnë bilancet. Bile, kur ka disa momente kyç të bujqësisë, ata duhet të venë t'i ndjekin ndërmarrjet

bujqësore edhe më shpesh nga ana financiare. Në qoftë se në Korçë, për shembull, filloi të kalbej panxhari dhe s'ishin marrë masat e nevojshme organizative, atëherë del pyetja: Financieri i rrethit ka vajtur ndonjëherë në ndërmarrjen bujqësore ta shihte në vend panxharin? Asnjëherë nuk bëhet kjo. Po si mund të thuhet që financieri interesohet, kur mua më shkruan një kooperativist i Dishnicës: «Shoku Enver, është kalbur panxhari dhe tani po ua hedhim lopëve, 70 kuintalë panxhar në ditë grijmë për lopët, të gjitha qepët tonë janë prishur e janë kalbur në kavaleta».

Këto janë pasuri, pasuri të një ekonomie kolektive, por edhe të tërë vendit. Po financierët çfarë bëjnë? Ata duhet të bëhen barrikadë për veprime të tilla. Kryesia e kooperativës ose edhe organizata-bazë e Partisë mund të kenë mbyllur sytë. As financieri nuk shihet të dalë dhe të thotë nëse do të merren masa apo jo, sepse nuk është e mundur të lejohet një gjë e tillë. Në praktikë këta njerëz nuk bëjnë zë. Pse? Sepse edhe vetë nuk përpilen e nuk luftojnë sa duhet, por edhe nuk është punuar që atyre t'u dëgjohet fjala, që të luajnë sic duhet rolin që u takon, pra, si të thuash, të kenë autoritetin e duhur përpara kryetarit të kooperativës.

Problemet financiare të kooperativave bujqësore duhen studiuar më mirë me Ministrinë e Financave dhe me atë të Bujqësisë, sepse nga dobësitë e vërejtura në këtë fushë, vazhdimisht kemi pasur dëme. Bëhen shumë abuzime, ka shkelje të dispozitave dhe veprime jo të rregullta e që janë mbuluar. Këto janë

shumë të rrezikshme. Ne kujtojmë se e ndreqim punën, duke vënë përpara autoritetin e njërit apo të tjetrit, por këto probleme, po të mos zgjidhen, janë me pasoja të rrezikshme.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Për Ministrinë e Industrisë së Lehtë pati shumë vërejtje lidhur me planet e furnizimit materialo-teknik. Sjellin llamarinë nga jashtë pör të bërë kutitë pör konservimin e peshkut dhe del se ajo nuk është e përshtatshme, prandaj shokët e ministrisë kanë një përgjegjësi të madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si duket, nuk e kanë kokën në vend këta drejtues.

Pasqyra që dhe për gjendjen e këtyre problemeve në rreth, tregon qartë për punën e përciptë që bën edhe udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit atje. Po që se puna e tyre e përditshme është e tillë e sipërfaqshme, edhe pasojat do të jenë të rënda. Kjo caktësi duket edhe në faktin që në mbledhje e analiza të ndryshme më shumë bëhet ndonjë raport i përgjithshëm sesa një pasqyrë e gjendjes konkrete. Dhe këtë raportim e pranon edhe sekretari ose i dërguari i komitetit të Partisë në mbledhje. Ai e pranon atë, siç duket, për arsy se nuk është në brendinë e problemit që t'u thotë drejtuesve të kooperativës: «More, ç'na duhen këto?! Ne do të diskutojmë në plenum për këtë dhe për këtë problem, prandaj ku janë të metat që të marrim masa?». Qoftë shokët e kooperativës, qoftë drejtuesit e Partisë t'i evidencojnë e të nxjerrin qartë të metat e shqctësimet që kanë në çështjet financiare dhe të diskutojnë se ç'masa duhen marrë për t'i

zgjidhur, se ato lidhen me jetën, me mirëqenien e anëtarëve të kooperativës, me paratë që kanë në xhep fshatarët. Me detyra dhe masa konkrete pastaj të shkohet edhe në mbledhjen e plenumit të komitetit të Partisë të rrethit. Ç'i shërben plenumit një autokritikë e sipërfaqshme që mund të bëjë atje kryetari i kooperativës apo qoftë edhe sekretari i parë, në qoftë se nuk flitet për masa konkrete për përmirësimin e punëve e shëndoshjen e gjendjes?! Çfarë vlerë do të ketë për plenumin ajo që mund të thotë ai se «edhe unë kam fajt e mia», «edhe unë kam përgjegjësi» etj.? Përse e bën ai këtë, apo sa për të thënë që bëri autokritikë?! Mund të mos e bëjë farc këtë gjë po të merrin masa për përmirësimin e gjendjes. Kjo ka rëndësi.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

# **PARTIA KA NEVOJË PËR GJAK TË RI, PËR NJEREZ TË ZOTË E PLOT ENERGJI QË TË DREJTOJNE PUNËN**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**14 shkurt 1977**

Edhe unë jam i po atij mendimi që je edhe ti Hysni [Kapo] për të gjitha problemet që shtrove, por, duke pasur parasysh këto, arrij në konkluzionin se nuk ekziston ai bashkëpunim i ngushtë që duhet të ekzistojë midis Komitetit Qendror të Rinisë dhe atij të Partisë.

Një gjë e tillë vihet re qartë në diskutimet që janë bërë dhe për të cilat na raportove. Unë nuk dëgjova të flitej për një bashkëpunim të ngushtë midis komiteteve të rinisë dhe komiteteve të Partisë në rrethe. Del, më duket mua, sikur komitetet e Partisë i kanë larë duart nga kjo punë, duke menduar se rinia ka një udhëheqje të sajën, e cila i njeh problemet dhe di se si të veprojë. Mirëpo nuk duhet të ndodhë kështu, sepse si në qendër, edhe në bazë Partia e njeh, por edhe nuk e njeh mirë punën e rinisë dhe, në të njëjtën

kohë, kjo tregon se ajo nuk i ka mirë të qarta detyrat e saj. Një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë është kujdesi për problemet që e shqetësojnë rininë. Këtë detyrë, mendoj unë, Partia nuk po e ndjek si duhei.

Vëmendja dhe kujdesi i jashtëzakonshëm për rininë ka qenë një nga detyrat kryesore të Partisë që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, se shumica dërrmuese e luftëtarëve partizanë ishin të rinj dhe nëpërmjet kësaj rinie Partia u fut e punoi me njerëzit e moshave të mesme e të kaluara. Kjo është një përvojë e madhe e punës sonë gjatë luftës, të cilën unë nuk mund ta harroj kurrë.

Aktualisht, ne jemi po në ato kushte për sa i përket nevojës së punës së domosdoshme me rininë, me përjashtim të faktit që vendi është i çliruar. Partia duhet ta ketë preokupimin më të madh çështjen e punës me rininë, sepse ajo është e ardhmja e vendit jo vetëm nga ana formale, por se është një e ardhme e shkrirë me të tashmen e ndërtimit të shoqërissë së re. Ti na the se 42 për qind e punëtorëve janë të rinj, pra këta njerëz kanë hyrë në punë, kanë hyrë në luftë, në përpjekje. Domethënë, ashtu siç hodhën dje në krah dyfekun për të çliruar vendin, ashtu dhe tash ata i janë përveshur punës për ndërtimin e socializmit.

Interesimi i Partisë duhet të jetë i madh, i vazhdueshëm e i kujdeshëm si për të rinjtë që janë në punë, ashtu edhe për të tjerët që janë akoma në bankat e shkollës. E kam fjalën për një interesim me të vërtetë si duhet, për një punë të organizuar nga Partia në drejtim të formimit dhe të rrënjosjes së koncepteve të

shëndosha te rinia. Ajo që the, Hysni, se shfaqjet e huaja vihen re më tepër tek të rintjtë punëtorë sesa në rininë shkollore, tregon se bëhet punë e pamjaftueshme nga Partia e bashkimet profesionale.

Kongresi i 7-të i Partisë është ngjarja kryesore e gjithë jetës së vendit, e Partisë, e rinisë, e gruas etj., sepse atje u pasqyruan gjithë direktivat dhe vija e drejtë e Partisë dhe, patjetër, gjatë kësaj kohe organizatat e rinisë, si dhe organizatat e tjera të masave, kanë pasur rastin të njiheshin me materialet e këtij Kongresi, bille, nga studimi që kanë bërë, duhet të kenë nxjerrë konkluzione dhe të kenë caktuar detyra për vënien e tyre në jetë.

Të kemi parasysh që kësaj i thonë rini, dhe rinia ka probleme të shumta ideologjike, politike dhe shoqërore, probleme që kanë të bëjnë me luftën e klasave, me luftën kundër rrëthimit imperialisto-revisionist etj., etj. Prandaj, mua më duket se në një mbledhje të udhëheqjes kryesore të rinisë, siç ishte plenumi, këto probleme duhej të zinin një vend më të rëndësishëm, me qenëse flitej për edukimin marksist-leninist të rinisë dhe, sipas mendimit tim, ky trajtim politiko-ideologjik i problemeve duhej të shoqërohej medoemos me shembuj konkretë. Këtë e them se mund të kalohet vetëm në numërimin e fakteve e të çështjeve pa nxjerrë konkluzionet përkatëse, domethënë, që nga këto fakte e nga këto gjëra të dilnin me konkluzione ideologjike e politike. Edhe herë tjetër e kam theksuar këtë problem, por, me sa po shoh, akoma nuk po vihet si duhet në vend kjo porosi. Është e domosdoshme që nga studimi

të kalohet në analiza konkrete dhe nga këto analiza të arrihet në konkluzione.

Mirë, plenumi mund të dalë me detyra, por kur flasim për edukimin, rezoluta apo programi, në radhë të parë, duhet të ketë karakter ideopolitik. E them këtë, sepse është bërë zakon që, kur flitet për aksionet e rinisë, theksohet vetëm realizimi i normave nga rinia. Mirëpo harrohet që aksioni i rinisë është një shfaqje konkrete e kuptimit politik dhe ideologjik të vijës së Partisë nga të rintjtë e të rejat, që shkojnë atje dhe punojnë pa u lodhur për kryerjen e zotimeve të marra. Prandaj në këtë drejtim duhet punuar shumë.

Më bëri përshtypje, siç e vure në dukje ti, Hysni, problemi që ngriti në diskutim kryeredaktori i revistës «Shkenca dhejeta», ose i riu që kishte lexuar letrat me kërkesa nga rinia drejtuar Radiotelevizionit tonë. Ky i fundit tha se, në përgjithësi, interesimi i rinisë është për këngë, qofshin këto të muzikës së lehtë apo popullore, kushtuar punës, jetës, dashurisë etj. Mirë, rinia le të interesohet për këngët e për muzikën, kjo është gjë e mirë, por një interesim të tillë ajo duhet ta tregojë edhe për probleme të shkencës, të industrisë, të bujqësisë, për probleme të historisë, të politikës dhe të ideologjisë.

Nuk është çështja t'u thuhet atyre: More djema, mos kérkon më vjersha e këngë! Jo, nuk duhet vepruar në këtë mënyrë. Në këtë punë kérkohet kujdes i madh, këto gjëra nuk ndryshojnë me urdhra nga lart. Të rintjtë le të kérkojnë edhe këngë e vjersha, por ne duhet të na shqetësojë fakti që ata nuk preokupohen

sa duhet edhe për problemet e ndryshme të jetës, pra, nuk ndiejnë sa duhet nevojën për të mësuar të reja e shkencës dhe të teknikës. Është detyra jonë, si udhëheqje e Partisë, dhe e udhëheqjes së organizatës së rinisë që ta bëjë rininë në masë të jetë e etur për dije e shkencë. Mendoj kështu, se i riu dhe e reja te ne, veç nevojës për argëtim, këngë e muzikë, kanë edhe detyra, qoftë në shkollë, në fabrikë apo në arë, kryerja e të cilave kërkon që këta gjithmonë e më shumë të mësojnë e të merren me problemet e ndryshme.

Ky problem, më duket mua, ka rëndësi të madhe, prandaj e theksoj që Partia nuk duhet ta konsidrojë rininë si një moshë që akoma nuk i ka ardhur koha të mendojë për këto probleme, pra ta konsiderojë atë si ajo buka që nuk ka ardhur akoma dhe nuk është gati për në furrë. Jo, në asnjë mënyrë nuk duhet menduar kështu, se, që të bëhet buka e mirë, ajo duhet mbrojtur e gatuar me kujdes. Kështu ndodh edhe me rininë. Mendimi im është se nuk bëhet aq sa duhet punë politike me rininë. Për këtë çështje kaq të rëndësishme të mos kemi iluzione. Ja, një ditë më fliste një e re studente për disa dobësi të punës së organizatës së rinisë në universitet për problemet e përgatitjes ushtarake.

Na lind pyetja: Çfarë edukate politike i jepet rinisë universitare? Me çfarë serioziteti e shikon rinia çështjen e mbrojtjes? Si e kupton ajo rrezikshmërinë e armiqve që na rrethojnë? Ka ndonjë rast në universitet që tregon se nuk punohet si duhet me rininë studenteske për t'i kuptuar thellë politikisht dhe ideologjikisht

probleme të tillë të rëndësishme, siç janë ato të përgatitjes për mbrojtje? Nuk është aq e lehtë kjo çështje, përkundrazi, është shumë e ndërlikuar. Domethënë, kur bëhet përgatitja ushtarake në universitet e kudo, duhet të kuptohet rëndësia e saj dhe përgatitja e studentëve të jetë aq metikuloze dhe aq e përpiktë, sa më s'bëhet, sepse në rast agresioni kemi për të përballuar jo lodra, por forca të tmerrshme, të përgatitura mirë ushtarakisht dhe të armatosura me armë nga më modernet.

Në punën me rininë duhet t'i kryejmë me përpikërinë më të madhe detyrat në fushën e mbrojtjes, që ta përgatitim mirë rininë dhe mbarë popullin ushtarakisht. Synimi ynë është që të gjithë, të rinj e të moshuar, ta vlerësojnë mirë rrezikshmérinë e një pune të dobët në këtë fushë dhe kur nisen për në stërvitje ta vlerësojnë atë tamam si në kohë lufte. Në qoftë se dikush shkon me vonesë, apo pjesëmarrja në stërvitje ka mungesa, kjo është në favor të armikut, në dëm të mbrojtjes sonë. Prandaj këto çështje duhen kuptuar dhe marrë me seriozitetin e duhur nga rinia jonë. Të gjithë të rinxjtë tanë duhet të jenë të disiplinuar kur doherë, por, në radhë të parë, në përgatitjen ushtarake. Në qoftë se ka shfaqje indisiplinimi, kjo tregon se nuk kuptohen mirë dhe thellë këto probleme nga pikëpamja politike dhe ideologjike. Dhe ajo që ka rëndësi është që si organizata e rinisë, por sidomos organizatat e Partisë të njojin mirë gjendjen lidhur me këtë problem kaq të madh. Prandaj duhet punuar më shumë e duhen marrë masa të forta në këtë drejtim, që

rinia jonë të jetë e edukuar dhe e përgatitur në mënyrë të gjithanshme, por, në radhë të parë, politikisht e ideologjikisht, dhe nga ana tekniko-profesionale e ushtarakisht. Kjo, natyrisht, nuk arrihet vetëm me disa urdhra sloganë dhe shembuj, por me një punë të madhe e të vazhdueshme, duke i pasur mirë parasysh mësimet e Partisë, nevojat e vendit, por edhe dëshirat e interesat e rinisë.

Këtë problem ua kemi theksuar herë pas here drejtuesve të Partisë e të rinisë, por është shqetësues fakti që Partia nuk e merr në dorë si duhet. Në diskutimet e shokëve të rinisë në këtë plenum, nuk u fol për atë qëndrim të ngrohtë udhëheqës, dashamirës, përkrahës ndaj organizatës së rinisë që duhet të mbajnë organizatat e Partisë, të nisura nga qëllimi për ta futur në jetë rininë sa më të përgatitur. Në qoftë se me të vërtetë ky atrim e bashkëpunim nuk ekziston, pra në qoftë se Partia neglizhon në këtë drejtim, ky është një gabim i madh.

Duhet thënë, gjithashtu, gjithmonë duke pasur parasysh këto që na u raportuan, se kjo mungesë bashkëpunimi e lidhjeje vihet re edhe me organizatat e tjera të masave.

Rëndësi nuk ka vetëm që të ngremë probleme, por edhe të punojmë për të gjetur forma sa më të përshtatshme e frytdhënëse që organizatat e masave të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën. Kjo është e domosdoshme, sepse zgjidhja e problemeve që ka secila organizatë masash, qoftë organizata e Bashkiimeve Profesionale, ajo e Gruas apo e Frontit, kërkon bashkë-

punim e koordinim të veprimeve nën udhëheqjen e Partisë. Përderisa këta të rinj nuk flasin për një bashkëpunim konkret për t'i zgjidhur së toku problemet e veçanta e të përbashkëta, duket se vazhdon akoma një punë e veçuar dhe kjo nuk është në favor të forcimit të edukatës së anëtarëve të këtyre organizatave.

Jam i mendimit që, të tria këto çështje, ajo e preokupimit të Partisë për rininë, e punës me materialet e Kongresit të Partisë dhe çështja e bashkëpunimit të organizatave të masave janë të tilla që duhen marrë në konsideratë sa më parë, që situata të ndryshojë.

Ne ua themi dhe ua kemi thënë shumë herë atyre se sa të nevojshëm janë për këto organizata bashkëpunimi dhe udhëheqja konkrete nga afér e Partisë, por, siç del, akoma vazhdohet, si me thënë, njëfarë pune rutinë lidhur me këtë problem dhe ka njëfarë mosinteresimi nga këto organizata dhe nga organizata e Partisë.

Kur themi që rinia është fidanishtja e Partisë, atëherë menjëherë duhet të reflektojmë se kjo fidanishte ka nevojë për kujdes e ndihmë, që t'i rrish pranë, t'i shikosh se si rriten e si lulëzojnë këta fidanë. Kjo do të thotë që të vesh te këta njerëz atje ku mblidhen, ku punojnë e të njohësh ata që dallohen e shquhen në punë, në shkollë e kudo. Partia do të ushqehet, ka nevojë për gjak të ri, jo vetëm për njerëz të rinj që të hyjnë në Parti, por edhe për njerëz të zotë e plot energji që të drejtojnë punën.

Vendi ynë, ndërtimi i socializmit, ka nevojë për kuadro të rinj. Pse t'u vijmë rrotull ne vetëm disa kua-

drove të vjetër? Me këtë nuk dua të them se këta kuadro nuk e bëjnë punën. Jo, ata janë njerëz që punojnë, por dhe mosha bën punën e saj, këtej del nevoja e ripërtëritjes. Prandaj të mos harrojmë që kjo punë duhet menduar me kohë e duhet bërë me kujdes të madh. Në këtë mënyrë kuadrot e rinj do të janë të studiuar mirë dhe nuk do t'i ngremë duke u nisur nga mendimi i këtij apo i atij për të, por t'i vihet syri të riut me perspektivë dhe të lihet për një periudhë relativisht të gjatë që të punojë me njerëz me përvojë, por me objektiva të caktuar. Këtë gjë duhet ta bëjë Partia.

Organizatat-bazë të Partisë, organizatat e bashkimeve profesionale dhe ato të rinasë vënë re se disa të rinj, që hyjnë në marrëdhënie pune, nuk kanë mbaruar shkollën, kanë sjellje jo të mira, nuk janë të disiplinuar etj. Por, pavarësisht nga këto, kujdesi i Partisë dhe i organizatave të tjera të masave për këta të rinj duhet të jetë i madh, me qëllim që cdhe këta të bëhen të vlefshëm për shoqërinë tonë. Me të vërtetë ata kanë bërë gabim që e lanë shkollën, ky është fakt, sepse nuk kishin vullnet për mësim, por që të marrin rrugë të keqe se nuk mbaruan dot shkollën, kjo nuk ka pse të ngjasë. Është detyra e shoqërisë sonë t'i mbajë në kujdes e gjithmonë afér këta të rinj. Partia u ka krijuar të gjitha mundësitë që edhe këta ta zgjerojnë horizontin, duke ndjekur shkollën pa shkëputje nga puna, që të bëhen njerëz të aftë për shoqërinë. Pra interesimi për këta të jetë më i madh.

Çfarë presin drejtuesit e organizatave të Partisë, kur shohin se disa nga kuadrot që merren me proble-

met e organizimit nuk kanë një kuptim të drejtë të punës me rininë? Të mos harrojmë se të ngarkuarit me këto probleme janë kuadro me përvojë të gjatë.

Direktivat, udhëzimet e ndryshime që shtron Partia merren dhe përpunohen nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë, po kështu edhe nga aparati i Komitetit Qendror të Rinisë etj. Mirëpojeta na tregon se në këto aparatet të Partisë apo të rinisë ka dhe shokë drejtues që e mbështetin punën e tyre në atë që përgatitet nga punonjësit e aparatit. Natyrisht, punonjësi i aparatit është i lidhur me problemet e bazës, por edhe drejtuesit kanë rolin e tyre, ata duhet të ndihmojnë me mendimet e me përvojën e tyre. Ndryshe, do të mbetemi në disa formula të përgjithshme, të cilat punonjësit bëjnë përpjekje t'i zbatojnë.

Udhëheqja e komiteteve të Partisë në rrethe mund të ketë pasur kontakte me drejtuesit e punonjësit e rinisë, mirëpo ajo lidhje apo ai bashkëpunim ka qenë në atë shkallë, saqë nuk u ka bërë fare përshtypje këtyre. Këta pa dyshim ecin me këmbët e tyre dhe në rrugën e Partisë, por nevojën e ngrohtësisë dhe të përkrahjes nga ana e Partisë ata e ndiejnë, prandaj e theksoj edhe një herë se në këtë drejtim duhet të bëjmë më shumë përpjekje.

Rastet si ai që përmendi i riu, i cili donte të punonte në minierë, por e pengonin babai e të afërmit e tij, flasin përmungesën e një pune politike intensive. Këto gjëra mund të ndodhin, se ka edhe njerëz që janë konservatorë, si babai i atij djali nga Kukësi, që shikon interesin e vet të ngushtë. Ai e kupton që puna e dja-

lit në minierë i siguron të ardhura më të mira. Atëherë lind pyetja: Pse mban ai këtë qëndrim? Ai mban një qëndrim të tillë, sepse ka disa paragjykime e mbeturina që e pengojnë të shohë më tej, por, po të punonte organizata e Frontit me të, me siguri do ta kishte bindur.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për rininë» (Përmbledhje vepresh), vëll. II, f. 447*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për rininë»  
(Përmbledhje retrash),  
vëll. II, f. 447*

## **«AVOKATI» SHARLATAN I VIJËS SE KRIMBUR KINEZE**

**Shënimë**

**14 shkurt 1977**

Vijës revizioniste të Partisë Komuniste të Kinës këtë herë iu shtua edhe një ushtar i bindur. Ky është Kazhimiezh Mijali, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Polonisë. Pas Hillit të Australisë, pas francezit Zhrke, doli edhe një renegat tjetër i marksizëm-leninizmit, për të atakuar tezat marksiste-leniniste të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këto kritika ai na i dërgoi me shkrim, nëpërmjet një letre, gjoja si vendime të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Polonisë, me të cilin ka 7-8 muaj që nuk ka asnjë lidhje. Letra vjen gjoja nga Varshava, por edhe me këtë Mijali nuk ka asnjë lidhje. I gjithë ky inskenim fals për t'u dhënë rëndësi «tczave» të tij revizioniste, pér t'u treguar se gjoja është parimor dhe se drejton kolegjialisht, ka pér qëllim të na tregojë neve se kritikat që i drejtohen Partisë së Punës të Shqipërisë janë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Polonisë dhe aspak të kinezëve, të fryra në vesh në Pekin

dhe, më vonë, pas Kongresit të 7-të, nga ambasadori kinez në Tiranë.

Revizionisti polak Mijal është bërë një shërbëtor i kinezëve. Ai, për problemet që na atakon ne e për shumë teza të tjera, ka qenë dhe është shprehur pro tezave tona dhe kundër Partisë Komuniste të Kinës. Këto janë të dokumentuara në procesverbale. Tash ai ndërroi flamur. Pse vallë? Sepse jo vetëm që ka qenë një revizionist i maskuar, por mund të jetë edhe një agjent i dërguar te ne, në format dramatike që dimë. Ne e kemi pritur, kemi sakrifikuar dhe kemi bërë çmos që, kur ndodhej këtu, ta ndiente veten si në vendin e tij.

Në mendimet politike dhe ideologjike nuk kishim asnjë kontradiktë me të, vetëm për një gjë e këshillorë: se duhej të vendoseshin lidhje, jashtë Polonisë, menjë shok të dërguar nga KQ i Partisë Komuniste të Polonisë.

Në fillim Mijali nuk fliste me simpati për Kinën, por edhe kundër jo. Javash-javash ai e thelloi kritikën dhe për një varg tezash kineze ishte kundër dhe i dënononte. Kur vajti një herë në Kinë, atje s'e përfillën fare, prandaj erdhi si bishë nga Pekini dhe foli kundër kinezëve. Mirë, deri këtu çdo gjë ishte normale, asgjë s'na linte shteg të dyshonim.

Por, pas disa veprimeve të dyshimta të tij, Mijali filloi të kritikojë, nëpërmjet tezash revizioniste, vendimet dhe veprimet e Partisë sonë. Kjo na bëri të ishim edhe më shumë vigjilentë. Ne iu përgjigjëm kritikave të tij e ai sikur u turbullua. Në vazhdim shkoi edhe më tej, derisa na dërgoi letrën në fjalë kundër Kongresit

tonë të 7-të dhe pro vijës revizioniste kinezë. Domethënë Mijali, kur pa se ne kishim kontradikta me kinezët, ndërroi fletë.

Mos vallë (dhe ky është një supozim) Mijali është në shërbim të sovjetikëve, i dërguar në Shqipëri me qëllime të caktuara? Në situatat e krijuara mes nesh dhe udhëheqësve kinezë mos, për interesa të tjerë, iu vu detyra të fitonte besimin e këtyre të fundit? Kjo është një «detyrë me rëndësi» që mund t'i kishin vënë agjentura polake dhe ajo sovjetike Mijalit, i cili pas Kongresit tonë filloi sulmin e hapët kundër nesh. Kinezët janë të kënaqur me këtë dhi të zgjebosur që u fut në stalin e tyre.

Po le të vijmë tash te letra që i ka drejtuar Partisë sonë ky shërbëtor i revizionistëve kinezë.

Kazhimiezh Mijali na kritikon ne për dy çështje, që ai i quan «gabime politike dhe ideologjike», «gabime fatkeqe, antileniniste dhe antistaliniane», se nuk akordohen me maocedunidenë. Duke shtrembëruar idetë dhe veprimet e Leninit e të Stalinit, ai i atakon këta të dy, atakon Partinë e Punës të Shqipërisë, ngre Maon dhe idetë e tij revizioniste me formula gjoja teorike, por që në të vërtetë janë arsyetime banale të propagandës kapitaliste dhe të propagandës së alambikuar, pra që nuk kanë asnjë fije nga ideologjia marksiste-leniniste, por që kinezët i kanë sajuar për t'u vënë «paterica» ideve të tyre revizioniste.

Cilat janë kundërshtimet e Kazhimiezh Mijalit me ne? Këto janë dy:

1. për «botën e tretë»;

2. për çështjen që mbron ai, se nuk ka dy armiq kryesorë për popujt e botës, por vetëm një, kurdoherë një.

Tezat e Kongresit tonë njihen, prandaj nuk do të zgjatem mbi to, por do të komentoj pak «xhevahiret» revisioniste të këtij renegati, «avokat» sharlatan i vijës së krimbur kineze.

1. «Botën e tretë» ai nuk ka si e fsheh që është «tezë e Maos», pavarësisht se thotë që «është Ten Hsiao Pini i cili e deklaroi hapur në OKB». Por kjo tezë duhet argumentuar ideologjikisht. Asnjë arsyetim i tillë nuk ekziston, të paktën botërisht, as nga Maoja, as nga Teni. Atëherë ndërhyr «avokat» Mijali ta mbrojë dhe këtë mbrojtje ky e bën «duke u mbështetur te Lenini». Mirëpo Lenini s'ë ka ndarë botën as në tri, as në katër. Lenini ka folur për grupe shtetesh dhe, kur flet për botë, ai përmend vetëm dy: botën kapitaliste dhe botën tonë të socializmit. Këtë tezë marksiste ka mbrojtur Partia jonë në kongreset e saj, këtë mbrojti edhe tash së fundi në Kongresin e 7-të.

Po si ta mbrojë «avokat» Mijali tezen «e pagabuar» të Maos për «tri botët»? Ai i bën interpretimin «marksist-leninist» teorisë së «tri botëve» të Maos, duke thënë se, po të zbërthehet, kjo do të thotë «grupe, tipa shtetesh». Pra «botët» u bënë «tipa shtetesh»; «bota e tretë» na qenka një «grup, tip shtetesh» dhe çdo gjë sipas «avokatit» u shpjegua politikisht, ideologjikisht nga ana klasore e nga çdo anë, «prandaj çdo gjë është klasore në këtë ndarje». Kështu, sipas tij, «Partia e Punës e Shqipërisë në Kongresin e saj ka gabuar».

«Avokati», për të ilustruar tezën revizioniste dhe kundërrevolucionare të Maos, thotë se «shkalla e zhvillimit të kapitalizmit në shtetet e ndryshme të botës, varësia e tyre ekonomike etj., në shkallë botërore, është kundër hegemonisë së superfuqive» etj. Po kjo tezë nuk provon tezën e «tri botëve».

Këto «grupe shtetesh» kapitaliste me zhvillime të ndryshme mbeten shtete kapitaliste dhe rezerva të njërit ose të tjetrit imperializëm. Këto «grupe shtetesh» kapitaliste kanë kontradikta me fuqitë imperialiste e mes tyre dhe duhet punuar për t'i thelluar këto kontradikta, me qëllim që të përfitojnë prej tyre revolucioni dhe çështja e çlirimt të popujve nga kapitali i brendshëm dhe i jashtëm. Kjo është teza marksiste-leniniste e Partisë sonë, dhe mbi tezat e Partisë së Punës të Shqipërisë «avokat» Mijali përpinqet të shpjegojë tezën maoiste të «tri botëve». Pasi e bën këtë «fokus», që të jetë brenda, «avokati» zë e flet se këta «tipa shtetesh» që Maoja i quan «botë», kanë në krye mbretër, feudalë etj. Ka në to elementë progresistë etj. dhe situata në këto shtete është e ndërlikuar, thotë «avokati». Siç duket, për ta bërë më pak të komplikuar, ka mundësi që «timonieri i madh» të ketë bërë një «botë të tretë», ku është futur edhe vetë tok me Kinën. Pra Maoja, shahu i Iranit, mbreti i Arabisë Saudite, fashisti Pinoçeti në Kili, junta fashiste e Brazilit etj. janë zënë dorë për dore dhe hedhin vallen e «botës së tretë». Më poshtë në letër «avokati» pohon se «këto shtete të botës së tretë janë të lidhura me sistemin neokolonial» etj.

Për formulimin që i bëjmë në tezës sonë, e që raporti i Kongresit e sëqaron mirë, po kështu edhe për problemet e shteteve, për kontradiktat etj., «avokati» do që «të tregojë» se «ky formulim është një formulim i përgjithshëm, kur thotë se këto janë shtete borgjeze, kapitaliste». Por, kur s'janë të tilla, atëherë çfarë janë? Këtë «avokati» s'na e thotë, vetëm kërkon të futë edhe Shqipërinë në «botën e tretë» (se Kina, po se po, është brenda). Pra, sipas tij, «duhet të futemi në botën e tretë, se jemi shtete në zhvillim». Ky është përcaktimi «teorik» dhe «klasor» që i bëjnë «botës së tretë» «timonieri i madh» dhe «avokati» i tij polak! Kjo, sipas tyre, na qenka klasore, e parë me syrin e klasës, nga prizmi i interesave të klasës dhe të revolucionit proletar! Shikim ky prej renegatësh revizionistë, agjentë të borgjezisë kapitaliste botërore dhe nacionale.

Kulmi është kur këta tradhtarë thonë se ndarja e shteteve në «botë» nuk i shqetësoi as Kominternin, as Stalinin. Po pse t'i shqetësonë? Si për Leninin dhe për Kominternin kishte shtete dhe grupe shtetesh, por për ta kishte vetëm dy botë dhe jo tri.

«Avokati» thotë se Lenini i ka ndarë shtetet borgjezo-kapitaliste në pesë grupe. Analiza e Leninit është e drejtë, por grupshtetet ai nuk i cilësonë «pesë botë» dhe Bashkimin Sovjetik nuk e fustë në këto grupe; ai vazhdonte të pohonte se ka dy botë, që janë bota kapitaliste dhe ajo socialiste.

«Avokati» Mijal do të ndërrojë kuptimin e formulimeve të Kominternit: «qyteti botëror» dhe «fshati botëror» dhe «të vërtetojë» me këto se gjoja «teza e tri

botëve» e Maos është leniniste. Por kur Kominterni thoshte «dy kopshte», pse vallë Maoja i bëri «tri kopshte»? Sa shtrembërime të ndyra! Pasi i bën këto shtrembërime, «avokati», për t'i maskuar e për të qenë brenda, thotë se «Lenini, duke folur për nevojën e mbështetjes nga lëvizja komuniste ndërkombejtare të lëvizjes revolucionare të vendeve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, që Maoja i quan «bota e tretë» (ai vuri kështu edhe Maon në krah të Leninit për të na bindur ne se Maoja mendon si Lenini!!), nuk e bëri këtë për të mbështetur shtetet, por lëvizjet e brendshme revolucionare të këtyre shteteve» etj. Ç'vërteton «avokati» me këtë? Të kundërtën e asaj që do të mbrojë, sepse kjo që thotë ky, vërteton që Maoja as në teori, as në praktikë nuk mbron lëvizjet revolucionare brenda në këto shtete, por mbron shtetet që i shtypin proletariatin dhe revolucionin.

Kulmi tjetër revizionist arrin kur «avokati» i falimentuar Kazhimiezh Mijal thotë se «nuk duhet të ngatërrojmë marrëdhëniet e lëvizjes punëtore ndërkombejtare, duke përfshirë në të edhe ato të shteteve socialistë, me lëvizjen revolucionare që zhvillohet në shtetet më shumë ose më pak të zhvilluara kapitaliste» etj. Po Maoja ç'bën?

Sipas tij, të dyja këto lëvizje nuk duhet të jenë aleate, as të konfondohen dhe as të udhëheqin njëratjetren. Me fjalë të tjera njëra t'i bjerë gozhdës, tjetra potkoit, mjafton të konfondohen në «botën e tretë», mjafton të mbrojnë tezat maoiste, aleancën me kapi-

talin dhe me imperializmin amerikan, kundër Bashkimit Sovjetik socialimperialist.

Më në fund, «avokati» na i rrumbullakos për të qenë brenda se «këto lëvizje të ndryshme nuk duhen konfonduar me marrëdhëniet ndërkombëtare midis shteteve». Për të na bindur se «bota e tretë» e Maos mbështetet në «pikëpamje klasore», ai thotë se «bota e tretë» nuk është abstraksion, sepse përbëhet nga njëqind shtete. Caktoi kështu edhe numrin, por në fakt abstraksion ai bëri për të gjitha kontradiktat klasore dhe për luftën që po zhvillohet brenda në këto shtete të «botës së tretë» kundër klasës kapitaliste të brendshme dhe kapitalit monopolist botëror.

Koka e «avokat» Mijalit, që përpinqet të hiqet si «teoricien leninist», është mbushur me botëkuptime kundërrevolucionare. Formulime dhe citate të Leninit, të Stalinit dhe të Kominternit ai i shtrembëron dhe i përgjysmon pa iu referuar burimeve. Megjithatë, edhe kështu si i shtrembëron, prapë ato nuk i vërtetojnë tezat e tij dhe të Maos, që janë revizioniste. Maoja është konsekuent në pikëpamjet e tij revizioniste, kurse polaku ngjan me një revizionist që ka mbetur «çiplak» në të katër rrugët dhe përpinqet të gjaje një strehë ku të futë kokën e tij plot plehra.

Nga mbrojtja që u bën tezave revizioniste të Maos për ndarjen në «tri botë», ai ngurron, përpinqet të gjejë versionin e «shteteve tipa», përpinqet të hedhë poshtë tezat tonë duke shtrembëruar formulimet e Leninit, i cili, duke analizuar situatën ndërkombëtare në atë kohë, i ndau shtetet borgjezo-kapitaliste në pesë grupe, por

Kazhimiezh Mijali e ka kot, sepse nuk del asgjëkundi dhe as nuk është në gjendje të rrëzojë qoftë edhe një grimë nga tezat leniniste të Kongresit tonë.

Ashtu si një avokat që, mbasi pyet fajtorin, të cilin e ka marrë në mbrojtje, formulon tezat e mbrojtjes që do t'i parashtrojë gjyqit, «avokat» Mijali shkoi e pyeti ambasadorin kinez në Tiranë se cilat çështje donte Hua Kuo Feni të mbronte përpara Partisë së Punës të Shqipërisë dhe lëvizjes komuniste ndërkontinentare. Dhe këtë ai e bëri, mbrojti revizionizmin modern maoist, goditi Partinë e Punës të Shqipërisë, lëvizjen komuniste ndërkontinentare, mbrojti tezat e kapitalit, të imperializmit amerikan dhe të Bashkimit revolucionist Sovjetik. Renegatë të tillë të mëdhenj si Titoja, Hrushovi, Maoja, pastaj edhe të vegjël si Mijali, Hilli dhe Zhrkeja do të dalin patjetër në kthesa të lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste, por të gjithë këta renegatë, të çdo kallëpi qofshin, do të demaskohen, do të diskreditohen dhe do të mbarojnë siç kanë mbaruar gjithë paraardhësit e tyre, në plerhat e historisë.

Ky është thelbi dhe arsyetimi i kritikës së parë që polaku Mijal i bën njërsë prej tezave të Kongresit të 7-të.

2. Kritika e tij e dytë është për tezën tonë «Të dyja superfuqitë përbëjnë të njëjtin rrezik». Sipas tij, «kjo është një e vërtetë me karakter abstrakt» dhe, për ta bërë konkrete, ai nuk mungon të marrë tezat e Kongresit tonë të 7-të, të cilat shpjegojnë gjendjen ndërkombëtare dhe forcat e ndryshme në luftë në një rea-

litet të madh dhe me konkluzione teorike marksiste-leniniste.

«Avokati» i revizionistëve kinezë, revizionisti Mijal, përdor po ato mënyra, po atë taktikë, po ato shtrembërime, po ato fokuse dhe po atë «siguri të një teoricieni» që përdori edhe për pikën e parë. Por këtu «cpa është e madhe» e me zor gjelltitet. Polaku do të gjejë arsyë për të vërtetuar atë tezë revizioniste së cilës edhe vetë kinezët nuk i kanë hyrë ta mbrojnë hapur, siç bën ky, se bien brenda.

Kinezët thonë se «armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës vijnë në radhë të dytë». Kjo tezë është antimarksiste. Ata të gjithë ideologjinë dhe politikën e mbështetin në këtë përcaktim dhe çdo veprim i tyre në arenën ndërkombëtare shkon në këtë rrjedhë. Por, për t'u maskuar, përpara vijës sonë marksiste-leniniste, përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe opinionit botëror, kinezët nuk mungojnë të thonë herë pas here se «kemi dy armiq kryesore, Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës».

Polaku Mijal po bëhet «më katolik se papa». Ai i përnga jet asaj bretkosës së fabulës, që deshi të bëhej sa një buall dhe për këtë u fry e u fry, gjersa plasi. Edhe polaku Mijal, për të mbrojtur një tezë revizioniste reaksionare, u fry sa plasi dhe nxori në shesh edhe qelbësirat e tij, por edhe ato të kinezëve njëkohësisht.

Si përpinqet ta rrëzojë Mijali tezen tonë? Fare thjesht: «Një vend nuk mund të ketë dy armiq, por vetëm një, një të jashtëm dhe një të brendshëm. Edhe në

shkallë kontinentesh ka një armik kryesor dhe jo dy»!

E vuri problemin polaku për të mbrojtur tezën kineze se «armiku kryesor është socialimperializmi sovjetik», sepse «është më i pasur ekonomikisht, më i armatosur, më dinamik, më i pademaskuar!» (Të gjitha arsyetime të përgatitura e të dërguara nga Gén Biaoja.)

Mirëpo Mijali e ka parasysh se strategjia kineze ndërron në çdo kongres. Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste të Kinës vinte në dukje se «armiku kryesor ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra të bashkohemi me Bashkimin Sovjetik kundër amerikanëve», ndërsa tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës qenkan bërë më pak të rrezikshme! S'është çudi, kur të bëhet Kongresi i 11-të i Partisë Komuniste të Kinës, ai mund të vendosë që armiku kryesor nuk është Bashkimi Sovjetik, por janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose të deklarojë se të dy këta janë të parrezikshëm!

Kështu këto *volte face* polaku i shpjegon me «argumentin» se «jcta nuk qëndron në vend», domethënë, sipas tij, partitë komuniste në çdo 7 vjet duhet të ndërrojnë strategji, pse sot «Bashkimi Sovjetik është armiku kryesor dhe të tjerët janë qen zinxhiri të tij», nesër «Shtetet e Bashkuara të Amerikës bëhen armiku kryesor dhe të tjerët kthehen në qen zinxhiri të tyre». Për të ilustruar idenë e tij, që është revizioniste, Mijali këtë «argument» gjoja e merr nga Lenini.

I nisur nga këto teza revizioniste, Mijali arsyeton si nationalist polak dhe aspak si internacionalist. Ai thotë: «Për Partinë Komuniste të Polonisë është një armik i jashtëm, Bashkimi Sovjetik, dhe një i brend-

shëm, Gierekut. Për t'i luftuar këta të dy Partia Komuniste e Polonisë duhet të bashkohet edhe me reaksionin më të zi». (Tezë e dërguar nga Gën Biaoja.) Kështu që Mijali, derisa mund të bashkohet me reaksionin më të zi (Vatikanin), atëherë pse të mos bashkohet edhe me Gierekun, se edhe ky nuk i do sovjetikët? Por edhe me Gierekun do të vijë koha që ai të bashkohet!

Po për Partinë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) kush është armiku kryesor, sipas Mijalit? Ai këtë nuk e thotë, por e mendon: «Bashkimi Sovjetik»....

Po Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste), që ka dy armiq të brendshëm dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër kujt duhet të luftojë sipas Mijalit? Edhe këtë ai nuk e thotë, por e mendon: «Kundër Bashkimit Sovjetik».

Ja, kështu, kaq qartë, kaq thjesht, kaq «teorikisht» i rregullon këto çështje ky renegat!!

Që këtej ai do të dalë në një çështje tjetër: në atë që ne shqiptarët gabojmë kur themi që «nuk duhet të mbështetemi në një imperializëm për të luftuar një tjetër». Sipas këtij shërbëtori të amerikanëve mund të mbështetemi te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe te zagarët e tyre për të luftuar armikun kryesor, Bashkimin Sovjetik.

Mijali thotë se teza e Kongresit tonë u mbyll derën «kompromiseve», «aleancave», qoftë brenda, qoftë jashtë. Dhe, për të demonstruar këtë absurditet, ai shtrembëron Leninin dhe Stalinin, deformon historinë! Ai merr si shembull paqen e Brest-Litovskit dhe e quan

këtë «një kompromis të Leninit me Gjermaninë». Paqja e Brest-Litovskit nuk ishte një kompromis i paprincipë, siç e interpreton Mijali, por një paqe që Leninit iu imponua nga nevoja e shpëtimit të Republikës Sovjetike. Me anën e saj Lenini, që krijoi shtetin e parë të proletarëve, e nxori këtë shtet nga një luftë grabitqare, imperialiste dhe mbrojti revolucionin. Ky ishte një veprim i drejtë dhe në kundërshtim me synimet e fisnikëve dhe të Kerenskëve, të cilët, krah për krah me imperialistët anglo-francezë, donin të vazhdonin luftën e Rúsise cariste të përbysur dhe të mbytnin revolucionin. Ky renegat shkon edhe më tej, duke përdorur «historinë e vagonit të plombuar» për të demonstruar se deri ku shkonte kompromisi i Leninit me Gjermaninë e Kaizerit. Me këtë ky renegat kërkon t'u hedhë baltë Leninit dhe Revolucionit të Totorit, se gjoja këta u ndihmuani nga perandoria gjermane.

Po ashtu, Mijali nuk lë pa përmendur as «traktatin e mossulmimit sovjeto-gjerman», që bëri Stalini, dhe aleancën e përfunduar midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Anglisë kundër nazizmit. Stalini veproi drejt dhe s'bëri asnje kompromis as me Hitlerin, as me imperializmin amerikano-anglez. Kur lufta ishte në prag të derës së Bashkimit Sovjetik, kur Hitleri kishte gllabëruar Austrinë dhe Çekoslovakinë, kur Çembëreni nënshkruante traktatin e Mynihut për ta shtyrë Hitlerin drejt Bashkimit Sovjetik, Stalini u bëri thirrje «demokrative» perëndimore për aleancë antifashiste, por këto e bënë veshin të shurdhër. Atëherë, për të fituar kohë, ai nënshkroi pak-

tin e mossulmimit dhe jo aleancë me Gjermaninë naziste.

Pasi jep këto «argumente», duke paraqitur «kompromiset», renegati polak vetë pyet dhe vetë përgjigjet: «Mos vallë me këto Lenini dhe Stalini tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe revolucionin? Në asnje mënyrë jo». Ky lloj «argumentimi» është një provokacion trockist.

Pra, renegati polak thotë se marksistë-leninistët në çdo kohë, në çdo situatë, mund të bëjnë aleanca dhe kompromise «edhe me djallin» për të mundur «shejtinan!» E gjithë kjo i shërben atij për të mbrojtur miqësinë e maoistëve me amerikanët, se «nuk mund të ketë njëkohësisht dy armiq, por ka vetëm një kryesor, pra mund të mbështetesh te njëri për të luftuar tjetrin». Në qoftë se kjo tezë e këtij renegati revisionist është e drejtë, atëherë, për të qenë konsekuent me vjetveten, ai duhet të pohojë se edhe uniteti i Gierckut me Bashkimin Sovjetik është i rregullt, i drejtë. Ky «teoricien i madh» është kundër shablloneve, por, në fakt, për të demonstruar tezat e tij revisioniste, nuk bën veç shtrembërimë të historisë dhe i trajton këto si shablonë për të nxjerrë Maon dhe Kinën nga këneta.

Polaku Mijal, i mbyllur dhe i shkëputur krojtësisht ngajeta revolucionare, botën dhe politikën i sheh me sytë e një të hutuari nga dielli, që orientohet nga «Zëri i Evropës së lirë», i Radio Varshavës dhc i asaj të Moskës. Duke qenë i ngopur me silazhin e HSINHUA-së, ai po tjerr mendime gjoja teorike marksiste-leniniste për të rrëzuar këto dy teza të Kongresit tonë të 7-të, sepse ai thotë që «me çdo tezë tjetër të Kongresit të 7-të të PPSH është dakord». Demagogu mbetet demagog dhe

këto kritika i mbulon me elozhe ditirambike për Partinë e Punës të Shqipërisë, për mua etj.

Çfarë kredie mund të ketë thënia e tij se tezat e tjera të Partisë së Punës të Shqipërisë janë të drejta, kur edhe këto që kritikon, ai i ka mbrojtur deri dje si shumë të drejta? Asgjë nuk kemi ndryshuar në në strategjinë e Partisë sonë, prandaj ajo ka korrur suksesë. Maoistët e futën Kinën në Ilumin e oportunizmit, prandaj atje po ngjasin këto gjëra. Revisionisti Mijal dëshiron që edhe ne të futemi si ai në këtë Ilum. Jo, askurrë nuk do të ngjasë një gjë e tillë, në qoftë se ne zbatojmë me përpikëri marksizëm-leninizmin, normat marksiste-leniniste, luftën e klasave, ashtu siç i kemi zbatuar deri tash. Partia e Punës e Shqipërisë nuk lëviz nga kjo rrugë.

Analizat që u ka bërë Partia jonë situatave të brendershme dhe të jashtme, janë marksiste-leniniste, prandaj konkludohet drejt, prandaj luftohet si duhet që të theillohen kontradiktat midis armiqve të revolucionit dhe të çlirimtë të popujve, prandaj Partia jonë i gjykon situatat dhe armiqtë jo vetëm ngushtë, nga pozita kombtare, por edhe si një parti e udhëhequr nga interesë i përgjithshëm i revolucionit proletar dhe nga internacionalizmi proletar. As Maoja, as Partia Komuniste e Kinës dhe as avokatët e tyre, në sulmet kundër nesh, nuk bëjnë fjalë për revolucionin proletar, për internacionalizmin proletar, për luftën e partive komuniste marksiste-leniniste të botës. Po të futen në këto probleme jetike të revolucionit, atëherë me siguri ata i lënë edhe ato pak pendë që u kanë mbetur.

Maoistët dhe avokatët e tyre revizionistë duan dhe luftojnë që të mos ketë polemikë. Polemika marksiste-lininiste i ka trembur kurdoherë revizionistët, si hru-shovianët, ashtu dhe maoistët. Pikërisht në letrën e fundit, ku na sulmojnë, revizionistët maoistë thonë se «ne nuk do t'ju përgjigjemi, se s'duam të bëjmë polemikë».

Polemikë ne nuk bëmë, veçse mendimet tona i thamë hapur. Kinezët dhe avokatët e tyre donin që ne të mos i thoshim, kurse maoistët t'i thoshin mendimet e tyre dhe ne t'i njihnim ato në heshtje si të vërteta universale. Shumë të zgjuar!!

«Pse i shtruat hapur këto çështje?» — na qorton «avokat» Mijali dhe bën sikur s'di gjë. Mirëpo ai e di fare mirë se këto kundërshtime parimore ne ia kemi vënë në dukje me letra Partisë Komuniste të Kinës, kemi kërkuar tre vjet me radhë të dërgonim delegacion partie për t'i diskutuar, po vetë Maoja dhe Çuja nuk kanë pranuar. Tash, ky «avokat» i një çështjeje të krimbur, na propozon që «të bëjmë një mbledhje shumë partish për t'i sheshuar këto kontradikta», kur ai e di fare mirë që Kina është kundër mbledhjeve të tillë, ajo është edhe kundër mbledhjeve dypalëshe me ne, kurse me partitë e tjera, si të Mijalit, të Zhyrkesë dhe të Hililit, që i ka shërbëtore dhe u fryn në vesh lloj-lloj absurditetesh, Kina bën mbledhje dypalëshe.

Me fjalë të tjera, Kina maoiste bën çmos të ruajë prestigjin e pamerrituar në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, pa bërë gjë në interes të kësaj lëvizjeje, ose duke bërë të kundërtën. Ajo kërkon dhe lufton të imponehet si udhëheqëse e luftës çlirimtare të popujve, dhe

pra tē «botës së tretë», përpinqet t'u mbushë mendjen të tjerëve se gjoja Maoja dhe pasardhësit e tij kanë bë-rë një analizë reale të situatës së botës «në lëvizje, në revolucion» dhe kanë dhënë recetat më të përshtatshme që të gjithë, popuj, revolucionarë, komunistë, parti komuniste marksiste-leniniste, «shtete tipa» të të «dy botëve» tok edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të «botës së parë», duhet të ndjekin Kinën për të luf-tuar socialimperializmin sovjetik, «armikun kryesor të njerëzimit».

Të gjithë këta renegatë kanë marrë përsipër të ripërçajnjë revolucionin dhe lëvizjen marksiste-lenini-stë, që është mëkëmbur dhe po forcohet. Mijalët, Zhyrketë dhe shokët e Hillëve janë Gierekët, Zhivkovët, Gomulkët, Sharkejtë, Marshetë e një varianti të ri revisionist, që duhen vënë nën predhat e artilerisë së rëndë, për t'i demaskuar, për t'i shkatërruar dhe për t'i likuiduar.

**Me të paqartët Partia e Punës e Shqipërisë duhet dhe do të tregojë durim të madh për t'i sqaruar, se nuk duhet të nenvleftësojmë mitin dhe kultin e Maos në botë si «marksist-leninist i madh». Kurse të tillë avokatë si Mijali nuk bëjnë pjesë në të paqartët, por janë renegatë të qartë dhe të rrezikshëm, prandaj zjarr ku-ndër tyre!**

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënimë për Kinën», vëll. II, f. 431*

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çë-shtje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 67*

**TI DUAM, TI VLERËSOJMË E TË PUNOJMË  
NJËLLOJ SI PËR BLEGTORINË  
DHE PËR BUJQËSINË**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**21 shkurt 1977**

*Në këtë takim shoku Hekuran Isai informoi për punimet në Hidrocentralin e Fierzës, si dhe për gjendjen në rrjetet e Tropojës, të Kukësit dhe të Pukës.*

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Isha në Fierzë, ku po ndërtohet hidrocentrali. Me këtë rast, në kantierin e ndërtimit të kësaj vepre, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të dekoratës «Hero i Punës Socialiste» dy brigadave që punojnë atje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të dyja këto brigada në emrat e tyre kanë dritën si simbol. Njëra mban emrin e mësuesit shkodran Ismet Sali Bruçaj, që përhapte dritën e dijes dhe të arsimit në malësitë e Mbishkodrës, dhe tjetra, po ashtu, quhet «Drita e Drinit». Në cilët sektorë të kantierit punonin këto brigada?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në digë, në tunele dhe bënин të gjitha llojet e punëve të vështira.

Për sa u përket të ardhurave dhe gjendjes ekonomike të punonjësve të Fierzës, vetë thanë se janë mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, ashtu është, të ardhurat e tyre janë të mira. Një punëtor merr sa një inxhinier.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Cilësia e punimeve atje ka rëndësi të madhe dhe është një problem mjafit delikat, prandaj duhet ushtruar një kontroll më i rreptë, sidomos në Fierzë. Ja, për shembull, tuneli ishte 18 metra i lartë dhe në këto përmasa që ka ai, mjafton që të bëhet puna një çikë me defekt dhe uji e shkatërron menjëherë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po të mos bëhen punimet në përputhje të plotë me rregullat dhe sipas kërkësave teknike, tuneli shkatërrohet, sepse uji ka forcë të madhe goditëse, ka presion të lartë.

Besoj se në organizatën e Partisë të Hidrocentralit të Fierzës ka më shumë komunistë se në çdo organizatë tjetër të rrethit të Tropojës. Edhe komiteti i Partisë i kantierit të ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës duhet të jetë akoma më luftarak nga ai i rrethit të Tropojës, për arsy se në Fierzë është koncentruar një klasë punëtore heroike.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Rrethi i Tropojës, në krahasim me rrethet e tjera që pashë, qëndron më prapa për sa i përket bujqësisë. Në pemëtari, qysh kur keni

qenë ju për vizitë<sup>1</sup>, shoku Enver, ata kanë bërë hapa përpara.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Ata kanë bërë plantacione të mëdha me pemë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po t'i trajtojnë mirë pemët, ato do të jepin prodhim të mbarë në kohën e caktuar. Por, në qoftë se nuk i ruajnë e nuk u bëjnë shërbimet e duhura, sipas kërkessave agroteknike, atëherë edhe mundi, djersa e investimet do t'u shkojnë koton dhe plantacionet do t'u mbeten një gjë e vdekur.

Si është puna me gështenjat në Tropojë, se unë kam dëgjuar që në treg shpesh ato vijnë të krimbura. Pse ndodh kështu? Për këtë punë janë marrë edhe masa, duke i pastruar vendet e mbjella me gështenja etj. Përveç kësaj, vilen e grumbullohen në rregull gështenjat dhe a trajtohen mirë, sipas rregullave, apo jo?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Mirë trajtohen, sepse shumicën e tyre i kanë ndërmarrjet bujqësore dhe ato kanë krijuar një sektor që merret vetëm me gështenjat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çështja është te grumbullimi në kohë dhe te respektimi me rigorozitet i të gjitha rregullave të trajtimit të tyre derisa të transportohen. Bile, edhe transportimi duhet të bëhet me kujdes.

Gështenja është ushqim i mirë. Ajo ka edhe shëquer dhe, si frysht i zier ose i pjekur, hahet kurdoherë me shije nga të gjithë. Gjithë ai pyll gështenjash që ka Tropoja, po të mbahet dhe të trajtohet mirë, është një

---

1. Është fjala për vizitën e shokut Enver Hoxha në rrëthim e Tropojës, nga 30 maji deri më 1 qershor 1970.

pasuri me vlerë. I theksoj gështenjat e Tropojës, se nuk kemi gjetkë pyje gështenjash si atje.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në rrethin e Tropojës ka shumë tokë acide, e cila, po të trajtohej me gëlqere, do ta rriste rendimentin aq sa e kërkon plani i gjashtë pesëvjeçar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po mirë, ata vetë pse nuk bëjnë furra gëlqeresh për këtë punë? Me sa di unë, gurë gëlqerorë atje ka sa të duash, kështu që nuk është i vështirë sigurimi i sasisë së nevojshme të gëlqeres për gëlqerizimin e tokave.

Për të ulur aciditetin e këtyre tokave duhet gëlqere, por duhen edhe gjëra të tjera suplementare. Ky problem nuk mund të zgjidhet duke pritur që trajtimi i tokës të bëhet vetëm me plehra kimike, se nuk mund të plotësohen menjëherë të gjitha nevojat për plehra të tilla. Pra. çështja qëndron këtu, që këta njerëz, konkretisht tropojanët, duhet t'i bëjmë të ndërgjegjshëm për të kuptuar jo vetëm domosdoshmérinë dhe vlerat e padiskutueshme të përllogaritjeve shkencore për sasinë e plehrave që i duhen hedhur tokës, por edhe për gjendjen e sasinë e plehrave kimike që kemi, që ta shikojnë kërkësën për to në krahasim edhe me sipërfaqen e tokave acide që ka gjithë Shqipëria. Me fjalë të tjera, ata duhet të kuptojnë faktin që shteti nuk ka mundësi t'u japë tërë atë sasi plehu që mund të llogaritin teorikisht e shkencërisht, se ai duhet t'u japë edhe zonave të tjera. Kështu, të përpinqen që ta kompensojnë vetë këtë mungesë plehu me gëlqere.

Para Çlirimt, kur, siç dihet, nuk kishte tableta kal-

ciumi, gratë shtatzëna, siç më thoshte nëna, gërvishtnin gëlqeren e murit dhe e hanin për t'i dhënë kalcium trupit, që të forcohej kocka e foshnjës. Pra, çështjen e kam këtu, që njerëzit, kur e kanë ndier të domosdoshme, edhe e kanë ngrënë gëlqeren, e jo të mos ia japid tokës për ta bërë sa më pjellore. Atëherë ç'i kushton kooperativës, fjala vjen, që të përdorë hirin e furrave për t'ia hedhur tokës?

Zona e Tropojës ka mundësi të mëdha edhe për sa i përket mbarështimit të bagëtive të imëta. Tropojanët kanë pasur tradita të lashta në blegtori. Në fillim ne kemi luftuar kundër disa anëve të dëmshme të kësaj tradite, për kushtet tonë, siç ishte ajo që banorët e atyre anëve ngriheshin me fëmijë e me gjithë ç'kishin dhe, tok me bagëtinë, shkonin në bjeshkë. Ata i vinin rëndësi blegtorisë dhe linin krejt pas dore bujqësinë.

Sidoqoftë, në Tropojë ekzistojnë mundësi të mëdha për të mbarështuar bagëtitë, dhe me këtë nuk duhet kuptuar vetëm shfrytëzimi i kullotave atje, por të shihet edhe ana tjetër e rëndësishme e problemit, dashuria për bagëtinë. Kjo dashuri është e natyrshme që duhet të ekzistojë edhe tani tek tropojanët sepse, siç dihet, këto ndjenja nuk shuhen lehtë. Puna është që pasionin e tyre për blegtorenë ne ta kanalizojmë drejt. Të mos lejojmë që ata për bagëtinë të braktisin bujqësinë, por t'i nxitim të duan, të vlerësojnë e të punojnë njësoj si për bujqësinë, edhe për blegtorenë. Malet e Tropojës kanë fuqi kullosore të madhe. Por kjo të mos kuptohet e të mos trajtohet si një gjë fare e thjeshtë. Sepse është e nevojshme që blegtoreve atje t'u krijohen kushtet e

nevojshme. Ka ardhur koha që jo vetëm të kullotësh bagëtitë gjatë verës, por edhe të korrësh barin dhe ta transportosh poshtë në fshat, te qendra, që kështu më të të mund të sigurosh dimërimin e bagëtive. Kjo është e domosdoshme edhe për faktin se tropojanët në dimër nuk lëvizin me bagëti në zonat fushore jashtë rrethit të tyre, siç lëvizin, për shembull, lumjanët e Kukësit. Fakti që ata nuk shtegtojnë jashtë rrethit në periudhën e dimrit, e bën të domosdoshëm sigurimin me kohë të rezervave ushqimore për bagëtitë. Jo vetëm kaq, por të insistohet që ato t'i ushqejnë sa më mirë e siç na lejojnë kushtet tanë dhe jo si në të kaluarën, kur kullo-tja ishte e dobët. Të gjitha këto formojnë atë kompleks faktorësh që do të ndihmojnë shumë për shtimin e numrit të bagëtive, duke zbatuar drejt orientimet e Partisë për zhvillimin e hovshëm të blektorisë edhe në këtë rreth.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Atje, shoku Enver, ka edhe disa probleme shoqërore si, për shembull, problemi i fesë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ku dhe si shfaqet konkretisht ky problem?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në Tropojë. Siç më treguan shokët atje disa dervishë të sektit rufai bëjnë edhe operacione, shkruajnë nuska e bëjnë propagandë fetare.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mund të ketë edhe influencë nga jashtë, por, sidoqoftë, Partia atje i ka të gjitha mundësitet që ta luftojë këtë propagandë. Nuk besoj që propaganda e tyre të jetë e atillë, që në kushtet

e sotme të zërë vend kollaj në njerëzit tanë. Ajo mund të zinte vend kur ne nuk kishim, fjala vjen, asnje infirmier, por jo sot që kemi jo vetëm infirmierë, por edhe tërë ata mjekë, spitale etj., etj.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në Pukë po punohet mirë për hapjen e tokës së re, sepse në bujqësi kanë pak tokë e shumë forca pune.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më e shumta e forcave të punës në bujqësi besoj se janë gra.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Po, shumica janë gra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur isha në Pukë, më bënë përshtypje të madhe gratë dhe vajzat e atjeshme. I pashë ato veçanërisht në drekën që u shtrua, ku, pasi thashë unë disa fjalë<sup>1</sup>, filluan të ngriheshin edhe ato e të flisnin. Siç duket, e kishin zakon që t'u përgjigjeshin miqve. Vajza të shëndetshme, energjike! Ngriheshin dhe flisnin me kurajë, trajtonin çështje shoqërore, shtetërore, ekonomike dhe shpreheshin aq bukur, me fjalë aq të zgjedhura e me mendime të drejta dhe entuziaste, sa mua më bënë shumë përshtypje. Pra, qëndrimi, shkattësia dhe energjia e tyre, që nuk e shikoja atje as te burrat, më lanë mbresa të thella. Po t'i dijë, t'i njohë e t'i përdorë Partia këto karakteristika dalluese të rinisë, dhe kur themi rini kuptojmë jo vetëm djemtë, por edhe vajzat, bën gjëra shumë të mëdha jo vetëm për realizimin e detyrave, por edhe për edukimin moralo-politik të brezit të mesüm e të vjetër.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Diçka që vura re në

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 43, f. 505.

Kukës ishte fakti që atje kishte mjaft kuadro me arsim të lartë, si veterinerë, ekonomistë e agronomë, që donin të transferoheshin në rrethet e tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po atje në Kukës kush të mbetet? Edhe agronomët bëkan lutje për t'u larguar? C'ndryshim ka fshati i Luzatit, që ndodhet në jug të Tepelenës, fjala vjen, nga fshatrat e Kukësit, si Kruma, Bicaj ose Kalaja e Dodës?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Unë bisedova shtruar me ta. Njëri thoshte se kishte dhjetë vjet që shërbente në rrethin e Kukësit e donte të shkonte në rrethin e tij.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk përjashtohet ndonjë rast, sidomos për ndonjë vajzë, por specialistët e dërguar në rrethet e largëta medoemos duhet të mbledhin mendjen e të punojnë mirë, se në ato fshatra e zona ne po drejtojmë gjithë rrininë e jo më të mos shkojnë apo të mos duan të rrinë specialistët e bujqësisë, agronomi, veterineri, ekonomisti, mjeku e të tjerë. Ata duhet ta kuptojnë që socializmi e ndryshoi situatën demografike të vendit tonë. Te ne u bë një lëvizje e madhe e popullsisë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** U formua një unitet i ri.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, u formua një unitet i ri i popullit. Iku tani ajo kohë kur pyetej tjetri «nga je». Kudo që të lindësh apo të banosh, ky fakt nuk sjell ndonjë ndryshim të madh në gjendjen e njeriut te ne.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në bisedën që bëmë, u ngritën edhe probleme të vlerësimit të specialistëve. Për shembull, kryetari i kooperativës që është me arsim

tetëvjeçar, më thanë, nuk dëgjon se çfarë i thuhet nga specialisti përkatës për probleme të ndryshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mund të ketë dhe ka ndonjë kryetar kooperative të tillë. Por, ama, normalisht, duket një çikë si e zorshme të jetë e vërtetë që një kryetar me arsim tetëvjeçar të mos dëgjojë specialistin me arsim të lartë, që ka tre apo katër vjet stazh pune praktike si agronom. Ky kryetar kooperative që vepron kështu, nuk duhet të jetë njeri politik, bile as i përgatitur nga ana teknike. Po pse nuk e dëgjoka ai zërin e specialistit dhe i nënvlerësoka shkencën e teknikën?! Mos vallë këtë qëndrim të tij duan të na e justifikojnë me faktin që kryetari e ka pasur babanë bujk dhe vetë ka përvojë? E kam fjalën këtu, se duket një çikë si i pabesueshëm nënvleftësimi i mendimit të specialistit. Unë mendoj se duhet parë edhe ana tjetër, se si e bëjnë punën këta specialistë. Fakti që ata kërkojnë të ngrenë plaçkat e të ikin prej andej, nuk flet mirë për ta.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Varet si e kupton specialisti vlerësimin që i bëhet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, ashtu është, varet si e kupton specialisti vlerësimin që i bëhet punës së tij për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë apo se si i mban ai lidhjet me kooperativistët. Ka apo nuk ka ngordhje të bagëtive, ka apo jo prodhime të bollshme? Kjo është një çështje kryesore nga e cila varet edhe vlerësimi i punës së tij dhe i vetë specialistit.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në Kukës ka rreth dy mijë ngordhje bagëtish në vit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ja si qenka puna! Po kur ka kaq ngordhje, atëherë jo më kryetari, por edhe koooperativisti ka të drejtë t'i thotë specialistit: «More, ç'më bën ti këtu?! Punon apo nuk punon? Ti nuk qenke për këtë punë!». Prandaj ka disa arsyё që njerëz të tillë, që kanë pikëpamje jo të drejta për shumë probleme. nxjerrin justifikime anësore, të paqena. Nuk mund të ndodhë që në gjithë rrethin të mos vlerësohen fjala e mendimi i specialistit, siç po bisedojmë për rastin konkret. Ndodh që ka edhe ndonjë përjashtim, mund të jetë edhe ndonjë kryetar arrogant që t'i thotë agronomit pa të drejtë: «Hajde, sikter!» etj., por disa elementë më duket se kapen vetëm pas këtyre rasteve e thonë pastaj se nuk dëgjohet zëri i specialistëve, se kryetari është arrogant etj. Këta e ngatërrojnë kërkesën e llogarisë me arrogancën. Por edhe ndonjëherë kur për raste të tilla kryetari në kërkesën e llogarisë e tepron me tonin e tij të rreptë, kjo nuk do të thotë se ai është arrogant. Unë nuk përjashtoj faktin se ka edhe kryetarë e drejtues arrogantë ordinerë, të cilëve u pëlqen koka e tyre dhe i nënvlerësojnë mendimet e të tjerëve. Atëherë specialisti, kur është i bindur se ka të drejtë dhe se mendimet e tij janë më të mira, le t'i bindë njerëzit që t'i pranojnë, por jo të gjejë rrugën e padrejtë që të kërkojë të largohet nga ai rreth.

Po materialet e Kongresit të 7-të të Partisë punoheshin atje?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Materialet punohen si në të gjithë vendin, tema e parë pothuajse ishte në përfundim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pate kontakt me njerezit ti vetë? Pyete ndonjë shok të bazës, apo bisedove vetëm me shokët drejtues? Në e ke këtë bindje nga bisedat me shokët drejtues, çështja duhet parë me rezervë, se ata ndonjëherë e zbukurojnë gjendjen.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Unë isha vetë në disa kooperativa të atyre rretheve dhe pashë se kudo njerezit ishin të interesuar për materialet e Kongresit. Bile edhe organizatat e masave në këto rrethe kishin planifikuar të zhvillonin gjithë ato tema.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, po mos mbushen ata të bazës me gjithë këto tema, se të tëra këto bëhen në një kohë dhe zhvillimi i tyre është një punë e madhe. Prandaj mendoj se duhet parë kjo çështje. Dakord, temat të bëhen, bile edhe organizatat e masave të zhvillojnë tema, por ato të bëhen një çikë me rregull, se, në qoftë se mbahen njerëzit çdo natë që të dëgjojnë temat, kjo për ta është një ngarkesë e madhe.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Do ta kontrollojmë këtë, se ne kemi biseduar që organizatat e Partisë, kur punojnë tema, të gjykojnë se për çfarë çështjesh do t'i flasin masës, sa do të jenë ato etj. Kjo është kryesore. Kur kemi biseduar me shokët e rretheve, ua kemi bërë shumë të qarta këto gjëra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kështu e kemi biseduar. Rregulli është që ta punojë njëherë temën organizata-bazë, pastaj kjo do të mendojë edhe për organizatat e masave se çfarë temash duhet të bëjnë ato sipas problemeve që dalin. Organizata-bazë e Partisë të mbledhë

drejtuesit e organizatave të masave dhe të bisedojë me ta për këtë problem. Ata do t'i thonë për temat që kanë menduar të trajtojnë si organizata masash. Organizata-bazë, mbasi të njihet e të diskutojë për to, të vendosë e t'u thotë që ju do të punoni këto tema nga materialet e Kongresit, se lidhen direkt me çështjet që na preokupojnë. Punimi i temave duhet parë me kujdes, që të mos bëhen shumë paralelizma gjatë zhvillimit të tyre.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

## ZIVILLONI MË TEJ TRADITAT E MIRA TË PËRMETIT

Bisedë në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit  
Popullor të RPSSH

25 shkurt 1977

Në këtë mbledhje, ku u diskutua rreth raportit «Mbi punën e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Përmetit për të rritur rolin e këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara», shoku Enver Hoxha zhvilloi këtë bisedë të përzemërt me shokë të ftuar nga ky rreth:

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mbahet mirë muzeu i Frashërllinjve, frekuencohet dhe pasurohet? Përveç jush, këtej nga qendra interesohet njeri për të? Po automobili shkon deri në Frashër?

**SHOKU DURO KOPO<sup>1</sup>:** Muzeu mbahet mirë dhe pasurohet. Të dy shokët e seksionit të arsimit e të kulturës në rreth, që merren me muzetë, kujdesen, por

---

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Përmetit.

edhe këtej nga qendra interesohen. Në Frashër venë grupe të rinjsh e kooperativistësh jo vetëm nga rrëthi ynë, por edhe nga Kolonja, Skrapari etj. Makina atje shkon vetëm gjatë beharit, nga muaji maj deri në shtator.<sup>1</sup>

**SHOKU ENVER HOXHA:** Përpinquni dhe interesohuni që ta pasuroni këtë muze. Instituti i Historisë duhet t'ju japë për këtë qëllim dokumente të rilindësve dhe të familjes së vëllezërve Frashëri. Po afron data e rëndësishme historike e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në të cilën kanë marrë pjesë vëllezërit Frashëri, por sidomos Abdyli personalisht. Prandaj mirë është të interesoheni për këtë ngjarje në Institutin e Historisë, të nxirrni faksimile të dokumenteve që flasin për Abdylin, për vëllezërit e tij dhe për shokët e tyre, sepse këto dokumente lypset të figurojnë atje. Në qoftë se të dy shokët, që ju keni caktuar për muzetë, interesohen dhe janë të pasionuar pas historisë e punës muzcore, ata duhet të bëjnë përpjekje që t'i kërkojnë dhe t'i gjejnë këto dokumente.

Kujdesuni që për muzeun e Frashërit të interesohet edhe rinia dhe jo vetëm ajo e rrëthit tuaj, por edhe e Kolonjës dhe e Korçës. Mirë do të ishte të organizoheshin grupe njerëzish edhe nga krahina e rrethe të tjera për ta vizituar këtë muze. Rinia të mobilizohet për ndërtimin e rrugës automobilistike dhe, kur të ketë kohë të lirë, të ndihmojë edhe ushtria.

Grupet e muzikës karakteristike të rrëthit tuaj me

1. Rruga automobilistike për në Frashër u ndërtua në vitin 1978 dhe që atëherë makina shkon atje gjatë gjithë vitit.

siguri i keni, i zhvilloni. Është e nevojshme ta zhvilloni më tej këtë traditë të mirë. Instrumentistët e njojur popullorë të Përmetit, si Laver Bariu e Tare Asllani, që ua marrin bukur këngëve dhe muzikës karakteristike përmetare, i nxitni të mësojnë edhe të rinxjtë dhe të përgatitin kështu instrumentistë e këngëtarë të tjera të zotë e të talentuar. Ja, Shefqeti [Peçi] i do shumë këngët tua-ja. Asaj që ju në Përmet i thoni gërnetë, ne në Gjirokastër i thoshim edhe buzuk. Kështu e di unë që në kohën kur i binte Ramoja, megjithëse ai i binte edhe violinës.

Me sa jam informuar, rrathi i Përmetit nuk shkon keq për sa i përket zhvillimit ekonomik, shokët e Partisë dhe punonjësit atje i kanë realizuar mirë detyrat gati në të gjitha drejtimet. Veçanërisht ndërmarrja juaj bujqësore i realizon dhe i tejkalon detyrat, kurse disa ndërmarrje bujqësore në rrethe të tjera subvencionohen nga shteti.

Nga Përmeti je ti, shoku Duro?

· SHOKU DURO KOPO: Po, nga Përmeti, nga Suka.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ti, shoku Spiro?

SHOKU SPIRO KRISTO<sup>1</sup>: Unë jam nga zona e Çarshovës.

SHOKU ENVER HOXHA: Miqtë dhe shokët tanë të luftës nga Odriçani, Kosina, Kosova, Alipostivani si i kemi? Janë mirë? Si shkojnë ato fshatra, kanë bërë përparime? Rrojnë mirë njerëzit dhe janë të kënaqur?

SHOKU DURO KOPO: Mirë janë, shoku Enver.

---

1. Në atë kohë kryetar i Këshillit Popullor të Rrethit të Përmetit.

Ata kanë dhënë 2 500 kuintalë drithëra mbi planin dhe morën 14,5 lekë për ditë-punë. Të tëra fshatrat e zonës lart, si Kosova e Alipostivani, janë bashkuar me Kosinën dhe shkojnë mirë.

**SHOKU SPIRO KRISTO:** Ata marrin 560 lekë për forcë pune çdo muaj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është një gjë shumë e mirë. Po nuk më thoni, jashtë prodhimeve të oborrit realizohet kjo e ardhur?

**SHOKU SPIRO KRISTO:** Këtë të ardhur e marrin vetëm nga kooperativa.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Urime, urime! Kjo është gjë shumë e mirë. 500 e ca lekë në fshat janë gati sa të ardhurat mesatare të një punëtori këtu në qytet.

**SHOKU SPIRO KRISTO:** Në qytet kemi nevojë për forca pune.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çështja e forcave të punës për qytetin tuaj nuk shtrohet njëlloj si për Tiranën ose për Korçën, që janë qytete të mëdha, sepse ju nuk keni shumë popullsi në qytetin e Përmetit dhe në atë të Këlcyrës. Për mbulimin e nevojave me fuqi punëtore në disa rrethe kryhen veprime që dëshmojnë për zbatimin shabllon të orientimeve të Partisë. Ja, për shembull, siç jam në dijeni, në Kolonjë thuhet që është problem dërgimi i të rinjve në fshat. Po kë të dërgosh atje? Gjithë qyteti i Ersekës rreth 3 000 veta ka gjithsej, duke përfshirë edhe pleq e kalamanë, po forcat e afta për punë duhen për të punuar në qytet e në ndërmarrjen bujqësore, prandaj nuk keni si i mbuloni menjëherë nevojat për fuqi punëtore. Sidoqoftë, vazhdoni të ecni

në rrugën që keni ndjekur deri tani. Zhvilloni mirë ekonominë dhe bëhuni shembull, sepse ju keni përvojë shumë të pasur sidomos për rritjen e zarzavateve e të frutave. Përmeti edhe përpara ka qenë i njohur në këtë drejtim, kurse sot që janë krijuar kushte shumë të favorshme ju duhet të dhjetëfishoni prodhimin e zarzavateve dhe të frutave, sepse në këto dy degë të bujqësisë kemi boshllëqe. Prandaj duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për t'i zhvilluar, dhe ato rrethe e krahina që kanë rezultate të mira duhet të bëhen shembull.

Perime e fruta duhet të hajë si qytetari, edhe fshatari. Ju nuk duhet ta keni zor këtë gjë, për arsy se vetë keni qenë dhe jeni bahçevanë. Laver Bariu bile u këndon edhe këngë bahçevanëve.

Kur theksoj rëndësinë e zhvillimit të perimeve e të frutave, nuk dua të përjashtoj detyrën e rëndësishme që keni ju edhe për zhvillimin e blegtorisë, edhe për rritjen e mëtejshme të rendimenteve të drithcrave të bukës.

A ujiten tokat e bregut të djathtë të Vjosës nga lart deri në Këlcyrë?

**SHOKU DURO KOPO:** Ujiten me elektropompa.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ku i keni rezervuarët?

**SHOKU DURO KOPO:** Një në Qilarisht, një në Këlcyrë, kemi edhe në Dishnicë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fabrika që keni për përpunimin e frutave e të perimeve a furnizohet rregullisht me lëndë të parë? Është zgjeruar ndonjë çikë?

**SHOKU DURO KOPO:** Është zgjeruar dhe, duke u mbështetur në rritjen e prodhimit të rrushit dhe të frutave, kemi menduar t'i bëjmë edhe një shëtesë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Luftoni për markën tuaj të rakisë, të verërave e të reçeleve. Ruajtjen e emrit të mirë të markës suaj merreni si një çështje sedre. Kjo do të thotë t'i nxirrni prodhimet sa më të mira, si për të plotësuar nevojat e popullit, ashtu edhe për eksport. E theksoj këtë, sepse disa njerëz bëjnë lëshime në punë dhe për pasojë prishet kualiteti i prodhimit. Ju përpinquni që edhe në të ardhmen rakia juaj, e dëgjuar kudo për të mirë për cilësinë e saj, të vazhdojë të dallohet nga të tjerat me tiparet e veçanta e karakteristike, që për të njerëzit të vazhdojnë të thonë: «Është raki e mirë, raki Përmeti», ashtu siç thonë për këpucët e prodhuara në Korçë, që janë nga më të mirat. Ja, Spiroja [Moisiu] ka pirë nga rakia juaj qysh atëherë, në kohën e luftës, kur pinim nga një komb, si i themi ne nga Gjirokastra, dhe ka parasysh që ajo ishte ndryshe nga të tjerat. Prandaj edhe sot bëni shumë kujdes, mos e ulni emrin e mirë të markës së prodhimeve tuaja. Ju i dini më mirë se unë këto punë.

Industria e verërave, e pijeve të tjera, e reçeleve etj. është shumë delikate, ajo kërkon teknologji të lartë, shumë kujdes dhe eksperiencë. Vlerësimi i pijeve është çështje gustoje, ai që pi verën ose rakinë duhet me të vërtetë t'i shijojë. Ja, për shembull, ne mund të bëjmë cigare sido-kudo dhe një vit blerësit e huaj t'i marrin ato, por, kur ata të shohin se cilësia e tyre është e dobët, vitin tjetër nuk do t'i blejnë më. Kjo ndodh sepse nuk bëhet kujdes për harmonizimin e gjethive të varieteteve të ndryshme të duhanit, mbasi, si janë sot cilësia dhe aroma e tyre, nuk janë nesër. Kështu qën-

dron çështja edhe për verën, duhet kujdes, ndryshe nuk ta blen njeri. Gjetkë, në vende të ndryshme, kanë krijuar shoqëri të specialistëve të verërave dhe ata që bëjnë pjesë në to janë njerëz me një ekspericencë të tillë, saqë vetëm duke vënë një çikë verë në majë të gjuhës janë në gjendje të thonë se prej cilit lloj rrushi është bërë, sa vjeçare është, sa sheqer ka e të tjera. Pra, ka njerëz që i kanë të zhvilluara shijet, që janë me ekspericencë në këtë çështje. Është mirë të gjenden edhe te ne të tillë njerëz dhe të aktivizohen që ta përdorin ekspericencën e tyre të vlefshme në të mirë të prodhimit.

Po në Leusë dhe në fshatrat e asaj ane janë zhviluar qershítë?

**SHOKU DURO KOPO:** Janë zhvilluar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Domethënë, sikur të vijmë, fjala vjen, në festën e përvjetorit të Kongresit të Përmetit, mund të na nxirrni qershi me tepsi, siç bënët atëherë në maj të 1944-ës, kur erdhëm bëmë Kongresin.

**SHOKU SPIRO KRISTO:** Atëherë ua nxirrnim me tepsi, sot jemi në gjendje të mbushim kamionë, shoku Enver. Kemi 700 hektarë të mbjellë me qershi, që në Kiçok e deri sipër në kufi. Më tepër qershi kemi në zonën e Çarshovës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si janë banorët e fshatrave nga ana e majtë e lumit? E kam fjalën për ata të Tri Urave afër kufirit. Kujdeseni t'i ndihmoni me furnizime e me të gjitha ç'u duhen?

Me Greqinë fqinje situata tani është më e qetë.

Nuk kemi më nga ato peripecitë e para, megjithatë vigjilencia nuk duhet ulur.

*SHOKU SPIRO KRISTO:* Ekonomia e fshatrave afër kufirit është e mirë, po kështu edhejeta e tyre kulturore. Lidhur me porosinë që na dhatë taniju, shoku Enver, që të mos e humbasim traditën e mirë të pemëve, të rrushit e të perimeve, ne kemi bërë edhe një aktiv partie.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Rrushi që do të mbillni tok me pemët, i çfarë varieteti është, «Razaki»?

*SHOKU SPIRO KRISTO:* Jo, ne kemi mbjellë më shumë për industrinë. Rrushi është «Merlot», taniquhet «Përmeti».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Llojet e rrushit i vini një çikë në rregull apo të përziera?

*SHOKU SPIRO KRISTO:* I kemi të ndara sipas llojit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në blloqet ku keni mbjellë rrush, keni vënë re ku piqet më shpejt, në Dishnicë, në Këlcyrë apo në Çarshovë? Pyes për këtë që të keni kujdes. Edhe llojet e ndryshme të rrushit nuk duhet t'i përzieni, domethënë të mos mbillni disa varietete në të njëjtën parcelë, por sidomos bëni shumë kujdes të mos përzieni lloje të ndryshme rrushi në fabrikë, pse, po nuk patët kujdes në këtë drejtim, vera nuk do të bëhet me cilësi të qëndrueshme. Pra kërkohet të respektohet radha e vjeljes së prodhimit, sipas kohës së pjekjes. Ai rrush që arrin të piqet, që merr diell më shumë, ka edhe sheqer më tepër. Rrushi që piqet më parë, futet në fabrikë dhe prej tij nxirret

kështu një lloj vere. Nga eksperienca ju e dini, për shembull, që në këtë ose atë zonë rrushi piqet më shpejt, kurse në një zonë tjetër duhet lënë edhe 10 ose 15 ditë të tjera, prandaj te vreshti i parë duhet të vini forcat për të vjelë prodhimin. Këto rregulla është e domosdoshme të mbahen.

Kështu duhet të luftohet si te ju edhe kudo për cilësinë dhe jo vetëm për këto që thamë, por edhe për këpucët, bezet, stofrat, ushqimet etj. Në çdo prodhim duhet të zhvillohet e fortë lufta jo vetëm për sasinë, por edhe për cilësinë dhe për assortimentet. Këto janë dy kërkesa të mëdha që duhet t'i keni parasysh absolutisht në punët tuaja. Janë të gjitha mundësítë që të prodhohen mallra me cilësi të mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimave të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

T R E G U E S I T



## TREGUESI I LËNDES

### A

*Akumulimi; konsumi — fon-  
di i akumulimit, burimet e  
sigurimit të akumulimit —  
18-19, 280-281, 285.*

*Ambasadat e RPSSh në ven-  
de të ndryshme — 24, 71, 72,  
91.*

*Armiqtë — veprimtaria armi-  
qësore dhe lufta kundër tyre  
— 47, 150.*

*Arsimi në RPSSh — sistemi  
arsimor; programet, lëndët,  
tekstet mësimore; edukimi  
ushtarak. Metodat e mësim-  
dhënieς. Mësuesit, pedagogët  
— 107-109, 223, 289-290, 319,  
339, 362-364, 366.*

*Arti Ushtarak i Luftës Po-  
pullore, përvetësimi i tij —  
107-108, 109, 114.*

### B

*Banka Bujqësore; kontrolli  
bankar — 257-264, 273, 287,  
350.*

*Bashkimet Profesionale të  
Shqipërisë; studimi i proble-  
meve të tyre — 214-215.*

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953)  
— 162, 169-170, 186, 380-382.*

*Bashkimi Sovjetik, revizioniz-  
mi sovjetik — degjenerimi  
kapitalist; strategja, politika  
e luftës dhe e agresionit —  
73-74, 144, 238-239, 286;  
— qëndrimi armiqësor ndaj  
PPSh dhe RPS të Shqip-  
përisë — 76, 77, 183, 187;  
— marrëdhënet dhe kon-  
tradiktat me Kinën — 76,  
78, 188.*

*Blegtoria në RPSSh — poli-  
tika e Partisë për zhvillimin  
dhe rritjen e efektivitetit të  
blegtorisë — 99-100, 103-104,  
390-391;*

*— lopa, bagëtitë e Imëta  
Traditat në blegtori —  
93-101;  
— baza ushqimore, foragje-  
ret dhe kullotat — 94,  
96, 97-98, 99, 267-268, 288-  
289, 390-391;*

— përmirësimi racor; lufta kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në blegtori — 94, 95-96, 319-320.

*Borgjezia* — 27, 148, 304-305.

*Bujqësia* në RPSSh — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Studimet dhe zbatimi i shkencës në bujqësi — 207-208, 287-290, 317-320;

— drithërat (gruri), perimet; pemëtaria, vreshtat — 1-2, 245, 252-253, 265, 320, 388-389, 402, 404, 405-406;

— toka, trajtimi shkencor; plehërimi — 317-318, 389-390;

— kuadrot, specialistët e bujqësisë; marrja e mendimit të specialistëve dhe këshillimi me ta — 1-2, 96, 277, 288, 289-290, 317-320, 394, 395.

*Eurokratizmi* dhe lufta kundër shfaqjere të tij — 18-19, 134-135, 332-333.

## C

*Centralizmi demokratik* — 18-19, 345.

## C

*Çmimet* — politika e Partisë në këtë fushë; çmimet e pro-

dhimeve bujqësore e blegtorale — 246-247, 251-252, 269-270, 273-274, 275.

## D

*Dallimet* në socializëm; ngushtimi i dallimeve thelbësore ndërmjet fshatit e qytetit — 151-152, 219-220, 277.

*Demokracia borgjeze* — 143.

*Demokracia socialiste* — thelbë i saj; liria e mendimit — 20-21, 136-137, 138, 147-151.

*Diktatura e proletariatit* — 140-141, 147, 153, 172-173, 230.

*Drejtimi dhe organizimi shkencor i ekonomisë* — 281-282, 342-348.

## E

*Eduktimi komunist, edukimi ideopolitik i masave* — 208-209, 343-345, 367-368.

*Efektiviteti i ekonomisë* — 67-68, 280.

*Ekonomia Popullore* — politika e Partisë për zhvillimin e saj dhe për harmonizimin e bujqësisë me blegtorinë — 50, 207-208, 279-280;

— vështirësitetë ekonomike dhe lufta për kapërcimin e tyre — 47-48, 83-90, 206;

— ekonomistët, financierët  
— 281, 345-346, 350-357.  
*Engels, Fridrik* — 10, 37, 38,  
314.

*Enver Hoxha* — të dhëna auto-biografike — 3, 22, 108, 167-  
-168, 200, 297, 301, 303.

*Estetika marksiste-leniniste* — e bukura në jetë dhe në art —  
305-306.

*Europa, «Europa e Bashkuar»*  
— 192, 194, 196-197, 229, 236.

**F**

*Financat, seksionet e finançës; kontrolli finanziar; për-  
puthja e planit finanziar me  
atë të prodhimit* — 257-264,  
345-346, 349-356.

*Franca; ngjarje nga historia  
e saj* — 27, 108-109.

*Fshatarësia kooperativiste,  
fshati socialist* — 101-104, 218,  
245-249, 252-253, 260, 263-  
-264, 279, 308.

*Fuqia blerëse e popullsisë;  
mbulimi i saj me mallra* —  
58, 245-249, 266, 267, 282-  
-283.

*Fuqia punëtore* — sigurimi  
dhe lëvizja qytet-fshat e saj  
— 401-402.

*Furnizimi, shpërndarja e pro-  
dukteve; stoqet dhe mallrat  
me qarkullim dhe konsum të*

*ngadalshëm* — 57-58, 282, 343,  
346.

**G**

*Gruaja* — emancipimi i saj —  
392.

*Grumbullimi, shitja dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore e blektorale* — 221-222.  
*Grupet armiqësore* në ushtri  
dhe në sektorin e nastës —  
15-16, 83-84.

**H**

*Historia e Shqipërisë* — 109.  
*Historia ushtarake* — 108-109,  
380-382.

**I**

*Industria e rëndë* — industria  
minerale dhe ajo mekanike —  
48-49, 209-210, 221.

*Shih edhe: Nafta dhe ga-  
zi...*

*Industria ushqimore* — 403-  
-404.

*Inteligjencia dhe lufta kundër  
shfaqjeve të intelektualizmit*  
— 327-328.

*Interesi i përgjithshëm* dhe  
interesi vetjak e lokal — 151,  
274-275, 276-277, 353.

*Internacionalja e Dytë* — 194-  
-195.

*Internacionalja e Tretë Komuniste (Komintern) — 25, 26-27, 38, 41, 374, 375, 376.*  
*Investimet; investimet në kooperativat bujqësore — 245, 246-247, 250, 257-261, 266, 271, 272-273, 275-277, 278, 284-285.*

**K**

*Kapitalizmi; degjenerimi i kulturës — 38, 57, 148, 301, 304-305, 373.*

*Kërkesa dhe oferta në socializëm — 57-58, 282-283, 346.*

*Këshillat popullore — komitetet ekzekutive, kryesitë, aparatet e tyre; kompetencat — 1, 17-19, 63-64, 65, 211, 252, 278, 292-293, 316-317, 346, 350, 354-355.*

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 3, 17, 59, 206-207, 210, 213, 214, 215-216, 217, 219-220, 221-222, 223, 224, 225-226, 248-249, 252, 255-256, 261, 273, 276, 277, 286.*

*Kina, Partia Komuniste e Kinës — maocedunideja, vija oportuniste dhe revizioniste; kongreset; fraksionet në parti — 7-12, 35, 37-38, 39-40, 43-44, 46-47, 72-85, 87, 156-*

- 182, 184-190, 197-198, 379; — gjendja e brendshme katolike, lufta e grupeve për pushtet; Revolucioni Kulturalor — 8-12, 153, 161-171, 174-175, 180-182, 189-190, 237, 240-241;
- strategjia dhe taktitat; politika e jashtme konkurrale; marrëdhëniet dhe kontradiktat me revisionistët sovjetikë; afritimi dhe kontradiktat me SIIBA — 32-33, 74, 75-77, 78-80, 81-83, 157-159, 161, 163, 165-166, 177-180, 185, 186-187, 189, 189, 191-204, 228-241, 378-382;
- kontradiktat, presionet që qëndrimet armiqësore ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 33, 40, 42-44, 47-48, 53-54, 55, 56-57, 71-91, 183, 184, 185, 188-189, 190-191, 192, 195-196, 199, 200, 230-231, 232, 233-234, 384;
- shtrembërimi i marksi-zëm-leninizmit dhe përpjekjet për të minuar e përcarë lëvizjet marksiste-leniniste, punëtore dhe të popujve të botës — 39, 40-41, 44, 177-180, 186-187, 190, 194-198, 202-204, 232, 369-385.

*Kinematografia dhe filmi në vendet borgjezo-rezisioniste* — 304-305, 309-310.

*Kinematografia, filmi në RPSSh dhe punonjësit e saj* — 296-304, 305-315.

*Klasa punëtore — roli udhëheqës dhe edukimi ideopolitik i saj* — 147-143, 359.

*Koha — shfrytëzimi me efektivitet i saj* — 336-337, 340.

*Komunisti — detyrat dhe të drejtat, roli pararojë; edukimi i tij* — 16, 110-111, 113, 262, 323-324, 333-334, 235, 336-337, 340.

*Kontradiktat në kapitalizëm* — 192-194, 373.

*Kontradiktat në socializëm* — 7, 230.

*Kontrolli i Partisë dhe i shtetit; kontrolli punëtor e fshatar* — 14, 97, 148, 220, 221, 257-258, 260, 263, 264, 353.

*Kooperativat bujqësore — politika e Partisë për forcimin e tyre të gjithanshëm* — 218-219, 246-249, 250, 270-279, 283-287;

— marrëdhëniet e tyre me shtetin — 243-244, 246-248, 257-267, 271, 272-279, 283-286;

— kooperativat bujqësore të tipit të lartë dhe shndërrimi i tyre në pro-

në të të gjithë popullit — 217-219, 242-249, 269-278, 283-287;

— finançat; të ardhurat, fondet, shpërblimi i punës — 243-245, 246-249, 250, 257-267, 270-277, 283-285, 350-354, 355-357, 401;

— administrimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e prodhimeve bujqësore — 264-266;

— tuftëzimi i bagëtive të oborreve kooperativiste; trajtimi dhe mbarëshimi i tyre — 93-104.

*Kostoja e prodhimit dhe domosdoshmëria e uljes së saj* — 18, 281, 346.

*Kuadrot, specialistët — politika e Partisë me kuadrin; përgatitja dhe edukimi ideopolitik i tyre* — 125-126, 213-214, 348, 368, 393;

— zgjedhja dhe vendosja e tyre; marrëdhëniet kuarder-masë; qarkullimi i kuadrore — 16-17, 213-214, 289-290;

— rolli dhe detyrat e tyre në zberthimin dhe zbatimin e direktivave e të materialeve të Partisë — 118, 119-120, 121-122, 126-127, 293-294, 324-333, 338, 339.

Kulti i individit dhe lufta kundër tij — 181, 199-200.

Kultura në RPSSh — marrëdhëniet kulturore me vendet e tjera — 52, 301, 314.

Kushtetuta — Projektkushtetuta e RPSSh — 20-23, 136-155.

Kushtetutat e vendeve borgjezo-revizoniste — 148.

Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor, deputetët — 20, 22-23, 136, 138, 221.

## L

Lenin, Vladimir Il'iç — 10, 26, 35, 37, 38, 39, 41, 47, 81, 97, 148, 150-151, 159, 161, 162, 163, 168, 169, 171, 172-173, 175, 188, 194, 196, 200-201, 203, 228, 314, 371, 372, 374, 375, 376, 379, 380, 381, 382.

Letërsia dhe artet në RPSSh; roli i tyre në edukimin komunist të masave — 301, 302-303, 309-312, 313-314;

— përbajtja dhe forma, partishmëria, pasqyrimi i realitetit, lidhjet me masat — 297-298, 301-304, 305-310, 311-312, 314;

— artistët dhe punonjësit e tjerë të arteve. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve — 298-302, 303,

301, 306-309, 310-314, 399-400.

Levat ekonomike — 218-219, 273, 346.

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare — strategjia dhe taktikat. Lufta e saj kundër imperializmit, borgjezisë dhe reaksionit — 25-26, 47, 361-302;

— mbledhjet, takimet, shkëmbimi i mendimeve ndërmjet partive marksiste-leniniste — 25-26, 28-29, 30-32, 35-36;

— mbledhjet e Moskës të viteve 1937 dhe 1960 dhe Mbledhja e Bukureshtit e vitit 1960 — 73, 74-77, 157-158, 186-187;

— parimet dhe normat e partive marksiste-leniniste; lufta kundër frakSIONeve — 7, 37;

— solidariteti dhe përkrahja internacionliste e partive marksiste-leniniste për PPSH — 20, 30-31, 129-130, 190, 203-204;

— partitë komuniste marksiste-leniniste të Amerikës Latine — 40, 199, 203-204;

— Partia e Punës e Koresë, Partia e Punonjësve të Vietnamit dhe Partia Po-

pullore e Laosit — 31;  
 — përhapja e revizionizmit  
 në gjirin e partive marksiste-leniniste; diferenci  
 mi dhe përcarja në ra-  
 dhët e tyre — 32, 33, 190,  
 197-198, 369-370, 377, 384-  
 -385.

*Lëvizjet dhe luftrat revolu-  
 cionare e përparimitare të po-  
 pupuje — 142, 148.*

*Ligjet, zbatimi i tyre — 19,  
 153, 262.*

*Ligji i vlerës në socializëm —  
 275, 346.*

*Liria, pavarësia, sovraniteti  
 kombëtar — 142-148.*

*Lufta Antifashiste Nacional-  
 çlirimtare e popullit shqiptar;  
 përvoja, mësimet — 109, 359.  
 Lufta e Parë Botërore (1914—  
 —1918); Lufta e Dytë Botëro-  
 re (1939—1945) — 193-194, 380-  
 -382.*

*Lufta e klasave në kapitali-  
 zëm — 229-230.*

*Lufta e klasave në socializëm  
 — 173-177, 231.*

*Lufta, kuptimi marksist-leni-  
 nist i saj. Shkaktarët e shpër-  
 thimit të luftrës; armatimi —  
 193-197, 229-230, 235-236,  
 237, 238-239.*

**M**

*Marksizëm-leninizmi — armë  
 dhe busull për udhëheqje e  
 veprim; studimi dhe mbrojtja  
 e tij — 7, 10-11, 37, 141-142,  
 208-209, 314, 371-372, 374-  
 -375, 376, 380-382.*

*Marks, Karl — 10, 37, 38, 39,  
 151, 161, 200, 228, 314.*

*Marrëdhëniet socialiste në  
 prodhim; marrëdhëniet e pro-  
 nësisë — 151-152, 217-219, 242-  
 -245, 247-248, 277-278, 283-  
 -287.*

*Mbrojtja e atdheut — forcimi  
 i gatishmërisë së popullit, të  
 ushtrisë dhe të të gjithë ven-  
 dit për mbrojtje — 105-111,  
 144-145, 150, 362-364.*

*Ministratë dhe kuadrot e tyre;  
 kompetencat — 213, 250, 256;*

— Komisioni i Planit të  
 Shtetit — 213, 250, 287;

— Ministria e Financave —  
 250, 287, 355;

— Ministria e Industrisë  
 dhe e Minierave — 17,  
 222, 287;

— Ministria e Bujqësisë —  
 211, 269, 278, 286, 288,  
 289, 290, 320, 322, 355;

— Ministria e Ndërtimit —  
 222-223, 249, 287;

— Ministria e Arsimit dhe

e Kulturës — 52, 223,  
299, 300.

*Mirëgenia* në shoqërinë tonë  
socialiste — 249, 278-280.

## N

*Nafta* dhe *gazi* — studimet  
dhe shpim-kërkimet për naftë  
dhe gaz — 15-17, 48, 207, 213.  
*NATO* (Organizata e Traktatit  
të Atlantikut Verior) — 191,  
229-230.

*Ndërmarrjet* socialiste — 343,  
344, 345-346;  
— ndërmarrjet bujqësore —  
270, 271, 321, 354-355.

*Ndërtimet* në RPSSh — studimi  
dhe kontrolli i preventivave  
dhe i normave të materialeve  
të ndërtimit — 222-223,  
249-250;

— ndërtimi i porteve (porti  
i ri i Vlorës) — 66-70.

*Ndërtimi* i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për  
ndërtimin socialist të vendit.

*Parime, ligje, karakteristika* të  
përpjithshme — 132, 140-142,  
147-149, 151-153, 277, 279,  
299.

## O

*Organet shtetërore; kompeten-*  
cat — 220, 221, 224, 343-345,  
348.

*Organizata-bazë* e Partisë —  
roli i saj udhëheqës; sekretari  
i saj — 291-292, 337-338,  
340;

— mbledhjet, gjallërimi dhe  
revolucionarizimi i tyre.  
Puna me vendimet dhe  
me direktivat e Partisë —  
108, 111-113, 119, 120,  
122, 123, 132, 323-333, 366-  
339, 396-397;

— roli i saj për edukimin  
dhe kalitjen revolucionare  
të komunistëve; puna  
me organizatat e masave —  
335, 364-365, 366;

— demokracia e brendshme  
në Parti; kritika dhe auto-  
kritika, pyetjet, diskutimet —  
326-333, 335-338,  
357;

— organizatat-bazë në sektorin  
e naftës, në kooperativa  
bujqësore dhe në  
institucione kulturore e  
artistike — 14, 16, 262-  
263, 297, 320.

*Organizatat e masave; bash-*  
këpunimi dhe bashkërendimi  
i punës *ndërmjet* tyre — 293,  
337-338, 364-365, 368, 396-  
397.

## P

*Paga, shpërblimi* i punës —  
261-262, 263, 273, 321.

- Paraja, qarkullimi monetar —** 245-246, 266-267, 273, 282-283.
- Partia e Punës e Shqipërisë — marrëdhëniet me partitë komuniste marksiste-leniniste —** 28-29, 36-37;
- lufta për demaskimin e revizionizmit sovjetik dhe të revolucionistëve të tjerë modernë — 11, 44-45, 46, 76, 77-78, 187-188;
  - marrëdhëniet, kontradiktat me Partinë Komuniste (revolucioniste) të Kinës dhe lufta për demaskimin e saj — 11-12, 30, 33-35, 37, 44-45, 46-47, 71-88, 183-184, 185, 187-189, 190-192, 195-197, 200, 228-231, 369-385.
- Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe**
- Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 21, 25, 26, 28, 29, 30, 32, 34, 37, 38, 39, 45, 58, 85, 86-87, 115-123, 126-127, 128-129, 137, 138, 183, 190, 198, 200, 205-206, 208-209, 228, 230, 280, 287, 323-326, 360, 372;
  - Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ — 2-4, 18, 20, 60, 71-72, 84, 91, 97, 116-117, 119, 120, 124, 136, 138, 200, 205-227, 242, 259, 261, 266, 294-295;
  - aparati i KQ të Partisë dhe instruktorët — 13, 130, 209, 211-212, 216, 249, 276, 367;
  - komitetet e Partisë në rrethe, plenumet dhe sekretarët; zgjedhja e organeve udhëheqëse lokale — 6, 13, 64-65, 96-97, 106, 112, 115-117, 118, 120-121, 122, 123, 124-125, 130, 132, 212-213, 216-217, 220, 228, 262-263, 264, 291, 292-294, 358-359, 367;
  - organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve të Tiranës (të rajoneve të Tiranës) e të Vlorës dhe të Hidrocentralit të Fierzës — 13-14, 128-129, 223, 226-227, 337, 340-341, 356-357, 387;
  - komitetet e Partisë të rretheve të Fierit, të Lushnjës, të Gjirokastrës dhe të Sarandës — 93, 224-225, 292, 316-317, 319-320;
  - komitetet e Partisë të rretheve të Shkodrës, të Kukësits dhe të Lezhës — 107, 224-225, 319-320;

- organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri dhe në terren; lidhja dne bashkëpunimi ndërmjet tyre — 105-107, 110-114, 291;
- aparatet e komiteve të Partisë në rrethe dhe instruktorët e tyre — 4-5, 13, 64-65, 124-125, 128-129, 338-339, 340;
- materialet, studimet për organet udhëheqëse të Partisë — 4-5, 17, 83, 205-227, 242-243, 250-252, 254, 294-295.

*Partia e Punës e Shqipërisë — përvoja dhe masat e saj përt'i prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri dhe përtë qasparë para ndërtimin e socializmit — 140-142, 150-151, 154-155, 333.*

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhejeta e brendshme*

- roli udhëheqës i Partisë — 21, 140, 141;
- vija, vendimet, direktivat; studimi, zbërthimi dhe zbatimi i tyre — 3-6, 12, 115-123, 187, 200-204, 224, 230, 231, 233, 241, 323-327, 367;
- shtimi i radhëve të Par-

- tië, pranimet në Parti — 60, 61-62;
- metoda dhe stil i punës; organizimi dhe drejtimi; puna e Partisë — 2-6, 13-14, 112-114, 115-123, 124-135, 323-326, 336-339;
- lidhjet me masat dhe me bazën — 61-62, 124-129, 130, 133, 134, 253;
- studimi dhe zbërthimi i materialeve të Kongresit VII të Partisë. Format e edukimit. Informacioni në Parti — 12, 45, 46, 107, 115-123, 126-129, 130, 133, 228-231, 253-254, 323-327, 333, 334-330, 360, 365, 395-396;
- aktivet, mbledhjet e Partisë — 112-113, 118-121, 122, 332, 334;
- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve; qëndrimi ndaj të përjashtuarve nga Partia — 133-133, 224-225, 330-331.

*Partia Komuniste e Australisë (marksiste-leniniste) — pikëpamjet dhe devijimi revolucionist i saj — 24-40, 41-42.*

*Partia Komuniste e Polonisë — pikëpamjet dhe devijimi revolucionist i saj — 369-385.*

*Partia Komuniste Portugaze (e Rindërtuar) — 40, 129.*

*Planifikimi — politika e Partisë në fushën e planifikimit; metodologja e planifikimit — 343-348, 351-352;*

- lufta për plotësimin e planeve; planifikimi dhe realizimi i planeve në kooperativat bujqësore — 48-49, 205-208, 270, 277-278, 294-295, 342-348, 349-357, 406.

*Politika e jashtme parimore e RPSSh — 35, 55, 142-147, 151, 200-204, 228-230, 371-383;*

- lufta për demaskimin e superfluiteve, imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 35, 79-80, 195-196, 233-234;
- solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për popujt e botës — 34, 35, 142-143, 145, 195, 202-204;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Kinës — 53-55, 81-83, 88-92, 189, 191, 195-196, 198-199;
- rritura e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe të RPSSh në botë. Të huajt, miqtë për Shqipërinë — 22, 51, 129-130, 131, 301.

*Politika ekonomike e Partisë — 274-275, 343-344.*

*Politika në plan të parë — trajtimi i problemeve me syrin politik — 4, 301-302, 343-344, 361, 363-364.*

*Populli shqiptar — cilësitet, vitytet moralo-politike. Të dhëna demografike — 131, 145, 155, 220.*

*Propaganda, agitacioni. Propaganda për botën e jashtme — 45-46, 52, 129-130, 133, 314.*

*Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizonist — 39, 41, 44, 78-79, 131, 150, 234-235, 236-237, 371, 382.*

*Propaganda dhe shtypi marksist-leninist dhe ai përparimtar botëror — 21-22, 51, 129-130.*

*Prona e gjithë popullit; prona e grupit (kooperativiste); formimi dhe mbrojtja e tyre — 100-101, 151-152, 265, 285-286;*

- oborri kooperativist dhe përdorimi i tokave që si-gurohen nga shkurtimi i tij — 101-104;
- prona vetjake — 152.

*Pushteti popullor — karakteri demokratik, pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit. Kompetencat e tij — 147-148, 292.*

*Shih edhe: Organet shtetërore...*

**R**

*Rendi ekonomik socialist — 151-152.*

*Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — kujdesi i Partisë për rininë; edukimi ideopolitik, kulturor dhe shkencor i saj; aksionet e rinisë — 215, 358-368.*

**RR**

*Rrethimi, blokada e presioni borgjezo-revizonist dhe lufta për përballimin e tyre — 42-46, 47-48, 50-52, 84-85.*

**S**

*Socializmi — 154, 162, 171, 172-174, 175, 177, 201.*

*Stacionet e makinave dhe të traktorëve — 218, 285-286.*

*Stalin, Josif Visarionovic — 10, 26, 27, 37, 38, 41, 73, 74, 81, 157, 159, 160, 161, 162, 163, 165, 168, 169, 170, 173, 176, 177, 180, 181, 185, 186, 187, 188, 193, 194, 218, 219, 243, 246, 273, 286, 297, 303, 314, 371, 374, 376, 380, 381, 382.*

*Superfuqitë — 142, 192-193, 195-196.*

**SII**

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme*

*hegjemoniste dhe e lufës; afërimi me Kinën — 144, 192-193, 234-238, 239.*

*Shtypi në RPSSh — 127-128, 129-130, 131.*

**T**

*Televizioni shqiptar dhe punonjësit e tij — 129, 296, 298-301, 312-315.*

*Teoritë borgjezo-revizoniste dhe kritika ndaj tyre — 24-47, 141-142, 150, 156-180, 230;*

*— të revizionistëve sovjetikë dhe të revizionistëve të tjera modernë — 143, 150, 170;*

*— revizionistëve kinezë për revolucionin dhe luftën e klasave, për rolin e proletariatit e të fshatarësisë, për pluralizmin politik e ideologjik — 5, 8-9, 10-11, 37-38, 39-40, 159-172, 173-177, 231;*

*— teoria e «tri botëve» dhe për mbështetjen në një imperializëm për të luttuar tjetrin — 33-35, 79-80, 160, 173-180, 191-197, 199, 200-203, 228-230, 232-241, 371-383, 385.*

*Të drejtat dhe detyrat e qytetarëve — 149-150, 151.*

*Traktati i Varshavës — 195,  
229-230.*

*Tregtia e brendshme; tregtia  
shtetërore; furnizimi i popull-  
sisë — 266-267, 329-330.*

*Tregtia e jashtme dhe puno-  
njësit e saj; eksporti, importi  
— 48-49, 52-57, 58-59, 88-91,  
322.*

## U

*Ushtria Popullore; roli udhë-  
heqës i Partisë. Kuadrot e saj.*

*Forcimi i lidhjeve dhe i bash-  
këpunimit ushtri-terren —  
105-114, 333.*

## V

*Vendet revizioniste, degjene-  
rimi i tyre kapitalist — 56-57.*

*Vigjilencia revolucionare — 91-  
-92.*

*Vija e masave — tërheqja e-  
mendimit të masave — 20-21.  
136-137, 138.*



## TREGUESI I ENRAVE

### A

Alia, Ramiz — 24, 73, 76, 121,  
130-131, 228, 251, 252, 350,  
354, 394, 396.

Asllani, Tare — 400.

### B

Balluku, Beqir — 83-84.  
Bariu, Laver — 400, 402.  
Bonaparti, Napoleon — 108,  
109.  
Bruçaj, Ismet Sali — 386.  
Brunsvik, Karl — 108.  
Bugurjek — 108.  
Bulganin, Nikolai — 187.

### C

Çarçanlı, Adil — 84, 85, 86,  
249.  
Çan Kai Shi — 11, 166.  
Çaushesku, Nicolae — 83, 85.  
Çembörlen, Nevil — 381.  
Çu En Lal — 9, 10, 32-33, 39,  
77, 78, 80, 83, 84-85, 158, 159,

175-176, 181, 189, 190, 191,  
198, 234, 238, 384.

### D

Dë Mil, Sesil Blount — 309-  
-310.  
Dimitrov, Gjergj — 26-27, 38.  
Dodbiba, Pirro — 218, 239,  
289.  
Dyklo, Zhak — 27.

### F

Ford, Xherald — 234, 235.  
Franko, Françisko — 198.  
Frashëri, Abdyl — 399.  
Frashëri (vëllezërit ~) — 399.

### G

Gën Biao — 379, 380.  
Gierek, Eduard — 380, 382,  
385.  
Gomulka, Vladislav — 385.

### H

Hoxha, Nexhmije — 307.

Hill, Eduard — 24-42, 46-47,  
190, 369, 377, 384, 385.

Hitler, Adolf — 193, 381.

Ho Shi Min — 83.

Hrushov, Nikita — 33, 34, 72,  
73, 74, 75, 76, 77, 78, 157,  
158, 161, 163, 165, 167, 168,  
183, 186, 187, 188, 191, 377.

Hua Kuo Fen — 10, 39, 156,  
158, 159, 180, 181, 189, 240,  
377.

## I

Isai, Hekuran — 22, 125, 254,  
267, 350, 386-388, 389, 391,  
392-394, 395-396.

## J

Jui Gun — 11.

## K

Kapo, Hysni — 60-61, 74-75,  
76, 100, 122, 129, 131, 133-  
134, 255, 258, 268, 358, 360,  
361.

Koleka, Spiro — 80.

Kan Shen — 76-77.

Kautski, Karl — 73-74.

Kerenski, Aleksandér — 381.

Kellezi, Abdyl — 256.

Kisinger, Henri — 84, 158,  
234-235.

Kondo, Anastas — 297.

Kopo, Duro — 398-399, 400-  
401, 402, 404.

Kosigin, Aleksei — 191.

Kristo, Spiro — 400, 401, 404,  
405.

## L

Lengo, Spiro — 98.

Li Hsien Nien — 39, 82, 91.

Lin Biao — 9, 11.

Liu Shao Ci — 10, 11, 73, 79,  
80, 84, 156, 181.

Longo, Luixhi — 27.

Luigji i 14-të — 108.

## M

Mihali, Qirjako — 323, 333,  
340.

Murra, Prokop — 15, 16, 17,  
254, 255, 257, 258, 260, 262,  
263, 265, 349, 350, 354, 356,  
388.

Malenkov, Georgi — 187.

Manushi, Violeta — 312.

Mao Ce Dun — 9-10, 11, 37-  
38, 39, 73, 74, 75, 78, 80,  
81, 83, 84, 156, 157-158,  
159, 160, 161-165, 166, 167,  
168-169, 170, 171-172, 173,  
174-175, 176-177, 178-179, 180,  
181, 182, 184, 185, 186-187,  
188, 189, 190, 193, 200, 234,  
238, 371, 372, 373, 375, 376,  
377, 382, 383, 384, 385.

Marshe, Zhorzh — 385.

Marti, Fransua — 27.

Mijal, Kazhimiezh — 369, 370,  
371, 372-381, 382-383, 384,  
385.

Mikojan, Anastas — 73-74, 187.

Moisiu, Spiro — 403.

Molotov, Viaçeslav — 73, 157,  
187.

### N

Nikson, Riçard — 83, 84, 158,  
179, 191, 234.

### P

Peristeri, Pilo — 123.

Peçi, Shefqet — 400.

Pen Çen — 75, 181.

Pinoçet, Augusto — 198, 199,  
373.

Polit, Harri — 27.

Prosi, Sandër — 307.

### R

Raidhi, Pandi — 308.

Ramo — 400.

### S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti  
— 109.

Suharto — 198.

### SH

Shamblli, Peti — 321.

Sharki, Lorens — 27, 385.

Shlezinger, Xhejms — 234.

Shtylla, Behar — 72, 73.

### T

Tashko, Koço — 164.

Ten Hsiao Pin — 9, 10, 75-76,  
84, 159, 181, 189, 372.

Tito Josip Broz — 34, 74, 79,  
82, 83, 85, 170, 202, 377.

Toliati, Palmiro — 27.

Torez, Moris — 27.

### TH

Theodhosi, Koço — 256.

Thomai, Themije — 289.

### V

Vilar, Klod — 108.

Vilhelmi II — 194, 381.

### ZH

Zhivkov, Todor — 385.

Zhyrke, Zhak — 190, 369, 377,  
384, 385.



## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA

### A

- Afrikë — 144, 193, 375.  
Akademia e Shkencave e RPSSh — 254.  
Alipostivan (Përmet) — 400.  
Ambasada e RP të Kinës në Shqipëri — 377.  
Amerika Latine — 144, 190, 193, 375.  
Arabia Saudite — 373.  
Arkivi Qendror i PPSh — 82.  
Australi — 38, 190, 193, 369.  
Austri — 196, 381.  
Azil — 144, 193, 375.

### B

- Ballkan — 57.  
Banka e Shtetit Shqiptar — 258, 287.  
«Beni ecën vetë» (filmi ~) — 308.  
Birmani — 179.  
Brazil — 373.  
Britania e Madhe — 193, 194, 196.  
Bukuresht — 157.

### C

Çarshovë (Përmet) — 403.

Çekosllovaki — 56, 144.

Çukë (Sarandë) — 265.

### D

- Dajt (mali ~) — 250.  
Deklaratat e përbashkëta shqiptaro-kinezë — 82-83.  
Dibër — 265.  
«Dimri i fundit» (filmi ~) — 301.  
Dishnicë (Korçë) — 405.

### E

Ersekë — 401.

### F

- Fabrika e Përpunimit të Frutave dhe të Perimeve, Përmet — 402, 403.  
«Fatet historike të doktrinës së Karl Marksit» (V. I. Lenin, vepra ~) — 159.  
Fier — 67, 318-319, 320.  
Frashër (Përmet) — 398-399.

**G**

Greqi — 404-405.  
 Guomindan (Partia Naciona-  
 liste) — 172.

**GJ**

«Gjenerali i ushtrisë së vde-  
 kur» (filmi ~) — 301.  
 Gjermani — 194, 381.

**H**

Hanët (kombësia ~, Kinë) —  
 170.

Hidrocentrali i Fierzës [Hi-  
 drocentrali «Drita e Partisë»]  
 — 3, 214, 222, 386-387.

Hidrocentrali i Komanit [Hi-  
 drocentrali «Enver Hoxha»] —  
 215.

HSINHUA (Kina e Re) — 39,  
 382.

**I**

«Illegalët» (filmi ~) — 309.

Indi — 237.

Indonezi — 198.

Instituti i Historisë, Tiranë —  
 399.

Instituti i Kërkimeve Bujqë-  
 sore, Lushnjë — 289.

Instituti i Lartë Bujqësor, Ti-  
 ranë — 289-290.

Instituti i Studimeve Ekono-

mike, Tiranë — 269, 287.

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të  
 PPSH — 209, 254.  
 Iran — 373.  
 Itali — 27.  
 Izrael — 199.

**J**

Japoni — 165, 179, 237.  
 Jenan (Kinë) — 160.  
 Jon (deti ~) — 297.

**K**

Këlcyrë (Përmet) — 401, 405.  
 Këneta e Kakariqit — 321.  
 Kili — 373.  
 Kinostudio «Shqipëria e re»,  
 Tiranë — 297, 298, 309.  
 KNER (Këshilli i Ndihmës  
 Ekonomike Reciproke) — 195,  
 229.

Kolonjë — 399, 401.  
 Komisioni i posaçëm për har-  
 timin e Projektkushtetutës së  
 RPSSh — 136, 138.  
 Konferanca e Parë e Vendit e  
 PKSh (17-22 mars 1943) —  
 164.

Konfucizmi — 237.  
 Kongresi i 20-të i Partisë Ko-  
 muniste (revisioniste) të BS  
 (1956) — 156-157, 186.  
 Kongresi i 22-të i Partisë Ko-

muniste (revisioniste) të BS (1961) — 32, 77-78.  
 Kooperativa bujqësore «Agimi», Fier — 276.  
 Kooperativa Bujqësore e Ball-drenit, Lezhë — 321.  
 Kooperativa Bujqësore e Dëshnicës, Korçë — 355.  
 Kooperativa Bujqësore e Djakës, Lushnjë — 284.  
 Kooperativa Bujqësore e Strovës, Pogradec — 268.  
 Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Shijakut, Durrës — 218.  
 Korçë — 399, 401, 403.  
 Kore — 237.  
 Kosinë (Përmet) — 400.  
 Kosovë [Kosovë-Gostnisht] (Përmet) — 400.  
 Krujë — 250.  
 Ksamil (Sarandë) — 265, 298.  
 Kukës — 225, 367, 393-396.

**L**

Letra e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK të Kinës (8 dhjetor 1976) — 87, 91.  
 Leusë (Përmet) — 404.  
 Lezhë — 321-322.  
 Librazhd — 319.  
 Liceu francez i Korçës — 108.  
 Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881) — 399.  
 Lindja e Mesme — 144.

Londër — 24, 29, 38.  
 Lufta (beteja) e Vaterlosë (1815) — 108.  
 Lufta e Spanjës (1936—1939) — 27.  
 «Lulëkuqet mbi mure» (filmi ~) — 301, 308.  
 Lushnjë — 292.

**M**

Mallakastër (Fier) — 317.  
 «Marshimi i Madh» në Kinë (1934—1936) — 160.  
 «Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore» (Mao Ce Dun) — 156-157, 158-160, 162-174, 177-178, 180.  
 Moskë — 75, 158, 191, 297.  
 Muzeu i vëllezërve Frashërl, Frashër — 398, 399.

**N**

Ndërmarrja Bujqësore, Përmet — 400.  
 Ndërmarrja e Farérave, Tiranë — 289.  
 Ndërmarrja e Furnizimit Materialo-teknik, Durrës — 255.  
 «Në fillim të verës» (filmi ~) — 307.

**O**

Odriçan (Përmet) — 400.  
 Okinava (ishujt ~, Japoni) — 170.  
 Oqeani Paqësor — 237.

Organizata e Kombeve të Bashkuara — 198.

P

Paqja e Brest-Litovskit (1918)

— 380-381.

Paris — 24.

Pekin — 10, 38, 71, 72, 73, 91,  
183, 191, 232, 369, 370.

«Përballimi» (filmi ~) — 301.

Përmet — 399-406.

Pogradec — 268.

Poloni — 369.

Porti i Durrësit [Porti detar i

Durrësit «Enver Hoxha»] —  
67, 69, 255, 256.

Portugali — 129.

Pukë — 392.

Q

Qyteti Stalin — 15, 67.

R

Radio Moska — 382.

Radio Varshava — 382.

Radio «Zëri i Evropës së lirë» — 382.

Revolucioni Demokratiko-Borqez Francez (1789—1794) — 108.

Revolucioni i Madh Socialist i Tectorit (1917) — 160.

Rusi — 196.

RR

«Rrugë të bardha» (filmi ~)

— 301.

S

Sarandë — 224.

Siberi — 81.

Spanjë — 27.

SH

«Shkenca dhe jetë» (revisita ~) — 361.

Shkodër — 68, 321.

Shkolla e Lartë e Partisë «V.I. Lenin», Tiranë — 125, 126; 209.

T

Tajvan (ishulli ~) — 82, 83,  
179, 198.

Teatri «Balshoj», Moskë — 303.

«Tinguj lufte» (filmi ~) — 301, 309.

Tiranë — 24, 227, 250, 341,  
401.

«Traktati i mossulmimit sovjeto-gjerman» (gusht 1939) — 381-382.

Traktati i Munihut (1938) — 381.

Tregu i Përbashkët Evropian — 192, 194, 229.

Tropojë — 388-392.

**U**

Uashington — 235.

«Udhëtim në pranverë» (filml ~) — 298.

Universiteti Shtetëror i Tiranës [Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha»] — 126, 223.

Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës, Ballsh — 55, 222.

**V**

Varshavë — 158, 369.

Vatikan — 380.

Vietnam — 83, 179-180, 237.

Vlorë — 13, 307, 349.

Vuno (Himarë) — 298.

**Z**

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 128, 129.

«Zonja nga qyteti» (filmi ~) 301, 312.



## LE N D A

PARATHËNIE PËR VELLIMIN E 60-TE ..... V-IX

1976

BAZA KA MUNDËSI T'I ZBËRTHEJË VETË DIREKTIVAT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (4 dhjetor 1976) .....	1—12
PROBLEMET STUDIOHEN E ZGJIDHEN ME MASA TË KOORDINUARA — Shënimë (6 dhjetor 1976) .....	13—14
KOMUNISTËT NË SEKTORIN E NAFTËS NUK JANË VETËM ZBATUES, POR EDHE VËZHGUËS E KËRKUES — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (10 dhjetor 1976) .....	15—19
KUSHTETUTA E RPSSH — VEPER E MADHE E PARTISE DHE E POPULLIT — Fjala në mbledhjen e fundit të komisionit të posaçëm për hartimin e Projektkushtetutës së RPSSH (15 dhjetor 1976) .....	20—23
AGJENTËT E KINËS PO I NXJERRIN VESHËT — Shënimë (16 dhjetor 1976) .....	24—49
PROBLEMET ZGJIDHEN ME STUDIM TË THELLË E JO ME FJALË TË PERGJITHSHME — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 dhjetor 1976) .....	50—59

MENDIMI I MASËS — DOMOSDOSHMËRI PËR PRANIMET NË PARTI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 dhjetor 1976) .....	60—62
HALLKAT E TEPERTA PENGJNË ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 dhjetor 1976) .....	63—65
NE NDËRTIMIN E PORTIT TË RI TË VLORES TË MBAHEN PARASYSH NEVOJAT E EKONOMISE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 dhjetor 1976) .....	66—70
NUK JEMI NE ATA QË SULMOJNË PARTINË KOMUNISTE TË KINËS, POR JANË UDHEHEQËSIT E SAJ QË SULMOJNË PARTINË TONË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 dhjetor 1976) .....	71—92
TUFËZIMI I BAGËTIVE BËHET PËR TË PËRMI-RESUAR JETESËN E KOOPERATIVISTËVÉ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1976) .....	93—104
TË SIGUROHET KURDOHERË NJË BASHKËPUNIM I PERSOSUR MIDIS TERRENIT DHE USHTRISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1976) .....	105—114
ZBËRTHIMI I MATERIALEVE TË KONGRESIT KËRKON PUNË KRIJUESE E THELLIM SHKEN-COR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 dhjetor 1976) .....	115—123

KONTAKTI ME BAZËN E GJALLERON MË TE PËR UDHËHEQJEN — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (24 dhjetor 1976) .....	124—135
KUSHTETUTA E VENDIT TONE SOCIALIST ëSHTË SHPREHJE E VULLNETIT TË POPULLIT — Fjala në mbledhjen e Kuvendit Popullor të RPSII (27 dhjetor 1976) .....	136—155
DISA MENDIME RRETH «DEKALOGUT» BALLIST TË MAO CE DUNIT — Shënime (28 dhjetor 1976) .....	156—182

## 1977

REVIZIONISTËT KINEZË SULMOJNË PRAPAT KRAHËVE PARTINË E PUNËS TË SHQIPËRISË — Shënime (8 janar 1977) .....	183—204
DUKE PASQYRUAR THIELLË REALITETIN, TË PERCAKTOJMË DETYRA DHE MASA KONKRETE — Shënime (14 janar 1977) .....	205—227
CILAT JANE KONTRADIKTAT PARIMORE QË KEMI ME KINEZËT — Shënime (14 janar 1977) .....	228—231
PSE KËTO VARIACIONE NË STRATEGJINË KINEZE? — Shënime (16 janar 1977) .....	232—241
PËR PROBLEMET QË DO TË DISKUTOJMË, TË BËHEN STUDIME TË THELLA — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 janar 1977) .....	242—254

TË ARDHURAT E KOOPERATIVISTËVE SHTOHEN DUKE RRITUR PRODHIMIN — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (28 janar 1977) .....	255—268
NE KOOPERATIVAT BUJQESORE TË TIPIT TE LARTE KËRKOHEN NJË PUNË MË E THELLË SHKENCORE, DREJTIM DHE KONTROLL MË I MIRE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 shkurt 1977) .....	269—290
DUKE USHTRUAR DREJT KOMPETENCAT E DHE-NA NGA PARTIA, ZBATOHET VIJA E SAJ — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 shkurt 1977) .....	291—295
KINEMATOGRAFIA E TELEVIZIONI U BËJNË NJË SHËRBIM TË MADH PARTISË, POPULLIT, INTERNACIONALIZMIT PROLETAR — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 shkurt 1977) .....	296—315
KUR NIHEN KONKRETISHT PROBLEMET, NXIRREN KONKLUZIONE TË DREJTA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 shkurt 1977) .....	316—322
SI TI BËJMË MË REVOLUCIONARE MBLEDHJET E PARTISË — Nga biseda me shokun Qirjako Mihali (7 shkurt 1977) .....	323—341
PRIRJA PËR TA REALIZUAR PLANIN VETËM NË GLOBAL ËSHTË E DËMSHME — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (10 shkurt 1977) .....	342—348

PLANI FINANCIAR TË BËHET KRAHAS ME PLANIN E PRODHIMIT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (12 shkurt 1977) .....	349—357
PARTIA KA NEVOJË PËR GJAK TË RI, PËR NJERËZ TË ZOTË E PLOT ENERGJI QË TË DREJTOJNË PUNËN — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (14 shkurt 1977) .....	358—368
«AVOKATI» SHARLATAN I VIJËS SË KRIMBUR KINEZE — Shënimë (14 shkurt 1977) .....	369—385
T'I DUAM, T'I VLERËSOJMË E TË PUNOJMË NJËLLOJ SI PËR BLEGTORINË DHE PËR BUJOËSINË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (21 shkurt 1977) .....	386—397
ZHVILLONI MË TEJ TRADITAT E MIRA TË PERMETIT — Bisedë në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (25 shkurt 1977) .....	398—406
Treguesi i lëndës .....	409
Treguesi i emrave .....	423
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	427